



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport për auditimin e ushruar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

“MBI PËRPUTHSHMËRINË”

NË INSTITUTIN E SIGURIMEVE SHOQËRORE

Tiranë, Korrik 2022

Nr.Përmbajtja	Faqe
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	3
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	7
II. HYRJA	
1. Objekti i auditimit.....	9
2. Qëllimi i auditimit.	9
3. Identifikimi i çështjes.....	9
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9
5. Përgjegjësitë e audituesve.....	9
6. Kriteret e vlerësimit.....	9
7. Standardet e auditimit.....	11
8. Metodatat e auditimit.....	11
9. Dokumentimi i auditimit.....	11
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	
1.Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	12
2.Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	12
2.1 Auditimi i administrimit të sigurimeve shoqërore dhe politikave të pensioneve në drejtim të mbulimit të popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore (akordimi i përfitimeve për pension, paafësi të përkohshme në punë, barrë lindje, aksidente në punë dhe sëmundje profesionale e përfitime suplementare në momentin e lindjes të së drejtës dhe nevojës për to); rritjes e numrit të kontribuuesve; përmirësimi i efijencës në menaxhimin e fondeve përkohësisht të lira dhe fondit rezervë.....	12
2.2 Auditimi i planifikimit dhe realizimit të buxhetit të sigurimeve shoqërore për vitin 2021, për sigurimin e detyrueshëm, sigurimet suplementare dhe programet kompensuese e shpërblimet në drejtim të grumbullimit të ardhurave; realizimit të shpenzimeve; analizimit të deficiti i skemës së pensioneve; analizimit të niveli i borxhit ndaj skemës së pensioneve dhe entitetet problematike; analizimit të listë pagesave të kontributeve; bashkëpunimit me institucionet.....	29
2.3 Auditimit funksionimit të strukturave të kontrollit në drejtim të inspektimit të pensioneve dhe auditimit të brendshëm.....	54
2.4 Auditimi i prokurimeve publike për mallra, punë e shërbime dhe përputhshmëria e transaksioneve që lidhen me to, në përputhje me legjislacionin në fuqi.....	69
2.5 Auditimi i administrimit të burimeve njerëzore, rekrutimet, largimet, ndjekja e procedurave...78	78
2.6 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.....	84
2.7 Të ndryshme të dala gjatë auditimit.....	93
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.....	100
V. ANEKSE	107

I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 17/1 prot., datë 14.01.2022 dhe Mbi përputhshmërinë e ndryshuar, me njoftim ndryshim programi nr. 17/2, datë 11.04.2022, të miratuara nga Kryetari i KLSH, nga data 17.01.2022 deri më datë 13.05.2022, në subjektin Instituti i Sigurimeve Shoqërore për periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2021 u krye auditimi nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. A. Z. Përgjegjës Grupi
2. E. A. Audituese
3. E. B. Audituese
4. E. M. Auditues

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e Gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Nga auditimi ka rezultuar se mungon Strategjia për zhvillimin e sistemit të sigurimeve shoqërore në periudhë afat-mesme dhe afat-gjatë; legjislacioni përkatës është shoqëruar me ndryshime të shumta (deri më tani 22 herë) pa arritur reformimin e sistemit dhe zgjidhjen e problematikave të tij: financimi buxhetor ka ardhur duke u rritur nga viti në vit; ka një rritje të ngadaltë dhe të ulët të numrit të kontribuesve, dhe kjo kryesisht në sektorin publik, ndërsa është në ulje numri i të siguruarve të vetëpunësuar në bujqësi; ka tendencë në rritje numri i përfituesve (pensionistëve), duke e mbajtur shkallën e vartësisë së sistemit në nivele të ulëta 1 kontribues për 1.42 përfitues; shkalla e zëvendësimit (pension mesatar/kontribute mesatare) është shumë e ulët, duke nxitur informalitetin në këtë drejtim; megjithëse niveli i kontributeve nuk ka ndryshuar për një kohë të gjatë, paga minimale dhe maksimale që nga viti 2014 janë rritur përkatësisht me rreth 65 % dhe 45 %, duke sjellë për pasojë që rritja e të ardhurave kontributeve të jetë kryesisht nga rritja e pagës; krahasuar edhe me vendet e rajonit, vijon të ketë një nivel të ulët të ardhurave nga kontributet shoqërore në raport me prodhimin e brendshëm bruto prej 5.4 % në vitin 2021; ka një numër të konsiderueshëm të</p>			<p>-Instituti i Sigurimeve Shoqërore në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të hartojë Strategjinë e zhvillimit të sistemit të sigurimeve shoqërore, me qëllim arritjen e konsolidimit të skemës, si dhe të mundësojë rritjen e performancës nëpërmjet një reforme të qëndrueshme që i përgjigjet problematikave të sistemit të sigurimeve shoqërore.</p>

	<p>subjekteve debitorë prej 103,628 njësi (kryesisht të biznesit të vogël rreth 75 %), duke shkaktuar pasoja këtyre kontribuuesve në përfitimin e pensioneve; edhe ndryshimet e gjëra të ligjit në 2014 nuk i kanë dhënë zgjidhje problematikave të skemës së sigurimeve shoqërore në vendin tonë.</p>		E lartë	
2	<p>Nga shqyrtimi i zbatimit të buxhetit për vitin 2021 rezulton se:</p> <p>- <i>Planifikimi i treguesve të fondit të sigurimeve shoqërore</i> nuk mbështet në nivelin bazë të rajoneve, si dhe nuk shoqërohet me një analizë të detajuar, por në përgjithësi i përmbahet skemave fikse të miratuara nga institucioni epror e konkretisht: në planifikimin strategjik të dhënat e dërguara nga MFE janë njësoj me ato të përgatitura nga ISSH, çka tregon se planifikimi nuk është realizuar plotësisht në bazë të analizave dhe studimeve konkrete, por është thjeshtë një përshtatje shifrash midis institucioneve të cilat llogariten në bazë të eksperiencës dhe një trendi rritës, madje shifrat e ISSH-së përshtaten njësoj me ato të organit epror; hartimi i treguesve të buxhetit vjetor e atij afatmesëm në fazën e I strategjike është kryer i përqendruar në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH-së, duke mos përfshirë në këtë fazë programimi njësitë shpenzuese rajonale, me justifikimin se ato nuk kanë tregues të mjaftueshëm për të realizuar atë, por përfshirja e tyre në këtë fazë të planifikimit strategjik mund të ishte e dobishme, sepse do të përmblihte eksperiencat e tyre në vite pavarësisht se nuk kanë të dhëna makro Plani i buxhetit të ISSH ka ndryshuar tre herë e konkretisht sipas ligjit nr. 137/2020, sipas Aktit Normativ nr. 18, datë 14.04.2021 dhe Sipas Aktit Normativ nr. 34, datë 03.12.2021 të dërguara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Të ardhurat gjithsej nga kontributet e sigurimeve shoqërore për vitin 2021 në shkallë vendi, nga 91,576,000 mijë lekë të programuara, u realizuan 94,857,582 mijë lekë ose në masën 104% .</p> <p>- Rezultati fiskal vjetor, i cili paraqitet si diferencë midis të ardhurave dhe</p>		E lartë	<p>-Instituti i Sigurimeve Shoqërore të mundësojë rritjen e të ardhurave e numrin e kontribuuesve, uljen e deficitit të skemës së pensioneve, zvogëlimin e subvencionit të buxheti shtetit për skemën e pensioneve dhe përmirësimin e raportit kontribute me prodhimin e brendshëm bruto (PBB).</p> <p>-Instituti i Sigurimeve Shoqërore t'ia bëjë prezent dhe të kërkojë që Ministria e Financave dhe Ekonomisë të ndërhyjë në zgjidhjen problematikave të mbartura në marrëdhëniet e saj me Drejtorinë e Përgjithshme të</p>

<p>shpenzimeve të vitit, tregon se nevojat për financimin e shpenzimeve të vitit, janë ulur në krahasim me planin në vlerën 2,994 milionë lekë, megjithatë ato vazhdojnë të mbeten akoma të larta, sepse subvencioni nga buxheti i shtetit për skemën e pensioneve i llogaritur për vitin 2021 është 37,715 milionë lekë.</p> <p>- Të ardhurat nga kontributet nuk janë të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të skemës së pensioneve për të dy skemat (qytetin dhe fshatin) duke krijuar një deficit të vazhdueshëm nga viti në vit. Ky deficit konstatohet në rritje në vlerë absolute për vitin 2021 në vlerën 899,901 mijë lekë kundrejt vitit 2020, megjithëse ka një përmirësim prej 0.14 pikë. Ky deficit fiskali sistemit, pavarësisht rezultatit vjetor dhe mbulimit të planifikuar të tij, rezulton të jetë 30,413 milionë lekë dhe nëse i zbritet kontributi për papunësinë i pa transferuar e ligjërish i lënë në llogaritë e ISSH në shumën 3,179 milionë lekë, redukton financimin buxhetor në vlerën 27,233.4 milionë lekë.</p> <p>- Numri i përfituesve të pensioneve të pleqërisë, invaliditetit dhe familjarë për vitin 2021, konstatohet se në fillim të vitit 2021, në skemën e detyrueshme ishin 665,567 pensionistë dhe në fund të vitit 2021, rezultuan 673,542 pensionistë, me një shtesë në total, prej 7,975 pensionistë.</p> <p>- Konstatohet mungesa e bashkëveprimit dhe komunikimit të rregullt në marrëdhëniet ndërinstucionale midis ISSH dhe DPT të cilat janë kthyer pothuajse në fenomen. ISSH në mënyrë të vazhdueshme ka ndjekur mangësitë që evidentohen në sistemin e transmetimit të listë-pagesave ashtu dhe në bashkëpunimin që kërkohet lidhur me angazhimin e organeve tatimore, për sa i përket rolit të tyre në drejtim të mbledhjes së detyrimeve të prapambetura.</p> <p>Sipas të dhënave të marra e përpunuara konstatohet se subjektet debitorë kanë pësuar një rritje të konsiderueshme prej 6,795 subjektësh si dhe një rritje të detyrimeve të prapambetura me 1,474,616 mijë lekë në vitin 2021. Ndërsa deri tani Institutit të Sigurimeve Shoqërore nuk i</p>		<p>Tatimeve për diferencat e kontributeve të derdhura nga subjektet privatë dhe shtetërore për sigurimet shoqërore të cilat konstatohen në 103 mijë subjekte debitorë me vlerë rreth 15.8 miliard detyrime prapambetura.</p>
--	--	--

	<p>janë vënë në dispozicion rreth 15.8 miliard lekë detyrime të prapambetura që ju përkasin mbi 103 mijë subjekteve debitorë.</p> <p>- Për vitin 2021 një tregues i rëndësishëm është edhe treguesi i skemës së sigurimeve krahasuar me PBB, (shpallur nga MFE, në procesin e hartimit dhe miratimit të treguesve në buxhet), i cili megjithëse ka ardhur në rritje është larg pritshmërisë dhe objektivave, kështu për vitin 2021 ai është realizuar 5.36 % nga 5.16 % i planifikuar.</p>			
3	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit me objekt ÷Sigurimi i aseteve të ISSH, DAQ-së Lundër, DRSSH-ve dhe ALSSH-ve përkatëse për periudhën 1-vjeçare për vitin 2021, me fond limit në vlerën 7,800,000 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate në shumën 7,778,000 lekë pa TVSH, rezultoi:</p> <p>Njësia e Prokurimit, në procesverbalin e mbajtur për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, nuk ka argumentuar teknikisht dhe ligjërisht kriteret e vendosura e konkretisht: 1. ÷Kopje e deklaratave të xhiros vjetore, realizuar gjatë vitit 2018 dhe 2019, ku vlera mesatare e xhiros vjetore gjate këtyre viteve të jetë sa vlera e fondit limit që prokurohet, 2. ÷Kopje të certifikuara të bilanceve të viteve 2018 dhe 2019 të paraqitura në autoritetet përkatëse dhe 3. ÷Dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjate tri viteve të fundit në një vlerë sa 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Veprime jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 61 pika 2.</p> <p>- Referuar sistemit elektronik të prokurimit rezulton se në datë 04.02.2021 u ka bërë ftesë për pjesëmarrje 5 operatorëve ekonomik, por nuk ka argumentuar dhe dokumentuar përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë të cilëve u ka dërguar ftesë në SEP.</p>		E mesme	<p>Drejtori i Përgjithshëm bashkëpunim me Sektorin e Prokurimeve, të krijojë komisionet për zbatimin e kontratave, për verifikimin e produktit apo shërbimit final në përputhje me kërkesat e vendosura nga AK dhe sugjerimet e APP, si dhe të argumentohen ftesat për pjesëmarrje të cilat ju dërgohen operatorëve ekonomik.</p>

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

Nga auditimi mbi përputhshmërinë¹, për sa i takon shkallës së zbatimit të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, gjatë auditimit nuk janë konstatuar problematika në garantimin e përputhshmërisë me aktet ligjore dhe nënligjore (kriteret) që rregullojnë aktivitetin e këtij institucioni, për periudhën nga 01.01.2021 deri më 31.12.2021, bazar në ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, akteve të tjera ligjore e nënligjore, në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH, në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), bazuar në dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga ky institucion .

Opinioni i Auditimit mbi Përputhshmërinë (ISSAI 4100²)

Opinion i pamodifikuar (siguri të arsyeshme)

Nga auditimi i përputhshmërisë, i mbështetur në standardet INTOSAI, në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së dhe Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH, i kryer në Institutin e Sigurimeve Shoqërore (ISSH), rezultoi se, në opinionin tonë, nga aktiviteti i tij është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e mjaftueshme dhe e plotë, si dhe asgjë nuk ka tërhequr vëmendjen apo të jenë konstatuar aspekte materiale të mospërputhshmërisë me kriteret e aplikuar të cilat justifikojnë dhënien e një **opinionit të pamodifikuar (siguri të arsyeshme)** i përputhshmërisë, adresuar për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes.

Baza për opinionin e pamodifikuar (siguri të arsyeshme)

Bazuar në punën e kryer të auditimit, informacioni mbi çështjen e subjektit të audituar është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale me kriteret e aplikuar bazuar në ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, akteve të tjera ligjore e nënligjore.

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI-s). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin për Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë, pjesë e projekt raportit tonë. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së.

Në dhënien e opinionit kemi marrë në konsideratë:

Opinionin e dhënë e mbështesim në gjykimin profesional të grupit të punës i cili ka marrë në konsideratë konstatimet në drejtim të: hartimit të strategjisë; planifikimit dhe realizimit të buxhetit të sigurimeve shoqërore për vitin 2021, për sigurimin e detyrueshëm, sigurimet suplementare dhe programet kompensuese e shpërblimet; të grumbullimit të ardhurave; realizimit të shpenzimeve; deficitit të skemës së pensioneve; nivelit të borxhit ndaj skemës së pensioneve dhe entitetet problematike; listë pagesave të kontributeve; bashkëpunimit me institucionet, realizimit të shpenzimeve brenda institucionit, procedurave të prokurimit, zbatimit të rekomandimeve; etj.

Përgjegjësia e Drejtuesve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore .

Është detyrimi i drejtimit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në

¹Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së dhe Vendimin nr.66, datë 23.06.2020 të Kryetarit të KLSH për miratimin e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

²ISSAI 4100 ó Objektivit i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në ligjin që të mbrojë qytetarët, si dhe të ruajë stabilitetin e transparencën në fushën e pensioneve.

Këshilli Administrativ i ISSH si organ më i lartë ekzekutiv është përgjegjës për vendimmarrjet e përcaktuara në zbatim të nenin 74 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993: Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 21 të VKM-së nr.161, datë 11.04.1994 për miratimin e Statutit të Institutit të Sigurimit Shoqërore, i ndryshuar.

Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës për veprimet dhe vendimet e nxjerra gjatë veprimtarisë funksionale të institucionit të përcaktuara në nenin 76 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, nenet 24 dhe 25 të VKM-së nr.161, datë 11.04.1994 për miratimin e Statutit të Institutit të Sigurimit Shoqërore, i ndryshuar dhe rregulloren e Brendshme të ISSH-së.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë.

Përgjegjësia jonë është që nëpërmjet auditimit të realizuar:

- Të vlerësojmë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4100*), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese;

-Të vlerësojmë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (*ISSAI 1500, ISA 300*);

-Të kryejmë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të objektivit.

Ne i përmbushim përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar.

II. HYRJA

1. Objekti i auditimit

Objektivat dhe qëllimi i këtij auditimi është vlerësimi i nivelit të përputhshmërisë së procedurave të ndjekura nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, gjatë procesit të realizimit të objektivave me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator në fuqi, në drejtim të planifikimit dhe realizimit të buxhetit të sigurimeve shoqërore për vitin 2021, për sigurimin e detyrueshëm, sigurimet suplementare dhe programet kompensuese e shpërblimet në drejtim të grumbullimit të ardhurave; realizimit të shpenzimeve; analizimit të deficitit të skemës së pensioneve; analizimit të nivelit të borxhit ndaj skemës së pensioneve dhe entitetet problematike; analizimit të listës pagesave të kontributeve; bashkëpunimit me institucionet. Gjithashtu, synohet raportimi i të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t'u bërë publike, nëpërmjet një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, gjatë veprimtarisë së tij.

2. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është vlerësimi nëse aktiviteti ekonomik dhe financiar dhe informacionet e raportuara në zbatim të buxhetit të shtetit, si dhe të veprimtarisë së subjektit nën auditim, janë në çdo aspekt material në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

3. Identifikimi i çështjes

Instituti i Sigurimeve Shoqërore është institucion shtetëror i ngarkuar për administrimin e sigurimeve shoqërore ai drejtohet nga: Këshilli Administrativ i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtori i Përgjithshëm i Sigurimeve Shoqërore dhe përfshin:

- Arkëtimin e detyrimeve, që rrjedhin nga derdhja e kontributit të punëmarrësve, punëdhënësve dhe të vetëpunësuarve;
- Pagimin e përfitimeve të sigurimeve, sipas dispozitave ligjore;
- Administrimin e sigurimeve shoqërore në përgjithësi dhe i politikave të pensioneve në veçanti;
- Mbulimin e popullsisë në të gjithë Republikën e Shqipërisë me elementë të sigurimeve shoqërore, kur iu lind kjo e drejtë;
- Përmirësimin e eficiencës në menaxhimin e fondeve të sigurimeve shoqërore, fondeve përkohësisht të lira dhe fondit rezervë.
- Përmirësimin e skemave aktuale nëpërmjet reformimit të shtyllës publike të pensioneve;

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Është detyrimi i drejtimit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në ligjin që të mbrojnë qytetarët, si dhe të ruajë stabilitetin e transparencën në fushën e pensioneve.

5. Përgjegjësitë e audituesve të KLSH-së

Përgjegjësia jonë është që nëpërmjet auditimit të realizuar:

- Të vlerësojmë nëse, dokumentacioni dhe informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4100*), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese;

-Të vlerësojmë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (ISSAI 1500, ISA 300);

-Të kryejmë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të objektivit.

Ne jemi të pavarur e theksuar kjo në ISSAI-n 10 ÷Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-të, si dhe ISSAI 30 ÷Kodi Etikë, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i përmbushim përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar.

6. Kriteret e vlerësimit

Për dhënien e opinionit të përputhshmërisë jemi bazuar në aktet ligjore, nënligjore, urdhra, udhëzime dhe rregullore në fushën menaxhimit të sistemit sigurimeve shoqërore e konkretisht:

- Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 ÷Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;

- Ligji nr. 9136, datë 11.09.2003 ÷Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ÷Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;

- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar;

- Ligji nr. 137/2020 ÷Për buxhetin e vitit 2021 si dhe Aktet Normative që kanë ndryshuar gjatë vitit;

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 ÷Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;

- Ligji nr. 29/2019 ÷Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji;

- Ligji nr. 8097, datë 21.03.1996 ÷Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit, i ndryshuar;

- Ligji nr. 10142, datë 15.05.2009 ÷Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;

- Ligji nr. 9361, datë 24.03.2005 ÷Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë lundrues, të nëndetësve dhe palombarëve të forcave detare në pension;

- Ligji nr. 8607, datë 27.04.2000 ÷Statusi i Dëshmorit të Atdheut, i ndryshuar;

- Ligji nr. 9128, datë 29.7.2003 ÷Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension, i ndryshuar;

- Ligji nr. 8455, datë 4.2.1999 "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve që humbasin jetën në përmbushje të detyrës gjatë fluturimit", i ndryshuar;

- Ligji nr. 10139, datë 15.5.2009 ÷Për Pensionet Shtetërore Suplementare të Punonjësve të Universiteteve, të Shkollave të Larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha Institucioneve të tjera Kërkimore Publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë Tituj Shkencorë, i ndryshuar;

- Ligji nr. 8685, datë 9.11.2000 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", i ndryshuar;

- Ligji nr. 9179, datë 29.1.2004 ÷Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake, i ndryshuar;

- Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 òPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò, i ndryshuar;- VKM nr. 53, datë 29.01.2020 òPër miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2021-2023ò;
- VKM nr. 761, datë 19.11.2004 òPër krijimin e arkivit qendror për sistemimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të periudhës së sigurimit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqëroreò, i ndryshuar;
- VKM nr. 730, datë 02.09.2015 Për një ndryshim në Vendimin nr. 429, datë 12.9.2002, të Këshillit të Ministrave, òPër kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetëroreò;
- VKM nr. 8, datë 14.01.2015"Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 Kwh në muaj";
- Udhëzimi i MFE nr. 7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm";
- Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 28.02.2020 òPër përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023ò;
- Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò;
- Rregullore të ndryshme të Institucionit të Sigurimeve Shoqërore.
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018 òPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò;
- Udhëzimet e Ministrit të Financave për procedurat e hartimit dhe zbatimit të buxhetit;
- Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar;
- Urdhri i Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit nr.125, datë 26.12.2011 òPër miratimin e hartave të azhuruara të Rrjetit Rrugor Kombëtar dhe distancave kilometrike ndërmjet qyteteve në RSHò;
- Rregullorja nr. 2115, datë 15.03.2018, òPër organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqëroreò;
- Rregullore Financiare nr. 5, datë 25.05.2009 e Institucionit të Sigurimeve Shoqërore;
- etj.

7. Standardet e auditimit

Auditimi u bazua në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren òPër Procedurat e Auditimitò, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 107 datë 08.09.2017, dhe në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 òStandardi i Auditimit të Përputhshmërisëò.

8. Metodatat e auditimit

Metodat dhe teknikat audituese që u përdorën janë si vijon:

- model logjik i çështjes nën auditim;
- mbledhje, shqyrtim dhe analizim cilësor e sasior i evidencave shkresore gjatë fazës studimore e të auditimit;
- kryqëzim i të dhënave për të gjeneruar evidenca të mjaftueshme, të besueshme dhe relevante;
- standardet dhe praktikatat më të mira.

9. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i Auditimit është bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren òPër Procedurat e Auditimitò, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 107 datë 08.09.2017 si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI).

ISSAI 1230 òDokumentimi i Auditimitò, dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH), është institucioni shtetëror i ngarkuar për administrimin e sigurimeve shoqërore në përgjithësi dhe politikave të pensioneve në veçanti, mbulimin e popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore në çdo vend dhe kohë kur lind kjo e drejtë, rritjen e numrit të kontribuuesve dhe grumbullimit të ardhurave nga kontributet, në përmirësimin e eficiencës në menaxhimin e fondeve të sigurimeve shoqërore, fondeve përkohësisht të lira dhe fondit rezervë.

ISSH është e fokusuar në përmirësimin e skemave aktuale nëpërmjet reformimit të shtyllës publike të pensioneve e forcimit të një lidhjeje më të drejtpërdrejtë midis kontributeve të paguara dhe përfitimeve të ardhshme, futjes graduale të skemave të përfitimeve suplementare të menaxhuara nga subjekte jopublike, krijimit të llogarive personale të çdo kontribuuesi dhe përfituesi, arritjen e transparencës maksimale, duke krijuar akses personal tek klientët me objektiva kryesore:

- garantimin e mbulimit sa më të plotë të popullsisë së vendit me elementë të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, të mbajtura në nivele të pranueshme, nëpërmjet zbatimit të një sistemi sigurimesh shoqërore që i përgjigjet më mirë stadi të arritur në zhvillimin ekonomik e social të vendi dhe përsosjes së menaxhimit të skemës së sigurimeve shoqërore, sidomos të mbledhjes të ardhurave kontributeve dhe shpërndarjes sa më të drejtë të tyre në formën e përfitimeve, aty dhe atëherë kur lind e drejta;
- përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare të skemës së sigurimeve shoqërore, duke synuar rritjen graduale por më të shpejtë të kontributeve në krahasim me rritjen e përfitimeve si dhe duke minimizuar subvencionet buxhetore.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

Grupi i Auditimit u njoh me kuadrin ligjor dhe rregullator në këtë auditim, ku përcaktohen detyrimet dhe përgjegjësitë e institucionit për realizimin me efektivitet të zhvillimit të fondit të sigurimeve shoqërore. Në vijim, auditimi u fokusua në administrimit të sigurimeve shoqërore dhe politikave të pensioneve në drejtim të mbulimit të popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore, planifikimit dhe realizimit të buxhetit të sigurimeve shoqërore për vitin 2021, funksionimit të strukturave të kontrollit në drejtim të inspektimit të pensioneve dhe auditimit të brendshëm, prokurimeve publike për mallra, punë e shërbime dhe përputhshmëria e transaksioneve që lidhen me to, administrimi i burimeve njerëzore.

2.1 Auditimi i administrimit të sigurimeve shoqërore dhe politikave të pensioneve në drejtim të mbulimit të popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore (akordimi përfitimeve për pension, paaftësi të përkohshme në punë, barrë lindje, aksidente në punë dhe sëmundje profesionale e përfitime suplementare në momentin e lindjes të së drejtës dhe nevojës për to); rritjes e numrit të kontribuuesve; përmirësimi i eficiencës në menaxhimin e fondeve përkohësisht të lira dhe fondit rezervë.

Sigurimet shoqërore në vendin tonë kanë filluar në vitin 1927, me ligjin e parë me nr. 129, datë 28 tetor 1927 òLigji i Pensioneve Civileò, por pavarësisht ekzistencës së këtij akti ligjor, vendosja e një sistemi të plotë të sigurimeve shoqërore për herë të parë u realizua në vitin 1947 i cili u konsolidua gradualisht në dy skema: një për të punësuarit e sektorit shtetëror dhe një skemë tjetër për anëtarët e kooperativave bujqësore. Ky sistemi ishte i bazuar në solidaritetin e brezave dhe siguronte mbrojtje të plotë sociale, duke mundësuar mosha të ulëta të daljes në pension dhe trajtim të diferencuar për kategori të caktuara të punësuarish. Analizat e kryera kanë evidentuar se ky sistem nga njëra anë ishte shumë òbujarò dhe nga ana tjetër, nuk siguronte mbrojtje të plotë sociale dhe përfundimtare në fillimet e tij dhe në vazhdim nuk kishte

përfitues, por vetëm kontribuues dhe modelet e financimit të përdorura ishin të tilla që nuk krijonin rezervat e domosdoshme financiare. Ai parashikonte mosha të ulët të daljes në pension dhe trajtim të diferencuar për kategori të caktuara të punësuarish. Sistemi financohej nga kontributet e punëdhënësve shtetërorë dhe të kooperativave bujqësore, të cilët natyrshëm ishin pjesë e kostos dhe e çmimeve të planifikuara. Në themel sistemi bazohej në solidaritetin e brezave, ku me kontributet e paguara financoheshin përfitimet e përcaktuara gjatë asaj periudhe dhe ndërkohë, nëpërmjet tyre të punësuarit siguronin të drejta të ardhshme në fushën e sigurimeve shoqërore.

Sistemi u plotësua në vitin 1966, me miratimin dhe fillimin e zbatimit të ligjit nr. 4171, datë 13.09.1966, òPër sigurimet shoqërore shtetërore në RPSSHò e konkretisht:

- për të punësuarit e sektorit shtetëror (ligji nr. 4171, datë 13.09.1966),
- për anëtarët e kooperativave bujqësore (ligji nr. 4976, datë 29.06.1972).

Deri në vitin 1991 numri i të punësuarve në ish-ndërmarrjet shtetërore dhe në ish-kooperativat bujqësore, të cilët përbënin edhe kontribuuesit në sistemin e sigurimeve shoqërore, ishte 1 milion e 446 mijë. Përfituesit e parë të sistemit evidentohen në vitin 1960. Sipas statistikave të kohës, në vitin 1966 evidentohen rreth 35 mijë përfitues, kryesisht me pensione të pjesshme, kundrejt 263 mijë kontribuuesve. Ndërsa në fund të vitit 1991 numri i përfituesve kishte arritur në 329 mijë, duke reflektuar një normë vartësie 4.5 kontribuues për 1 përfitues.

Numri i kontribuuesve pësoi një rënie drastike në vitin 1991-1993, por realisht këtë vit numri i kontribuuesve ishte akoma edhe më i ulët. Kjo për faktin se në shumë ndërmarrje shtetërore një pjesë e madhe e punëtorëve merrnin pagesë papunësie të financuar nga buxheti i shtetit në masën 60 % të pagës dhe njëkohësisht evidentoheshin edhe si kontribuues. Në vitin 1994, kur edhe u ndërpre në këto pagesa, numri i kontribuuesve zbriti në 386 mijë. Nga ana tjetër, mbyllja e ndërmarrjeve shtetërore bëri të nevojshme vendosjen e skemave të pensioneve të parakohshme dhe si rrjedhim numri i pensionistëve në vitin 1993 u rrit me 123 mijë duke shkuar në 453 mijë në total.

Kështu në kuadrin ligjor pas viteve -90-të, ndodhën ndryshimet në sistemin politik dhe ekonomik në vend gjë e cila solli dhe nismën e një reforme të sistemit të sigurimeve shoqërore i cili u realizua nëpërmjet ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, òPër Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisëò, në përputhje me zhvillimet e reja të sistemit ekonomik në vend, ku u përcaktuan edhe parimet bazë të sistemit të pensioneve.


Sistemi i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore mbështetet në parimin kontributeve, parimin e vetë përgjegjësisë së individit për risqet e së ardhmes në fushën sociale, si dhe në parimin e marrëveshjes së brezave *“paguaj sot që të përfitosh nesër”*.

Legjislacioni i vitit 1993, për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisëò, modeloi një sistem të detyrueshëm, të sigurimeve shoqërore.

Sistemi i përgjithshëm i sigurimeve i modeluar në vitin 1993, nëpërmjet ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, òPër Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisëò përbëhet nga:

- *Një skemë sigurimesh shoqërore e detyrueshme* që administrohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe mbulon të punësuarit në shtet dhe në sektorin privat dhe të vetëpunësuarit në zonat urbane dhe rurale, me kusht që ata të kenë kontribuar për një kohë të përcaktuar në skemë.
- *Një skemë vullnetare* që përfshin ata që nuk janë më të siguruar, që kanë qenë dhe duan të vazhdojnë të jenë si edhe ata që nuk janë të mbuluar nga ligji përfshirë dhe studentët e universitetit.
- *Një skemë suplementare* për funksionet e larta kushtetuese, shërbimin civil dhe ushtarakët e punësuar në ushtri, në polici dhe në shërbimin informativ. Pensionet suplementare financohen drejtpërdrejt nga buxheti i shtetit.
- *Pensione të veçanta* për ata që kanë marrë pjesë në luftë, që kanë tituj në fushën e kulturës, arteve, ekonomisë dhe politikës si edhe të përndjekurit nga regjimi totalitar. Pensionet e veçanta financohen gjithashtu drejtpërdrejt nga buxheti i shtetit.

SISTEMI I SIGURIMEVE SHOQËRORE




Burimi: ISSH, punuar nga grupi i KLSH.

Në vitet në vijim e deri në ditët e sotme, legjislacioni i Sigurimeve Shoqërore, në përshtatje me zhvillimet e përgjithshme ekonomike, të diktuar nga koha si dhe i fokusuar për t'u përshtatur dhe plotësuar standardet e përcaktuara në konventat dhe kodet e ratifikuara, ka pësuar mjaft ndryshime e përmirësime, të cilat e kanë bërë atë më të përshtatshëm, dhe më të krahasueshëm me vendet e komunitetit ku duam të aderojmë, kështu në mënyrë të përmbledhur mund të themi:


- 1993 - reformim i sistemit të sigurimeve shoqërore të vitit 1966
- Reformat parametrike:
 - 2002 rritja graduale e moshës së pensionit,
 - 2006-2009 reduktim i normës së kontributit,
 - 2014 reforma e sistemit PAYGO (Pay As You Go)

SIGURIMET SHOQËRORE TË DETYRUESHME



Burimi: ISSH, punuar nga grupi i KLSH

PËRQINDJA E KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE SIPAS DEGËVE





Në vitin 1992, me Vendim të Këshillit të Ministrave u miratua për herë të parë Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH), si institucioni shtetëror i ngarkuar për administrimin e sigurimeve shoqërore. Përpara miratimit të këtij akti nënligjor, administrimi i sigurimeve shoqërore realizohej nga Drejtoria e Përgjithshme e Sigurimeve Shoqërore, e cila ishte në varësi të Ministrisë së Financave.

ISSH-së është krijuar me qëllim administrimin e sigurimeve shoqërore, ai drejtohet nga: Këshilli Administrativ i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtori i Përgjithshëm i Sigurimeve Shoqërore. Instituti i Sigurimeve Shoqërore përfshin:

- Arkëtimin e detyrimeve, që rrjedhin nga derdhja e kontributit të punëmarrësve, punëdhënësve dhe të vetëpunësuarve;
- Pagimin e përfitimeve të sigurimeve, sipas dispozitave ligjore;
- Investimin e fondit rezervë, me qëllim rritjen e tij.
- Administrimi i sigurimeve shoqërore në përgjithësi dhe i politikave të pensioneve në veçanti;
- Përcaktimi i personave të siguruar dhe përmirësimi i shërbimeve ndaj tyre;
- Mbulimi i popullsisë në të gjithë Republikën e Shqipërisë me elementë të sigurimeve shoqërore, kur iu lind kjo e drejtë;
- Rritja e numrit të kontribuuesve dhe grumbullimi i të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe të siguruarit vullnetar;
- Përmirësimi i efijencës në menaxhimin e fondeve të sigurimeve shoqërore, i fondeve përkohësisht të lira dhe fondit rezervë.
- Përmirësimin e skemave aktuale nëpërmjet reformimit të shtyllës publike të pensioneve;
- Forcimin e një lidhjeje më të drejtpërdrejtë midis kontributeve të paguara dhe përfitimeve të ardhshme;
- Futjen graduale të skemave të përfitimeve suplementare të menaxhuara nga subjekte jopublike;
- Krijimin e llogarive personale të çdo kontribuuesi dhe përfituesi, me qëllim arritjen e transparencës maksimale.

- Menaxhimi i FSSH bëhet nga ISSH
- ISSH drejtohet nga:
 - Këshilli Administrativ
 - Drejtori i Përgjithshëm i ISSH



ISSH gjithashtu bazuar në objektivin kombëtar të integritit në BE, në Nenin 70 i MSA-së që përcakton përafrimin e gjithë legjislacionit të brendshëm me atë të Bashkimit Evropian, në Planin Kombëtar të Integritit Evropian, legjislacioni për sigurimet shoqërore në tërësi përfshirë edhe menaxhimin dhe administrimin e gjithë sistemit të sigurimeve shoqërore ka synuar në përafrimin me legjislacionin e BE-së, megjithatë me gjithë punën e bërë ai vijon të përmirësohet dhe të përshtatet me të kështu:

- Në vitin 2014 në përafrim me legjislacionin BE-së (**Kapitulli 19 i PKIE-së**, “*Politikat Sociale dhe punësimi* “), për përmirësimin e parametrave të sistemit të sigurimeve shoqërore, u bënë ndryshime reformime që konsistuan në:
 - Forcimin e parimit të kontributeve dhe krijimin i një sistemi të drejtë, në të cilin përfitimet lidhen drejtpërdrejt me kontributet, nëpërmjet:
 - optimizimit gradual të përfitimeve duke përmirësuar formulën e llogaritjes së pensioneve, për të siguruar pensione të financuara nga kontributet;
 - rritjes graduale të moshës së daljes në pension, në proporcion me shtimin e parashikuar të jetëgjatësisë;
 - përmirësimit konceptit të skemës dhe formulës së pensioneve të fshatit, si dhe heqjes graduale të subvencioneve kontributeve.
 - Koordinimin i skemës së përfitimeve bazuar në parimin kontributeve me përfitimet shoqërore të formës së asistencave të garantuara nga shteti (pensionet sociale) si dhe zhvillimi i skemave të pensioneve profesionale dhe private.
 - Ripërcaktimin e përfitimeve nga skemat kompensuese, bashkimi i tyre pas datës 01.01.2015 me pensionin, përmirësimin dhe përcaktimin e rregullave të indeksimit të pensioneve në mënyrë periodike, të cilat bazohen mbi ecurinë e indeksit të çmimeve dhe ecurinë e zhvillimit të kontributeve individuale dhe të ardhurave.
- Në kuadër të Rekomandimeve të Bashkimit Evropian, Direktivës 79/7/KE të Mbi zbatimin gradual të parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në çështjet e sigurimeve shoqërore legjislacioni shqiptar (Ligji Nr. 7703/1993 për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar) rezultoi i përputhur plotësisht.

Gjithashtu duke filluar nga viti 2009 e deri më sot, në përafrim me legjislacionin BE-së (Kapitulli 2 të PKIE-së të Lëvizja e lirë e punëtorëve ku përfshihet gjetja e mekanizmit për të koordinuar dispozitat e sigurimeve shoqërore kombëtare për personat e siguruar dhe anëtarët e familjeve të tyre që lëvizin në një Shtet tjetër Anëtar, ka lind detyrimi i bashkërendimit të sistemit shqiptar të sigurimeve shoqërore me shtetet anëtare të BE-se dhe jo vetëm.

Për sa më sipër, mbështetur në Rregulloret (KE) nr. 883/2004 dhe 987/2009 të Parlamentit Evropian “*Për koordinimin e sistemeve të mbrojtjes sociale*” janë në fuqi 8 marrëveshje dypalëshe, (Turqinë, Republikën e Maqedonisë së Veriut, Dukatit e Luxemburgut, Austrinë, Hungarinë, Mbretërinë e Belgjikës, Republikën Federale të Gjermanisë, me Republikën Çeke).

Nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe realizohet trajtimi i barabartë i personave në lidhje me të drejtat dhe detyrimet për plotësimin kushteve për të drejtën për përfitim dhe pagesat e përfitimeve që rrjedhin nga legjislacioni i të dy shteteve

Sipas llojit të përfitimit të caktuar kryhet eksportimi i përfitimeve nga Shqipëria në shtetin e huaj dhe anasjelltas pa kufij dhe pa zbritje.

Kështu për sa më sipër, Instituti i Sigurimeve Shoqërore në zbatim të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit neni 48 ku është përcaktuar :

Pika 1. Do të vendosen rregulla për bashkërendimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore për punonjësit me nënshtetësi shqiptare, të punësuar ligjërisht në territorin e një Shteti Anëtar dhe për pjesëtarët e familjeve të tyre që janë ligjërisht rezidentë aty.

Për këtë qëllim, një vendim i Këshillit të Stabilizim-Asociimit, i cili nuk duhet të ndikojë në të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshje dypalëshe ku këto të fundit parashikojnë një trajtim më të favorshëm, do të vendosin dispozitat e mëposhtme:

ó të gjitha periudhat e sigurimeve, punësimit apo qëndrimit të përfunduara nga punonjës të tillë në Shtete të ndryshme Anëtare duhet të mblidhen bashkë për qëllimin e dhënies së pensioneve dhe pagave vjetore në lidhje me pleqërinë, paaftësinë fizike dhe vdekjen dhe për qëllim përkujdesjeje shëndetësore për këtë kategori punonjësish dhe familjarët e tyre;

ó pensionet ose pagesat vjetore në lidhje me pleqërinë, vdekjen, aksidentet në punë ose sëmundjet profesionale, ose invaliditeti që shkaktohet nga puna, me përjashtim të përfitimeve jo-kontribuuese, transferohen pa pengesë në masën e aplikuar sipas legjislacionit të Shtetit ose Shteteve Anëtare debitor;

ó punonjësit në fjalë marrin asistencë financiare për pjesëtarët e familjeve të tyre siç përcaktohet më sipër;

Pika 2. Shqipëria u akordon punonjësve të cilët janë shtetas të një Shteti Anëtar dhe ligjërish të punësuar në territorin e saj, dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre rezidentë të ligjshëm aty, të njëjtin trajtim siç specifikohet në pikën e dytë dhe të tretë të paragrafit 1.

Si dhe Rregullores 883/2004 të Bashkimit Evropian është rritur hapësira ligjore dhe administrative për trajtimin dhe mbulimin nga skema e sigurimeve shoqërore të shtetasve shqiptarë dhe të huaj, në kushtet e lëvizjes së lirë të punonjësve, duke nënshkruar marrëveshje në fushën e mbrojtjes shoqërore, nëpërmjet koordinimit të skemës së sigurimeve shoqërore shqiptare, me skemën e sigurimeve shoqërore me vendet me të cilat Shqipëria ka lidhur marrëveshje.

Rritja e numrit të marrëveshjeve që kanë hyrë në fuqi ka sjellë edhe rritjen e numrit të personave që kanë përfituar nga skema e sigurimeve shoqërore si shtetas shqiptarë dhe të huaj, në kushtet e lëvizjes së lirë të punonjësve. Në këto marrëveshje jepen përfitime për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë vendit, por që kanë vite pune në Shqipëri si edhe për shtetasit e huaj që punojnë në Shqipëri dhe kanë vite pune në vendet me të cilat kemi marrëveshje.

Me nënshkrimin e këtyre marrëveshjeve bëhet koordinimi i skemave të sigurimeve shoqërore në të dy vendet, në mënyrë që shtetasit që kanë qenë subjekt i legjislacioneve të dy vendeve të mos humbasin të drejtat gjatë lëvizjes nga Shqipëria në shtetin tjetër dhe anasjelltas.

Këto marrëveshje mbështeten në këto parime themelore që janë:

Trajtim të barabartë : do të thotë që nuk i lejon shtetet t'at trajtojnë shtetasit e huaj ndryshe nga vendasit, u mundëson atyre të kenë të njëjtat të drejta dhe detyrime lidhur me mbrojtjen shoqërore si vetë vendasit;

Përcaktimi i legjislacionit të zbatueshëm parashikon zbatimin vetëm të legjislacionit të njërit shtet;

Ruajtja e të drejtave të arritura parashikon që periudhat e sigurimit të realizuara në një shtet duhet të njihen po ashtu edhe nga shteti tjetër. Bazuar në këtë parim, bashkimi i periudhave të siguruar sipas secilit legjislacion kombëtar, merret në konsideratë për të siguruar të drejtën e përfitimeve dhe si dhe për llogaritjen e tyre, me kusht që këto periudha të mos mbivendosen;

Eksportim të përfitimeve nënkupton që çdo person ka të drejtë të tërheqë përfitimin e siguruar kudo ku ai ndodhet, dhënia e përfitimeve realizohet si brenda dhe jashtë shtetit të origjinës dhe sasia e përfitimit nuk duhet të pakësohet thjesht me arsyetimin se është ndryshuar vendbanimi;

Bashkëpunimi administrativ parashikon marrëveshje administrative midis institucioneve kompetente zbatuese, të cilat përcaktojnë procedurat dhe formularët për zbatimin e marrëveshjeve bazë të ratifikuara nga qeveritë përkatës.

Konkretisht marrëveshjeve dypalëshe në fushën e mbrojtjes shoqërore, janë:

- Zbatimi i Marrëveshjes në fushën e mbrojtjes shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Turqisë ka nisur zbatimin që nga viti 2005,
- Marrëveshja për Mbrojtjen Shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Belgjikës hyri në fuqi më datë 01.01.2016;
- Marrëveshja në fushën e mbrojtjes shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Hungarisë hyri në fuqi prej datës 01.07.2016;
- Marrëveshja në fushën e mbrojtjes shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut,, hyrë në fuqi që prej datës 01.07.2016;
- Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë, ka hyrë në fuqi prej datës 01.06.2016;
- Marrëveshja në fushën e mbrojtjes shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Çeke, hyrë në fuqi prej datës 01.02.2017;
- Marrëveshja në fushën e mbrojtjes shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë, ka hyrë në fuqi prej datës 01.12.2017;
- Marrëveshja dypalëshe në fushën e mbrojtjes shoqërore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë, hyri në fuqi 01.12.2018;
- Marrëveshja me Bullgarinë në fuqi nga 20.11.1952, ratifikuar me Dekret Nr.1578, datë 10.11.1952;
- Marrëveshja me Kosovës, ÷Për vërtetimin e periudhave të sigurimit për realizimin e të drejtës për pension ÷ hyrë në fuqi 01.12.2018,
- Lidhur me marrëveshjet me;
 - Kanadanë, ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr. 58, datë 12.09.2019
 - Rumaninë, ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr.42/2016, datë 14.04.2016.

Transferimi i përfitimeve të dhëna në përputhje me legjislacionin shqiptar (përfitime për pension pleqërie, familjar apo invaliditeti), nënkupton, që pagesa i dërgohet përfituesit atje ku ai banon, në atë vend, në territorin e shtetit tjetër kontraktues ose edhe në një shtet të tretë ku ai ka vendbanimin e përhershëm qoftë ky shtetas shqiptar apo i huaj.

Për këtë qëllim ISSH, bazuar në Vendimin të Këshillit Administrativ nr. 22, datë 31.07.2019 *“Për transferimin e përfitimeve për përfituesit me vendbanim jashtë e territorit të Shqipërisë, në zbatim të marrëveshjeve dypalëshe në fushën e mbrojtjes shoqërore* ÷ nëpërmjet marrëveshjes me Bankën Credins, nënshkruar më 23.04.2020, kryhet transferimi i pagesave të pensioneve nga Banka Credins në llogaritë e përfituesve jashtë vendit.

Në përmbushje të misionit në fushën e sigurimeve shoqërore dhe në veçanti në fushën e pensioneve, ISSH është fokusuar në disa drejtime si:

- Rritja e cilësisë së shërbimit ndaj përfituesve dhe kontribuuesve, nëpërmjet përmirësimit të rregullave dhe praktikave të vlerësimit të dokumentacionit individual, ku drejtim të përmirësimit të shërbimit ndaj qytetareve është ndërmarrë në lidhje me reduktimin e dokumentacionit që paraqitet nga qytetari si dhe të thjeshtëzimit të procedurave ku:
 - duke filluar nga data 1 janar 2020 kërkesat për shërbime në fushën e sigurimeve shoqërore filluan të realizohen on-line nëpërmjet portalit e-Albania dhe gjatë vitit 2020 u implementuan online të gjitha shërbimet.
 - është analizuar dokumentacioni për të gjitha shërbimet në kuadër të masave lidhur me deregulimin për lehtësimin dhe reduktimin e dokumentacionit që paraqitet nga qytetari duke u siguruar nga vetë strukturat e sigurimeve shoqërore nëpërmjet sistemit SQDNE si dhe reduktuar dokumentacioni që mund ti kërkohet qytetarit në rreth 12 për qind dhe rreth 88 për qind e dokumentacionit të domosdoshëm për përfitime sigurohet nga vetë strukturat e sigurimeve shoqërore. Gjithashtu është realizuar:

- Eliminimi i shërbimit Rinovim i pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi.
- Eliminimi i shërbimit Rinovim trajtim i veçantë financiar sipas ligjit nr.8685, datë 09.11.2000, të ndryshuar.
- Eliminimi i shërbimit Rinovim trajtim i veçantë financiar sipas ligjit nr. 9179, date 29.01.2004, òPër një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake.
- Zbatimi i politikave të Qeverisë për rritjen e të ardhurave të pensionistëve, nëpërmjet indeksimit të përfitimeve të caktuara, indeksimit të pagave referuese për përfitimet e reja të vitit e në vazhdim, si dhe nëpërmjet zbatimit të një praktike tashmë të konsoliduar, që është bonusi (shpërblimi) vjetor i pensionistëve. Janë vendosur rregulla të sakta dhe strikte për indeksimin e masës në pensionit në vlerësim të indeksimit të inflacionit.
Për sa më sipër edhe gjatë vitit 2021 është realizuar procedura administrative e dhënies së shpërblimeve për mbi 688 mijë përfitues, nga sistemi i përgjithshëm i sigurimeve shoqërore si dhe është realizuar procedura administrative të indeksimit të pensioneve, si dhe përfitimeve të tjera për mbi 688 mijë përfitues, duke filluar nga data 01.04.2021, në masën 2.7 %.
- Rritjes së numrit të kontribuuesve dhe grumbullimi i të ardhurave kontributeve nga personat e vetëpunësuar në bujqësi dhe ata të siguruar vullnetarisht si një nga detyrat e ISSH-së.

Nga përgjigjet e pyetësorëve rezulton se nuk ka një strategji për sistemin e sigurimeve shoqërore, mungesa e së cilës bën që një numër sfidash mbeten për t'u adresuar me mbrojtjen e pensionistëve ku të jenë të përcaktuara objektivat drejtimet, në përputhje me drejtimet e strategjisë së Qeverisë si dokument që duhet të ofrojë zgjidhje të qëndrueshme për sfidat e sektorit, në bazë të një metodologjie gjithëpërfshirëse bazuar mbi vlerësime reale të sistemit. Strategjia për sistemin e sigurimeve shoqërore duhet do të jetë dokument që përcakton politikat dhe aktivitetet e institucioneve dhe të strukturave qendrore e vendore, si dhe të gjitha subjekteve të tjera, shtetërore, privatë e qytetarë në menaxhimin e këtij sistemi. Argumentet në favor të pasjes së strategjisë përtej atyre të sipërpërmendura për domosdoshmërinë e përmirësimit ligjor janë, si më poshtë vijon:

- ✚ hartimi i strategjive është i rëndësishme sepse nëpërmjet tyre arrihet modernizmi i sistemit të sigurimeve shoqërore në mbrojtje të qytetarit me synimin e:
 - ✓ përfshirjes së të gjitha konventave, iniciativave, marrëveshjeve dhe dokumente të tjera të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e sigurimeve shoqërore etj.;
 - ✓ parashikimit të gjitha detyrave dhe përgjegjësive të institucioneve qendrore e lokale, subjekteve private, organizatave dhe shoqatave të shoqërisë civile, të shtetasve;
 - ✓ detyrimit dhe forcimit të kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare të sistemit të sigurimeve shoqërore;
 - ✓ detyrimit ligjor për të gjitha institucionet publike, subjektet private, në modernizmin e sistemit të sigurimeve shoqërore;
 - ✓ forcimit e funksionimit të mekanizmit të inspektimit për kontrollin e detyrave dhe përgjegjësive të aktorëve të sistemit sigurimeve shoqërore;
 - ✓ rritjes dhe forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, me qëllim rritjen e shpejtësisë dhe fleksibilitetit në kërkesën, marrjen, pranimin, dhënien dhe dhënies së shërbimit ndaj qytetarëve;
 - ✓ rritjes së bashkëpunimit të gjitha institucioneve dhe strukturave në nivel qendror e vendor, shtetasit, subjektet private, organizatat dhe shoqatat e shoqërisë civile, institucionet kërkimore-shkencore, universitetet, organizatat vullnetare, organizmat ndërkombëtare dhe organizatat homologe për zvogëlimin e riskut, nëpërmjet përcaktimit të drejtave dhe detyrave të qarta për secilin prej tyre;

- ✓ planifikimit të fondeve financiare për zvogëlimin e riskut nga ana e institucioneve dhe përmirësimit të sistemit të financimit;
- ✓ përmirësimit thelbësor të sistemit të edukimit dhe trajnimit të punonjësve dhe individëve në rritjen e kapaciteteve të tyre;
- ✓ marrjes së masave konkrete të sensibilizimit të gjithë shoqërisë, për sigurimet shoqërore si një detyrë e secilit nëpërmjet rritjes së rolit të gjithë aktorëve;
- ✓ planifikimit dhe realizimi sa më cilësor të masave parandaluese në rastet e mungesës së fondeve.

Legjislacioni i sigurimeve shoqërore në vendin tonë ka filluar të reformohet:

- në vitin 1927, me ligjin e parë me nr 129, datë 28 tetor 1927 òLigji i Pensioneve Civile
- në vitin 1947 u realizua për herë të parë sistemi të plotë të sigurimeve shoqërore,
- në vitin 1966, me miratimin e ligjit nr. 4171, datë 13.09.1966, òPër sigurimet shoqërore shtetërore në RPSSHò,
- në vitin 1993 me miratimin e ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, òPër Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisëò, në përputhje me zhvillimet e reja të sistemit ekonomik në vend, ku u përcaktuan edhe parimet bazë të sistemit të pensioneve i cili për rreth 30 vite është ndryshuar me ligje dhe me aktet normative deri më tani 22 herë.

Kjo tregon se ky sistem ka problematika të cilat e bëjnë më imediate dhe të domosdoshme marrjen e një reforme të plotë dhe afatgjatë të tij nëpërmjet analizave të mirë studiuar të këtij sistemit ku të evidentoheshin treguesit që çënojnë qëndrueshmërinë fiskale të sistemit për të plotësuar standardet e zgjidhur problematikat financiare e sociale të tij.

Nëse do të analizonim reformim e sistemit të pensioneve, para vitit 2007 dhe nga viti 2013-2014 e deri në ditët e sotme mund të themi se:

- sipas analizave konstatohet se në vitet e fundit para reformës 2014, sistemi kishte rritur mjaft nivelin e përfitimeve si në qytet dhe sidomos në fshat, duke mos i lidhur më kontributet çka kishte deformuar masën e përfitimeve. Në disa raste rritja e përfitimeve individuale, sidomos të atyre minimale kishte ndjekur trende shumë më të larta se rritja e indeksit të çmimeve apo edhe të nivelit të kontributeve, çka kishte sjellë si pasojë rritjen e subvencioneve buxhetore jo vetëm për vitin kur kanë ndodhur, por edhe në vitet e tjera dhe për më tepër në periudha shumë afatgjata.
- sistemi akumulonte në fondin e Sigurimeve Shoqërore kontribute të drejtpërdrejta që arrinin në 3,8 % të prodhimit të brendshëm bruto, tregues që vlerësohej të jetë mjaft i ulët krahasuar edhe me vendet e rajonit ndërkohë që përfitimet nga skema e pensioneve evidentohen të jenë rreth 5,7 % e PBB. Dega e pensioneve evidenton një nevojë të lartë për financime duke arritur në rreth 2 % të PBB dhe me tendencë drejt rritjes.
- evidentohet zhvillim kritik të shkallës së varësisë së sistemit; numri i personave të siguruar për çdo pensionist ishte në nivelet 1.2 me 1; kjo shkallë e lartë vartësie e pamjaftueshme për mbulimin e parametrave financiar të sistemit kompensohet me rritjen e subvencioneve buxhetore dhe gjithashtu nga masa pensionesh të kufizuara në mënyrë administrative, nëpërmjet taveve, të cilat dëmtojnë lidhjen organike midis kontributit dhe përfitimit si dhe stimulojnë shmangiet nga pagesat për së paku të gjithë ata që kanë pasur rroga mbi nivelin e pagës mesatare.
- evazioni në pagimin e kontributeve nga të punësuarit dhe të vetëpunësuarit në qytet si dhe nga fermerët ishte mjaft i lartë, kjo ndër të tjera, edhe për shkak të mungesës së koordinimit të punës midis agjencive shtetërore si dhe inspektimit jo eficient.
- aplikimi i masave të emergjencës p.sh. kompensimi për çmimet, kompensimi për të ardhurat etj., të cilat janë masa tranzicioni që zbutin pasojat sociale të liberalizimit të çmimeve në vazhdim ishte bërë mjaft i kushtueshëm pasi përfitimet nga këto skema arritën të kalojnë 9 miliard lekë ose rreth 1.3 % të PBB.
- disa përfitime të tjera sidomos disa kompensime familjare për energjinë elektrike, për shkak të procedurave ligjore, nuk ishin targetuar drejt. Ato nuk janë të lidhura me

kontributet e për pasojë nuk ka përse të jenë të administruara nga sistemi i Sigurimeve Shoqërore. Me gjithë kostot ekzistuese mjaft të larta evidentohen kërkesa tepër të mëdha për pensione shtetërore suplementare dhe rritje të pensioneve të ushtarakëve, të cilat janë mbi 80 % të financuara, edhe në nivelin aktual të përfitimeve.

- struktura e pensionit publik ngjante më shumë një përfitimi bazë, edhe pse njerëzit ishin të detyruar të paguanin kontribute të ndryshme bazuar në të ardhurat e tyre, kjo bënte që skema urbane të kishte pengesa të konsiderueshme për kontributin e ndërjegjshëm për periudha më të gjata dhe për deklarim të të ardhurave të plota.
- sektori rural kërkonte transferta nga buxheti i shtetit si për plotësimin e masës së kontributeve ashtu edhe për të financuar deficitin, kjo bënte që skema e pensioneve rurale të ishte bërë de facto një skemë e ndihmës sociale, e cila administrohet si një skemë kontributeve.
- fondet e pensioneve private të ngritura ishte dhe ende vazhdon të jetë mjaft i brishtë, po ashtu edhe nxitja për pjesëmarrje to ishte e dobët.

Për sa më sipër, si rezultat i këtyre mangësive u ndërmorën masa për reformimin e sistemit duke ndërhyrë përsëri në ligjin bazë të sigurimeve shoqërore të vitit 1993 me ndryshimet përkatëse e cila u mendua se do të përmirësonte dukshëm sistemin e sigurimeve shoqërore me qëllim miradministrimin e tij. Duke kryer analiza e të dhënave të nxjerra nga ISSH si institucioni kompetent për administrimin e sigurimeve shoqërore, konstatohen problematika për të cilat duhet të ndërhyhet që të përcaktohen objektivat dhe prioritetet në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, por edhe institucione të tjera me qëllim përmirësimin e sistemit të sigurimeve si nevojë imediate e kohës për arsye se:

TË ARDHURAT NGA KONTRIBUTET E DREJTPËRDREJTA *Në milionë/lekë*

Emërtimi/vitet	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Të ardhurat nga kontributet	51,390	61,720	60,068	66,321	73,556	79,340	84,199	83,420	94,803
skema e detyrueshme	50,676	61,081	58,978	65,111	72,236	77,970	82,748	81,997	93,310
skema suplementare	714	638	1,090	1,210	1,320	1,370	1,451	1,423	1,493
rritja nga viti ne vit									
në vlerë	2,147	10,330	-1,651	6,253	7,234	5,784	4,859	-779	11,383
në përqindje	4.4	20.1	-2.7	10.4	10.9	7.9	6.1	-0.9	13.6
në përqindje nga PBB	3.8	4.4	4.2	4.5	4.7	4.8	5	5.2	5.4

Burimi: ISSH, punuar nga grupi i KLSH.

SHPENZIMET NE TOTAL *Në milionë/lekë*



Emërtimi/vitet	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Shpenzimet ne total	95,597	101,498	107,309	114,276	119,081	125,364	131,238	134,151	148,030
shpenzime për përfitime	79,632	85,296	88,904	93,457	100,174	105,426	111,868	113,212	126,070
progr. të veç qeverisë	9,202	9,633	11,497	13,687	11,830	13,082	11,723	12,598	12,612
skemat suplementare	4,789	4,707	4,892	4,973	4,933	4,722	5,355	6,110	6,934
shpenzime administrativ	1,973	1,862	2,016	2,159	2,144	2,134	2,293	2,231	2,414
rritja nga viti në vit									
në vlerë	5,737	5,902	5,811	6,967	4,805	6,283	5,874	2,913	13,879
në përqindje	6.4	6.2	5.7	6.5	4.2	5.3	4.7	2.2	10.3
në përqindje nga PBB	7.1	7.3	7.5	7.8	7.7	7.6	7.8	8.3	8.4

Burimi: ISSH, punuar nga grupi i KLSH.

FINANCIMI BUXHETOR *Në milionë/lekë*

Emërtimi/vitet	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Shpenzimet ne total	95,597	101,498	107,309	114,276	119,081	125,364	131,238	134,151	148,030
Te ardhurat kontributet	51,390	61,720	60,068	66,321	73,556	79,340	84,199	83,420	94,803
Financimi buxhetor	44,207	39,778	47,242	47,955	45,525	46,024	47,039	50,731	53,227

Burimi: ISSH, punuar nga grupi i KLSH.



Nga tabelat e mësipërme, konstatohet se të ardhurat dhe shpenzimet për sigurimet shoqërore kanë ardhur duke u rritur nga viti në vit, ndërsa ajo që vihet re është se edhe financimi buxhetor i sigurimeve shoqërore ka ardhur duke u rritur, por nga momenti i implementimit të ndryshimeve ligjore të viti 2014 ai është rritur me 34 % në vitin 2021 ose rreth 13,992 milion lekë.

Një analizë tjetër është edhe numri i kontribuesve dhe përfituesve në sistemin e sigurimeve shoqërore ku nga të dhënat konstatohet se:

NUMRI I KONTRIBUESVE NË MIJË PERSONA

Emërtimi/vitet	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Numri i kontribuesve	561	655	718	718	764	778	781	748	791
rritja nga viti në vit									
në numër	11.4	93.4	63.5	0.2	45.7	14	3	-33	43
në përqindje	2.1	16.6	9.7	0	6.4	1.8	0.4	-4.3	5.8

Burimi: ISSH, punuar nga grupi i KLSH.

NUMRI I KONTRIBUESVE NË PERSONA (i detajuar)

Emërtimi	Vitet									
	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	
Sipas subjekteve	510,747	608,519	668,614	661,655	694,411	721,160	729,816	694,736	738,008	
Buxhetore	138,010	138,651	124,849	137,012	141,436	140,600	140,568	139,555	143,195	
Jobuxhetore	20,029	20,552	20,897	18,389	18,320	17,752	17,403	15,690	20,672	
firma private	201,270	226,886	321,023	325,303	357,630	409,120	418,552	405,003	373,918	
të vetëpunësuar	80,050	86,168	104,686	120,460	110,472	86,796	83,756	82,236	135,695	
të vetëpunësuar në bujqësi	64,274	127,728	89,527	53,168	58,526	58,940	61,563	46,743	58,091	
të siguruar vullnetarisht	7,114	8,534	7,632	7,323	8,027	7,954	7,973	5,509	6,437	

Nga shteti	36,928	32,789	34,125	40,780	41,014	39,272	36,563	35,744	34,985
Ushtarët									
të papunët që përfitojnë pagesë papunësie	13,003	11,304	8,016	5,561	7,106	6,703	9,513	9,518	9,583
personat me pagesë kalimtare	138	176	90	105	46	146	144	166	160
ushtarakët në reformë	10,661	10,057	10,713	10,208	9,840	9,473	8,964	8,297	7,614
policiët në reformë	1,624	1,687							
punonjësit e nëntokës	3,659	3,605	3,208	3,013	3,041	3,177	3,544	3,412	3,163
punonjës të industrisë ushtarake	687	628	592	535	479	435	374	320	338
gra të pensionuara për vitin raportues	7,156	5,331	11,506	21,358	20,502	19,338	14,024	14,031	14,127
Me përfitim afatshkurtër (3)	13,494	13,255	15,331	15,851	16,958	17,679	15,545	17,395	17,842
paaftësi të përkohshme në punë mbi ditën e 14-të	1,445	1,116	1,485	1,419	1,600	1,971	1,249	1,113	1,440
leje barrë lindje	12,014	12,114	13,808	14,403	15,322	15,649	14,251	16,242	16,336
paaftësi nga aksidentet e sëmundje profesionale	35	25	38	29	37	59	45	40	65
Numri i kontribuuesve	561,169	654,563	718,070	718,286	752,383	778,111	781,924	747,875	790,835

Burimi: ISSH, punuar nga grupi i KLSH.

Nga analiza e treguesve në tabelat e mësipërme mbi numrin e kontribuuesve për sigurimet shoqërore duket qartë se numri i tyre ka ardhur duke u rritur nga viti në vit, megjithatë ajo që vlen të theksohet se me gjithë punën e bërë nga institucionet për rritjen e tyre vihen re disa fenomene negative si:

- rritja e tyre ka qenë shumë e ulët sidomos gjatë vitit 2019 dhe 2020 ku dhe ka patur ulje të kontribuuesve, kjo mund të justifikohet edhe me faktin se këto dy vite kanë qenë vite të pandemisë, megjithëse numri i punonjësve buxhetor është rritur;
- numri i punonjësve buxhetor është rritur shumë deri në vitin 2021 në krahasim me vitin 2015, kështu ai është rritur me 18 mijë punonjës ose me 15%, kjo sjell dhe rritjen e ardhurat nga kontributet për sigurimet shoqërore, por duhet thënë se këto detyrime i paguan buxheti i shtetit në pjesën më të madhe;
- numri i punonjësve buxhetor ka pësuar një rritje të konsiderueshme gjatë vitit 2021 e krahasuar me vitin 2019 ó 2020, ku numri i punonjësve është rritur me rreth 3640 punonjës;
- numri i punonjësve jobuxhetor ku përfshihen punonjësit që punojnë në institucionet shtetërore apo bashkive të cilët marrëdhëniet e punës i rregullohen nga kodi i punës, punonjësit ku shtetit është aksionari në më shumë se 51 %, etj., ka pësuar rritje nga viti 2019 por rritjen më të madhe e ka patur gjatë vitit 2021 krahasuar me 2020 me rreth 5,000 punonjës, për të cilët edhe në këtë rast duhet thënë se sigurimet shoqërore dhe shëndetësore i paguan buxheti i shtetit në pjesën më të madhe;
- numri i punonjësve të siguruar nga firmat private në përgjithësi ka ardhur duke u rritur nga viti në vit megjithëse ai ka pësuar ulje të ndjeshme gjatë dy viteve të fundit 2020-2021 por një rritje të ndjeshme ka patur numri i të vetëpunësuarve gjatë vitit 2021;
- një fenomen tjetër është dhe ulja në mënyrë të vazhdueshme e numrit të siguruarave në bujqësi apo të vetëpunësuarit në bujqësi megjithatë edhe këtu duhet theksuar se kemi një rritje të numrit të tyre sidomos gjatë vitit 2021 ku numri i tyre ka filluar të arrijë shifrat e vitit 2017.

NUMRI I PENSIONEVE TË PLEQËRISË NË MIJË PERSONA

Emërtimi/vitet	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
pensione pleqërie	447.3	460.7	474.5	488	498.1	512.5	529.1	544	557
rritja nga viti në vit									
në numër	13.4	13.5	13.7	13.6	10.1	14.4	16.6	14.9	13
në përqindje	3.1	3	3	2.9	2.1	2.9	3.2	2.8	2.4


Burimi: ISSH, punuar nga grupi i KLSH.

RAPORTI NË MIJË PERSONA I NUMRIT TË KONTRIBUESVE ME NUMRIN E PËRFITUESVE

Emërtimi /vitet	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Kontribuues	561.2	654.6	718.1	718.3	764	778	781	748	791
pensione pleqërie	447.3	460.7	474.5	488	498.1	512.5	529.1	544	557
NVS (K/P)	1.25	1.42	1.51	1.47	1.53	1.52	1.48	1.37	1.42

Nga analiza e treguesve në tabelat e mësipërme mbi numrin e pensionistëve si dhe raporti i numrit të kontribuuesve me numrin e përfituesve konstatohet se:

- evidentohet zhvillim kritik i shkallës së varësisë së sistemit;
 - o numri i personave të siguruar për çdo pensionist ishte në nivelet 1.2 me 1;
 - o kjo shkallë e lartë vartësie e pamjaftueshme për mbulimin e parametrave financiar të sistemit është kompensuar me rritjen e subvencioneve buxhetore dhe gjithashtu nga masa pensionesh të kufizuara në mënyrë administrative, nëpërmjet tavaneve, të cilat kanë dëmtuar lidhjen organike midis kontributit dhe përfitimit si dhe kanë stimuluar shmangiet nga pagesat për së paku të gjithë ata që kanë pasur rroga mbi nivelin e pagës mesatare;
- numri i pensionistëve nga viti në vit ka ardhur duke u rritur ku krahasuar me vitin 2014 ai është rritur me rreth 90 mijë pensionistë çka tregon se ai është në trend rritës të vazhdueshëm, gjithashtu ai do të ishte edhe më i lartë nëse nuk do të rritej mosha e daljes në pension e grave e cila për disa vite do të barazohet me të burrave ndërsa e të burrave do të rritet më vonë. Rritja e moshës daljes grave në pension bën që numri i pensionistëve të jetë më i ulët sepse është shtyrë koha e daljes tyre në pension për një periudhë nga një deri në pesë vite;
- fenomen tjetër shqetësues për gjithë sistemin e financave të vendit dhe në mënyrë të veçantë për sigurimet shoqërore është shkalla e vartësisë së sistemit e cila me gjithë përmirësimet vazhdon të jete e brishtë sepse vazhdon të jetë e ulët sepse për 1 përfitues duhet të paguajnë 1.42 kontribuues;
- gjithashtu një fenomen tjetër është edhe nëse shohim shkallën e zëvendësimit të pensioneve e cila llogaritet si raport i pensionit mesatar me pagën mesatare ai është në nivele të ulëta, që do të thotë se pensionistët përfitojnë një pension shumë më të vogël sesa paga mesatare.



Nga analiza e treguesve në tabelës së mësipërme mbi kufirin e pagës minimale dhe maksimale, afatet dhe % e kontributit sipas viteve të ndryshuara vit pas viti me ligj apo VKM konstatohet se:

- paga minimale dhe maksimale nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, gjë e cila reflektohet edhe në masën e përfitimit,
- % e kontributit ka ardhur duke u ulur me rritjen e pagës minimale dhe maksimale, ku uljet më të mëdha janë bërë në vitin 2006 nga 41.9 % në 32.9% dhe në vitin 2009 nga 32.9 % në 27.9 % ,
- paga minimale nga viti 2014 është rritur me rreth 65 % ndërsa paga maksimale nga viti 2014 është rritur me 45 % ,
- nëse do të analizonim bashkë treguesit e rritjes së të ardhurave me rritjen e pagës minimale dhe maksimale do të shikonim që rritja e të ardhurave megjithëse jo në të njëjtat nivele ka ardhur kryesisht nga rritje e pagave, çka tregon se nuk është bërë një punë e mjaftueshme dhe më shumë përpjekje për rritjen e të ardhurave nga shtimi i numrit të kontribuuesve.

TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET NË RAPORT ME PRODHIMIN E BRENDSHËM BRUTO

Në milionë/lekë

Emërtimi/vitet	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Të ardhurat nga kontributet	51,390	61,720	60,068	66,321	73,556	79,340	84,199	83,420	94,803
në përqindje nga PBB	3.8	4.4	4.2	4.5	4.7	4.8	5.0	5.2	5.4
Financimi buxhetor	44,207	39,778	47,242	47,955	45,525	46,024	47,039	50,731	53,227
në përqindje nga PBB	3.3	2.9	3.3	3.3	2.9	2.8	2.8	3.1	3.0
Shpenzimet në total	95,597	101,498	107,309	114,276	119,081	125,364	131,238	134,151	148,030
në përqindje nga PBB	7.1	7.3	7.5	7.8	7.7	7.6	7.8	8.3	8.4

Burimi: ISSH, punuar nga grupi i KLSH.

Nga analiza e treguesve në tabelës së mësipërme mbi të ardhurat dhe shpenzimet në raport me prodhimin e brendshëm bruto konstatohet se:

- të ardhurat nga kontributet në skemën e sigurimeve shoqërore të cilat në vitin 2013 arrijnë në 3,8 % të prodhimit të brendshëm bruto, tregues që vlerësohet të jetë mjaft i ulët krahasuar edhe me vendet e rajonit kanë filluar të rriten nga viti në vit dhe në vitin 2021 kanë arritur në 5.4% të prodhimit të brendshëm bruto;
- financimi buxhetor në skemën e sigurimeve shoqërore pothuajse është në të njëjtat nivele, megjithëse ka patur një tendencë shumë të vogël ulje, çka tregon edhe një herë se skema e sigurimeve shoqërore është shumë e varur nga buxheti i shtetit dhe asnjëherë nuk është shkëputur nga varësia e saj apo treguesit të jenë në përmirësim.

TË DHËNAT DERI MË 31.12.2021 PËR DETYRIMET NË KONTRIBUTET E SIGURIMEVE SHOQËRORE TË PAPAGUARA NË AFAT PËR SUBJEKTET BUXHETORE, JOBUXHETORE, SUBJEKTE JURIDIKEE BIZNES I VOGËL

Në lekë

Nr.	SUBJEKTET	NUMRI	DETYRIMI	GJOBA	INTERESA	DEBIA	%
1	Buxhetorët	384	99,093,273	90,386,858	151,983,878	341,464,009	2.2
2	Jobuxhetorët	279	363,048,551	56,119,657	29,927,907	449,096,115	2.8
3	Subjekte juridike	25,074	8,035,643,527	1,043,729,871	511,605,577	9,590,978,975	60.4
4	Biznes i Vogël	77,891	4,811,671,522	555,636,071	117,890,044	5,485,197,637	34.6
5	TOTAL	103,628	13,309,456,873	1,745,872,457	811,407,406	15,866,736,736	

Burimi: ISSH, punuar nga grupi i KLSH.

Nga analiza e treguesve të tabelës së mësipërme, e të dhënave deri 31.12.2021 për detyrimet në kontributet e sigurimeve shoqërore të papaguara në afat për subjektet buxhetore, jobuxhetore, subjekte juridikee biznes i vogël, konstatohet se:

- një numër shumë i madh prej 103,628 subjektësh janë debitorë i cili ka ardhur nga viti në vit në rritje, ku vlen të theksohet se janë edhe shumë subjekte buxhetore e jobuxhetore të cilat financohen nga buxheti i shtetit për pagën dhe pagesat e sigurimeve shoqërore që vijnë të jenë debitorë;

- një numër shumë i madh subjektsh debitorë janë subjektet juridikë të cilët përbëjnë dhe vlerën më të madhe të detyrimeve ndaj sigurimeve shoqërore rreth 60 % por edhe sepse pas subjekteve debitorë dhe shumave të papaguara të kontributeve, janë një numër i konsiderueshëm personash, të punësuar në këto subjekte, të cilët nuk mund të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore;
- një numër shumë i madh subjektsh të biznesit të vogël e cila përbën rreth 75% të subjekteve debitorë çka nënkupton se mund të jenë rreth 77,891 por edhe më shumë persona të cilët kanë probleme me kontributet në sigurimet shoqërore por edhe nuk mund të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore.

Për sa më sipër, me gjithë punë e bërë nga ISSH, tregon se reforma e ndërmarrë me ndryshimin më të madh të ligjit ekzistues të bërë në vitin 2014 ka problematika të cilat me mbështetjen e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë por dhe më gjerë, duhen analizuar sepse ky proces kërkon:

- përzgjedhje;
- miratim në parim;
- diskutim për mbulimin e kostove ose rritje kontributesh;
- përlllogaritje të plota;
- identifikimi i ndryshimeve ligjore etj.

Kështu sipas specialistëve të ISSH evidentohet që reforma të ketë rezultatet e veta ajo mund të reformohet dhe të përshtatet sa më mirë si në drejtim të:

Si mund të jetë formula e re?

U ndërtua një formulë e re,

- e përbashkët si për skemën e qytetit dhe të fshatit
- aplikohet për personat që kanë 15 vite e më shumë histori kontributesh
- komponent bazë
- një komponent të dytë, që varet nga të ardhurat dhe kontributet individuale

Formula e re, nëpërmjet përgjysmimit të shumës bazë,

- thëllon dhe stimulon në vazhdim parimin kontributeve,
- vendos pensione të lidhura drejtpërdrejt me kontributet e derdhura dhe
- krijon premisa për mbajtjen në nivele të pranuar të raportit të zëvendësimit pension/pagë.

Si duhet bërë indeksimi në vazhdim?

- ❖ *A duhet të hiqet liria e veprimit për indeksim më të lartë.* Institucionalizohet:
 - Indeksi i përfitimeve bazuar vetëm në rritjen vjetore të indeksit të çmimeve.
 - Përcaktohet indeksimi i pagave të mëparshme që do të bëhet bazuar në bazë të rritjes së indeksit mesatar të pagave mbi të cilat janë paguar kontributet përgjatë
 - Këto dispozita ligjore shmangin vendosjen e shtesave administrative apo indeksimet e pa barabarta të masës së pensioneve, të pa mbuluara me rritje të pagave dhe kontributeve.
 - Problemet për rritjen e pensioneve dhe rritjen e pagave !!!!
- ❖ *A duhet të vazhdojë diferenca ndërmjet pagës maksimale dhe pensionit maksimal?* Kjo problematike është konsideruar një deformim i rëndësishëm i parimeve të sistemit si dhe cenim i të drejtës. Formula e re ÷ekonomikisht÷ dhe administrativisht ka abroguar tavanet e përfitimeve.
- ❖ *Cila duhet të jetë diferenca që synohet midis pensionit mesatar dhe atij minimal?* Formula e re vendos gradualisht një shkëputje të lehtë të masës së pensionit të vitit 2014 me atë të vitit 2015 dhe e thëllon atë gradualisht. Raporti midis pensionit minimal me atë mesatar parashikohet të arrijë në nivelet 1 me 1.65.

- Formula e re shmang rritjen e pensionit mesatar në nivele të pa pranueshme ndërkohë që e sjell atë gradualisht në rreth 49 % të pagës mesatare.
- ❖ *Çfarë mbrojtje sociale mund të sigurohet për individë që nuk kanë historik kontributesh, që janë nën kufirin e varfërisë? Pension Social, shuma mujore e të cilit është përcaktuar të jetë afërsisht e barabartë me shumën e të ardhurave që ofrohet nga skema ekzistuese për një të siguruar që ka minimumin e periudhës së sigurimit prej 15 vjetësh,*
- ❖ *Çfarë duhet të bëhet në lidhje me sistemin rural? Opsionet mund të jenë:*
 - t'ua mundësohet kontribuuesve ruralë opsioni për të kontribuar me normë të plotë kontributi dhe me të drejta të plota si për një kontribuues urban,
 - ose marrja vetëm e një pensioni social për ata që nuk kualifikohen për pension. Faktikisht është përzgjedhur një rritje graduale e kontributit deri në barazimin me qytetin, në harkun e 4 viteve.
Një opsion i mirë por jo i vetëm lidhet me masat e qeverisë për riorganizimin e prodhimit dhe reformat strukturore të ekonomisë fshatare, duke përdorur si stimul subvencionet.
- ❖ *Cila duhet të jetë moshja e daljes në pension? A do të marrë në konsideratë Shqipëria të dy apo një prej këtyre propozimeve?*
 - Rritja graduale e moshës së grave për pension, deri në barazimin me burrat (2032) dhe në vazhdim, indeksimi i moshave sipas indeksit të rritjes së jetëgjatësisë-deri në 67 vjeç.
 - Rritja e periudhës maksimale të sigurimit nga 35 në 40 vite, kjo me efekt në masën e shumës bazë të pensionit si dhe të shtesës mbi pension,
 - rritja e moshës së nënave me shumë fëmijë, me 5 vite,
 - rritja e moshës së daljes në pension dhe e kontributeve në skemat suplementare.
- ❖ *Çfarë roli do të kenë kursimet në sistemin e reformuar të pensioneve dhe çfarë duhet të bëhet nga Qeveria për të inkurajuar kursimet?*
 - Përzgjedhja e variantit të parë, përcakton edhe definicionin se pesha dhe roli i skemave të kursimeve pensionale nuk mund të jetë shumë e gjerë dhe dominues por edhe parimisht mbetet të jetë plotësues dhe i zhvilluar dhe për këtë përveç përsosjes së legjislacionit, mbikëqyrjes, forcimit dhe zhvillimit të tregut të investimeve dhe në përgjithësi të tregut të kapitaleve.
 - Një rol i veçantë përcaktohet për Qeverinë e cila brenda hapësirave buxhetore dhe rregulluese të tregut të punës dhe kostove të tij etj., do të duhet të stimulojë forma për zhvillimin e skemave të kursimeve pensionale.
 - Në kushtet kur skema e detyrueshme pasqyron një deficit fiskal sa 1.66 % të PBB, me perspektive afatmesëm jo të mirë edhe pse deficiti disi reduktohet, rruga më normale u konsiderua nxitja e zhvillimit të kolonës së tretë dhe e fondeve profesionale të sigurimit.

✚ Alternativa të një sistemi të plotë pensionesh Konkluzione paraprake.

- ❖ *Referuar argumenteve problematikave dhe përlllogaritjeve :*
 - Reformimi i sistemit PAYG në të gjithë rastet, ku më shumë dhe ku më pak, në një periudhe 30 vjeçare, i shton kostot dhe kërkesat për mbulimin e balancave negative të sistemit,
 - ose, nëse kjo mund të jetë e pa pranueshme atëherë do të duhet të vendosen kontribute shtesë të cilat do të sillnin mjaft problematika në tregun e punës, kostot e saj etj.
 - Nga ana tjetër, kalimi në një sistem të sigurimeve më të plotë mbetet domosdoshmëri si në kuptim të përmirësimit të shkallës së zëvendësimit, rritjes

së përgjegjësisë së individit, shmangies së presioneve për pensione të parakohshme etj.

- Mbetet të diskutojmë mbi këto variante, dhe të tjera, të zgjedhim më të mirin, më të mundshmin, më të balancuarin dhe me një kosto tranzicioni të pranueshme.
- Të përfitojmë nga eksperiencat e disa vendeve të Evropës perëndimore dhe lindore lidhur me sistemet, reformat, problematikat dhe ecurinë e tyre.

Për sa më sipër, të gjitha këto do të arrijnë që sistemi i sigurimeve shoqërore të mundësojë që:

- ✓ të garantojë përfitime për të gjithë, por në proporcion me kontributet e dhëna;
- ✓ të sigurojë një nivel të pranueshëm të mbulimit të popullsisë së vendit me elemente të sigurimit social duke realizuar një koordinim të mirë të sistemit kontributeve me atë asistencial, por pa dekurajuar sistemin kontributeve;
- ✓ të arrijë të realizojnë një reformim rrënjësor të skemës së pensioneve rurale duke eliminuar formulat aktualisht të ndryshme për llogaritjen e pensioneve rurale ndaj atyre urbane;
- ✓ të formulojë dhe zbatojë metoda bashkëkohore të indeksimit të pensioneve duke shmangur problematikat apo emergjencat që krijohen në momente politike të caktuara;
- ✓ realizojë përmirësimin gradual të qëndrueshmërisë financiare të sistemit, garantim të përfitimeve të mbajtura në nivele të pranueshme dhe të merituar, bazuar në kontributet e dhëna.

Titulli i Gjetjes: Përmbyllje e objektivave politikave të pensioneve në drejtim të mbulimit të popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore, rritjes e numrit të kontribuuesve, përmirësimi i efikasitetit në menaxhimin e fondeve përkohësisht të lira dhe fondit rezervë.

Situata: Nga auditimi ka rezultuar se mungon Strategjia për zhvillimin e sistemit të sigurimeve shoqërore në periudhë afat-mesme dhe afat-gjatë; legjislacioni përkatës është shoqëruar me ndryshime të shumta (deri më tani 22 herë) pa arritur reformimin e sistemit dhe zgjidhjen e problematikave të tij: financimi buxhetor ka ardhur duke u rritur nga viti në vit; ka një rritje të ngadaltë dhe të ulët të numrit të kontribuuesve, dhe kjo kryesisht në sektorin publik, ndërsa është në ulje numri i të siguruarve të vetëpunësuar në bujqësi; ka tendencë në rritje numri i përfituesve (pensionistëve), duke e mbajtur shkallën e vartësisë së sistemit në nivele të ulëta 1 kontribuues për 1.42 përfitues; shkalla e zëvendësimit (pension mesatar/kontribute mesatare) është shumë e ulët, duke nxitur informalitetin në këtë drejtim; megjithëse niveli i kontributeve nuk ka ndryshuar për një kohë të gjatë, paga minimale dhe maksimale që nga viti 2014 janë rritur përkatësisht me rreth 65 % dhe 45 %, duke sjellë për pasojë që rritja e të ardhurave kontributeve të jetë kryesisht nga rritja e pagës; krahasuar edhe me vendet e rajonit, vijon të ketë një nivel të ulët të ardhurave nga kontributet shoqërore në raport me prodhimin e brendshëm bruto prej 5.4 % në vitin 2021; ka një numër të konsiderueshëm të subjekteve debitorë prej 103,628 njësi (kryesisht të biznesit të vogël rreth 75 %), duke shkaktuar pasoja këtyre kontribuuesve në përfitimin e pensioneve; edhe ndryshimet e gjëra të ligjit në 2014 nuk i kanë dhënë zgjidhje problematikave të skemës së sigurimeve shoqërore në vendin tonë.

Kriteri: **Baza Ligjore**

Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

- Ndikimi/Efekti:** Përmirësimi i performancës në administrimin e sistemit të sigurimeve shoqërore.
- Shkaku:** Mospërbushja e objektivave dhe rritja e performancës.
- Rëndësia:** E lartë
- Rekomandime:** Instituti i Sigurimeve Shoqërore në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të hartojë Strategjinë e zhvillimit të sistemit të sigurimeve shoqërore, me qëllim arritjen e konsolidimit të skemës, si dhe të mundësojë rritjen e performancës nëpërmjet një reforme të qëndrueshme që i përgjigjet problematikave të sistemit të sigurimeve shoqërore.

2.2 Auditimi i planifikimit dhe realizimit të buxhetit të sigurimeve shoqërore për vitin 2021, për sigurimin e detyrueshëm, sigurimet suplementare dhe programet kompensuese e shpërblimet në drejtim të grumbullimit të ardhurave; realizimit të shpenzimeve; analizimit të deficitit të skemës së pensione; analizimit të niveli i borxhit ndaj skemës së pensione dhe entitetet problematike; analizimit të listë pagesave të kontributeve; bashkëpunimit me institucionet.

Në zbatim të drejtimit të mësipërmu shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- raporte vjetore të ISSH-së;
- pasqyrat financiare të ISSH-së dhe relacionet shpjeguese të veprimtarisë ekonomiko-financiare;
- raporte statistikore të ISSH-së dhe analiza statistikore;
- plane pune dhe relacione.

Nga ku rezulton:

I. Miratimi i buxhetit

a. Në lidhje me aktivitetin financiar të Instituti të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2021, në bazë të ligjit nr. 137/2020, datë 16.11.2020 òPër buxhetin e vitit 2021ö kemi:

Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2021 është:

I. Sigurimi i detyrueshëm, programet kompensuese dhe trajtimet e veçanta.

Të ardhurat gjithsej	137 133	milione lekë;
Nga të cilat:		
- kontributet	83 675	milione lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	51 238	milione lekë;
- transferta për indeksimin e pensioneve	2 220	milione lekë;
Shpenzimet	137 133	milione lekë.

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, është e barabartë me pagën minimale në shkallë vendi dhe ndryshon sa herë që ndryshon kjo pagë. Këshilli i Ministrave përcakton masën e kontributit për personat e vetëpunësuar në bujqësi, si dhe për kategoritë e veçanta të personave të vetëpunësuar. Për vitin 2021 teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve dhe programeve të sigurimit shoqëror të detyrueshëm e suplementar, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensione.

2. Sigurimi suplementar

Të ardhurat gjithsej	7 532	milione lekë;
Nga të cilat:		
- kontributet	1 796	milione lekë;
- transferimet nga buxheti i shtetit	5 556	milione lekë;
- transferta për indeksimin e pensioneve	180	milione lekë;
Shpenzimet	7 532	milione lekë.

Fondi për indeksimin e pensioneve është parashikuar 2,400 milionë lekë. Përdorimi i këtij fondi bëhet sipas përcaktimeve në nenin 61 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, òPër sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisëö, të ndryshuar. Shpenzimet administrative, si pjesë e

shpenzimeve totale për skemën e sigurimeve shoqërore, janë jo më shumë se 2,500 milionë lekë dhe ndahen sipas skemave në proporcion me shpenzimet e drejtpërdrejta. Nga teprica e të ardhurave dhe fondi rezervë i sigurimeve shoqërore përdoren 4,000 milionë lekë për financimin e shpenzimeve, si më sipër.

II. Programimi nga ISSH i PBA 2021-2023 (faza I & II), si dhe programimi i buxhetit të vitit 2021.

Programimi i buxhetit të ISSH-së është i ndarë në tre produkte kryesore dhe secili nga produktet është i ndarë në aktivitetet e veta. Për përgatitjen e buxhetit, ISSH është bazuar në ÷Politikën e Programit, në ÷Qëllimin e Politikës së Programit dhe ÷Objektivat e Politikës së Programit.

Në përputhje me Qëllimin e Politikës së Programit të Sistemit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2021, nga auditimi ISSH ka punuar në arritjen dhe në përmbushje të objektivave si:

1. realizimi i programit së të ardhurave të fondit të sigurimeve shoqërore, në veçanti i të ardhurave në përgjegjësi të ISSH, në shumën vjetore gjithsej 3,324 milionë lekë (këto janë të ardhura të derdhura nga fermerët dhe vullnetarët, të cilat mblidhen nga vetë ISSH);
2. indeksimin e përfitimeve bazuar në rritjen e indeksit të çmimeve të mallrave të konsumit të shportës së pensionistëve për vitin 2021, në shumën 2,400 milion lekë, (e cila llogaritet në bazë të indeksimit të çmimeve të një viti më parë, nga INSTAT);
3. indeksimin e bazës së vlerësuar, bazuar në ecurinë e ngarkesës mesatare të kontributeve si dhe të zbatimit të këtij indeksi në të njëjtën kohë me indeksimin e përfitimeve aktuale;
4. rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve dhe orientimit punës së ISSH-së pro-klient duke shtrirë në të gjitha kuptimet sistemin on-line të aplikimit dhe të plotësimit të kërkesave të qytetarëve ndaj sistemit të sigurimeve shoqërore për të gjitha llojet e përfitimeve;
5. thjeshtëzimin e procedurave të përfitimeve, eliminimi i barrierave administrative dhe respektimin e afateve ligjore të shërbimit, në uljen me 3% të numrit të pensioneve që caktohen jashtë afateve ligjore, duke vënë theksin sidomos në drejtim të ngushtimit të afateve të caktimit të pensioneve të invaliditetit; si dhe zbatimin e programit të ri të aplikimeve online për përfitimet afatshkurtra- sëmundje, barrëlindje, e të tjerë;
6. përditësimin e bazës së të dhënave për kontributet dhe periudhat e sigurimit të periudhës nga viti 2012 e në vazhdim, ku sistemi i të dhënave është informatizuar ose pagat e kontribuuesve hidhen në sistem nga DPT.
7. informimin e vazhdueshëm të organeve vendimmarrëse dhe ekzekutuese në MFE dhe DPT, për mbledhjen e borxheve të kontributeve të subjekteve ndaj personave të punësuar;
8. mbështetjen aktive sipas dispozitave të kodit Evropian të Sigurimeve Shoqërore, për shqiptarët që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit, për punonjësit shqiptarë që punojnë në mënyrë sezonale në vendet e tjera, duke i dhënë prioritet vendeve ku ka më shumë prezencë të shqiptarëve.

Hartimin e projektbuxhetit afatmesëm 2021-2023, dhe në veçanti i projektbuxhetit vjetor 2021 me detajimin e fondeve të planifikuara për sistemin e sigurimeve shoqërore, ISSH e ka realizuar duke mbajtur parasysh metodikat e përcaktuara me ligj, në tavanet e shpenzimeve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, udhëzimet përkatëse nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe Programi ÷Sigurime Shoqërore, i cili mbulon me fonde të drejtat e fituara dhe ato që lindin gjatë vitit planifikues nga skemat e sigurimit shoqëror të detyrueshëm, programet e veçanta sociale të qeverisë, sigurimeve suplementare dhe trajtimeve financiare të veçanta. Gjithashtu, ky program parashikon fonde për kryerjen e funksioneve të ISSH, për administrimin e modernizimin e sistemit të sigurimeve shoqërore, të infrastrukturës së tij, transmetimit të dhënave, funksionimit të Regjistrave Qendrorë, si dhe komisione shërbimi që u paguhen të tretëve për realizimin e transfertave nga buxheti i ISSH, në buxhetet familjare.

Për përgatitjen e PBA-së 2021-2023, ISSH ka kryer llogaritjet në bazë të parashikimeve dhe të dhënave statistikore marrë nga sektori i statistikës, sektori i IT e të tjerë, si dhe ka marrë parasysh tendencat e treguesve në vite.

Programimi i buxhetit ka filluar me Programimin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2021-2023, i cili është miratuar me VKM nr. 53, datë 29.01.2020 për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2021-2023, si dhe të udhëzimit të MFE nr. 9, datë 28.02.2020 për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023. Në bazë të tyre dhe tavanëve të programimit buxhetor afatmesëm për ISSH, shpenzimet për fondet speciale të Sigurime Shoqërore dhe Politika të reja pensionesh, janë përcaktuar kuotat e shpenzimeve, të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 1 Kuotat e shpenzimeve të PBA 2021-2023

Në milionë lekë

Emërtimi	2021	2022	2023
I Shpenzimet	143,465	150,465	159,065
II Politika të reja pensionesh	2,620	3,120	3,120

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Sipas të dhënave, konstatohet se përgatitja e buxhetit ka kaluar në dy faza:

-Faza I- strategjike dhe

-Faza II- teknike.

Faza I- Faza Strategjike

Në përputhje me Aktin Normativ nr. 17, datë 22.04.2020 për përfundimin e zbatimit të procedurave dhe afateve për përgatitjen e projektdokumentit të programimit buxhetor afatmesëm për vitin 2020, ku përfundim bënte viti 2020, si pasojë e situatës pandemike të shkaktuar nga Covid-19, procedurat dhe afatet për përgatitjen e projektdokumentit të programit buxhetor afatmesëm për njësitë e qeverisjes së përgjithshme nuk janë zbatuar në këtë fazë strategjike, megjithatë nga ana e ISSH janë marrë masat që të zbatohet të gjithë procedurat e programimit të buxhetit afatmesëm me MFE. Programi është hartuar në variantin pasiv bazuar në metodologjinë e dërguar, duke programuar në vetë politikat e indeksimit të pensioneve, si dhe të kompensimeve shtesë për rritjen e çmimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të VKM nr. 8, datë 14.01.2015 "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 KWH në muaj". Bazuar në programin buxhetor të vitit 2020, në përfundim të bëra në përgatitjen e PBA, në volumin e të drejtave të fituara dhe në të drejtat për shpenzimet e ardhshme, sipas kërkesave të dispozitave ligjore në fushën e pensioneve dhe limitet e shpenzimeve për projektbuxhetin e vitit 2021. Gjithashtu, janë hartuar edhe nevojat për fonde, për zbatimin e politikave të indeksimit të pensioneve.

Nga hartimi i programit buxhetor të ISSH-së për periudhën 2021-2023, evidentohet se shpenzimet e programit të Sigurime Shoqërore në variantin pasiv për vitet 2021, 2022, 2023, duke marrë parasysh edhe efektet mbetëse të rritjes së pensioneve për çdo vit në nivelet e inflacionit të vendosura nga qeveria nga data 1 prill për secilin vit, si për qytetin ashtu edhe për fshatin, janë si më poshtë:

Tabela nr. 2 Shpenzimet e programit "Sigurime Shoqërore" në variantin pasiv.

Në milionë lekë

Emërtimi	2021	2022	2023
Shpenzimet e Programit	143,465	150,465	159,065
Politika të reja pensionesh	2,620	3,120	3,120

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Ndërkohë, tavanet e dërguara nga MFE në fazën strategjike, për shpenzimet e programit të Sigurime Shoqërore janë të njëjta si tabela e mësipërme.

Për sa më sipër konstatohet se në planifikimin strategjik të dhënave të dërguara nga MFE janë njësoj me ato të planifikuara nga ISSH, çka tregon se planifikimi nuk është realizuar plotësisht

në bazë të analizave dhe studimeve konkrete, por është thjeshtë një përshtatje shifrash midis institucioneve të cilat llogariten në bazë të eksperiencës dhe një trendi rritës madje mund të themi se shifrat e ISSH-së përshtaten njësoj me ato të MFE si organ epror.

Gjithashtu nga auditimi konstatohet se, hartimi i treguesve të buxhetit vjetor e atij afatmesëm në fazën e I strategjike, sipas të dhënave të paraqitura është kryer i përqendruar në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH-së, duke qenë se vëmendja kryesore në këtë fazë përqendrohet në drejtim të hartimit të treguesve të buxhetit të përgjithshëm të përfitimeve, të politikave të pensioneve, si dhe të politikave të zhvillimit të infrastrukturës duke mos përfshirë në këtë fazë programimi, njësitë shpenzuese rajonale, me justifikimin se ato nuk kanë tregues të mjaftueshëm për të realizuar atë, pasi si regjistri i shtetasve ashtu edhe arkivat e periudhave të sigurimit dhe politikat e pensioneve janë çështje qendrore. Mendojmë se, përfshirja e tyre në këtë fazë të planifikimit strategjik mund të ishte e dobishme, sepse do të përmbledhonte eksperiencat e tyre në vite pavarësisht se nuk kanë të dhëna makro.

Faza II – Faza Teknike

Në këtë fazë, konstatohet se ISSH ka aktivizuar në këtë proces programimi të gjithë strukturat dhe njësitë shpenzuese, për të hartuar udhëzimin për procesin e programimit. Grupet (ekipet) e programimit kanë shpërndarë dhe mbledhur nga të gjithë njësitë shpenzuese treguesit e programit së të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit të ardhshëm 2021.

Në përfundim të fazës së II, treguesit e programit buxhetor si dhe relacioni i projektvendimit òPër Buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për Vitin 2021ò, është paraqitur për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Administrativ. Me Vendimin e Këshillit Administrativ nr. 8, datë 30.12.2020, është miratuar detajimi i treguesve të buxhetit të ISSH për vitin 2021, për çdo Drejtori Rajonale, për Arkivin Qendror dhe për Buxhetin e Brendshëm. Vendim, i cili ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2021. Në përfundim të fazës së II, ISSH ka dërguar në MFE treguesit e programit buxhetor, të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 3 Shpenzimet e programit “Sigurime Shoqërore”, faza II

Në milionë lekë

Emërtimi	2021	2022	2023
Shpenzimet e Programit	143,215	150,365	158,065
Politika te reja pensionesh	2,500	3,000	3,120

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Tavanet e dërguara nga MFE për fazën e II të PBA-së, për shpenzimet e programit òSigurime Shoqëroreò përkatësisht sipas viteve 2021, 2022, 2023 paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 4Tavanet e programit“Sigurime Shoqërore”,dërguar nga MFE

Në milionë lekë

Emërtimi	2021	2022	2023
Shpenzimet e Programit	143,215	150,365	158,065
Politika te reja pensionesh	2,500	3,000	3,120

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Në variantin aktiv, shumës së shpenzimeve do të shtohet për çdo vit efekti financiar vjetor i rritjes së pensioneve në nivelet e inflacionit.

Me shkresën nr. 4814 prot., datë 17.08.2020 òMbi hartimin e treguesve të projekt-buxhetit të ISSH-së për vitin 2021-2023ò, Drejtoria e Financës në ISSH, i ka dërguar Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH), udhëzimin dhe kalendarin për hartimin e treguesve të projekt-buxhetit të vitit 2021, raportet standarde të evidentimit të treguesve të vitit 2019, 2020, të treguesve të projekt-buxhetit të vitit 2021, si dhe draft regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike të vitit 2021.

Në vitin 2020 programi i buxhetit afatmesëm është realizuar edhe nëpërmjet sistemit AFMIS. Për pasojë, programimi nëfazën e III të PBA 2021-2023, është hartuar në zbatim të shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në MFE, nr. 23724 prot., datë 21.12.2020 òMbi përditësimin e të dhënave në sistemin AFMIS për fazën e tretë të PBA 2021-2023ò, në të cilën është kërkuar hedhja dhe përditësimi i të dhënave në sistemin AFMIS nga ana e ISSH, brenda

datës 24.12.2020, si dhe detajimin e planit të buxhetit për shpenzimet korrente dhe kapitale për vitet 2021, 2022, e 2023 për çdo njësi shpenzuese, brenda datës 29.12.2020.

Gjithashtu konstatohet se, PBA 2021-2023 ka kaluar për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Administrativ dhe me Vendim nr. 8, datë 30.12.2020, është miratuar PBA 2021-2023, si dhe protokolluar me nr. 280, datë 13.01.2021.

Tavanet për shpenzimet e vitit 2021 janë në vlerën 144,665 milionë lekë, të cilat janë ndarë në:

- Të ardhurat nga sigurimet shoqërore, në vlerën 85,471 milionë lekë;

- Shuma e transfertës buxhetore (604), në vlerën 59,194 milionë lekë.

Në programin e shpenzimeve për vitin 2021, janë parashikuar edhe shpenzimet nga politikat e indeksimit të pensioneve, të cila për vitin 2021 janë 2,400 milionë lekë. Miratimi me ligjin 137/2020 òPër buxhetin e vitit 2021ò i ISSH-së, si dhe ndryshimi me aktet normative është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 5 Buxheti i ISSH për vitin 2021

Në milionë lekë

Nr.	Emërtimi	Tavanet nga MFE	Aprovuar nga MFE	Plani i ndryshuar sipas A/N të MFE	Fakti /Realizimi
I	Totali i shpenzimeve:	145,715	144,665	149,165	148,030
1	Shpenzime për përfitime	123,569	123,019	126,048	126,126
2	Shpenzime për prog. të tjera	9,394	9,394	13,025	12,610
3	Shpenzime për skemën supliment.	7,652	7,352	7,532	6,879
4	Shpenzime administrative	2,600	2,500	2,560	2,414
5	Indeksi i pensioneve	2,500	2,400		
II	Totali i të ardhurave	145,715	144,665	149,165	152,698
1	Nga kontributet	91,139	85,471	91,271	94,804
2	Nga buxheti i shtetit	52,076	56,794	57,894	57,894
3	Indeksi i pensioneve	2,500	2,400		
III	Te ardhura - Shpenzime				4,668

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Buxheti i vitit 2021

Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar shpenzimet dhe numri i përfituesve për vitet 2019, 2020 dhe 2021, detajuar sipas programeve:

Tabela nr. 6 Shpenzimet dhe nr. i përfituesve për vitet 2019, 2020 dhe 2021*Në milionë lekë*

	Programet	Fakti 2019		Fakti 2020		Programimi 2021	
		Shpenzime	Nr. përfituesve	Shpenzime	Nr. përfituesve	Shpenzime	Nr. përfituesve
1	Shpenzime për përfitimet.	112,027	660,667	113,212	659,182	125,235	728,862
2	Shpenzime për programe të tjera.	11,723	547,588	12,597	538,660	9,398	514,480
3	Shpenzime të skemës suplement.	5,195	56,742	6,110	41,860	7,532	61,382
4	Shpenzimet administrative.	2,294		2,232		2,500	
	TOTALI	131,239		134,151		144,665	

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Përfundimisht, buxheti i sigurimeve shoqërore i vitit 2021, është miratuar me ligjin nr. 137/2020 òPër buxhetin e vitit 2021ò, i cili është detajuar për çdo njësi shpenzuese dhe pas miratimit në KA është dërguar për zbatim me shkresën nr. 37, datë 05.01.2021 òDërgohet buxheti i vitit 2021ò.

Bazuar në metodologjinë e programimit dhe në politikat e programeve, përveç mbulimit me fonde të përfitimeve të pensionistëve dhe të programeve të veçanta e suplementare, si e drejtë e fituar, në buxhetin e vitit 2021 janë parashikuar dhe mbuluar me fonde:

- Rritja e nivelit të përfitimeve të pensionistëve për shkak të rritjes së indeksit të çmimeve, duke vendosur në dispozicion një fond prej 2,400 milionë lekë, i cili ka mbuluar indeksimin e pensioneve, politikë e cila zbatohet çdo vit.
- Zgjerimi i numrit të përfituesve të kompensimit të çmimit të energjisë elektrike duke futur në këtë skemë edhe pensionistët e vetëm të fshatit me një efekt financiar prej 145 milionë lekë.
- Zbatimin e plotë të skemave të përfitimeve suplementare dhe të parakohshme të profesioneve shumë të vështira, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 29/2019 òPër trajtimin

financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji, me një efekt financiar për rreth 1,500 milionë lekë.

Në buxhetin e vitit 2021 janë të përllogaritura dhe të përfshira edhe efektet financiare të rritjes së numrit të përfituesve të pensioneve, krahasuar me vitin 2020.

Sa më sipër, buxheti i ISSH për vitin 2021, në variantin pasiv është përcaktuar 142,265 milionë lekë pa indeksimin dhe së bashku me fondet për rritjen e pensioneve arrijnë në shumën 144,665 milionë lekë, me një rritje prej 4,0 % më shumë se buxheti i vitit 2020. Edhe për vitin 2021, buxheti i ISSH-së përbëhet nga tre programe bazë:

- Sigurimi i Detyrueshëm Shoqëror;
- Programet e Veçanta e Kompensuese të Shtetit;
- Sigurimet Suplementare e Trajtimet e Veçanta.

Transferrat në buxhetet familjare nga të tre programet, në variantin pasiv ndahen si më poshtë:

- a. **Sigurimi i detyrueshëm shoqëror** 125,235 milionë lekë, ose rreth 86.6 % të totalit të transfertave në buxhetet familjare. Sigurimi i detyrueshëm financohet nga kontributet e drejtpërdrejta të personave juridik dhe fizikë që parashikohen 83,675 milionë lekë, me një rritje ndaj vitit 2020 prej 5.5 %, përafërsisht sipas parametrave të vijueshmërisë vjetore të rritjes së të ardhurave, krahasuar me vitin 2019, para pandemisë. Pjesa tjetër e shpenzimeve financohet nga kontributet e shtetit për ushtarakët, asistentët e paraplegjikëve, diferenca e kontributit të fermerëve, periudha e njohur e sigurimit për gratë që kanë kryer shkollën e lartë, si dhe nga financimet për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.
- b. **Programet e veçanta e kompesuese të shtetit**, 9,398 milionë lekë, zënë 6.5 % të transfertave në buxhetet familjare dhe financohen nga Buxheti i Shtetit.
- c. **Sigurimi suplementar dhe trajtimet e veçanta** 7,532 milionë lekë, zënë 5.2 % të shpenzimeve dhe financohen kryesisht nga Buxheti i Shtetit, si dhe nga kontributet suplementare. Shpenzimet për skemat suplementare përgjithësisht financohen nga buxheti i shtetit dhe një pjesë e tyre për 1,796 milionë lekë, nga kontributet suplementare të punonjësve të lartë të shtetit, personave që kryejnë funksione kushtetuese, ushtarakët, policia dhe struktura të tjera në varësi të Ministrisë së Brendshme. Transferata buxhetore vjetore e parashikuar për sistemin e sigurimeve, realizohet nëpërmjet buxhetit të dy ministrive, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me 53,814 milionë lekë dhe Ministria e Mbrojtjes, për programin òMbrojtje sociale për ushtarakët, në shumën 5,380 milionë lekë.
- d. **Buxheti administrativ**, parashikohej të ishte në shumën 2,500 milionë lekë, dhe zë 1.8 % të totalit të shpenzimeve.

Nga ana e ISSH, financimi i shpenzimeve të buxhetit të sigurimeve shoqërore për vitin 2021 është realizuar:

1. nga kontributet e sigurimeve shoqërore, në vlerën 85,471 milionë lekë ose 59.1 % të totalit së të ardhurave;
2. nga financimet e buxhetit të shtetit, në vlerën 59,194 milionë lekë ose 40.9 % të totalit së të ardhurave e ndarë në:
 - skemën e detyrueshme, në vlerën 51,594 milionë lekë ose 36 % e totalit të shpenzimeve të ISSH-së;
 - skemën suplementare, në vlerën 5,200 milionë lekë ose 3,6 % e totalit të shpenzimeve të ISSH-së;
 - politikatat e rritjes së pensioneve për vitin 2021, e cila është në vlerën 2,400 milionë lekë.

Në mënyrë të përmbledhur plani i ISSH me ndryshimet e Buxhetit të Skemës së Sigurimeve Shoqërore sipas ligjit nr. 137/2020 dhe akteve normative, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 7 Buxheti i ISSH, viti 2021

Në milionë lekë

Buxheti i ISSH-së për vitin 2021, sipas Akteve normative	Sipas ligjit të buxhetit 137/2020	Sipas Aktit Normativ nr. 18, datë 14.04.2021	Sipas Aktit Normativ nr. 34, datë 03.12.2021	Ndryshimi
Skema e sigurimit të detyrueshëm, programet kompensuese dhe trajtimet e veçanta				
Të ardhurat, gjithsej	137,133	137,133	141,633	4,500
Nga të cilat:				
Kontributet	83,675	84,475	89,340	5,665
Transferimet nga Buxheti i Shtetit	51,238	50,438	46,573	(4,665)
Transferta nga buxheti për indeksimin e pensioneve	2,220	2,220	2,220	-
Transferta nga buxheti për bonusin e pensionisteve			3,500	3,500
Shpenzimet	137,133	137,133	141,633	4,500
Skema e sigurimit suplementar				
Të ardhurat, gjithsej	7,532	7,532	7,532	-
Nga të cilat:				
Kontributet	1,796	1,796	1,931	135
Transferimet nga Buxheti i Shtetit	5,556	5,556	5,421	(135)
Transferta për indeksimin e pensioneve nga buxheti	180	180	180	-
Shpenzimet	7,532	7,532	7,532	-
Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror dhe suplementar				
Të ardhurat, gjithsej	144,665	144,665	149,165	4,500
Nga të cilat:				
Kontributet	85,471	86,271	91,271	5,800
Transferimet nga Buxheti i Shtetit	56,794	55,994	51,994	(4,800)
Transferta nga buxheti për indeksimin e pensioneve	2,400	2,400	2,400	-
Transferta nga buxheti për bonusin e pensionisteve			3,500	3,500
Shpenzimet	144,665	144,665	149,165	4,500

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

III.

A. Realizimi i programimit së të ardhurave, për vitin 2021.

Nga auditimi i realizimit të programimit së të ardhurave për vitin 2021, konstatohet se, të ardhurat gjithsej nga kontributet e sigurimeve shoqërore për vitin 2021 në shkallë vendi, nga 91,576,000 mijë lekë të programuara, u realizuan 94,857,582 mijë lekë ose në masën 104%. Të ardhurat e programuara për vitin 2021, të ndara sipas përgjegjësisve, janë realizuar si më poshtë:

- Për ISSH, të ardhurat ishin programuar 2,800,000 mijë lekë dhe u realizuan 3,324,074 mijë lekë ose 119 %, me një tejkalim prej 524,074 mijë lekë, nga të cilat:
 - o Të ardhurat për sigurimet shoqërore ishin programuar 2,495,000 mijë lekë dhe u realizuan 3,270,000 mijë lekë ose 131%, me një tejkalim prej 775,000 mijë lekë;
 - o Të ardhurat për sigurimet shëndetësore ishin programuar 305,000 mijë lekë dhe u realizuan 54,074 mijë lekë ose 18%, me një mosrealizim prej 250,926 mijë lekë;
- Për DPT, të ardhurat ishin programuar 88,776,000 mijë lekë dhe u realizuan 91,533,508 mijë lekë ose në masën 103 %.
- Të ardhurat për sigurimin suplementar janë të ardhura nga subjektet në përgjegjësi të DPT. Për këto të ardhura nuk ka programim fillestar.

Të ardhurat plan-fakt për vitin 2021, sipas sektorëve dhe llojit të kontributit, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 8 Realizimi i të ardhurave Plan/Fakt për vitin 2021

Në mijë/ lekë

Nr.	Emërtimi i subjekteve	Gjithsej		Realizimi ne %
		Plan	Fakt	
I	Spektori Publik	-	36,674,950	
1	Buxhetorë	-	31,729,089	
2	Jo buxhetor	-	4,945,861	
II	Spektori Privat	-	52,988,219	
3	Biznesi i Madh	-	49,774,168	
4	Biznesi i Vogël	-	3,214,051	
5	Sigurim Suplementar	-	1,489,319	
6	Sigurim vullnetar	450,000	500,628	111
7	Bujk privat	2,030,000	2,239,044	110
	Sigurime shoqërore	1,725,000	2,184,970	127
	Sigurime shëndetësore	305,000	54,074	18

8	Të ardhura të tjera nga ISSH	320,000	480,386	150
	Të ardhura nga interesat e depozitave		196,415	
	Të ardhura të tjera jotatimore		283,587	
	Të ardhura të tjera		384	
9	Të tjera DPT		381,020	
10	Derdhur në llog të sigurimeve shoqërore	-	104,016	
	Pagesa për ish punonjës & punonjës të rafinerisë Ballsh		100,123	
	Pagesa për familjarët e përfaqësive		3,893	
	GJITHSEJ	91,576,000	94,857,582	104
	Gjithsej sigurime shoqërore	91,271,000	94,803,508	104
	Gjithsej sigurime shëndetësore	305,000	54,074	18

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Tabela nr. 8/1 Realizimi i të ardhurave Plan/Fakt për vitin 2021 Në mijë/ lekë

Nr.	Emërtimi	Sipas ligjit të Buxhetit	Sipas AN 34	ISSH	Shënime
1	Gjithsej	85,471,000	91,271,000	94,803,508	
	<i>Sigurimi i detyrueshëm</i>	<i>83,675,000</i>	<i>89,340,000</i>	<i>93,314,190</i>	
	<i>Sigurimi suplementar</i>	<i>1,796,000</i>	<i>1,931,000</i>	<i>1,489,319</i>	
a)	DPT	85,471,000	91,271,000	91,533,508	
	<i>Sigurimi i detyrueshëm</i>			90,044,189	<i>Realizimi i të ardhurave të raportuar nga DPT e MFE, rakorduar me Akt Rakodim nr. 691/1 dt. 18.01.2022 të MFE dhe nr. 278/1 dt. 24.01.2022 të ISSH</i>
	<i>Sigurimi suplementar</i>			1,489,319	<i>Realizimi i të ardhurave të raportuar nga DPT e MFE, rakorduar me Akt Rakodim nr. 691/1 dt. 18.01.2022 të MFE dhe nr. 278/1 dt. 24.01.2022 të ISSH</i>
b)	ISSH	2,800,000	2,800,000	3,324,075	
	Sigurime shoqërore	2,495,000	2,495,000	3,270,000	<i>Realizimi i të ardhurave nga ISSH (të ardhurat sigurim fermer, kamatëvonesa, sigurim vullnetar, sigurim të derdhura në ISSH sipas VKM 909 dt. 18.11.2020" Derdhje Kontributeve Naftëtar", të ardhura të tjera ISSH)</i>
	Sigurime shëndetësore	305,000	305,000	54,074	

Më hollësisht të dhënat për tabelat me rakordimet dhe shkresat me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë janë në aneks.

/ITI 2021 TE DHENAT FAKTIKE TE KONTRIBUTEVE

		12 mujori
		PROGRESIVE
512	KONTRIBUTE TE SIG.SHOQËRORE E SHENDETESORE SUPLEMENT. DHE TJERA NGA TSA	91,533,507,952.00
5120100	KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE SHOQËRORE TSA	90,044,189,346.00
5120100	KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE SHENDETESORE TSA (12.188%)	-
5120100	SIGURIME SUPLEMENTARE	1,489,318,646.00
5120100	TE ARDHURA TE TJERA TSA (gjoha+kamat vonesa)	-
7	KONTRIBUTE TE SIG.SHOQËRORE E SHENDETESORE NGA ISSH	2,843,688,449.00
752	KONTRIB. TE SIG.SHOQ-SHENDET NGA SUB.TJERA (derdh ne llog e rajoneve)	104,016,276.00
7520100	SIG.SHOQËRORE	104,016,276.00
7520200	SIG.SHENDETESORE	-
753	SIGURIME TE FERMERIVE	2,239,044,388.29
7530100	SIG.SHOQËRORE	2,088,601,107.06
4670100	SIG.SHENDETESORE	54,074,058.20
7115103	GJOBA DHE SEKUESTRIME	-
7115500	KAMAT VONESA	96,369,211.03
754	SIGURIMI SHOQËRORE VULLNETAR	500,627,788.71
7540100	SIG.SHOQ.NGA SHTETAS ME BANIM JASHE	471,139,117.71
7540200	SIG.SHOQ.NGA KONTRIBUES TE PERKOHSEM	29,488,671.00
7	TE ARDHURA TE TJERA TE ISSH ILOG. (765;719; 711; 710; 116)	480,386,051.83
437	TRANSFERUAR NE ISKSH	
4371299	XHIRIME TE KONTRIB. TE MBLEDHURA NE LLOG.E ISKSH NGA TSA	52,241,495.20
4371499	XHIRIME TE KONTRIB. TE MBLEDHURA NE LLOG.E ISKSH NGA ISSH	-
	SIGURIME SHOQËRORE	52,241,495.20
		94,803,508,436.63

INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA E KONTRIBUTEVE
SEKTORI I MARRDHËNIEVE ME TATIMET DHE ADMINISTRIMIT TË TË DHËNAVE

EVIDENCA E TË ARDHURAVE KONTRIBUTIVE PËR MUAJIN JANAR - DHJETOR 2021

Pasq.nr.1/1
në mijë lekë

Nr	Emertimi i subjekteve	Gjithsej		Realizimi ne %	Nga këto						
		Plan	Fakt		ISSH		Realizimi ne %	Tatime		Realizimi ne %	
					Plan	Fakt		Plan	Fakt		
I	Sektori Publik	-	36,674,950		-	-	-	-	-	-	-
1	Buxhetore	-	31,729,089		-	-	-	-	-	-	-
2	Jobuxhetor	-	4,945,861		-	-	-	-	-	-	-
II	Sektori Privat	-	52,988,219		-	-	-	-	-	-	-
3	Bisnesi i Madh	-	49,774,168		-	-	-	-	-	-	-
4	Bisnesi i Vogël	-	3,214,051		-	-	-	-	-	-	-
5	Sigurim Suplementar	-	1,489,319		-	-	-	-	-	-	-
6	Sigurim vullnetar	450,000	500,628	111	450,000	500,628	111	-	-	-	-
7	Bujk private	2,030,000	2,239,044	110	2,030,000	2,239,044	110	-	-	-	-
	Sigurime shoqërore	1,725,000	2,184,970	127	1,725,000	2,184,970	127	-	-	-	-
	Sigurime shëndetësore	305,000	54,074	18	305,000	54,074	18	-	-	-	-
8	Të tjera ISSH	320,000	480,386	150	320,000	480,386	150	-	-	-	-
9	Të tjera DPT	-	381,020		-	-	-	-	-	-	-
10	Derdhur në llog të sig.shoq	-	104,016		-	-	-	-	-	-	-
	GJITHSEJ	91,576,000	94,857,582	104	2,800,000	3,324,074	119	-	-	-	-
	Gjithsej sigurime shoqërore	91,271,000	94,803,508	104	2,495,000	3,270,000	131	88,776,000	91,533,508	103	103
	Gjithsej sigurime shëndetësore	305,000	54,074	18	305,000	54,074	18	88,776,000	91,533,508	103	103

2,184,970 (2,088,601 sig shoq bujk dhe 96,369 kamate e bujkut)

Shifra 91,537,376 në mijë lekë janë të ardhurat të dërguara nga DPT

Sipas aktit normativ nr 34 datë 03.12.2021 për disa ndryshime në ligjin nr 137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, është bërë rritja e planit me 5,000 në miliona lekë.

Ndërsa përsa i përket realizimit të të ardhurave nga tatimet (nga rakordimi me ministrinë e Financave dhe Ekonomisë), kemi pakësim të të ardhurave . Përkatesisht për llog. 75XXXXX: 3.286,575 lekë dhe per llogarine 7090101: 581.682 lekë (kamate).

Pas konfirmimit nga Drejtoria e Financës në ISSH shifra 3,287 (49,777,455-3,287) në mijë lekë është zbritur tek biznesi i madh dhe kamata 582 (381,602-582)

është zbritur tek "të tjera" ku përfshin gjokat dhe kamatat. Pas ndryshimeve, plani dhe realizimi i të ardhurave nga tatimet për vitin 2021 paraqiten në pasqyrën e mësipërme.

Tabela 8/2 Investimii fondit rezervë

Viti 2021	banka ku u bllokua shuma(escrow)	afati maturimit	Data e emetimit	Data e maturimit	Shuma e investuar	Interesi Neto
Obligacion	BSH	2Vjeçar	18.09.2020	09.07.2022	2,452,900,000	6,130,746
Bono Thesari	BSH	12mujour	31.12.2020	30.12.2021	789,400,000	17,493,476
Bono Thesari	BSH	12mujour	04.03.2021	03.03.2022	1,114,910,000	21,374,573
Bono Thesari	BSH	12mujour	22.04.2021	21.04.2022	2,700,000,000	33,142,217
Bono Thesari	BSH	12mujour	01.07.2021	30.06.2022	360,000,000	
Obligacion	BSH	2Vjeçar	26.07.2021	26.07.2023	410,000,000	24,393,073
Bono Thesari	BSH	12mujour	02.09.2021	01.09.2022	1,090,450,000	15,383,102
Obligacion	BSH	2Vjeçar	01.10.2021	01.10.2023	338,000,000	
Bono Thesari	BSH	12mujour	21.10.2021	20.10.2022	1,443,000,000	18,155,661
Bono Thesari	BSH	12mujour	04.11.2021	03.11.2022	295,600,000	4,410,681
Bono Thesari	BSH	12mujour	04.02.2021	03.02.2022	1,734,380,000	29,319,999
					12,728,640,000	169,803,528


Instituti i Sigurimeve Shoqërore që nga koha e krijimit të tij e deri më sot ka krijuar një fond rezervë për skemën e sigurimit shoqëror, fond i cili garanton mbulimin e pagesave të skemës së pensioneve në raste fatkeqësish apo situata të jashtëzakonshme për të paktën një muaj.

Fondi rezervë i pensioneve të ISSH që nga koha e krijimit të tij është investuar në tituj financiar qeveritar që garantojnë besueshmëri dhe siguri financiare. Ky portofol investimi është diversifikuar me tituj financiar siç janë dëftesat Bono Thesari, të cilët janë tituj të emetuara nga Qeveria Shqiptare. Ndërkohë, nisur nga fakti që fondi rezervë nuk është përdorur apo ky fond ka ardhur duke u rritur ndër vite, por edhe në vijim të rekomandimeve të KLSH-së, portofoli i investuar i fondit të sigurimit shoqëror të ISSH-së është diversifikuar duke shtuar në investim edhe tituj financiar qeveritar siç janë Obligacionet.

Si rezultat i investimit të fondit rezervë janë realizuar përvitin 2021, 196.415 mijë lekë ku vetëm nga obligacionet dhe bonot e thesarit të ardhura janë 169.804 mijë lekë, ndërsa shuma 26.611 mijë lekë janë të ardhura nga depozita javore dhe mujore në bankat e nivelit të dytë.

Pra shuma në total 196.415 mijë lekë janë të ardhura të realizuara nga këto interesa dhe depozita. Grafiki, realizimi i të ardhurave për vitin 2021, paraqitet si më poshtë:

Plan - Fakt i të ardhurave për vitin 2021



Përsa i përket të ardhurave kontributeve të realizuara nga subjektet nën varësi të ISSH-së, informacioni paraqitet sipas përgjegjësive dhe rajoneve në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 9 Realizimi i të ardhurave të sigurimeve shoqërore sipas rajoneve.

Në mijë/ lekë

Nr.	RAJONI	Gjithsej			Nga këto:					
		Plan	Fakt	%	ISSH			Tatimet		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
1	BERAT	2,073,800	2,249,676	108	129,741	149,500	115	1,944,059	2,100,176	108
2	DIBËR	1,772,564	1,928,850	109	123,460	143,810	116	1,649,104	1,785,400	108
3	DURRËS	7,756,825	7,967,779	103	143,851	167,672	117	7,612,974	7,800,107	102
4	ELBASAN	4,009,439	4,339,330	108	243,395	314,727	129	3,766,044	4,024,603	107
5	FIER	4,690,721	5,067,091	108	319,864	384,788	120	4,370,857	4,682,303	107
6	GJIROKASTËR	1,613,372	1,760,482	109	114,679	139,969	122	1,498,693	1,620,513	108
7	KORÇË	3,326,780	3,538,907	106	210,391	278,383	132	3,116,389	3,260,524	105
8	KUKËS	1,092,674	1,265,802	116	53,388	61,683	116	1,039,286	1,204,119	116
9	LEZHË	2,200,439	2,343,323	106	125,078	159,283	127	2,075,361	2,184,040	105
10	SHKODËR	3,526,799	3,802,260	108	160,556	194,544	121	3,366,243	3,607,716	107
11	TIRANË	54,947,590	55,592,162	101	341,428	397,426	116	54,606,162	55,194,736	101
12	VLORË	3,939,997	4,367,700	111	209,169	298,069	143	3,730,828	4,069,631	109
	ISSH (të tjerë)	320,000	580,146	181	320,000	580,146	181			
	TOTALI	91,271,000	94,803,508	104	2,495,000	3,270,000	131	88,776,000	91,533,508	103

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Nga të dhënat e tabelës, konstatohet se të ardhurat gjithsej janë realizuar dhe tejkaluar nga të gjitha Drejtoritë Rajonale, e konkretisht:

DRSSH Berat 108%, DRSSH Dibër 109%, DRSSH Durrës 103%, DRSSH Elbasan 108%, DRSSH Fier 108%, DRSSH Gjirokastrë 109%, DRSSH Korçë 106%, DRSSH Kukës 116%, DRSSH Lezhë 106%, DRSSH Shkodër 108%, DRSSH Tiranë 101%, DRSSH Vlorë 111%.

B. Realizimi i të ardhurave nga të vetëpunësuarit në bujqësi.

Realizimi i të ardhurave nga të vetëpunësuarit në bujqësi, në ISSH dhe sipas Drejtorive Rajonale është si më poshtë:

Tabela nr. 10 Realizimi i të ardhurave të vetëpunësuarve në bujqësi.

Në mijë/ lekë

Nr.	RAJONET	Janar - Dhjetor 2021			Fakt 2020	Diferencë/ (2021-2020)
		Plan	Fakt	Përqindje		
1	BERAT	125,500	130,375	104	104,339	+ 26,036
2	DIBËR	140,000	144,615	103	123,683	+ 20,932
3	DURRËS	105,000	113,348	108	82,556	+ 30,792
4	ELBASAN	275,000	293,775	107	238,038	+ 55,737
5	FIER	350,000	353,330	101	271,516	+ 81,814
6	GJIROKASTËR	110,000	123,630	112	99,794	+ 23,836
7	KORÇË	223,500	251,958	113	193,436	+ 58,522
8	KUKËS	61,000	61,912	101	56,038	+ 5,874
9	LEZHË	125,000	149,806	120	119,158	+ 30,648
10	SHKODËR	165,000	179,465	109	158,486	+ 20,979
11	TIRANË	160,000	184,023	115	158,398	+ 25,625

12	VLORE	190,000	252,807	133	176,788	+ 76,019
	SHUMA	2,030,000	2,239,044	110	1,782,230	+ 456,814

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Nga tabela e mësipërme, konstatohet se, të gjithë rajonet e kanë realizuar dhe tejkeluar planin vjetor së të ardhurave për personat e vetëpunësuar në bujqësi. Plani i të ardhurave është realizuar dhe tejkeluar me një vlerë totale prej 209,044 mijë lekë për vitin 2021, ndërsa krahasuar me faktin e një viti më parë, është realizuar më shumë, të ardhurat paraqiten në vlerën 456,814 mijë lekë.

Për sa më sipër, për realizimin e objektivave të Sektorit së të Vetëpunësuarve në Bujqësi, krahas realizimit së të ardhurave, Drejtoritë Rajonale duhet t'ia vënë theksin edhe rritjes së numrit së të siguruarve të vetëpunësuarve në bujqësi, e cila ka të bëjë me rritjen e të ardhurave dhe balancimin e treguesit, numrit të pagesve me numrin e përfituesve. Gjatë vitit 2021, nga auditimi u konstatua se, skema e sigurimeve shoqërore të vetëpunësuarve në bujqësi, është rritur me kontribuues të rinj, në 11,348 kontribuues më shumë, krahasim me vitin 2020.

Nga ana e ISSH, puna për rritjen e numrit të kontributeve në bujqësi gjatë vitit 2021, ka konsistuar në:

a. Shpërndarjen e Njoftimeve tip (formulari 3) për të vetëpunësuarit në bujqësi;

Inspektorët e të vetëpunësuarve në bujqësi, sipas njësive administrative që mbulojnë, kanë shpërndarë njoftimet tip për pagesat e kryera dhe detyrimin për vitin 2021, për të vetëpunësuarit në bujqësi dhe personat që futen për herë të parë në skemë. Në vitin 2021, në të gjithë rajonet janë shpërndarë 78,080 njoftime tip.

b. Shpërndarjen e materialeve publicitare, postera dhe fletë palosje;

c. Publicitetin e bërë nga drejtoritë rajonale në mediat vizive lokale;

d. Programe pune në drejtoritë rajonale;

- Gjatë vitit 2021 nga ana e ISSH-së, janë hartuar programe pune me tematikë si ÷Analizë e detajuar pune, në drejtim të realizimit së të ardhurave dhe numrit fizik të vetëpunësuarve në bujqësi për çdo inspektorë dhe ÷Realizimi i detyrave të lëna në kontrollin e fundit që është ushtruar në DRSSH-të përkatëse,

e. Masat administrative.

Janë dhënë masa disiplinore ndaj inspektorëve të vetëpunësuarve në bujqësi, për mosrealizim së të ardhurave të programuara gjatë periudhës deri në muajin Dhjetor 2021;

C. Realizimi i të ardhurave nga sigurimi vullnetar.

Nga auditimi i realizimit së të ardhurave nga sigurimi vullnetar për vitin 2021, u konstatua se, administrata e ISSH në bashkëpunim me DRSSH, kanë mundur realizimin e të ardhurave të programuara në masën 111 % ose me një tejkalim prej 50,628 mijë lekë, të cilën e kanë arritur, me rritjen e publicitetit të vazhdueshëm dhe intensiv. Në tabelën e mëposhtme po paraqesim realizimin e të ardhurave nga sigurimi vullnetar, sipas DRSSH duke e krahasuar edhe me vitin 2020.

Tabela nr. 11 Realizimi i të ardhurave nga sigurimi vullnetar.

Në mijë/ lekë

Nr.	RAJONET	Janar - Dhjetor 2021			Fakt 2020	Diferencë/ (2021-2020)
		Plan	Fakt	Përqindje		
1	BERAT	20,000	22,058	110	17,465	+4,593
2	DIBËR	2,500	2,910	116	2,153	+757
3	DURRËS	52,000	56,914	109	43,649	+13,265
4	ELBASAN	20,000	27,555	138	15,142	+12,413
5	FIER	37,000	38,608	104	33,822	+4,786
6	GJIROKASTËR	19,000	20,869	110	15,492	+5,377
7	KORÇË	29,000	32,131	111	22,124	+10,007
8	KUKËS	1,000	1,730	173	792	+938
9	LEZHË	10,000	12,839	128	8,190	+4,649
10	SHKODËR	17,000	19,329	114	16,008	+3,321
11	TIRANË	200,000	214,084	107	161,984	+52,100
12	VLORE	42,500	51,601	121	34,488	+17,113
	SHUMA	450,000	500,628	111	371,309	+129,319

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Të ardhurat nga sigurimi vullnetar për vitin 2021, ishin programuar 450,000 mijë lekë dhe u realizuan 500,628 mijë lekë ose 111 %, me një tejkalim prej 50,628 mijë lekë.

Gjatë vitit 2021, Sektori i Sigurimit Vullnetar në ISSH ka bashkërenduar punën me DRSSH-ve në drejtim të rritjes së numrit të kontribuuesve vullnetar në drejtim të: kryerjes së analizave periodike; monitorimit të punës së inspektorëve; sensibilizimit me fushata publicitare, ndjekjes brenda afateve ligjore etj.

Sektori i Sigurimit Vullnetar, ka ndjekur praktikën në zbatim të protokolleve të bashkëpunimit që ISSH me disa patronate si: INAS-CISLI, ACLI-IPSIA, INAC-ALBANIA, me qëllim evidentimin dhe përfshirjen në skemën e sigurimit vullnetar të emigrantëve shqiptarë, të cilët jetojnë jashtë vendit dhe kanë periudha kontributive.

D. Realizimi i të ardhurave të tjera.

Realizimi i të ardhurave të tjera të cilat janë nga ISSH, ishin programuar në masën 320,000 mijë lekë dhe u realizuan në 480,386 mijë lekë ose 150%, me një tejkalim prej 160,386 mijë lekë si dhe të ardhura, ÷Derdhur në llogari të ISSH, 104,016 mijë lekë. Gjithsej 584,402 mijë lekë.

Tabela nr. 12 Realizimi i të ardhurave të tjera

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Janar ó Dhjetor			Diferencë (fakt me plan)
		Plan	Fakt	Përqindje	
1	Të tjera	320,000	480,386	150	160,386
2	Derdhur në llog. Sig. shoq.	0	104,016	0	104,016
	SHUMA	320,000	584,402	183	264,402

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Realizimi dhe tejkalimi i ÷Të ardhurave të tjera ÷ ka ardhur si rezultat i investimit të fondeve përkohësisht të lira të ISSH-së, në letra me vlerë, nga interesat bankare. Ndërsa të ardhurat e derdhura në llogari të ISSH janë kryesisht depozita, obligacione e bono thesari.

IV.

Administrimi i Përfitimeve dhe Transfertave në Buxhetet Familjeve për vitin 2021.

Administrimi i Përfitimeve dhe Transfertave në Buxhetet Familjeve për vitin 2021 konsiston në pagesa për pensione, sëmundje, barrëlindje, aksidente, programeve të veçanta të qeverisë, etj. Administrimi i buxhetit dhe mbajtja e shpenzimeve në limitet e programuara ka qenë një nga detyrat e punës së administratës së ISSH. Nga ana e saj janë ndjekur dhe respektuar çdo muaj limitet e programuara të fondeve për shpenzimet e administrimit, për transfertat në buxhetet familjare si edhe për shpenzimet e tjera.

Nga auditimi u konstatua se, shpenzimet për sistemin e sigurimeve shoqërore janë realizuar në masën 99 %, ose nga 149,165 milionë lekë të programuara janë realizuar 148,030 milionë lekë, pra me mosrealizim prej 1,135 milionë lekë për vitin 2021. Ky mosrealizim sipas grupeve, paraqitet më poshtë:

Tabela nr. 13 Shpenzimet për administrimin e përfitimeve dhe transfertave në buxhetet familjeve, viti 2021

Në milionë lekë

	SHPENZIMET PËR ISSH	Plan	Fakt	Ndryshimi	Në %
I	Shpenzime administrative	2,560	2,414	-146	94%
II	Sigurimi shoqëror i detyrueshëm	126,048	126,126	78	100%
1	Pagesa për sëmundje	570	529	-41	93%
2	Pagesa për barrëlindje	4,074	4,137	63	102%
3	Pagesa për pensione	121,379	121,441	62	100%
4	Pagesa për aksidente	25	20	-5	79%
III	Programe të veçanta të qeverisë	13,025	12,610	-415	97%
1	Kompensime çmimesh dhe të ardhurash	12,572	12,253	-318	97%
2	Pensione të posaçme	88	77	-12	87%
3	Pensione sociale	197	181	-16	92%
4	Statusi i veteranit të luftës	77	68	-9	88%
5	Rimbursim çmimi karburant për invalidë	92	32	-60	35%
IV	Sigurime suplementare	7,532	6,879	-653	91%
	Totali i Shpenzimeve	149,165	148,030	-1,135	99%

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Konkretisht, nga analiza e të dhënave kemi:

- Shpenzimet për skemën e detyrueshme janë realizuar në masën 100% ose 78.2 milionë lekë më shumë se programi, kjo e justifikuar, për shkak të tërheqjes së pensioneëve të prapambetura të krijuara nga moskryerja e të gjitha pagesave të pensioneëve me ritmet e parashikuara të tre viteve të fundit, kjo, referuar përfituesve që jetojnë jashtë shtetit si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19;
- Shpenzimet për programe të veçanta janë realizuar në masën 97.0 % ose 414.5 milionë më pak se programi, për shkak të mosrealizimit të kompensimeve të ardhurave, pasi të gjitha pensionet e reja që lidhen me ligjin 104/2014 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, janë pa kompensime të ardhurave, të cilat janë të bashkuara me pensionin;
- Shpenzimet administrative janë realizuar në masën 94 % ose 146 milionë lekë më pak se programi, duke bërë kujdes në respektimin e treguesve të programuar për shpenzimet administrative korente apo edhe në investimet;
- Shpenzimet në skemën suplementare janë realizuar në masën 91% ose me një mosrealizim prej 652.7 milionë lekë, kryesisht për arsye të mos tërheqjes në afate.

Tabela nr. 14 Shpenzimet sipas programeve, viti 2021

Në milionë lekë

	SHPENZIMET	PLAN	FAKT	NDRYSHIMI	%
I	SHPENZIME PER PERFITIME	126,048	126,126	78	100
a.	Shpenzime për Sëmundje	570	529	(41)	93
b.	Shpenzime për Barrëlidje	4,074	4,137	63	102
c.	Shpenzime për pensione	121,379	121,441	62	100
	<i>Shpenzime për Pensione Qytet</i>	<i>108,835</i>	<i>108,975</i>	140	100
	<i>Shpenzime për Pensione Fshat</i>	<i>12,544</i>	<i>12,466</i>	(78)	99
ç.	Për Aksidente dhe Sem. Profesionale	25	20	(5)	79
II	PER PROGRAMET E TJERA	13,025	12,610	(415)	97
a.	Pensione Speciale e te Posaçme	88	77	(12)	87
B	Shpërblime te Invalidëve te Luftës dhe Veteraneve	77	68	(9)	88
C	Shtese nga Statusi i Invalidit të Punës	92	32	(60)	35
Ç	Kompensime çmimesh dhe të ardhurash	12,572	12,253	(318)	97
D	Pensione Sociale	197	181	(16)	92
III	SHPENZIME ADMINISTRATIVE	2,560.00	2,414	(146)	94
A	Paga, Shpërblime dhe Shpenzime te tjera Personeli	1,040	996	(44)	96
B	Kontribute për Sigurime Shoqërore e Shëndetësore	160	159	(2)	99
C	Mallra dhe Shërbime te tjera	1,245	1,221	(24)	98
Ç	Për Rritjen e Aktiveve te Qëndrueshme te Trupëzuara	115	38	(77)	33
IV	SHPENZIME PËR SKEMA SUPLEMENT	7,532	6,879	(653)	91
	TOTALI I SHPENZIMEVE (I+II+III+IV)	149,165	148,030	(1,135)	99

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

V.

Shpenzimet administrative të ISSH dhe DRSSH-ve në rrethe

Më poshtë po paraqesim në mënyrë analitike realizimin e shpenzimeve administrative të ISSH-së, për periudhën Janar- Dhjetor 2021, ku konstatohet se, të gjitha DRSSH-të kanë mbajtur nën kontroll kryerjen e shpenzimeve administrative, brenda kufijve të planifikuar për vitin 2021.

Tabela nr. 15 Realizimi i shpenzimeve administrative sipas DRSSH-ve, viti 2021*Në milionë lekë*

Nr.	Emërtimi	Plan	Fakt	Ndryshimi	Në %
	Totali ISSH	2,560	2,414	(146)	94
1	Berat	107	107	(0)	100
2	Dibër	111	110	(1)	99
3	Durrës	185	157	(28)	85
4	Elbasan	198	197	(1)	100
5	Fier	210	204	(5)	97
6	Gjirokastrë	95	93	(2)	98
7	Korçë	179	177	(2)	99
8	Kukës	77	73	(5)	94
9	Lezhë	100	94	(6)	94
10	Shkodër	136	132	(5)	96
11	Tiranë	421	426	5	101
12	Vlorë	178	178	(1)	100
13	DAQ	129	121	(8)	94
14	Brendshëm	370	342	(27)	93

15	Përgjithshme	64	3	(60)	5
----	--------------	----	---	------	---

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

ISSH, ka mbajtur dhe ka ndjekur, shpenzimet administrative duke respektuar treguesit e programuar të shpenzimeve, me mosrealizim në vlerën 146 milionë lekë, të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 16 Shpenzimet administrative për ISSH, viti 2021

Në milionë lekë

Nr.	Emërtimi	Plan	Fakt	Ndryshimi	Në %
I.	Totali i Shpenzimeve Administrative	2,560.00	2,414.00	-146	94%
1.	Paga, Shpërblime dhe Shpenzime të tjera personeli	1,040.10	996.3	-43.8	96%
2.	Kontribute për sigurimet shoqërore shëndetësore	160.3	158.5	-1.8	99%
3.	Mallra dhe shërbime të tjera	1,244.80	1,221.00	-23.9	98%
	<i>nga këto - Komisione të Pagesës së Përfitimeve</i>	<i>881.8</i>	<i>874.6</i>	<i>-7.2</i>	99%
4.	Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	114.7	38.2	-76.6	33%

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

VI.

Rezultati Fiskal Vjetor dhe Deficiti i Skemës së Pensioneve.

A. Rezultati Fiskal Vjetor.

Rezultati fiskal vjetor paraqitet si diferencë midis të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit. Rezultati fiskal dhe deficiti për periudhën 12- mujore të vitit 2021, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 17 Të ardhurat, shpenzimet dhe deficiti për vitin 2021 Në mijë lekë

Emërtimi	Plan	Fakt	Diferenca (fakt-plan)
A. TË ARDHURAT			
I. Kontribute të personave juridikë dhe fizikë (DPT)	91,576,000	93,368,264	1,792,264
II. Kontribute me destinacion nga buxheti i shtetit	7,185,791	7,202,630	16,839
III. Financime me destinacion nga buxheti i shtetit	9,733,966	9,733,966	0
A. TOTALI I TË ARDHURAVE TË ISSH	108,495,757	110,304,860	1,809,103
B. SHPENZIMET			
I. Shpenzime për përfitime	126,048,119	126,126,307	78,188
II. Shpenzime administrative	2,560,000	2,413,986	-146,014
III. Shpenzime për programe të tjera	13,024,791	12,610,305	-414,486
IV. Shpenzimet suplementare	7,531,870	6,879,215	-652,655
B. TOTALI I SHPENZIMEVE TË ISSH	149,164,780	148,029,812	-1,134,968
SUBVENCIONI I LLOGARITUR (B - A)	40,669,023	37,724,952	-2,944,071

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Nga tabela e mësipërme konstatojmë se, nevojat për financimin e shpenzimeve të vitit, janë ulur në vlerën 2,994 milionë lekë. Tejkalmi i shpenzimeve prej 78 milionë lekë është evidentuar në zërin ÷ Shpenzime për përfitime (pensione), i cili ka ardhur si pasojë e tërheqjes së pensioneve të prapambetura (deri në 36 këste) të përfituesve që jetojnë jashtë vendit. Ky fenomen i rritjes së shpenzimeve, është vërejtur kryesisht në muajt korrik, gusht dhe dhjetor 2021, të cilët krahasuar me realizimin e vitit të kaluar kanë një rritje të konsiderueshme.

Rëndësi të veçantë ka realizimi nga ISSH i analizave të burimeve dhe shpenzimeve krahasuar me buxhetin vjetor, me fokusin e vazhdueshëm për të ulur deficitin fiskal të sistemit. Rezultati fiskal i sistemit për në vitin 2021, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 18 Rezultati fiskal i vitit 2021

Në mijë lekë

	TË ARDHURAT	Gjithsej		Diferencë	%
		Plan	Fakt		
I	Të ardhura të kontributeve dhe të tjera	91,271,000	94,803,508	3,532,508	104
	nga persona juridikë e fizikë	88,776,999	91,255,921	2,478,922	103
	nga të vetëpunësuarit në bujqësi	1,725,000	2,088,601	363,601	121
	nga kontributet vullnetare	450,000	500,628	50,628	111
	nga kamatëvonesa dhe të ardhura të tjera	320,000	958,357	668,953	299
II	Financime nga buxheti për programe dhe subvencione	57,894,000	57,893,749	(251)	100
	për kontributet e disa kategorive të personave	6,806,288	7,202,630	396,342	106
	për programe dhe subvencione	51,087,712	50,691,119	(396,593)	99
	Totali i të hyrave	149,165,000	152,697,257	3,532,257	102
1	transferta në buxhetet familjare (përfitime të pensionistëve)	146,604,780	145,615,827	(988,953)	99
2	shpenzime të administrimit të sistemit	2,560,000	2,413,986	(146,014)	94

	Totali shpenzimeve	149,164,780	148,029,812	(1,134,968)	99
	Rezultati Fiskal		4,667,445		

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Nga të dhënat e tabelës, konstatohet tejkalim i të hyrave mbi shpenzimet vjetore të sistemit në shumën 4,667 milionë lekë, si pasojë e tejkalimit së të ardhurave të planifikuara me 3,532 milionë lekë dhe mosrealizim të shpenzimeve me 1,135 milionë lekë. Rezultati pozitiv fiskal i vitit, ka përmirësuar edhe rezultatin financiar të degës së pensioneve, si kundrejt planit ashtu edhe në këndvështrimin e deficitit të sistemit nga PBB vjetor.

B. Deficiti i degës së pensioneve për vitin 2021.

Duke u bazuar në raportet financiare të ISSH për vitin 2021, kontributet e drejtpërdrejta në total, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 19 Të ardhurattë kontributeve dhe të tjera Në mijë lekë

	KONTRIBUTET	GJITHSEJ		DIFERENCË	%
		PLAN	FAKT		
I	DPT	88,776,000	91,533,508	2,757,508	103.1
II	KONTRIBUTE TË TJERA	-	104,016	104,016	
III	ISSH	2,495,000	3,165,984	670,984	126.9
	TOTALI	91,271,000	94,803,508	3,532,508	103.9

Burimi: Drejtoria e Kontributeve në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Kështu, konstatohet një tejkalim i të ardhurave ndaj planit me 3,9% dhe në vlerë 3,532 milionë lekë. Tejkalmi është reflektuar në të gjithë subjektet kontribut pagues, por më e theksuar konstatohet në subjektet e të vetëpunësuarve në bujqësi, si edhe në të ardhurat e tjera si pasojë e mbledhjes së borxheve dhe e pagesave të interesave dhe kamatëvonesave. Bazuar në normën e kontributeve sipas degëve të sigurimit, kontributi për degën e pensioneve dhe degët e tjera për vitin 2021, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 20 Kontributet sipas skemave dhe degëve të pensioneve, viti 2021

EMËRTIMI	NORMA	SEMUNDJE	BARRELINDJE	PENSIONE	AKSIDENTE	PAPUNESI	SUPLEMENT	SHUMA
		0.3	1.4	21.6	0.3	0.9	24.5	
A	SIGURIM SHOQEROR	93,310,296	1,059,780	5,268,408	82,742,991	1,059,780	3,179,339	93,310,296
	BUXHETORE	31,729,089	388,519.5	1,813,090.8	27,973,400.8	388,519.5	1,165,558.4	31,729,088.9
	JO BUXHETORE	5,045,985	61,787.6	288,342.0	4,448,704.8	61,787.6	185,362.7	5,045,984.7
	FIRMA	49,773,586	609,472.5	2,844,204.9	43,882,019.0	609,472.5	1,828,417.5	49,773,586.4
	INDIVIDE	3,214,051		195,637.9	3,018,412.8			3,214,050.7
	TE TJERA	958,357			958,356.9			958,356.9
	VULLNETARE	500,628			500,627.8			500,627.8
	TE VETPUNESUAR NË BUJQESI	2,088,601		127,132.2	1,961,468.9			2,088,601.1
B	KONTRIBUTE TE BUXHETIT	4,925,957	-	229,341.2	4,696,616.0	-	-	4,925,957.2
	SIG.SHOQ.PER TE PAPUNET	827,752		50,384.9	777,366.7			827,751.6
	SIG.SHOQ.PER USHTARAKE NE REFORME E PENSION TE PARAKOHSHEM	201,608		12,271.8	189,336.2			201,608.0
	SIG.SHOQ.PER POLICE NE REF DHE PENSION TE PARAKOHSHEM	289,399		17,615.6	271,783.8			289,399.4
	SIG.SHOQ.PER ISH-FUNKSIONARET	12,260			12,260.2			12,260.2
	SIG.SHOQ.PER USHTARAKE NE REFORME E PENSION TE PARAKOHSHEM	2,429,549		147,885.6	2,281,663.4			2,429,549.0
	SIG. SHOQ. PER GRA TE PENSIONUARA	1,145,949			1,145,949.1			1,145,949.1
	SIG.SHOQ.PER PUNONJ. E INDUSTRISE USHT+S PUNONJESIT E MINIERAVE	19,440		1,183.3	18,256.7			19,440.0
C	DIFERENCË KONTRIBUTI FERMERET	2,276,673	138,580.1	2,138,092.9				2,276,673.0
	TOTALI SIGURIMI DETYRUESHEM	100,512,927	1,059,780	5,636,329	89,577,700	1,059,780	3,179,339	100,512,927
D	KONTRIBUTE PER PENSIONE SUPLEMENTARE	1,493,212					1,493,212	1,493,211.81
	TOTALI	102,006,138	1,059,780	5,636,329	89,577,700	1,059,780	3,179,339	102,006,138

Burimi: Drejtoria e Kontributeve në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

B.1 Skema e fshatit

Tabela nr. 21 Kontributet në total sipas degëve të sigurimit

Në mijë lekë

Emërtimi	2019	2020	2021	Ndryshimi 2021-2020
----------	------	------	------	---------------------

Kontribute për fshatin	4,269,442	3,354,626	4,365,274	1,010,648
Barrë lindje fshat	259,879	204,195	265,712	61,518
Pensione fshat	4,009,563	3,150,432	4,099,562	949,130

Burimi: Drejtoria e Kontributeve në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Tabela nr. 22 Shpenzimet sipas degëve të sigurimit

Në mijë lekë

Emërtimi	2019	2020	2021	Ndryshimi 2021-2020
Shpenzime për fshatin	14,065,531	13,676,870	13,408,530	-268,341
Barrë lindje fshat	682,629	710,461	736,549	26,088
Pensione fshat	13,382,902	12,966,410	12,671,981	-294,429

Burimi: Drejtoria e Kontributeve në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Tabela nr. 23 Bilanci i skemës së fshatit

Në mijë lekë

Bilanci i fshatit	2019	2020	2021	Ndryshimi 2020-2019
Barrë lindje fshat	-422,750	-506,266	-470,836	35,430
Pensione fshat	-9,373,339	-9,815,978	-8,572,419	1,243,559
Shuma	-9,796,089	-10,322,244	-9,043,256	1,278,988
Deficiti si % ndaj PBB	-0.58	-0.66	-0.51	0.09
PBB Nominal / Në milionë lekë	1,678,400	1,572,500	1,769,258	196,758

Burimi: Drejtoria e Kontributeve në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Për skemën e fshatit sa më sipër:

- Krahasuar me vitin 2020 deficiti i saj është ulur me 1,279 milionë lekë ose me 0.09 % ndaj PBB;
- Edhe pse ka përmirësime në rezultatet e vitit 2021, skema mbetet mjaft deficitare dhe dikton nevojën për reformim dhe rregullime të mëtejshme;
- Krahas degës së pensioneve, mjaft me rëndësi ka qenë përmirësimi dhe balancimi i degës së barrë lindjes në fshat, e cila për vitin 2021 rezultoi me humbje prej 470,8 milionë lekë. Kjo vjen si pasojë e numrit të ulët të kontribuuesve, sidomos të kontribuuesve të rinj.

B.2 Skema e qytetit

Tabela nr. 24 Kontributet në total sipas degëve të sigurimit

Në mijë lekë

Kontribute për qytetin	2019	2020	2021	Ndryshimi 2021-2020
Kontribute sipas degëve	84,620,440	85,063,701	96,147,652	11,083,952
Sëmundje	936,959	934,582	1,059,780	125,198
Barrë lindje qytet	4,581,768	4,547,914	5,370,617	822,703
Pensione qytet	75,373,560	75,842,879	85,478,138	9,635,259
Aksidente	936,959	934,582	1,059,780	125,198
Papunësi	2,791,193	2,803,745	3,179,339	375,594

Burimi: Drejtoria e Kontributeve në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Në tabelën e mësipërme janë paraqitur edhe kontributet e papunësisë. Ato ndikojnë në rezultatin fiskal të sistemit, në përmirësim të tij, por nuk mund të jenë pjesë e analizës dhe të ndikimit të rezultatit financiar të degës së pensioneve për vitin 2021, pasi janë kontribute që ligjërisht nuk i përkasin kësaj dege. Në këtë këndvështrim, ato veçohen nga analiza e odeficitit të degës së pensioneve.

Tabela nr. 25 Shpenzimet sipas degëve të sigurimit

Në mijë lekë

Emërtimi	2019	2020	2021	Ndryshimi 2021-2020
Shpenzime për qytetin	99,953,938	101,450,587	114,808,670	13,358,083
Sëmundje	530,721	469,226	537,465	68,240
Barrë lindje qytet	2,985,538	3,254,390	3,469,130	214,740
Pensione qytet	96,416,369	97,704,975	110,781,766	13,076,791
Aksidente	21,310	21,996	20,308	-1,688

Burimi: Drejtoria e Kontributeve në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Deficiti i degës së pensioneve të qytetit

Tabela nr. 26 Deficiti i degës së pensioneve në qytet

Në mijë lekë

Vitet / Degët	2019	2020	2021	Ndryshimi 2021-2020
Rezultati financiar sipas degëve	-18,124,691	-19,190,631	-21,840,356	-2,649,725
Sëmundje	0	0	0	0
Barrë lindje qytet	0	0	0	0
Pensione qytet	-18,124,691	-19,190,631	-21,840,356	-2,649,725
Aksidente	0	0	0	0
Deficiti / GDP	-1.08	-1.22	-1.23	-0.01

Burimi: Drejtoria e Kontributeve në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Deficiti në total për të dy skemat fshat - qytet

Tabela nr. 27 Deficiti për të dy skemat

Në mijë lekë

Vitet / Degët	2019	2020	2021	Ndryshimi 2021-2020
Deficiti pensioneve	-27,920,780	-29,512,875	-30,412,775	899,901
PBB nga MFE /vendimi 7, datë 13.01.2021 dhe 25, datë 25.01.2021	1,678,400	1,572,500	1,769,258	196,758
	-1.66	-1.88	-1.74	0.14
Deficiti barrë lindje fshat	-422,750	-506,266	-470,836	35,430

Burimi: Drejtoria e Kontributeve në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Nga të dhënat e tabelës konstatohet se të ardhurat nga kontributet nuk janë të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të skemës së pensioneve për të dy skemat (qytetin dhe fshatin) duke krijuar një deficit të vazhdueshëm nga viti në vit. Ky deficit konstatohet në rritje në vlerë absolute kështu gjatë vitit 2021, ai është rritur me 899,901 mijë lekë kundrejt vitit 2020 megjithëse me pikë ka një përmirësim prej 0.14 pikë.

Për sa më sipër, deficiti i përgjithshëm do të ishte edhe më i ulët nëse do të kemi parasysh, efektin fiskal të pagesave të pensioneve të paguara, në krahasim me vitin 2020-2021, ku shuma e pensioneve të paguara në vitin 2021 për llogari të periudhave të mëparshme është rritur me rreth 1,943,236 mijë lekë.

Deficiti fiskal i sistemit, pavarësisht rezultatit vjetor dhe mbulimit të planifikuar të tij, rezulton të jetë 27,233.4 milionë lekë, ose 1.54 % e PBB, pasi i zbritet kontributi për papunësinë i pa transferuar dhe ligjërisht i lënë në llogaritë e ISSH, duke reduktuar financimin buxhetor në shumën 3,179 milionë lekë.

Bazuar në të ardhurat dhe shpenzimet sipas degëve, skema e fshatit, sigurimi i detyrueshëm për personat e vetëpunësuar në bujqësi, rezulton të jetë me deficit më të lartë, si në degën e barrë lindjeve ashtu edhe në atë të pensioneve. Për pasojë ky deficit mbetet përfundimtar dhe i mbuluar me subvencione.

VII.

Numri i përfituesve të pensioneve në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020.

Numri i përfituesve të pensioneve të pleqërisë, invaliditetit dhe familjarë për vitin 2021, sipas kategorive dhe rajoneve paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 28 Numri i përfituesve urban dhe rural sipas rajoneve, viti 2021.

PENSIONE RAJONET	Pleqërie		Invaliditeti		Familjare		Gjithsej		TOTALI I PENSIONEVE
	Urban	Rural	Urban	Rural	Urban	Rural	Urban	Rural	
BERAT	25,131	6,245	2,380	433	1,415	164	28,926	6,842	35,768
DIBËR	12,766	5,663	2,246	230	2,218	299	17,230	6,192	23,422
DURRËS	42,290	7,714	6,777	699	4,505	614	53,572	9,027	62,599
ELBASAN	36,228	11,621	9,991	877	4,179	591	50,398	13,089	63,487
FIER	52,616	13,436	5,281	805	4,035	568	61,932	14,809	76,741
GJIROKASTËR	18,675	4,301	1,550	181	1,309	77	21,534	4,559	26,093
KORÇË	43,334	8,911	6,125	471	3,888	321	53,347	9,703	63,050
KUKËS	8,012	3,037	2,583	74	1,616	136	12,211	3,247	15,458
LEZHË	17,915	4,821	3,763	345	2,792	196	24,470	5,362	29,832
SHKODËR	33,804	8,777	3,469	386	2,955	242	40,228	9,405	49,633
TIRANË	12,3646	14,269	13704	1,281	12,634	1,151	149,984	16,701	166,685
VLORË	45,490	8,070	3,856	407	2,811	140	52,157	8,617	60,774
TOTALI	459,907	96,865	61,725	6,189	44,357	4,499	565,989	107,553	673,542

Burimi: Drejtoria e Statistikës dhe marrëdhëniet me publikun në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Numri i pensioneve urbane krahasuar me pensionet rurale, si dhe pesha specifike e secilit lloj për vitin 2021, paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela nr. 29 Peshat specifike të pensioneve urbane e rurale, viti 2021.

RAJONET	Pensione gjithsej		Totali i pensioneve	% Urban	% Rural
	Urban	Rural			
BERAT	28,926	6,842	35,768	81	19
DIBËR	17,230	6,192	23,422	74	26
DURRËS	53,572	9,027	62,599	86	14
ELBASAN	50,398	13,089	63,487	79	21
FIER	61,932	14,809	76,741	81	19
GJIROKASTËR	21,534	4,559	26,093	83	17

KORÇË	53,347	9,703	63,050	85	15
KUKËS	12,211	3,247	15,458	79	21
LEZHË	24,470	5,362	29,832	82	18
SHKODËR	40,228	9,405	49,633	81	19
TIRANË	149,984	16,701	166,685	90	10
VLORË	52,157	8,617	60,774	86	14
TOTAL	565,989	107,553	673,542	84	16

Burimi: Drejtoria e Statistikës dhe marrëdhënieve me publikun në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se, numri i pensioneve të kategorive pleqëri, invalid dhe familjar më 31.12.2021, ka qenë 673,542, nga të cilët 565,989 ose 84% rezultojnë pensione urbane dhe 107,553 ose 16% e tyre, pensione rurale.

Numri i përfituesve të pensioneve të pleqërisë, invaliditetit dhe familjarë në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 dhe diferencat në numër dhe në përqindje, sipas kategorive dhe rajoneve paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 30 Numri i përfituesve të pensioneve në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020.

DRSSH	Pensione në total		Diferenca	Pleqërie		Invaliditeti		Familjare	
	2020	2021		2020	2021	2020	2021	2020	2021
BERAT	35,603	35,768	165	30,567	31,376	2,951	2,813	2,085	1,579
DIBËR	23,726	23,422	-304	18,298	18,429	2,609	2,476	2,819	2,517
DURRËS	61,267	62,599	1,332	48,158	50,004	7,567	7,476	5,542	5,119
ELBASAN	63,623	63,487	-136	47,272	47,849	10,898	10,868	5,453	4,770
FIER	75,731	76,741	1,010	64,323	66,052	6,309	6,086	5,099	4,603
GJIROKASTËR	25,894	26,093	199	22,524	22,976	1,871	1,731	1,499	1,386
KORÇË	62,348	63,050	702	51,030	52,245	6,805	6,596	4,513	4,209
KUKËS	1,5897	15,458	-439	11,077	11,049	2,717	2,657	2,103	1,752
LEZHË	29,472	29,832	360	22,365	22,736	4,152	4,108	2,955	2,988
SHKODËR	49,481	49,633	152	41,861	42,581	3,978	3,855	3,642	3,197
TIRANË	162,692	166,685	3,993	134,344	137,915	15,105	14,985	13,243	13,785
VLORË	59,833	60,774	941	52,138	53,560	4,428	4,263	3,267	2,951
TOTALI	665,567	673,542	7,975	543,957	556,772	69,390	67,914	52,220	48,856

Burimi: Drejtoria e Statistikës dhe marrëdhënieve me publikun në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Pra, duke analizuar të dhënat e mësipërme, konstatohet se në fillim të vitit 2021, në skemën e detyrueshme ishin 665,567 pensionistë dhe në fund të vitit 2021, rezultuan 673,542 pensionistë. Me një shtesë në total, prej 7,975 pensionistë (shtesa e numrit vjen si rezultat i numrit të personave që dalin në pension dhe hyjnë në skemën e pensioneve, në raport me pensionistët që dalin nga skema e pensioneve / vdesin e të tjerë).

Numri i pensionistëve për tre kategoritë, paraqitet:

- Pensione pleqërie në fund të vitit 2021, rezultuan 556,772 ndërsa në fund të vitit 2020 ishin 543,957 pensione, pra, janë shtuar 12,815 pensione në këtë kategori;
- Pensione invaliditeti në fund të vitit 2021, rezultuan 67,914 ndërsa në fund të vitit 2020, ishin 69,390 invalidë, pra paraqitet ulje e numrit të përfituesve të kësaj kategorie me 1,476 pensione;
- Pensione familjare në fund të vitit 2021, rezultuan 48,856 ndërsa në fund të vitit 2020, ishin 52,220 pensione. Pra për vitin 2021, ishin 3,364 pensione më pak se viti 2020.

VIII.

Mbi zbatimin e afateve të lidhjes së pensioneve.

Në zbatim të pikës nr. 3, të nenit 85, të ligjit nr. 7703 òPër Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, e cila citon: “Pensionet do të caktohen nga zyrat rajonale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore brenda ditës së fundit të muajit të ardhshëm nga data e pranimit të kërkesës dhe të dokumenteve të plota e të sakta për pension”, si dhe në zbatim të rregullores nr. 1, datë 21.10.2008 òPër caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve. Në vlerësim me përputhshmërinë epërcaktimeve ligjore, nga auditimi i të dhënave lidhur me pensionet e caktuara brenda afatit, si dhe të caktuara jashtë afatit, për të 12 DRSSH në vitin 2021, u konstatua si më poshtë vijon:

Tabela nr. 31 Pensione të caktuara brenda dhe jashtë afatit, viti 2021

Rajoni	Pensione Gjithsej	Pensione brenda afatit	Pensione Jashtë afatit	Përqindja
--------	-------------------	------------------------	------------------------	-----------

		Nr.	Nr.	Brenda afatit	Jashtë afatit
BERAT	2,559	2,476	83	97	3
DIBËR	1,380	1,336	44	97	3
DURRËS	3,993	3,970	23	99	1
ELBASAN	4,006	3,705	301	92	8
FIER	5,104	4,952	152	97	3
GJIROKASTËR	1,827	1,810	17	99	1
KORÇË	4,226	4,195	31	99	1
KUKËS	708	707	1	100	0
LEZHË	1,825	1,818	7	100	0
SHKODËR	3321	3,318	3	100	0
TIRANË	11,140	10,822	318	97	3
VLORË	4,183	4,151	32	99	1
TOTAL	44,272	43,260	1,012	98	2

Burimi: Drejtoria e Statistikës dhe marrëdhënieve me publikun në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Kështu, numri gjithsej i pensioneve të reja në vitin 2021, ka qenë 44,272 nga të cilët:

- 98 % e tyre ose 43,260 pensione ishin të lidhura në afat;
- 2% e tyre ose 1,012 pensione të lidhura jashtë afatit.

Për caktimin e një pensioni për vitin 2021, nga ana e të gjithë DRSSH, u konstatua se janë nevojitur mesatarisht 25 ditë, nga 45 ditë që është treguesi mesatar i caktimit të pensioneve, përcaktuar në rregulloren nr. 1, datë 21.10.2008 ÷ Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve, të ndryshuar. Për të realizuar uljen e ditëve të caktimit të një pensioni, Drejtoria e Statistikave dhe marrëdhënieve me publikun në ISSH, ka ndjekur sistematikisht të dhënat duke mbajtur kontakt zyrtar, të vazhdueshëm me rajonet, kanë monitoruar treguesit çdo muaj, si dhe kanë realizuar trajnime e monitorime të punës së degëve të përfitimeve.

Numri i pensioneve të reja dhe përqindja e caktimit në afat e tyre, për 12 DRSSH në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020, në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 32 Numri i pensioneve të reja caktuar në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020.

Rajoni	Numri i pensioneve të reja								% e lidhjes në afat të pensioneve	
	Gjithsej		Pleqërie		Invaliditeti		Familjare		Pensione gjithsej	Pensione gjithsej
	Viti		Viti		Viti		Viti		Viti	Viti
	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021	2020	2021
BERAT	2,282	2,559	2,079	2,312	95	104	108	143	98	97
DIBËR	1,230	1,380	1,034	1,166	89	95	107	119	95	97
DURRËS	3,480	3,993	2,954	3,358	286	269	240	366	99	99
ELBASAN	3,590	4,006	2,992	3,270	417	481	181	255	90	92
FIER	4,932	5,104	4,522	4,578	186	211	224	315	95	97
GJIROKASTËR	1,518	1,827	1,382	1,662	53	40	83	125	99	99
KORÇË	3,608	4,226	3,183	3,700	242	257	183	269	97	99
KUKËS	658	708	491	551	97	77	70	80	96	100
LEZHË	1,606	1,825	1,312	1,507	194	161	100	157	97	100
SHKODËR	2,838	3,321	2,515	2,909	166	156	157	256	100	100
TIRANË	8,815	11,140	7,619	9,428	573	713	623	999	96	97
VLORË	3,482	4,183	3,163	3,757	140	147	179	279	98	99
TOTAL	38,039	44,272	33,246	38,198	2,538	2,711	2,255	3,363	96	98

Burimi: Drejtoria e Statistikës dhe marrëdhënieve me publikun në ISSH, punuar nga grupi i KLSH.

Numri i pensioneve të reja të lidhura gjithsej për periudhën Janar-Dhjetor 2021, është 44,272 ose 6,233 pensione më shumë se viti 2020. Treguesi i përqindjes së lidhjes në afat të tyre është 98 % ose 2% më shumë se viti i kaluar. Nga analiza e të dhënave, konstatohet përmirësim i treguesve të afateve të caktimit të pensioneve, si në përqindjen e pensioneve të caktuara brenda afatit ashtu edhe në ditët mesatare të caktimit të një përfitimi.

IX.

Analizimi i listëpagesave të kontributeve nga DPT dhe mbi problematikat e mbartura.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në zbatim të detyrimeve që burojnë nga Marrëveshja e Bashkëpunimit nr.4473/1, datë 23.05.2017 dhe nr.11422, datë 19.05.2017, si dhe të Protokollit Elektronik të listëpagesave dhe konkretisht referuar kapitullit IV të Detyrimit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, pika 1 dhe 2, si dhe mbështetur në Udhëzimin nr.2, datë 06.02.2012, të Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit, Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dërgon në Institutin e Sigurimeve Shoqërore të dhënat mbi të ardhurat e realizuara për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore për periudhën vjetore përkatëse, të saktësuar sipas sistemit informatik C@TS.

Gjithashtu, Ministria e Financave, dërgon në ISSH nëpërmjet postës elektronike të dhënat ditore dhe progresive për të ardhurat e kontributeve nga subjektet në përgjegjësi të organeve tatimore.

ISSH, çdo muaj kryen krahasimin e të ardhurave faktike me të ardhurat e raportuara nga DPT me transfertat e Ministrisë së Financës.

Për rakordimin e të ardhurave të kontributeve të dërguara nga DPT me transfertat e kryera nga Ministria e Financave, në rastet kur konstatohet mospërputhje, Drejtoria e Financës në ISSH komunikon me drejtorinë përgjegjëse pranë Ministrisë së Financave me qëllim rakordimin e plotë të dhënave.

Për sa i përket programimit dhe planifikimit të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore për subjektet në përgjegjësi të organeve tatimore, theksojmë se Instituti i Sigurimeve Shoqërore nuk ka asnjë detyrim ligjor që të jetë pjesë e programimit të të ardhurave të kontributeve të sigurimeve shoqërore, për subjektet buxhetore, jobuxhetore, subjektet të biznesit të madh, të biznesit të vogël dhe të sigurimeve suplementare.

Ky planifikim vjen në total nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe jo i detajuar sipas kategorive të biznesit sepse të dhënat për programimin buxhetor përgatiten dhe dërgohen në këtë format nga Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Makroekonomisë, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit në Ministrinë e Financave.

Gjithashtu nga auditimi ikëtyre marrëdhënieve ndër-institucionale midis ISSH dhe DPT, konstatojmë se, është kthyer pothuajse në fenomen mungesa e bashkëveprimit dhe komunikimit të rregullt midis tyre lidhur me problematikat që trajtohen nga ISSH, në zbatim të:

- pikës 5.19, të kreut 5, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 23, datë 09.12.2014, “5.19 Administrata tatimore dërgon në organet përkatëse të sigurimeve shoqërore dhe të sigurimeve të kujdesit shëndetësor, të dhënat për kontributet siç përcaktohet në Vendimin përkatës e Këshillit të Ministrave. Administrata tatimore dërgon në Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe në Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore të dhënat mujore dhe progresive për kontributet e papaguara në afat, në mënyrë të përmbledhur dhe për çdo tatimpagues”
- dhe të kreut II Objekti i Marrëveshjes e konkretisht të nënpikës 5.19, shkronja 5.19, të kreut II, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr.4473/1, datë 23.05.2017 dhe nr.11422, datë 19.5.2017, ndërmjet DPT dhe ISSH “dërgimin në format elektronik e të dhënave për detyrimet kontributeve progresive të papaguara për çdo subjekt debitor”,

të cilat ISSH ka ndjekur në vazhdimësi, e me përparësi në drejtim të gjithë problematikave të hasura si në drejtim të mangësive që evidentohen në sistemin e transmetimit të listëpagesave ashtu dhe në bashkëpunimin që kërkohet lidhur me angazhimin e organeve tatimore, për sa i përket rolit të tyre në drejtim të mbledhjes së detyrimeve të prapambetura, etj., e konkretisht nga auditimi konstatohet se:

A. nga ana e DPT në lidhje me listëpagesat e kontributeve, deri më datë 22.01.2022, janë dërguar në ISSH gjithsej 10,953,766 listëpagesa, të formatit elektronik që i përkasin periudhës kohore 2012 ó 2021, nga këto:

1. Për vitin 2012 janë 718,190 listëpagesa (për periudhën janar - dhjetor);

2. Për vitin 2013 janë 822,975 listëpagesa (për periudhën janar - dhjetor);
3. Për vitin 2014 janë 913,539 listëpagesa (për periudhën janar - dhjetor);
4. Për vitin 2015 janë 1,102,361 listëpagesa (për periudhën janar - dhjetor);
5. Për vitin 2016 janë 1,281,403 listëpagesa (për periudhën janar - dhjetor);
6. Për vitin 2017 janë 1,241,279 listëpagesa (për periudhën janar - dhjetor);
7. Për vitin 2018 janë 1,261,172 listëpagesa (për periudhën janar - dhjetor);
8. Për vitin 2019 janë 1,260,577 listëpagesa (për periudhën janar - dhjetor);
9. Për vitin 2020 janë 1,261,131 listëpagesa (për periudhën janar ó dhjetor);
10. Për vitin 2021 janë 1,091,140 listëpagesa (për periudhën janar ó dhjetor);

në lidhje me to ekziston, problemii listëpagesave të munguara, ku përveç saj janë relatuar edhe shumë raste të subjekteve apo individëve që kanë patur probleme në lidhje me sistemin elektronik të derdhjeve të kontributeve në DPT-së, kryesisht në mungesa dhe gabime si:

- rastet e evidentimit të vendosjes gabim të Numrit Personal NID, të cilat kanë sjellë problem të përsëritur, pavarësisht se është kryer rregullimi nga sistemi i D.T, pas konstatimit të NID-it të gabuar për periudhat në vazhdim, mbetet problem i pa zgjidhur për periudhat përpara konstatimit të NID të gabuar;
- në sistemin CMIS ende nuk shfaqen listëpagesat e periudhave të personave gjyqfitues;
- në sistemin CMIS nuk shfaqen muaj të veçantë, për subjekte të ndryshme (disa Drejtori Arsimore Rajonale) dhe individë të ndryshëm, në vite të ndryshme, periudha të cilat ndërkohë shfaqen në sistemin tatimor;
- kur subjektet kryejnë pagesa pjesore dhe për punëmarrës të veçantë, të dhënat e kontributeve të paguara nuk shfaqen në sistemin CMIS;
- kur subjektet kryejnë korigjimin e deklaratës tatimore listëpagesat ESIG-25, në sistemin CMIS nuk shfaqet data kur është kryer korigjimi, çka krijon probleme të mundshme lidhur me kushtet e përfitimeve afatshkurtra dhe afatgjata;
- në lidhje me bazën e të dhënave të subjekteve për periudhën 2005-2012, për subjektet e mbyllura para vitit 2010, nuk është përcjellë asnjë e dhënë nga ana e organeve tatimore;
- për subjekte të cilat kanë bërë pagesë me vonesë (jashtë afateve ligjore) apo për subjekte që janë me grafik të shlyerjes së debisë, për periudhat tatimore 2005-2012, nga ana e DPT nuk është përcjellë përditësimi i të dhënave përkatëse, ndërsa personat paraqiten në sigurimet shoqërore me urdhër pagesat dhe vërtetimin sipas periudhave përkatëse (kryesisht periudhat tatimore 2013- 2014) nga organet tatimore të cilat gjenerohen nga sistemi i DPT-së.

B. Të gjitha këto shqetësime, ISSH i ka ndjekur rast pas rasti dhe për rastet problematike të mësipërme gjatë vitit 2021 i është drejtuar DPT-së:

- Me shkresën nr. 1864 prot, datë 16.03.2021 òMbi dërgimin e listëpagesave të formatit elektronik;
- Me shkresën nr. 5331 prot, datë 25.08.2021 òPër problematikat e DARò, nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve;
- Me shkresën nr. 5731 prot, datë 17.09.2021 òMbi subjektet me detyrime të prapambetura në përgjegjësi të organeve tatimore;
- Me shkresën nr. 5331/3 prot, datë 29.10.2021 òPër listëpagesat e munguara, DARò, nga Drejtoria e Burimeve të Informacionit;
- Me shkresën nr. 7705 prot, datë 07.12.2021 òMbi gjendjen e detyrimeve të prapambetura dhe problematikat shqetësuese.

Nga ana e DPT, është kthyer një përgjigje në ISSH, me shkresën nr. 5295/3 prot, datë 02.08.2021 ku informohet që puna për zgjidhjen e këtyre problematikave ka nisur, dhe ka filluar dërgimi i listëpagesave të padërguara, ndërkohë për disa nga rastet e referuara nga ana ISSH-së për problematikat e DAR informohemi se, listëpagesat nuk plotësojnë kushtet për dërgim në ISSH, duhen sistemuar dhe plotësuar të dhënat në mungesë më parë nga vetë subjekti.

C. Për sa më sipër, të dhënat e marra i janë dërguar DRSSH-ve për vazhdimësi të evidentimit dhe të përpunimit të mëtejshëm të tyre dhe konkretisht DRSSH-të kanë bërë grupimet e subjekteve debitorë në: buxhetorë, jobuxhetorë, biznes i madh dhe biznes i vogël, procedurë e cila ndiqet pothuajse, në fund të çdo periudhe tremujore.

Për efekt të ndjekjes së ecurisë dhe të krahasimit është marrë periudha progresive e detyrimeve deri më 31.12.2021 duke u krahasuar me periudhën progresive të detyrimeve 31.12.2020 dhe janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 33 Detyrimet e papaguara nga subjektet debitorë në mijë lekë

Nr.	EMËRTIMI	Detyrimet e papaguara nga subjektet debitorë deri më 31.12.2021		Detyrimet e papaguara nga subjektet debitorë (deri më 31.12. 2020		Diferencat krahasuese të datës 31.12.2021 me datën 31.12.2020	
		Nr. i subjekteve debitorë	Detyrimet e prapambetura - në mijë lekë	Nr. i subjekteve debitorë	Detyrimet e prapambetura - në mijë lekë	Nr. i subjekteve	Detyrimet e prapambetura - në mijë lekë
1	Buxhetorë	384	341,464	491	385,683	(107)	(44,219)
2	Jobuxhetorë	279	449,096	296	339,582	(17)	109,514
3	Biznes i Madh	25,074	9,590,979	24,940	9,143,609	134	447,370
4	Biznes i Vogël	77,891	5,485,198	71,106	4,523,247	6,785	961,951
	SHUMA	103,628	15,866,737	96,833	14,392,121	6,795	1,474,616

Nga analiza e tabelës (një subjekt identifikohet si debitor nga mospagimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore në momentin kur pagesa e kryer është më e vogël në vlerë se vlera e përcaktuar në Deklaratën e Listëpagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe të ardhurave nga TAP-i.), shihet se ka një rritje të konsiderueshme të numrit të subjekteve debitorë, prej 6,795 subjektsh si dhe një rritje të detyrimeve të prapambetura me 1,474,616 mijë lekë nga viti 2020 në vitin 2021.

Në analizë të detyrimeve të prapambetura të subjekteve debitorë, në organet tatimore, vihet re numri i lartë i subjekteve debitorë dhe detyrime të mëdha, për kontribute të papaguara nga këto subjekte. Numri i tyre deri më 31.12.2021 është 103,628 mijë subjekte debitorë dhe detyrimet kontributeve të prapambetura të tyre janë rreth 15.8 miliard lekë nga 14.4 miliard lekë që ishin deri në fund të vitit 2020.

Ky fakt është një problem mjaft i madh dhe shqetësues, social dhe financiar, për organet e sigurimeve shoqërore sepse:

- pas subjekteve debitorë dhe shumave të papaguara të kontributeve, janë një numër i konsiderueshëm personash, të punësuar në këto subjekte, të cilët nuk mund të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore;
- deri tani fondit të sigurimeve shoqërore nuk i janë vënë në dispozicion rreth 15.8 miliard lekë detyrime të prapambetura që ju përkasin mbi 103 mijë subjekteve debitorë.

Gjithashtu nëpërmjet tabelave të më poshtme po paraqesim në mënyrë më të detajuar fenomenin e mësipërm mbi subjektet me detyrime të papaguara e konkretisht:

Tabela nr. 34 Të dhënat progresive për detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore të papaguara në afat për çdo subjekt, për drejtorinë rajonale tatimore (subjekte buxhetore) në lekë

Nr.	RAJONET	NR. I SUBJEKTEVE SIPAS NIPT-it	DETYRIMI	GJOBA	INTERESA	DEBIA
1	BERAT	11	63,874	164,137	20,764	248,775
2	DIBËR	28	235,380	537,332	620,328	1,393,040
3	DURRËS	16	404,404	478,988	650,291	1,533,683
4	ELBASAN	28	1,738,077	1,123,173	2,443,291	5,304,541
5	FIER	14	28,962	1,156,113	3,070,710	4,255,785
6	GJIROKASTËR	18	1,257,889	4,504,989	4,838,076	10,600,954
7	KORÇË	17	222,086	102,725	22,812	347,623
8	LEZHË	12	1,929,837	148,869	69,949	2,148,655
9	SARANDË	7	765,810	187,518	217,582	1,170,910
10	SHKODËR	24	5,212,101	220,422	145,620	5,578,143
11	TIRANË	146	58,478,209	68,905,048	113,469,654	240,852,911
12	VLORË	12	382,357	128,123	41,652	552,132
13	KAVAJË	9	191,608	211,842	61,206	464,656

14	KUKËS	35	26,323,941	12,057,540	22,508,997	60,890,478
	Shuma	377	97,234,535	89,926,819	148,180,932	335,342,286
15	VIP-AT	7	1,858,738	460,039	3,802,946	6,121,723
	TOTALI	384	99,093,273	90,386,858	151,983,878	341,464,009

Tabela nr. 35 Të dhënat progresive për detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore të papaguara në afat për çdo subjekt, për drejtorinë rajonale tatimore (subjekte jobuxhetore) në lekë

Nr.	RAJONET	NR. I SUBJEKTEVE SIPAS NIPT-it	DETYRIMI	GJOBA	INTERESA	DEBIA
1	BERAT	8	25,865,547	1,805,403	729,302	28,400,252
2	DIBËR	15	1,502,084	1,463,787	1,232,607	4,198,478
3	DURRËS	15	44,671,552	2,983,176	418,995	48,073,723
4	ELBASAN	28	23,943,319	2,893,280	1,275,101	28,111,700
5	FIER	20	35,027,337	10,952,729	2,348,881	48,328,947
6	GJIROKASTËR	19	12,571,432	400,805	554,784	13,527,021
7	KORÇË	18	30,978,037	418,184	106,021	31,502,242
8	LEZHË	9	17,006,205	2,437,580	709,774	20,153,559
9	SARANDË	5	90,160	16,057	258	106,475
10	SHKODËR	15	35,317,867	14,111,978	12,401,902	61,831,747
11	TIRANË	94	33,187,294	7,087,078	4,887,420	45,161,792
12	VLORË	12	46,069,007	5,230,548	2,069,209	53,368,764
13	KAVAJË	5	49,418,177	2,775,828	984,312	53,178,317
14	KUKËS	13	7,400,532	3,530,995	2,205,989	13,137,516
	Shuma	276	363,048,550	56,107,428	29,924,555	449,080,533
15	VIP-AT	3	1	12,229	3,352	15,582
	TOTALI	279	363,048,551	56,119,657	29,927,907	449,096,115

Tabela nr. 36 Të dhënat progresive për detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore të papaguara në afat për çdo subjekt, për drejtorinë rajonale tatimore (subjekte juridike) në lekë

Nr.	RAJONET	NR. I SUBJEKTEVE SIPAS NIPT-it	DETYRIMI	GJOBA	INTERESA	DEBIA
1	BERAT	427	89,759,230	9,157,222	5,335,606	104,252,058
2	DIBËR	387	187,100,936	19,396,274	9,199,639	215,696,849
3	DURRËS	3,763	1,112,460,330	159,463,830	92,001,682	1,363,925,842
4	ELBASAN	889	202,186,452	28,110,284	12,817,744	243,114,480
5	FIER	1,215	326,369,424	36,350,289	19,644,337	382,364,050
6	GJIROKASTËR	364	83,553,961	13,145,728	10,422,578	107,122,267
7	KORÇË	758	179,025,470	21,387,707	17,812,523	218,225,700
8	LEZHË	629	217,375,257	21,069,680	14,178,530	252,623,467
9	SARANDË	338	45,531,290	6,954,510	4,299,907	56,785,707
10	SHKODËR	1,015	368,396,779	70,751,164	28,234,191	467,382,134
11	TIRANË	12,909	4,470,501,563	561,512,869	240,107,924	5,272,122,356
12	VLORË	1,297	324,117,718	50,097,621	40,831,960	415,047,299
13	KAVAJË	685	115,617,323	13,151,084	6,229,642	134,998,049
14	KUKËS	235	84,668,982	9,146,539	4,344,375	98,159,896
	Shuma	24,911	7,806,664,715	1,019,694,801	505,460,638	9,331,820,154
15	VIP-AT	163	228,978,812	24,035,070	6,144,939	259,158,821
	TOTALI	25,074	8,035,643,527	1,043,729,871	511,605,577	9,590,978,975

Tabela nr. 37 Të dhënat progresive për detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore të papaguara në afat për çdo subjekt, për drejtorinë rajonale tatimore (subjekte biznesi i vogël) në lekë

Nr.	RAJONET	NR. I SUBJEKTEVE SIPAS NIPT-it	DETYRIMI	GJOBA	INTERESA	DEBIA
1	BERAT	2,247	104,879,108	12,143,201	4,366,951	121,389,260
2	DIBËR	1,565	63,324,963	15,369,866	5,948,003	84,642,832
3	DURRËS	7,851	484,879,005	58,936,469	15,936,553	559,752,027
4	ELBASAN	4,622	315,551,287	31,470,108	6,592,497	353,613,892
5	FIER	5,606	334,906,673	38,378,323	8,561,816	381,846,812
6	GJIROKASTËR	1,349	60,322,530	10,452,402	2,195,546	72,970,478
7	KORÇË	4,665	249,275,454	39,457,826	15,527,627	304,260,907
8	LEZHË	2,951	187,732,745	17,490,776	8,287,607	213,511,128
9	SARANDË	2,229	106,184,631	12,821,801	4,850,066	123,856,498
10	SHKODËR	5,066	260,378,719	32,253,957	5,567,802	298,200,478
11	TIRANË	32,722	2,231,815,262	235,569,651	25,796,455	2,493,181,368
12	VLORË	4,774	273,608,026	34,852,907	9,108,464	317,569,397
13	KAVAJË	1,534	99,820,023	11,386,852	4,375,117	115,581,992
14	KUKËS	710	38,993,096	5,051,932	775,540	44,820,568
	Shuma	77,891	4,811,671,522	555,636,071	117,890,044	5,485,197,637

Tabela nr. 38 Të dhënat progresive për detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore të papaguara në afat për çdo subjekt, subjektet buxhetore, jobuxhetore, juridike dhe biznesi i vogël në lekë

NR	SUBJEKTI	26.04.2021		26.07.2021		25.10.2021		26.01.2022	
		NR. I SUBJEKTEVE	DEBIA	NR. I SUBJEKTEVE	DEBIA	NR. I SUBJEKTEVE	DEBIA	NR. I SUBJEKTEVE	DEBIA
1	Buxhetoret	399	356,821,445	396	335,775,743	373	324,159,669	384	341,464,009
2	Jobuxhetoret	272	347,659,098	274	388,280,766	285	414,955,387	279	449,096,115
3	Sub juridike	23,558	9,174,558,605	24,588	9,368,660,089	25,134	9,544,716,839	25,074	9,590,978,975
4	B i Vogël	72,563	4,938,771,431	77,186	5,231,047,525	81,139	5,481,821,791	77,891	5,485,197,637
TOTALI		96,792	14,817,810,579	102,444	15,323,764,123	106,931	15,765,653,686	103,628	15,866,736,736

Gjithashtu janë në aneks edhe të dhënat sipas (Tabelës nr. 39) me 50 subjektet debitorë, të subjekteve buxhetore me debinë më të madhe, si dhe (Tabelanr. 41) me 50 subjekte debitorë, subjekte jobuxhetore me debinë më të madhe.

X.

Një tregues i rëndësishëm për vitin 2021 është edhe treguesi i skemës së sigurimeve krahasuar me PBB, (shpallur nga MFE, në procesin e hartimit dhe miratimit të treguesve në buxhet), që pasqyrohen si më poshtë:

Tabela nr. 42 Treguesi i PBB 2013-2021 sipas buxhetit të konsoliduar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

EMËRTIMI	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
PBB nominal	1,350,053	1,395,305	1,434,307	1,472,479	1,550,645	1,636,730	1,691,727	1,617,541	1,769,258

Burimi: Drejtoria e Financës në ISSH, e marrë nga MFE

Tabela nr. 43 Treguesit e skemës së sigurimeve krahasuar me PBB në %

Nr.	NDAJ PBB	PLAN	FAKT
1	KONTRIBUTE DHE TË ARDHURA TË TJERA	5.16	5.36
2	FINANCIME NGA BUXHETI (plan 57,894 milionë sipas A/N të ndryshuara e sipas tabelës 8 të buxhetit). Fakti i llogaritur sipas rezultatit faktit së të ardhurave e shpenzimeve dhe nevojës për financim.	3.27	3.01
3	SHPENZIME PËR PËRFITIME	8.43	8.37
	SHPENZIME PËR PËRFITIME SIGURIM I DETYRUESHËM	7.25	7.25
	SHPENZIME PËR PROGRAME TË VEÇANTA SHTETËRORE	0.75	0.72
	SHPENZIME PËR PROGRAME E SKEMA SUPLEMENTARE	0.43	0.40
4	FINANCIM I NEVOJSHËM PËR SKEMËN E DETYRUESHME	1.81	1.57
	PBB	1,769,258	1,769,258

Burimi: Drejtoria e Kontributeve në ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Titulli i Gjetjes: Për planifikimin e buxhetit të sigurimeve shoqërore për vitin 2021, grumbullimit së të ardhurave; analizimit të deficitit të skemës së pensione; analizimit të nivelit të borxhit ndaj skemës së pensione dhe entitetet problematike; analizimit të listëpagesave të kontributeve; bashkëpunimit me institucionet;

Situata: Nga shqyrtimi i zbatimit të buxhetit për vitin 2021 rezultojnë se:
 - Planifikimi i treguesve të fondit të sigurimeve shoqërore nuk mbështet në nivelin bazë të rajoneve, si dhe nuk shoqërohet me një analizë të detajuar, por në përgjithësi i përmbahet skemave fikse të miratuara nga institucioni epror e konkretisht: në planifikimin strategjik të dhënat e dërguara nga MFE janë njësoj me ato të përgatitura nga ISSH, çka tregon se planifikimi nuk është realizuar plotësisht në bazë të analizave dhe studimeve konkrete, por është thjeshtë një përshtatje shifrash midis institucioneve të cilat llogariten në bazë të eksperiencës dhe një trendi rritës, madje shifrat e ISSH-së përshtaten njësoj me ato të organit epror; hartimi i treguesve të buxhetit vjetor e atij afatmesëm në fazën e I

strategjike është kryer i përqendruar në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH-së, duke mos përfshirë në këtë fazë programimi njësitë shpenzuese rajonale, me justifikimin se ato nuk kanë tregues të mjaftueshëm për të realizuar atë, por përfshirja e tyre në këtë fazë të planifikimit strategjik mund të ishte e dobishme, sepse do të përmblihte eksperiencat e tyre në vite pavarësisht se nuk kanë të dhëna makro Plani i buxhetit të ISSH ka ndryshuar tre herë e konkretisht sipas ligjit nr. 137/2020, sipas Aktit Normativ nr. 18, datë 14.04.2021 dhe Sipas Aktit Normativ nr. 34, datë 03.12.2021 të dërguara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Të ardhurat gjithsej nga kontributet e sigurimeve shoqërore për vitin 2021 në shkallë vendi, nga 91,576,000 mijë lekë të programuara, u realizuan 94,857,582 mijë lekë ose në masën 104% .

- Rezultati fiskal vjetor, i cili paraqitet si diferencë midis të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit, tregon se nevojat për financimin e shpenzimeve të vitit, janë ulur në krahasim me planin në vlerën 2,994 milionë lekë, megjithatë ato vazhdojnë të mbeten akoma të larta, sepse subvencioni nga buxheti i shtetit për skemën e pensioneve i llogaritur për vitin 2021 është 37,715 milionë lekë.

- Të ardhurat nga kontributet nuk janë të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të skemës së pensioneve për të dy skemat (qytetin dhe fshatin) duke krijuar një deficit të vazhdueshëm nga viti në vit. Ky deficit konstatohet në rritje në vlerë absolute për vitin 2021 në vlerën 899,901 mijë lekë kundrejt vitit 2020, megjithëse ka një përmirësim prej 0.14 pikë. Ky deficieti fiskali sistemit, pavarësisht rezultatit vjetor dhe mbulimit të planifikuar të tij, rezulton të jetë 30,413 milionë lekë dhe nëse i zbritet kontributi për papunësinë i pa transferuar e ligjërisht i lënë në llogaritë e ISSH në shumën 3,179 milionë lekë, redukton financimin buxhetor në vlerën 27,233.4 milionë lekë.

- Numri i përfituesve të pensioneve të pleqërisë, invaliditetit dhe familjarë për vitin 2021, konstatohet se në fillim të vitit 2021, në skemën e detyrueshme ishin 665,567 pensionistë dhe në fund të vitit 2021, rezultuan 673,542 pensionistë, me një shtesë në total, prej 7,975 pensionistë.

- Konstatohet mungesa e bashkëveprimit dhe komunikimit të rregullt në marrëdhëniet ndërinstitucionale midis ISSH dhe DPT të cilat janë kthyer pothuajse në fenomen. ISSH në mënyrë të vazhdueshme ka ndjekur mangësitë që evidentohen në sistemin e transmetimit të listë-pagesave ashtu dhe në bashkëpunimin që kërkohet lidhur me angazhimin e organeve tatimore, për sa i përket rolit të tyre në drejtim të mbledhjes së detyrimeve të prapambetura.

Sipas të dhënave të marra e përpunuara konstatohet se subjektet debitorë kanë pësuar një rritje të konsiderueshme prej 6,795 subjektësh si dhe një rritje të detyrimeve të prapambetura me 1,474,616 mijë lekë në vitin 2021. Ndërsa deri tani Institutit të Sigurimeve Shoqërore nuk i janë vënë në dispozicion rreth 15.8 miliard lekë detyrime të prapambetura që ju përkasin mbi 103 mijë subjekteve debitorë.

- Për vitin 2021 një tregues i rëndësishëm është edhe treguesi i skemës së sigurimeve krahasuar me PBB, (shpallur nga MFE, në procesin e hartimit dhe miratimit të treguesve në buxhet), i cili megjithëse ka ardhur në rritje është larg pritshmërisë dhe objektivave, kështu për vitin 2021 ai është realizuar 5.36 % nga 5.16 % i planifikuar.

Kriteri:

Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 ÷ Për sigurimet shoqërore në Republikën e

Shqipërisë, i ndryshuar;
Ligji nr. 9136, datë 11.09.2003 për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;
Ligji nr. 137/2020 për buxhetin e vitit 2021 si dhe Aktet Normative që kanë ndryshuar gjatë vitit;
Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;
Udhëzimi i MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit";
Rregullore të ndryshme të Institucionit të Sigurimeve Shoqërore.

Ndikimi/Efekti: Përmirësimi i performancës në administrimin e sistemit të sigurimeve shoqërore.

Shkaku: Rritja e të ardhurave e numrit të kontribuuesve dhe mbledhja e debitorëve.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime:

- Instituti i Sigurimeve Shoqërore të mundësojë rritjen e të ardhurave e numrit të kontribuuesve, uljen e deficitit të skemës së pensioneve, zvogëlimin e subvencionit të buxheti shtetit për skemën e pensioneve dhe përmirësimin e raportit kontribute me prodhimin e brendshëm bruto (PBB).
- Instituti i Sigurimeve Shoqërore ti bëjë prezent dhe të kërkojë që Ministria e Financave dhe Ekonomisë të ndërhyjë në zgjidhjen e problematikave të mbartura në marrëdhëniet e saj me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për diferencat e kontributeve të derdhura nga subjektet privatë dhe shtetërore për sigurimet shoqërore të cilat konstatohen në rreth 103 mijë subjekte debitorë dhe arrijnë në një vlerë rreth 15.8 miliard detyrime të prapambetura.

2.3 Auditimi i funksionimit të strukturave të kontrollit në drejtim të inspektimit të pensioneve dhe auditimit të brendshëm.

A. Inspektimi i pensioneve

Per auditimin e inspektimit të pensioneve, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Evidenca dhe statistika të proceseve të inspektimit për vitin 2021,
2. Dokumentet e punës të mbajtura nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve për inspektimet e kryera.

Njësia e Inspektimit të Përfitimeve është një strukturë e cila si objekt të veprimtarisë së saj ka, kontrollin e të gjitha përfitimeve që administron sistemi i sigurimeve shoqërore, përfitimet afatgjata si dhe ato suplementare.

Bazuar në informacionin dhe të dhënat e vëna në dispozicion rezulton se:

Gjatë vitit 2021, Njësia e Inspektimit të Përfitimeve në ISSH në punën e saj është fokusuar që, në mbështetje të Rregullores nr. 1/2, datë 04.03.2011 për një shtesë në Rregulloren nr. 1, datë 21.10.2008 për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve, të ndryshuar, Rregullores nr. 25/1, datë 04.03.2011 për një shtesë në rregulloren nr. 25/1, datë 03.09.1999 për caktimin, administrimin dhe pagimin e përfitimeve suplementare të ushtarakëve, të ndryshuar, Rregullores nr. 3/1, datë 04.03.2011 për një shtesë në Rregulloren nr. 3, datë 15.08.1996 për caktimin, administrimin dhe pagimin e përfitimeve shtetërore suplementare, të ndryshuar, Rregullores nr.23, datë 31.7.2019 për caktimin, administrimin dhe pagesën e trajtimit financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të

industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji, si dhe standardeve të kontrollit të përcaktuara me ligj, të realizojë inspektimin e përfitimeve afatgjata të caktuara në zbatim të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, si dhe të përfitimeve suplementare të caktuara në zbatim të ligjeve të veçanta që rregullojnë marrëdhëniet në fushën e përfitimeve suplementare, nga Degët e Përfitimeve të DRSSH-ve dhe Degëve të sigurimeve shoqërore.

Për vitin 2021 është hartuar Plani Vjetor i Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, me nr. 405 prot., datë 19.01.2021, sipas të cilit është planifikuar inspektimi i përfitimeve nga kjo Njësi.

Në planifikimin vjetor të punës së Njesisë është marrë parasysh numri i përfitimeve të caktuara nga subjektet, objekt kontrolli për vitet 2017 ó 2018 ó 2019 ó 2020, si dhe burimet njerëzore në dispozicion të Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve.

Për të bërë të mundur planifikimin e programeve të inspektimit, edhe për vitin 2021 planifikimi i programeve të inspektimit është bërë duke patur në vëmendje, rregullin tashmë të vendosur sipas të cilit çdo specialist inspektimi në çdo ditë pune të inspektojë 15 dosje përfitimi. Secili nga specialistët e njesisë, pasi bën kontrollin e dosjes së përfitimit, kushtet ligjore të përfitimit, dokumentacionin mbi të cilin është caktuar përfitimi, mënyrën e llogaritjes, bën edhe ballafaqimin me të dhënat e sistemit PCAMS për çdo dosje përfitimi, si dhe në rubrikën òKomente të auditit bën komentin përkatës. Përfitimet të cilat rezultojnë të caktuara në përputhje me dispozitat ligjore, certifikohen, ndërsa për përfitimet, në të cilat konstatohen gabime dhe moszbatim të dispozitave ligjore mban akt konstatimin për secilin rast.

I. Inspektimi i përfitimeve afatgjata nga skema e detyrueshme.

Spektori i Inspektimit të Përfitimeve Afatgjata gjatë vitit 2021, përveç programeve të inspektimit të planifikuara për vitin 2021, ka përfunduar programin e inspektimit në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë, inspektimi për të cilin ka qenë planifikuar në programin vjetor të vitit 2020 dhe afati i inspektimit ishte 05.10.2020 ó 29.01.2021. Rezultatet e inspektimit për këtë DRSSH nuk janë raportuar në të dhënat e vitit 2020. Sipas programit vjetor, Njësia e Inspektimit, ka kryer inspektimet në DRSSH ó të si më poshtë:

DRSSH Durrës ó Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2018 ó 31.12.2019;

Afati i kontrollit 25.01.2021 ó 16.06.2021.

Programi i inspektimit nr. 434 prot., datë 19.01.2021

DRSSH Elbasan - Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2017 ó 31.12.2019;

Afati i kontrollit 25.01.2021 ó 17.06.2021.

Programi i inspektimit nr. 433 prot., datë 19.01.2021

DRSSH Berat - Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2018 ó 31.12.2019;

Afati i kontrollit 23.06.2021 ó 28.07.2021.

Programi i inspektimit nr. 3890 prot., datë 17.06.2021.

DRSSH Dibër ó Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2018 ó 31.12.2019;

Afati i kontrollit 02.08.2021 ó 03.09.2021.

Programi i inspektimit nr. 4569 prot., datë 14.07.2021.

DRSSH Gjirokastër ó Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2018 ó 31.12.2019;

Afati i kontrollit 13.09.2021 ó 08.10.2021;

Programi i inspektimit nr. 5350 prot., datë 27.08.2021.

DRSSH Vlorë ó Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2018 ó 31.12.2019;

Afati i kontrollit 14.10.2021 ó 19.11.2021;

Programi i inspektimit nr. 6090 prot., datë 04.10.2021.

DRSSH Sarandë ó Përfitimet e caktuara në periudhën kohore 01.01.2018 ó 31.12.2019.

Afati i kontrollit 25.11.2021 ó 17.12.2021.

Programi i inspektimit nr. 7095 prot., datë 12.11.2021.

Sipas programit vjetor është planifikuar edhe inspektimi i përfitimeve afatgjata të caktuara nga DRSSH Tiranë në periudhën kohore 01.01.2019 ó 31.12.2019, inspektim i cili ka filluar në datën 23.12.2021 dhe është planifikuar të përfundojë në datën 18.03.2022, rezultatet e të cilit do të paraqiten për vitin 2022.

Kontrollet e kryera për vitin 2021, si dhe rezultatet e gjetjeve të konstatuara, nga sektori i inspektimit të përfitimeve afatgjata, janë pasqyruar në evidencën e cila është në aneks.

Meqenëse inspektimi i përfitimeve është kryer pjesërisht në ambientet e DRSSHÓve, pra aty ku administrohet dosja e përfitimit, e cila është objekt inspektimi, si dhe gjithë logjistika mbështetëse, dhe pjesërisht në ambientet e ISSH ó së, në përfundim të periudhës së inspektimit, në ato DRSSH ku është kryer inspektimi, kanë mbetur pa u certifikuar në total (nga dosjet e paraqitura) vetëm 2.91 % e dosjeve, për të cilat janë lënë detyra për rishqyrtim apo plotësim dokumentacioni.

Ndërkohë që gjatë periudhës së kontrollit është kryer rishqyrtimi apo plotësimi me dokumentacionin e kërkuar për 1,004 përfitime. Një ndër pikat me rëndësi të programeve të inspektimit është edhe kontrolli i zbatimit të rekomandimeve të paraqitura në Raportet Përfundimtare në zbatim të programeve të mëparshme të inspektimit.

Sipas rekomandimeve të Njësisë së Inspektimit të Përfitimeve janë kontrolluar 1,130 dosje përfitimi, nga të cilat për 977 prej tyre ishin realizuar rekomandimet e lëna gjatë kontrolleve të mëparshme, ndërsa mbeten për tu zbatuar rekomandimet për 150 dosje përfitimi. Për 3 dosje përfitimi është bërë pezullimi i tyre.

Nga dosjet e kontrolluara, për të cilat ishin zbatuar rekomandimet e paraqitura, për 264 prej tyre, si rezultat i rishqyrtimit kanë rezultuar me efekte financiare debitorë dhe kreditorë. Nga këto, 118 dosje përfitimi kanë rezultuar me efekt financiar debitor në shumën 11,493,060 lekë, ndërsa 146 dosje përfitimi kanë rezultuar me efekt financiar kreditor në shumën 7,311,551 lekë.

Referuar të dhënave dhe informacionit të vënë në dispozicion rezulton se nga Njësia e Inspektimit për gjithë periudhën e vitit 2021 janë kontrolluar 42,155 dosje të përfitimeve afatgjata, si dhe janë rikontrolluar 1,130 dosje përfitimi. Në total janë kontrolluar 43,285 dosje të përfitimeve afatgjata.

II. Sektori i Inspektimit të Përfitimeve suplementare dhe trajtimeve të veçanta.

Sektori i Inspektimit të përfitimeve suplementare dhe trajtimeve të veçanta gjatë vitit 2021 ka përfunduar programin e inspektimit në Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore të cilat janë të përshkruara si më poshtë, lidhur me përfitimet e caktuara nga këto DRSSH, ku është kryer inspektimi, në periudhat respektive:

1. DRSSH Fier ó Përfitimet suplementare dhe trajtimet e veçanta të caktuara në periudhën kohore 01.07.2018 ó 30.06.2020. Afati i kontrollit 20.01.2021 ó 31.03.2021
Programi i inspektimit nr. 432 prot., datë 19.01.2021.
2. DRSSH Elbasan - Përfitimet suplementare të caktuara në periudhën kohore 01.07.2018 ó 31.12.2020; Programi i inspektimit nr. 2293 prot., datë 02.04.2021.
Afati i kontrollit 07.04.2021 ó 18.06.2021.
3. DRSSH Vlorë - Përfitimet suplementare të caktuara në periudhën kohore 01.07.2018 ó 31.12.2020; Programi inspektimit nr. 3964, datë 21.06.2021.
Afati i kontrollit 23.06.2021 ó 22.10.2021.
4. DSSH Sarandë ó Përfitimet suplementare të caktuara në periudhën kohore 01.07.2018 ó 31.12.2020; Programi nr. 3964 prot., datë 21.06.2021.
Afati i kontrollit 23.06.2021 ó 22.10.2021.
5. DRSSH Berat ó Përfitimet suplementare të caktuara në periudhën kohore 01.07.2018 ó 31.12.2020; Programi nr. 6360 prot., datë 15.10.2021.
Afati i kontrollit 27.10.2021 ó 22.12.2021.

Një ndër pikat me rëndësi të programeve të inspektimit është edhe kontrolli i zbatimit të rekomandimeve të paraqitura në Raportet Përfundimtare në zbatim të programeve të mëparshme të inspektimit.

Sipas rekomandimeve të Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve janë kontrolluar 41 dosje përfitimi, për të cilat ishin paraqitur rekomandime gjatë kontrolleve të mëparshme.

Nga këto, janë zbatuar rekomandimet për 29 dosje përfitimi, duke rezultuar me efekte financiare debitorë dhe kreditorë, apo edhe pa efekte financiare.

Efekti financiar debitor nga zbatimi i rekomandimeve për 5 dosje përfitimi është në vlerën 371,437 lekë, ndërsa efekti financiar kreditor nga zbatimi i rekomandimeve për 4 dosje përfitimi është në vlerën 82,350 lekë. Në rastin e 20 dosjeve të përfitimit, zbatimi i rekomandimeve ka rezultuar pa efekte financiare.

Në përfundim të vitit 2021 janë kontrolluar 8,036 dosje të përfitimeve suplementare, si dhe janë ri kontrolluar 41 dosje të përfitimeve suplementare. Në total, kanë kaluar në proces inspektimi 8,077 dosje të përfitimeve suplementare. (Për më hollësisht, trajtuar në aneksin përkatës të inspektimit të pensioneve të planifikuar dhe realizuar për vitin 2021.)

Inspektimet e kryera për vitin 2021, si dhe rezultatet e gjetjeve të konstatuara, nga sektori i inspektimit të përfitimeve suplementare dhe trajtimeve të veçanta, janë pasqyruar në evidencën e cila është në aneks.

Në përfundim të programeve të inspektimit gjatë vitit 2021, nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve, janë inspektuar gjithsej 50,156 dosje përfitimi të cilat kanë qenë objekt kontrolli i radhës, si dhe 1,163 dosje përfitimi për të cilat është kontrolluar zbatimi i rekomandimeve, sipas raporteve përfundimtare të programeve të mëparshme të inspektimit.

Për të gjitha përfitimet e caktuara, bazuar në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 òPër Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar, si dhe ligjet e veçanta që rregullojnë marrëdhëniet në fushën e përfitimeve suplementare dhe trajtimeve të veçanta, për të cilat është lënë detyrë dhe janë në proces rishqyrtimi dhe verifikimi, nga specialistët e Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve, do të shqyrtohen gjatë inspektimeve në vijim.

Problematikat e ndeshura në përfitimet e caktuara sipas ligjit 7703, datë 11.05.1993.

- Moszbatim unik, i saktë, i drejtë dhe korrekt i akteve ligjore e nënligjore, që veprojnë në fushën e sigurimeve shoqërore të skemës së detyrueshme dhe skemave suplementare.
- Moszbatim korrekt i procedurave dhe afateve të përcaktuara sipas Rregullores Nr. 1, datë 21.10.2008 òPër caktimin, Administrimin dhe Pagesën e Pensioneve.
- Rastet e pezullimit të përfitimeve, më së shumti kanë të bëjnë me kategorinë e pensioneve të invaliditetit, lidhur me kushtet e përfitimit (nuk plotësohet kushti ligjor 1 vit sigurim në 5 vitet e fundit), apo edhe pensionet me periudhë sigurimi prej 15 vitesh

Për pasojë ka llogaritje të gabuara dhe përfitime të pamerituara, të pabazuara në dokumentacion.

Profilet e problematikave:

- Konstatohen raste të caktimit të përfitimeve jashtë kushteve ligjore, si rezultat i të cilave përfitimet janë rekomanduar të pezullohen apo të rishqyrtohen në kushte të tjera përfitimi.
- Për llogaritjen e bazës së vlerësuar nuk ka qëndrime të unifikuara për pagat referuese sipas VKM nr. 561, datë 12.8.2005 òPër përcaktimin e pagave referuese për efekt pensioni para vitit 1994 dhe ka në shumë raste përcaktime të gabuara
- Nuk është llogaritur saktë baza e vlerësuar për periudhën e trajtimit me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi apo pagesë kalimtare, në zbatim të nenit 23 të ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009, të ndryshuar;
- Është njohur si periudhë sigurimi për efekt të pensionit të pleqërisë, periudha e përfitimit të pensionit të invaliditetit të plotë, kur kjo periudhë, së bashku me vitet e punës dhe të sigurimit të realizuara nga përfituesi, e kanë kaluar periudhën e sigurimit të detyrueshëm të përcaktuar në nenin 92 të ligjit nr.7703/1993, të ndryshuar.
- Ka problematikë në datën e fillimit të pensionit dhe dhënien e shtesës së pensionit.
- Janë përfshirë në periudhën e përgjithshme të sigurimit, periudha të pa pasqyruara në sistemin CMIS, dhe të pakonfirmuara nga DPT.

- Gjithashtu janë lënë detyrë për verifikim në DPT, dhe shumë raste të tjera, për të cilat janë përfshirë në llogaritje, periudha të pa pasqyruara në sistemin CMIS.
- Konstatohen raste të llogaritjes së pensionit, për të cilat nuk është përcaktuar saktë, data e lindjes të së drejtës për përfitim.
- Nuk ka qëndrime të unifikuara në lidhje me njohjen e periudhave të sigurimit të pasqyruara në librezën e punës, ku në disa raste merren të mirëqena librezat edhe pse nga verifikimet me regjistra kanë rezultuar periudha sigurimi me mangësi, kurse në disa raste të tjera librezat nuk është marrë parasysh, nëse nga verifikimet kanë rezultuar periudha sigurimi me mangësi;
- Në disa raste llogaritja e pensionit nuk është kryer në kushtet e datës së lindjes së të drejtës për përfitim.

Problematika e konstatuar në inspektimin e përfitimeve suplementare.

Gjatë inspektimit të përfitimeve të caktuara sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, të ndryshuar, është konstatuar se:

- Ka pasaktësi tek të dhënat e periudhës së shërbimit aktiv si ushtarak aktiv dhe tek përcaktimi i saktë i datës së lindjes të së drejtës, (të dhëna që pasqyrohen në modelarin 03, të lëshuar nga strukturat përkatëse) nga e cila varet edhe llogaritja e pagës neto mesatare referuese, mbi të cilën do të llogaritet përfitimi.
- Ka pasaktësi në llogaritjen e masës fillestare të përfitimit, si dhe nuk janë zbatuar saktë rritjet në masën fillestare të përfitimit, deri në datën e pagesës. Gjithashtu, ka mospërputhje të masës së përfitimit sipas sistemit PCAMS dhe masës së përfitimit sipas VCP.
- Në rastet e rishqyrtimit të masës së pensionit të pleqërisë, nuk reflektohet ndryshimi të masa e pensionit suplementar. Është i domosdoshëm një bashkëpunim më i mirë mes sektorit të përfitimeve afatgjata dhe përfitimeve suplementare.
- Për dosjet e përfitimit sipas ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009, ka problematikë lidhur me ushtrimin e veprimtarisë ekonomike nga personat përfitues, si rezultat i së cilës, varet masa e përfitimit.

Gjatë inspektimit të përfitimeve të caktuara sipas ligjit nr. 29/2019 është konstatuar se:

- Nga procesi i inspektimit, janë konstatuar problematika në dosjet e përfitimeve të caktuara në zbatim të ligjit nr. 29/2019, lidhur me dokumentacionin justifikues, sa i përket konfirmimit të periudhave të punës në profesion, mbi të cilat janë caktuar përfitimet, si dhe përfshirjes së tyre si subjekte përfituese sipas ligjit. Nga ana e DRSSHÓve është mjaftuar vetëm me plotësimin e Vërtetimit të Posaçëm Zyrtar.

- Pezullimet e këtyre përfitimeve kanë ardhur si rrjedhojë e përfshirjes në skemën e përfitimeve edhe të personave që kanë kryer punë, të cilat nuk përfshihen si kategori përfituese sipas ligjit.

- Po ashtu, rishqyrtimet e kryera kanë ardhur si pasojë e përfshirjes së periudhave të punës në kundërshtim me përcaktimet ligjore, ashtu sikurse nuk janë përfshirë në llogaritje të gjitha periudhat e punës.

- Për të gjitha përfitimet suplementare, të cilat nuk e lejojnë ushtrimin e veprimtarisë ekonomike gjatë periudhës së përfitimit të pensioneve suplementare, konstatohen raste të përfitimit në kundërshtim me përcaktimet ligjore. Prandaj, është rekomanduar që në mënyrë periodike të ushtrohet kontroll për këto kategori përfitimesh.

Rekomandimet e Njesisë së Inspektimit për evadimin e detyrave të lëna.

- Për rastet e përfitimeve për të cilat është rekomanduar pezullimi nga ana e Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve është kërkuar mbyllja e menjëhershme e përfitimeve dhe vazhdimi i procedurave të parashikuara në dispozitat ligjore në fuqi. Dëmi i shkaktuar është pasqyruar në evidencën përkatëse.

- Për Përfitimet që kanë rezultuar me dëmtime të fondeve, për gabime teknike dhe moszbatim të drejtë të dispozitave ligjore në fuqi, është rekomanduar sistemimi i fondeve të dëmtuara sipas

përcaktimeve në nenin 62, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 òPër Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar.

- Nisur nga problematikat e konstatuara dhe gabimet që bëhen në llogaritjen e pensioneve dhe moszbatimin e saktë të procedurave të parashikuara në Rregulloret në fuqi, është e nevojshme të bëhen trajnime për punonjësit e Degëve të Përfitimeve.

Titulli i gjetjes: Diferenca nga inspektimet e dosjeve të përfituesve, tejkallim afati për certifikimin e dosjeve të pensioneve.

Situata: Nga shqyrtimi i veprimtarisë së Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve rezultoi se:

- Për vitin 2021 nga 42,713 dosje për t'u inspektuar janë paraqitur 42,155 dosje nga të cilat janë certifikuar 39,963 dosje. Nga dosjet e inspektuara kanë rezultuar 2,232 dosje (ose 5.6%) me problematika të ndryshme të cilat konsiderohen të pa certifikuara nga ku, 980 dosje përfitimesh kanë rezultuar me efekte debitorë apo kreditorë. Janë 424 dosje me efekt debitor në shumën 17,835,579 lekë dhe 556 dosje me efekt kreditor në shumën 17,052,504 lekë. Kjo vjen si rezultat i mangësive të konstatuara nga dokumentacioni i verifikuar në dosjet e përfituesve të cilat vijnë prej llogaritjeve të gabuara të punonjësve në Degët e Përfitimeve referuar dokumentacionit të disponueshëm në dosjet e përfituesve, edhe pse këto konstatime janë hasur edhe në auditimet e mëparshme.

- Gjithashtu, konstatohet se për dy subjekte rajonale, DRSSH Elbasan dhe DRSSH Korçë, inspektimet e kryera për dosjet e përfitimeve të vitit 2017 kanë qenë përtej afatit 3 vjet nga marrja e tyre. Konkretisht kanë qenë pa inspektuar 7,355 dosje në DRSSH Korçë prej të cilave kanë rezultuar 241 dosje me probleme dhe 118 prej tyre me efekte financiare ndërkohë që në DRSSH Elbasan kanë qenë pa inspektuar 9,993 ku kanë rezultuar 561 dosje me problema dhe 176 dosje me efekte financiare. Mbikëqyrja e sektorit të Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve nuk ka siguruar monitorim efikas të zbatimit të politikave dhe strategjive të ISSH, në drejtim të sugjerimeve për përmirësimin e dhënies së ekspertizës së mjaftueshme, mbi zgjidhjen e problemeve të metodologjisë së përlllogaritjes së përfitimeve, për të bërë të mundur uljen e riskut të diferencave të konstatuara dhe rritjen e përgjegjësisë për mbarëvajtjen e aktivitetit Institucional në këtë drejtim.

Kriteri: Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 òPër Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar,

Rregullore nr. 1/2, datë 04.03.2011 òPër një shtesë në Rregulloren nr. 1, datë 21.10.2008 òPër caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve, të ndryshuar, Rregullores nr. 25/1, datë 04.03.2011 òPër një shtesë në rregulloren nr. 25/1, datë 03.09.1999 òPër saktimin, administrimin dhe pagimin e përfitimeve suplementare të ushtarakëve, të ndryshuar,

Rregullore nr. 3/1, datë 04.03.2011 òPër një shtesë në Rregulloren nr. 3, datë 15.08.1996 òPër caktimin, administrimin dhe pagimin e përfitimeve shtetërore suplementare, të ndryshuar.

Ndikimi/efekti: Ndikimi financiar për përfituesit e pensioneve në vlerën debitorë 17,835,579 lekë dhe në vlerë kreditorë 17,052,504 lekë. Efekte financiare nga tejkallimi i afatit për certifikimet e dosjeve të përfituesve.

Shkaku: Mos përmbushje e rregullt i legjislacionit dhe procedurave ligjore në vendimmarrjet e Këshillit Shqyrtimit Administrativ si pasojë edhe e interpretimeve të rregullores.

- Rëndësia:** E lartë
- Rekomandim:** Drejtori i Përgjithshëm në bashkëpunim me Njësinë e Inspektimit të Përfitimeve, të hartojnë plan masash me afate, për të mundësuar certifikimin e 980 dosjesh përfitimesh të cilat kanë rezultuar me efekte debitorë dhe kreditorë, si dhe të marrë masa për inspektimin dhe certifikimin e të gjitha dosjeve të përfituesve brenda afatit 3-vjeçar.

B. Auditimi i brendshëm

Auditimi i funksionimit të strukturave të auditimit të brendshëm.

Në zbatim të pikës së auditimit të funksionimit të strukturave të auditimit të brendshëm u shqyrtuan dokumentacionet për çështjet e mëposhtme:

- a) Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm (DAB këtu, e më poshtë). Niveli profesional i audituesve, certifikimi i tyre dhe trajnimet e detyrueshme;
- b) Bashkëpunimi me Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm (DHAB) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE), raportimi në këtë drejtori;
- c) Realizimi i treguesve të planifikuar nga DAB;
- d) Auditim me zgjedhje mbi misionet e auditimeve të kryera nga DAB, zbatimimi i akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e auditimit të brendshëm, standardet dhe manualët të dala në zbatim të tyre.

Misioni i Auditit të Brendshëm, mbështetur në nenin 5, të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 për auditimin e brendshëm në sektorin publik, është të japë siguri të arsyeshme Titullarit të Institucionit, në mënyrë të pavarur dhe objektive.

Objektivat e DAB.

- ✓ siguridhënia objektive ndaj Titullarit të ISSH-së, zbatimimi i proceseve të punës kryhet me efikasitet, efikasitet dhe ekonomikitet, në përmbushje të objektivave të përcaktuara;
- ✓ zhvillimi i një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit.

Organizimi dhe funksionimi i DAB.

Nga shqyrtimi i dokumentacioneve u konstatua se, krijimi i DAB në ISSH, është përcaktuar në nenin 12, të vendimit nr. 1022, datë 09.07.2008, për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 161, datë 11.4.1994, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e statutit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore". DAB për periudhën objekt auditimi, ka funksionuar sipas përcaktimeve të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 për auditimin e brendshëm në sektorin publik, i ndryshuar, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë; të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, i ndryshuar, të VKM nr. 83, datë 03.02.2016 për miratimin e kritereve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik, i ndryshuar.

Në bazë të nenit 29, të ligjit nr. 9377, datë 21.04.2005, për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 DAB në aspektin organizativ dhe funksional ka varësi të drejtpërdrejtë nga Drejtori i Përgjithshëm i ISSH, si dhe punonjësit e saj emërohen prej tij.

Me shkresën nr. 7376 prot, datë 07.09.2017, të Titullarit të ISSH, bazuar në pikën nr. 4, të vendimit nr. 5, datë 20.07.2010 për ndryshimin e strukturës organizative të ISSH-së, të Këshillit Administrativ, struktura e drejtorisë është organizuar me 9 punonjës (1+6+2), të ndarë në Degën e Auditimit Financiar (1+5) dhe në Sektorin e Raporteve dhe Menaxhimit të Riskut (2).

Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2021, DAB ka funksionuar me strukturë jo të plotë, duke pasur 1 vend vakant/të lirë, në pozicionin auditues, në Degën e Auditimit Financiar, jo në përputhje me strukturën organike, të miratuar me Vendimin e Këshillit Administrativ nr. 5, datë

20.07.2010 “Për ndryshimin e strukturës organizative të ISSH-së”. Ky veprim kasjellë mungesë performance të kësaj drejtorie.

Për vitin 2021, veprimtaria e DAB është mbështetur edhe në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100 datë 25.10.2016, Kapitulli III ÷Planifikimi i veprimtarive të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV ÷Kryerja e auditimit të brendshëm, ndjekja e procedurave dhe raportimi e komunikimi i auditimit. Përveç këtyre akteve, në punën audituese, ka shërbyer edhe legjislacioni në fuqi, sipas fushave objekt auditimi.

DAB e realizon veprimtarinë e auditimit të brendshëm në:

- ✓ Drejtorinë e Përgjithshme të Sigurimeve Shoqërore;
- ✓ 12 Drejtori Rajonale të Sigurimeve Shoqërore;
- ✓ 2 Drejtori Qarku;
- ✓ Drejtorinë e Arkivit Qendror të ISSH.

Nga auditimi u konstatua se, punonjësit e DAB kanë arsim bazë: 6 prej tyre profil ekonomik, 1 profil juridik, si dhe 1 ekonomik e juridik, janë të pajisur me certifikatën ÷Auditues i Brendshëm në sektorin publik. Gjithashtu, të gjithë kanë përvojë pune, mbi 5 vite si auditues të brendshëm. Pra, punësimi i tyre është bërë në përputhje me nenin 11, të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 ÷Për auditimin e brendshëm në sektorin publik.

Punonjësit e DAB kanë kryer trajnimet e vijueshme të detyrueshme, 40 orë në vit dhe kanë marrë pjesë në të gjitha trajnimet që ka organizuar Njësia Qendrore e Auditit të Brendshëm (NJQAB). Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion grupit të auditimit, u konstatua se nuk ishin kryer trajnimet e planifikuara nga ISSH, në Planin e vitit 2021. Trajnime të cilat ishin konsideruar të nevojshme për audituesit e brendshëm, si dhe ishin me tema: Shërbimet online, Gjykimi i audituesve për vlerësimin e risqeve nga menaxhimi, ekspozimet e reja të riskut në kushtet e pandemisë etj.

Në aneks ndodhet tabela: Të dhëna për burimet njerëzore të auditit të brendshëm për vitin 2021.

Identifikimi i sistemeve dhe fushat me risk për auditim.

DAB në fazën e planifikimit vjetor është mbështetur në auditimin e sistemeve dhe subjekteve që kanë një risk më të lartë në realizimin e objektivave të ISSH. Nisur nga fakti që strukturat e ISSH, përfshirë dhe Drejtorinë e Përgjithshme përdorin fonde të mëdha publike, niveli i riskut është vlerësuar *nivel i mesëm*, ndaj auditimi i këtyre strukturave bëhet vjetor. Ndërkohë, sistemet që mbeten në nivelin e riskut *të mesëm* janë: sistemi i pagesave të përfitimeve, sistemi i prokurimeve, zbatimi i buxhetit sipas zërave të miratuar, transferimi i tij ndaj subjekteve të kontraktuar, dokumentet justifikues në pagesat e ndryshme, mbajtja e kontabilitetit sipas standardeve, kontrolli i zbatimit kontratave me ofruesit e shërbimeve.

Në shumë sisteme siç janë: zbatimi i legjislacionit në sistemin e pagave të punës, respektimi i strukturave organizative, respektimi i procedurave të punësimit, zbatimi i strukturave buxhetore, hartimi i treguesve financiarë, niveli i riskut ka zbritur nga nivel i mesëm *në të ulët*.

Për vitin 2021, DAB në bazë të vlerësimit të riskut ka identifikuar si sisteme, fusha dhe funksione prioritare që kanë qenë pjesë e angazhimeve të auditimit si vijon:

- Sistemi i caktimit të përfitimeve afatgjata dhe afatshkurtra
- Sistemi i rishqyrtimit të përfitimeve afatgjata dhe afatshkurtra
- Sistemi i kontributeve vullnetare, vetëpunësuarve në bujqësi, suplementare
- Sistemi i buxhetimit
- Sistemi i detyrimeve të prapambetura
- Sistemi i prokurimit
- Sistemi i personelit
- Sistemi i arkivës
- Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar

Nga auditimi u konstatua se, në identifikimin e sistemeve dhe vlerësimin e nivelit të riskut për subjektet e planifikuara për auditim në vitin 2021, janë vlerësuar edhe *sistemet e teknologjisë së informacionit*. Për Drejtorinë e Arkivit Qendror të ISSH, niveli i riskut është vlerësuar *i lartë*, ndërsa për të 15 DRSSH e tjera, niveli i riskut është vlerësuar *i mesëm*. Pavarësisht këtij vlerësimi, fushat që ishin planifikuar në Planin e vitit 2021, kanë qenë kryesisht ekonomiko-financiar/ të kombinuara. Në shqyrtimin e dokumentit, *oHarta e riskut për ISSH viti 2021*ö, u evidentua: *mungesa e një audituesi të brendshëm, ekspert në fushën e informatikës me risk të mesëm, para dhe pas kontrollit*.

Titulli i Gjetjes: Funksionimi i strukturave të auditimit të brendshëm.

Situata: - Nga shqyrtimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm në ISSH rezulton se: Struktura e DAB është organizuar me 9 punonjës, nga të cilët 1 Drejtor, 1 Kryetar Dege dhe 7 Specialistë Auditues. Nga auditimi u konstatua se, përgjatë vitit 2021, DAB ka funksionuar me strukturë jo të plotë, duke patur 1 vend vakant/ të lirë, gjë që ka sjellë mosfunksionim me kapacitet të plotë të kësaj drejtorie.

Në identifikimin e sistemeve dhe vlerësimin e nivelit të riskut për subjektet e planifikuara për auditim në vitin 2021, u konstatua se janë vlerësuar edhe *sistemet e teknologjisë së informacionit*. Për Drejtorinë e Arkivit Qendror të ISSH, niveli i riskut është vlerësuar *i lartë*, ndërsa për të 15 DRSSH e tjera, niveli i riskut është vlerësuar *i mesëm*, si fushat e planifikuara, kanë qenë kryesisht ekonomiko-financiar/ të kombinuara. Në shqyrtimin e dokumentit *oHarta e riskut për ISSH viti 2021*ö, u evidentua: *mungesa e një audituesi të brendshëm, ekspert në fushën e informatikës me risk të mesëm, para dhe pas kontrollit*.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se audituesit e DAB nuk kanë kryer trajnimet e planifikuara në Planin e vitit 2021 nga ISSH, të konsideruara të nevojshme për audituesit e brendshëm.

Kriteri: Ligji 7961 datë 12.07.1995 *oKodi i punës në Republikën e Shqipërisë*ö, i ndryshuar;

Ligji 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetëroreö;

Ligji nr. 7703, datë 11.5.1993 *oPër Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar;

Ligji nr. 114, datë 22.10.2015 *oPër Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikö*;

Vendimi i KA nr. 5, datë 20.07.2010 *oPër ndryshimin e strukturës organizative të ISSH-së*ö,

Manuali i Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III.

Ndikimi/efekti: Mosplanifikimi dhe moskryerja e auditimeve gjatë vitit 2021, në sistemet e teknologjisë së informacionit, të cilat përfshijnë vlerësimin e kontrolleve të menaxhimit në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit, në lidhje me ruajtjen e aseteve, integritetin e të dhënave dhe operimin në mënyrë efektive për të arritur qëllimet dhe objektivat e Institucionit.

Shkaku: Mungesa e një audituesi me profil arsimit në fushën e IT.

Rëndësia: E mesme

Rekomandime: Drejtori i Përgjithshëm të plotësojë pozicionin në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, vakant në fushën e teknologjisë së informacionit, si dhe të marrë masa që të kryejë trajnime të punonjësve të kësaj drejtorie.

Përgatitja e Planit Vjetor 2021 dhe Planit Strategjik 2021-2023.

Për periudhën objekt auditimi, DAB në ISSH ka hartuar planin strategjik dhe vjetor për vitet 2021-2023. Me shkresën nr. 5931/3 prot., datë 16.10.2020, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ISSH janë dërguar në Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (NJQH/AB). Nga auditimi u konstatua se, planet janë dërguar brenda afatit (20 Tetor), të përcaktuara në pikën 3.2 ëPlani vjetor i auditit të brendshëm dhe pikën 3.3 ëAfati i përgatitjes dhe dërgimit të planit vjetor dhe strategjik të auditit të brendshëm, në Manualin e Auditimit të Brendshëm, pasi është kryer procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm në MFE, i cili me Vendimin nr. 20, datë 09.10.2020, ka dhënë mendimin dhe rekomandimin pozitiv.

Me shkresën nr. 395 prot., datë 19.01.2022, i është dërguar Komitetit të Auditimit të Brendshëm në MFE, ëRaporti i Veprimtarisë së DAB-së në ISSH për vitin 2021ë duke i bashkëngjitur dhe ëPasqyrat Përmbledhëse 1-6ë në formatin Excel.

Gjithashtu, mbështetur në Kapitullin VII, pika 7.1.1. ëVlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet nga vetë Njësia e Auditimit të Brendshëm, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar; me shkresën nr. 395 prot., datë 19.01.2022, është dërguar nga ISSH, Aneksi 3 ëPyetësori i Vetëvlerësimit të DABë, te Komiteti i Auditimit të Brendshëm në MFE. Pyetësori përmban në total 40 pyetje dhe të gjitha përgjigjet janë dhënë nga DAB: “përputhshmëri e plotë”. Por, nga auditimi i veprimtarisë audituese së DAB për vitin 2021, u konstatua se jo e gjithë veprimtaria është në përputhmëri të plotë.Përgjigjet e pyetjeve nr. 27, 32 dhe 40 duhet të ishin “Përputhshmëri në disa fusha”. Më të detajuara, pyetjet dhe përgjigjet e dhëna në pyetësorin e vetëvlerësimit janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 1 Pyetësori i Vetëvlerësimit të DAB.

Nr. i pyetjes	Pyetjet	Arsyetimi mbi Vlerësimin e kryer	Vlerësimi	Komente të grupit të auditimit KLSH
27	Gjatë angazhimit të auditimit respektohen të gjitha fazat e përcaktuara në MAB.	Në të gjitha auditimet respektohen të gjitha fazat e përcaktuara në MAB.	Përputhshmëri e plotë	Jo, në të gjitha auditimet janë dokumentuar takimet (fillëstar, përmbyllës) me subjektin e audituar.
32	Plani i veprimit hartohet dhe miratohet nga titullari i subjektit të audituar dhe dërgohet në NjAB brenda afatit.	Nga NjAB në përfundim të çdo auditimi sugjeron Plan Veprimin dhe nga subjekti i audituar hartohet dhe miratohet Plani i Veprimit nga titullari i subjektit të audituar dhe dërgohet në NjAB brenda afatit.	Përputhshmëri e plotë	Jo në çdo rast, plani i veprimit është hartuar dhe miratuar nga titullari i subjektit të audituar.
40	Dosjet e përhershme/të përkohshme plotësojnë kërkesat e MAB dhe arkivohen sipas legjislacionit në fuqi.	Në çdo rast dosjet e përhershme/të përkohshme plotësojnë kërkesat e MAB dhe arkivohen sipas legjislacionit në fuqi.	Përputhshmëri e plotë	Jo në çdo rast, dosjet i plotësojnë kërkesat e MAB, kanë mungesa në dokumentacione.

Burimi: DAB në ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Plani dhe realizimi i auditimeve për vitin 2021.

Në planin vjetor të auditimeve për vitin 2021, ishin planifikuar gjithsej 13 misione auditimi:

- ✓ 11 misione auditimi të kombinuara e të plota (zbatimi i ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare), në DRSSH-të Lezhë, Berat, Elbasan, Kukës, Tiranë, Fier, Vlorë, Gjirokastër, Drejtoria e Arkivit Qendror të ISSH, dhe DSSH Tropojë e Sarandë.
- ✓ 1 mision auditimi tematik financiar (zbatimi i mbajtjes së kontabilitetit dhe vlerësimi i raportit financiar për vitin 2020, në Drejtorinë e Financës në ISSH);
- ✓ 1 mision auditimi performance, në Drejtorinë e Përfitimeve në ISSH.

Nga auditimi rezultoi se, gjatë vitit 2021 nuk ka patur ndryshim plani të auditimeve dhe as kërkesë nga Titullari i Institucionit, për programe shtesë auditimi. DAB ka realizuar planin e auditimit bazuar në planin e miratuar për vitin 2021, duke ushtruar misionet e auditimit në 10 DRSSH ku ajo zhvillon aktivitetin e saj, në DAQ dhe në 2 drejtori të Drejtorisë së Përgjithshme të Sigurimeve Shoqërore. Realizimi i misioneve audituese për vitin 2021, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 2 Realizimi i misioneve të auditimit për vitin 2021

Nr	Subjekte të audituara nga DAB	Realizimi i angazhimeve të auditimit									
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre							Statusi i Angazhimit		
		Total	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:					Shërbi me Këshilli mi	Angazhime	Angazh. të përfunduara	Angazh në proces
			Përputh.	Perform.	Financë	IT	Të kombinuara				
1	DRSSH LEZHË	1					1			1	
2	DRSSH BERAT	1					1			1	
3	DRSSH ELBASAN	1					1			1	
4	DRSSH KUKËS	1					1			1	
5	DSSH TROPOJË	1					1			1	
6	DRSSH TIRANË	1					1			1	
7	DAQ. LUNDËR	1					1			1	
8	ISSH Dr. e Financës	1			1					1	
9	ISSH Dr. e Përfitimeve	1		1						1	
10	DRSSH VLORË	1					1			1	
11	DSSH SARANDË	1					1			1	
12	DRSSH GJIROKASTËR	1					1			1	
13	DRSSH FIER	1					1			1	
	Totali	13		1	1		11			13	

Burimi: DAB në ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Mbështetur në Standardin 2060, në Manualin e Auditimit të Brendshëm që përcakton: *“Drejtuuesi i auditimit të brendshëm duhet t’i raportojë periodikisht menaxhimit të lartë dhe bordit mbi qëllimin, autoritetin, përgjegjësinë dhe rezultatin e aktivitetit të auditimit të brendshëm në raport me planin e tij”*. Në përputhshmëri me zbatimin e këtij standardi, nga auditimi u konstatua se, drejtori i DAB ka paraqitur informacione dhe realizimet e planeve të auditimit, për periudha të ndryshme të vitit. Më datë 11.11.2020, ka përcjellë te Këshilli Administrativ informacionin për planifikimin e auditimeve për vitin 2021. Më datë 15.06.2021, ka përcjellë te Drejtori i Përgjithshëm informacion mbi veprimtarinë e DAB për periudhën 5 mujore, Janar-Maj 2021. Gjithashtu, ka përgatitur raportin përmbledhës së veprimtarisë së DAB, për 6-mujorin e parë të vitit 2021. Në hartimin e planit fillestar të auditimit për vitin 2021, i cili është pjesë e planit strategjik 2021-2023, DAB është bazuar në regjistrin e riskut që ka hartuar ISSH, si dhe ka planifikuar misionet e auditimit, duke i dhënë më shumë prioritet menaxhimit të këtyre risqeve.

Gjetjet/Rekomandimet.

Tabela nr. 3 Përmbledhëse e gjetjeve në vlerë, si dhe rekomandimeve për vitin 2021

000 lekë

Nr	Subjektet e Audituar	Gjetje në numër	Gjetje në vlerë (000 lekë)	Rekomandime për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm	Rekomandime të karakterit masa organizative	Rekomandime për arkëtim të vlerave monetare	Rekomandime të tjera
1	DRSSH DURRËS	16	23.2	1	13	2	
2	DRSSH LEZHË	14	10.2	1	12	1	
3	DRSSH BERAT	14		1	13		
4	DRSSH ELBASAN	13		1	10		2
5	DRSSH KUKËS	11	21.9	1	9	1	
6	DRSSH TROPOJË	7		1	6		
7	DRSSH TIRANË	14	1092.5	1	12	1	
8	DAQ. LUNDËR	3			3		
9	ISSH DR. E FINANCËS	2			2		
10	ISSH DR. PËRFITIMEVE	2		1	1		
11	DRSSH VLORË	7			7		
12	DSSH SARANDË	3			3		

13	DRSSH GJIROKASTËR	15	123.2		13	2	
14	DRSSH FIER	14	69.2	1	12	1	
	GJITHSEJ	135	1340.2	9	116	8	2

Burimi: DAB në ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga analiza e tabelës së mësipërme bazuar në fushat e gjetjeve, sipas auditimeve të kryera nga DAB, për periudhën 01.01.2021-31.12-2021, janë lënë 135 rekomandime në total (përfshirë dhe rekomandimet e auditimit të kryer në DRSSH Durrës, viti 2020 dhe evaduar në vitin 2021), nga të cilat: 9 rekomandime për përmirësime të sistemeve të kontrollit të brendshëm, 116 rekomandime për masa organizative, 8 rekomandime për arkëtim të vlerave monetare, dhe 2 rekomandime të tjera. Gjithashtu janë konstatuar dhe shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik në vlerën 1,340.2 mijë lekë të evidentuara në 6 DRSSH (Durrës, Lezhë, Kukës, Tiranë, Gjirokastrë dhe Fier) në fushën e fondeve të sigurimeve shoqërore, sigurimeve shëndetësore dhe përkujdesjes shoqërore.

Gjetjet kryesore nga auditimet lidhen kryesisht me:

- ✓ *Sistemin e proceseve organizative. Menaxhimi i burimeve njerëzore.*
- ✓ *Sistemin e programimit dhe zbatimit të buxhetit.*
- ✓ *Sistemin e programimit dhe realizimit të të ardhurave.*
- ✓ *Sistemin e caktimit të pagesave të përfitimeve afatgjata dhe afatshkurtra.*
- ✓ *Sistemin e prokurimeve.*
- ✓ *Sistemin e menaxhimit të aktiveve.*
- ✓ *Sisteme të tjera sipas misionit dhe qëllimit të institucionit.*

Rekomandimet e dhëna nga DAB gjatë vitit 2021, janë pranuar nga të gjithë subjektet e audituara. Të 135 rekomandimet janë pranuar në masën 100%, janë zbatuar 71.8% e tyre dhe janë në proces zbatimi 28.2 %, me afat realizimi të tyre deri më 31.03.2022. Në tabelën e mëposhtme paraqitet shkalla e zbatimit të tyre.

Tabela nr. 4 Shkalla e zbatimit të rekomandimeve për vitin 2021.

Periudha	Rekomandime gjithsej	Rekomandime të pranuar	Rekomandime të zbatuara plotësisht	Rekomandime në proces zbatimi	Realizimi %
Viti 2021	135	135	97	38	71.8%

Burimi: DAB në ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Në zbatim të gërmës (ç), të nenit 6 òRoli i auditimit të brendshëm, të ligjit nr. 114 datë 22.10.2015 òPër Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, si dhe të Standardit 2500 òMonitorimi i zbatimit të rekomandimeve, të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, i ndryshuar; pas angazhimeve të vitit 2021, DAB ka dërguar shkresën: òRaportim të ndjekjes së rekomandimeve, titullarëve të DRSSH-ve të audituara.

Në zbatim të pikës 13.2 òRaportimi i ndjekjes së rekomandimeve, Kapitulli IV iManualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, i ndryshuar,nga auditimi u konstatua se, në Planin Vjetor të vitit 2022, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ISSH, me shkresën nr. 5602/1 prot, datë 14.10.2021, në periudhën 14.03.2022-26.03.2022 është planifikuar një mision auditimi për të gjithë subjektet e audituara gjatë vitit 2021, si dhe vlerësimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Zbatimi i procedurave dhe evadimi i materialeve të auditimit, ruajtja dhe arkivimi i tyre.

Grupi i auditimit shqyrtoi për vlerësim, 7 dosje me zgjedhje të rastësishme nga 14 dosje në total, të angazhimeve të kryera në vitin 2021, në të cilat u evidentua se grupet e auditimit kanë grumbulluar informacionet e nevojshëm për përgatitjen e Raporteve të Auditimit. Audituesit kanë analizuar të gjithë informacionet e grumbulluara nëpërmjet metodave dhe teknikave të përdorura të auditimit, që janë gjykuar më të përshtatshme dhe të besueshme për subjektin. Në dosjet e auditimit gjenden të administruara letrat e punës, evidencat e përshtatshme si dhe

pyetësorët e dhënë nga grupet e auditimeve, të cilat lënë gjurmë dhe dëshmojnë mbi proceset e ndjekura për zbatimin e programit të auditimit të miratuar.

Por, në dosjet e audituara u konstatuan edhe mangësi në dokumentacion, e konkretisht:

- në të gjitha dosjet audituara, u konstatuan mungesa të shkresës së inventarit të dosjeve sipas Formatit Standard nr. 1, në Kapitullin VI, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar;
- jo për çdo angazhim auditimi, grupi i punës ka krijuar një dosje të veçantë. Në angazhimet të cilat kanë patur të njëjtin numër programi, arkivimi i dokumentacionit është kryer në një dosje;
- inventarizimi i dokumentacionit që përmbajnë dosjet, është kryer me inventar personal nga secili anëtar i grupit të auditimit;
- u konstatuan mungesa të nënshkrimeve të audituesve dhe drejtorit të drejtorisë, dokumenti i takimit fillestar, deklaratat e konfliktit të interesit, dokumenti i takimeve të angazhimit të auditimit ballafaques ose përmbyllës, kontrolli i cilësisë pas përfundimit të auditimit, ndërsa shkalla e vlerësimit nga subjekti i audituar ishte e paplotësuar;
- në auditimin e kryer në DRSSH Lezhë projektraporti ishte i pafirmosur nga 2 anëtarë të grupit të auditimit, raporti përfundimtar i pafirmosur nga 3 anëtarë, ndërsa shkalla e vlerësimit nga subjekti i audituar ishte e paplotësuar;
- në dosjen e auditimit të kryer në DRSSH Kukës dhe Tropojë u konstatuase të dy subjektet e audituara kanë kthyer planin e veprimit të pa firmosur dhe shkallën e vlerësimit për punën e audituesve, të paplotësuar;
- në shkresën përcjellëse të raportit përfundimtar të audituar në DRSSH Lezhë, DRSSH Sarandë dhe DRSSH Gjirokastrë, DAB është shprehur: (...) në zbatim të Nenit 12 “Përgjegjësitë e titullarëve të njësisë publike, të ligjit nr. 114, datë 22/10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të përgatisni programe me afate dhe persona përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve dhe t’i dërgoni zyrtarisht në DAB pranë ISSH, brenda afatit prej 20 ditëve pune nga data e marrjes së tyre. Referenca ditore e përcaktuar nga DAB është shënuar gabim pasi, mbështetur në pikën (d), të nenit 12, të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik, subjekti i audituar duhet të hartojë, miratojë dhe të dërgojë në DAB, Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të miratuar, brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të raportit përfundimtar;
- në të gjitha rastet, plan veprimi për realizimin e rekomandimeve, i plotësuar nga subjekti i audituar nuk është kryer sipas kërkesave që përcakton Formatin Standard 10, në kolonën: Reagimi i menaxhimit të subjektit të audituar. Për të gjitha rekomandimet rezultoi se, nga subjekti i audituar është dhënë përgjigjja: *I dakordësuar* dhe po në këtë mënyrë janë pranuar nga grupet e auditimit të ISSH. Pra sqarojmë se, nga subjektet vetëm është konfirmuar pranimi i rekomandimit, fazë e cila kryhet në takimin përmbyllës së auditimit në terren. Në këtë hapësirë duhet të pasqyrohen hapat që do të ndërmerret subjekti i audituar për realizimin e rekomandimeve të lëna.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhëna të detajuara, të subjekteve të audituara gjatë vitit 2021, numrat e programeve të tyre, afatet e kryerjes së angazhimit në terren. Afatet e dorëzimit të projekt raporteve, konfirmimet e tyre nga subjektet e audituara, si dhe afatet e dorëzimit të raporteve përfundimtare. Gjithashtu, komente të grupit të auditimit të KLSH.

Tabela nr. 5 Të dhëna mbi numrin e programeve dhe zbatimin e afateve të auditimeve për vitin 2021.

Nr.	Subjekti	Programi i auditit		Afati i kryerjes së angazhimit	Projekt raporti		Konfirmimi i Projekt raportit		Raporti Përfundimtar		Komente të KLSH
		Nr.	Datë		Nr.	Datë	Nr	Datë	Nr.	Datë	
1	DRSSH LEZHË	136	07.01.2021	11.01.2021-06.02.2021	136/1	22.02.2021	638/2	16.03.2021	136/3	26.03.2021	Observimet kanë ardhur me 6 ditë pune në tejkalim të afatit ligjor nga marrja e Projekt Raportit

2	DRSSH ELBASAN	1987	19.03.2021	22.03.2021-17.04.2021	1987/1	28.04.2020	7347/1	17.05.2021	1987/3	08.06.2021	
3	DRSSH KUKËS	2657	20.04.2021	26.04.2021-28.05.2021	2657/2	11.06.2021	1242/2	25.06.2021	2657/4	01.07.2021	
4	DRSSH TROPOJË	2657	20.04.2022	26.04.2021-28.05.2021	2657/1	09.06.2021	748/1	09.07.2021	2657/5	13.07.2021	Konfirmimi i Projektraportit me 10 ditë pune në tejkalim të afatit ligjor.
5	DR. FINANCË, ISSH	4391	07.07.2021	12.07.2021-06.08.2021	4391/1	17.08.2021			4391/2	07.09.2021	
6	DR. E PËRFITIMEVE ISSH	4390	07.07.2021	12.07.2021-06.08.2021	4390/1	17.08.2021			4390/2	01.09.2021	
7	DRSSH VLORË	5395	01.09.2021	06.09.2021-30.09.2021	5395/2	08.10.2021	9622/1	20.10.2021	5395/4	27.10.2021	
8	DSSH SARANDË	5395	01.09.2021	06.09.2021-30.09.2022	5395/1	07.10.2021	2711/1	21.10.2021	5395/6	08.11.2021	Dërgimi i Raportit Përfundimtar 5 ditë pune në tejkalim të afatit ligjor.
9	DRSSH GJIROKASTËR	6126	06.10.2021	11.10.2021-05.11.2021	6126/1	17.11.2021	7219/2	07.12.2021	6126/3	21.12.2021	

Burimi: DAB në ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga analiza e të dhënave në tabelë, konstatohet se, DRSSH Lezhë ka dërguar observimet me 6 ditë pune, në tejkalim të afatit ligjor nga marrja e projektraportit, DRSSH Tropojë ka konfirmuar projektraportin me 10 ditë pune, në tejkalim të afatit ligjor. Ndërsa nga ana e grupit të angazhimit të kryer në DRSSH Gjirokastrë, i është dërguar subjektit, raporti përfundimtar me 5 ditë pune në tejkalim të afatit ligjor.

Në zbatim të standardeve të Kapitullit VII ÷ Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm, 4.1.10. Hapi 9: ÷ Rishikimi i punës së Auditimit në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, i ndryshuar; i cili citon: *Sigurimi i cilësisë ka rëndësi të veçantë, pasi nëpërmjet rishikimit duhet të sigurohet nëse puna e AB është kryer në përputhje me Standardet.* Në vlerësim të përputhshmërisë me këtë standard, u auditua Rishikimi i Cilësisë së Punës për auditimin në DRSSH Elbasan, ku u konstatua se, komentet e dhëna për pikën (h) dhe (a) nga përgjegjësi i grupit nuk vërtetohen, pasi në dosje nuk ka gjurmë të dokumenteve të takimeve të mbajtura. Për komentin e pikës (f), u konstatua se subjekti ka paraqitur kundërshtime/observacione pas marrjes së projektraportit. Të detajuara këto në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 6 Rishikimi i Cilësisë së Punës pas auditimit në DRSSH Elbasan.

OPERACIONET QË RISHIKOHEN	KOMENTE TË PËRGJEGJËSIT TË GRUPIT TË AUDITIMIT	KOMENTE TË KLSH NGA AUDITIMI I DOSJES
Planifikimi i Angazhimit (ISPPA 2200) pika (h) I janë shpjeguar qartë subjektit të audituar objektivat gjatë takimit fillestar?	Po, i janë shpjeguar qartë subjektit të audituar objektivat gjatë takimit fillestar.	Nuk ka gjurmë të dokumentit të takimit fillestar të mbajtur në subjekt.
Rezultatet dhe Komunikimi (ISPPA 2400) pika (a) A iu janë paraqitur gjetjet dhe konkluzionet përfundimtare subjekteve të audituara në takimin përmblyës? (f). A i përfshin në raportin final audituesi i brendshëm komentet e subjekteve të audituara?	(a) Po, në takimin përmblyës u prezantuan gjetjet dhe konkluzionet përfundimtare. (f) Nuk ka komente subjekti i audituar.	(a) Nuk ka gjurmë të dokumentit të takimit përmblyës të mbajtur në subjekt. (f) Subjekti ka paraqitur kundërshtimet me nr. 7347/1 prot, datë 17.05.2021, si dhe është mbajtur një procesverbal në takimin e ballafaqimit në lidhje me to. Kundërshtimet janë përfshirë në raportin përfundimtar.

Burimi: DAB në ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Nga auditimi i dokumentimit të punës audituese të DAB për vitin 2021, u konstatua se jo për çdo angazhim, grupi i punës ka krijuar një dosje të veçantë. Në angazhimet audituese të cilat kanë patur të njëjtin numër programi, si në rastin e angazhimit në DRSSH Vlorë dhe DRSSH Sarandë, dokumentimit i punës është kryer në një dosje. Ky veprim është në kundërshtim me

përcaktimet e Kapitullit VI, ÷Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar.

Nga auditimi u konstatua se, inventarizimi i dokumentacionit që përmbajnë dosjet, është kryer me inventar personal, nga secili anëtar i grupit të auditimit dhe nuk i janë përmbajtur Formatit Standard nr. 1, në Kapitullin VI, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar.

Në zbatim të kërkesave të parashikuara në ÷Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 ÷Për arkivatë, një kopje e dokumenteve të dosjeve të auditimeve (shkresa dhe/ose dokumente që lidhen me të), duhet të dorëzoheshin në arkivën e ISSH. Nga auditimi u konstatua se, dosjet e auditimit për vitin 2021 janë ende të pa arkivuara.

Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit

Në zbatim të pikave nr. 1, 2 dhe 6, të VKM nr. 816, datë 16.11.2016 ÷Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike, në zbatim të ligjit nr. 60/2016, për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, Drejtori i Përgjithshëm i ISSH me urdhrin nr. 533 prot., datë 19.01.2017, ka ngritur strukturën e Njësisë Përgjegjëse të Sinjalizimit. Gjatë vitit 2021, nuk ka patur ndryshime në strukturë dhe në organizim të punonjësve që janë pjesë e Njësisë Përgjegjëse të Sinjalizimit, ai përbëhej nga Drejtori i DAB, z. P.B. dhe Kryetari i Degës së Auditit Ekonomik-Financiar, z. A.B.

Titulli i gjetjes: Moszbatimi i procedurave në evidentimin dhe dokumentimin e punës gjatë dhe pas misioneve audituese gjatë vitit 2021.

Situata: Nga auditimi mbi vlerësimin e veprimtarisë së auditit të brendshëm rezultoi se:

- Grupi i punës nuk ka krijuar një dosje të veçantë për çdo angazhim auditimi, pasi në angazhimet të cilat kanë patur të njëjtin numër programi, arkivimi i dokumentacionit është kryer në një dosje; inventarizimi i dokumentacionit që përmbajnë dosjet, është kryer me inventar personal nga secili anëtar i grupit të auditimit, pramungoneshkresa einventarit të dosjeve sipas Formatit Standard nr. 1, në Kapitullin VI, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar; rezultuan mungesa të nënshkrimeve të audituesve dhe drejtorit të drejtorisë tek dokumenti i takimit fillestar, dokumenti i takimeve të angazhimit të auditimit ballafaques ose përmbyllës, kontrolli i cilësisë pas përfundimit të auditimit, ndërsa shkalla e vlerësimit nga subjekti i audituar ishte e paplotësuar.

- Në auditimin e dosjeve, u konstatua se, në të gjitha rastet, plan veprimi për realizimin e rekomandimeve, i plotësuar nga subjekti i audituar nuk është kryer sipas kërkesave që përcakton Formatin Standard 10 i Manualit të Auditimit të Brendshëm, në kolonën: *Reagimi i menaxhimit të subjektit të audituar*. Për të gjitha rekomandimet, rezultoi se nga subjekti i audituar është dhënë përgjigjja: i dakordësuar, si dhe po në këtë mënyrë janë pranuar nga grupet e auditimit të ISSH. Pra, nga subjektet vetëm është konfirmuar pranimi i rekomandimit, fazë e cila kryhet në takimin përmbyllës së auditimit në terren, pa pasqyruar hapat që duhet të ndërmerret subjekti i audituar për realizimin e rekomandimeve të lëna.

- Në shkresën përcjellëse të raportit përfundimtar të audituar në DRSSH Lezhë, DRSSH Sarandë dhe DRSSH Gjirokastrë, referenca ditore e përcaktuar nga DAB është vendosur 20 ditë pune për përgatitjen e programeve me afate dhe persona përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, ndërsa afati i duhur është brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të raportit përfundimtar.

- DRSSH Lezhë ka dërguar observimet me 6 ditë pune, në tejkallim të

afatit ligjor nga marrja e projektraportit, DRSSH Tropojë ka konfirmuar projektraportin me 10 ditë pune, në tejkalim të afatit ligjor. Ndërsa nga ana e grupit të angazhimit të kryer në DRSSH Gjirokastrë, i është dërguar subjektit, raporti përfundimtar me 5 ditë pune në tejkalim të afatit ligjor.

- Në Rishikimin e Cilësisë së Punës për auditimin në DRSSH Elbasan, disa nga komentet e dhëna nga përgjegjësi i grupit nuk vërtetohen, pasi në dosje nuk ka gjurmë të dokumenteve.

- Në vlerësimin e brendshëm të cilësisë për vitin 2021, që kryhet nga vetë DAB dhe dërgohet te Komiteti i Auditimit të Brendshëm në MFE, përmes Aneksit 3 ÷ Pyetëtori i Vetëvlerësimit të DABö, të gjitha përgjigjet janë dhënë: ÷ përrputshmëri e plotë, por nga auditimi u konstatua se jo e gjithë veprimtaria e DAB është në përrputshmëri të plotë.

- Dosjet e auditimit për vitin 2021, janë ende të pa arkivuara, veprim ky në kundërshtim me ÷ Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 ÷ Për arkivatö.

Kriteri: Ligji nr. 114, datë 22.10.2015 ÷ Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publikö;

Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 ÷ Për arkivatö;

Manuali i Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar.

Ndikimi/efekti: Moszbatimi i procedurave të akteve ligjore në dokumentimin e veprimtarisë audituese.

Shkaku: Mospërgjegjshmëri në zbatimin e detyrave, nga stafi i DAB.

Rëndësia: E mesme

Rekomandime: Drejtori i Përgjithshëm të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mangësitë e evidentuara në veprimtarinë e auditit të brendshëm, si dhe të marrë masa në bashkëpunim me Drejtorin e Auditit të Brendshëm që të realizojë dokumentimin e punës audituese gjatë dhe pas kryerjes së auditimit.

2.4 Auditimi i prokurimeve publike për mallra, punë e shërbime dhe përrputshmëria e transaksioneve që lidhen me to, në përrputhje legjislacionin në fuqi.

Për auditimin e këtij drejtimi u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Regjistri i realizimeve të prokurimeve për vitin 2021.
- 2) Dosjet e procedurave të prokurimit të realizuara për periudhën objekt auditimi.
- 3) Shpenzimet e kryera për procedurat e realizuara.

Nga dokumentacioni dhe të dhënat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua si më poshtë vijon:

Nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH), referuar kërkesave të sektorëve, për vitin 2021 ka realizuar:

Nr.	Lloji i procedurës	Planifikuar		Realizuar			Audituar		
		Numër	F limit	Numer	F limit	F kont	Numer	F limit	F kont
1	Procedurë kërkesë për propozim	1	7,800,000	1	7,800,000	7,778,000	1	7,800,000	7,778,000
2	Blerje te vogla	17	4,625,828	17	4,625,828	3,931,682	17	4,625,828	3,931,682
	Gjithsej	18	12,425,828	18	12,425,828	11,709,682	18	12,425,828	11,709,682

-Një procedurë prokurimi kërkesë për propozim objekt ÷ Sigurimi i Aseteve të ISSH-së, DAQ-së në Lundër, DRSSH-ve dhe ALSSH-ve përkatëse për periudhën 1-vjeçare për vitin 2021, me fond limit në shumën 7,800,000 lekë pa TVSH dhe me vlerë kontrate në shumën 7,778,000 lekë me TVSH, procedurë e cila u auditua.

1- Procedura e Prokurimit “Sigurimi i aseteve të ISSH, DAQ-së Lundër, DRSSH-ve dhe ALSSH-ve përkatëse për periudhën 1-vjeçare për vitin 2021”

Urdhër prokurimi Nr. 834, datë 03.02.2020	Njësia Prokurimi Nr. 874, datë 03.02.2021	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave Urdhër nr. 847/2 datë 03.02.2021
Fondi limit 7,800,000 lekë pa TVSH	1. E. P 2. N. Ç 3. B. D	1. L. Sh Dr. Juridike 2. E. D Sp. Administrate 3. F. Sh Sp. Dr. Juridik
Procedura e prokurimit Kërkesë për Propozim		
Burimi i Financimit: Buxheti i ISSH		Diferenca nga Fondi limit 22,000 ose 0.28%
Datë e hapjes së tenderit Date 23.02.2021 ora 11.00	Fitues: A SHA	Lidhja e kontratës Nr. 874/5 prot, datë 23.03.2021
Marrin pjesë 1 OE S`kualifikuar 0 OE	Raporti Përmbledhës: Nr. 874/3 prot., datë 11.03.2021.	Vlera e kontratës 7,778,000lekë pa TVSh
Ankimime në AK - jo Ankimime në KPP - jo	Afati kontratës 1 vit nga data e nënshkrimit të kontratës	Titullar i AK ó A. H

Me urdhër nr. 133 prot, datë 07.01.2021, të titullarit të Autoritetit Kontraktor (AK), është ngritur Komisioni për përgatitjen e termave të referencës për Sigurimi i aseteve të ISSH, DAQ-së Lundër, DRSSH-ve dhe ALSSH-ve përkatëse për periudhën 1-vjeçare për vitin 2021, i përbërë nga znj. L. Gj, Kryetar, E. D anëtar, M. Z anëtar, E. D anëtar, P. R anëtar. Komisioni ka hartuar termat e referencës me aktin nr. 610 prot., datë 27.01.2021, i cili është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit. Vlera e aseteve që kërkohet të sigurohet është bërë sipas inventarit kontabël të datës 30.12.2019, në vlerën totale 905,058,435 lekë sipas vlerës neto të mbetur. Gjithashtu në Termat e Referencës është përcaktuar se Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën që me mbylljen e bilancit ekonomik për vitin 2020 të rishikojë vlerën e aseteve të siguruara dhe për çdo ndryshim të njoftojë kontraktorin.

Me shkresën nr. 874/1 prot, datë 03.02.2021, është dërguar për publikim njoftimi i kontratës i cili është publikuar në buletin publik të APP-së nr. 17, datë 08.02.2021.

Titulli i gjetjes: Mangësi në procedurën e prokurimit.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit me objekt Sigurimi i aseteve të ISSH, DAQ-së Lundër, DRSSH-ve dhe ALSSH-ve përkatëse për periudhën 1-vjeçare për vitin 2021, me fond limit në vlerën 7,800,000 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate në shumën 7,778,000 lekë pa TVSH, rezultoi:

Njësia e Prokurimit, në procesverbalin e mbajtur për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, nuk ka argumentuar teknikisht dhe ligjërisht kriteret e vendosura e konkretisht: 1. ÷Kopje e deklaratave të xhiros vjetore, realizuar gjatë vitit 2018 dhe 2019, ku vlera mesatare e xhiros vjetore gjate këtyre viteve të jetë sa vlera e fondit limit që prokurohet, 2. ÷Kopje të certifikuara të bilanceve të viteve 2018 dhe 2019 të paraqitura në autoritetet përkatëse dhe 3. ÷Dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit në një vlerë sa 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Veprime jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 61 pika 2.

- Referuar sistemit elektronik të prokurimit rezulton se në datë 04.02.2021 u ka bërë ftesë për pjesëmarrje 5 operatorëve ekonomik, por nuk ka argumentuar dhe dokumentuar përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë të cilëve u ka dërguar ftesë në SEP.

Kriteri: VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit

	publiko, i ndryshuar, neni 39, pika 5, neni 61 pika 2.
Ndikimi/Efekti:	Procedurat e prokurimit paraqesin një shmangie apo neglizhencë, duke mosrespektuar rregullat e procedurave të Prokurimit Publik.
Shkaku:	Mosrespektimi i kuadrit ligjor për Prokurimin Publik.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandime:	Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm bashkëpunim me Sektorin e Prokurimeve, të krijojë komisionet për zbatimin e kontratave, për verifikimin e produktit apo shërbimit final në përputhje me kërkesat e vendosura nga AK dhe sugjerimet e APP, si dhe të argumentohen ftesat për pjesëmarrje të cilat ju dërgohen operatorëve ekonomik.

- Ka realizuar 17 procedura prokurimi blerje me vlerë të vogël me fond limit në shumën 4,625,828 lekë pa TVSh, dhe me vlerë kontrate në shumën 3,931,682 lekë pa TVSh. Në këto procedura përfshihen edhe 6 procedura të cilat janë në vlerën deri në 100,000 lekë dhe janë kryer në mënyrë shkresore. Nga këto u verifikuan 17 procedura, pra 100% e tyre.

Personat përgjegjës për prokurimet për vitin 2021, kanë qenë znj. N. Ç. dhe z. B. D.

Me urdhrin nr. 398, datë 18.01.2021, nga titullari i AK z. A. H. është krijuar komisioni i prokurimit me vlera të vogla me përbërje z. E. P. kryetar dhe anëtarët znj. N. Ç. e z. B. D., komisioni i cili ka funksionuar deri në fund të vitit.

Për të gjitha rastet e blerjeve me vlera të vogla duhet të grupohen për tre problematika që kanë, duke e trajtuar në këtë mënyrë:

Nga auditimi i procedurës së prokurimit blerje me vlera të vogla ÷Mirëmbajtja e faqes zyrtare të ISSH, ÷Riparim automjeti me targë AA165VXö ka rezultuar se: Titullari i AK nuk ka ngritur komision për marrjen në dorëzim me jo më pak se 3 persona ku një ndër tyre të jetë specialist i fushës, për të garantuar kryerjen e shërbimit sipas specifikimeve teknike. Punonjësi i cili ka nënshkruar aktin e marrjes në dorëzim, nuk ka qenë i autorizuar nga titullari për kryerjen e nënshkrimit të aktit dhe certifikimin e kryerjes së shërbimit. Mbi këtë akt është bazuar dhe kryerja e shpenzimit nga Drejtoria e Financës. Faturat tatimore nuk janë nënshkruar nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018, "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, pika 19, si dhe me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve", i ndryshuar, pika 35, 42, 43.

- Auditimi i procedurës dhe zbatimit të blerjes me vlera të vogla "Mirëmbajtja e faqes zyrtare të ISSH"

Procedura e prokurimit me objekt ÷Mirëmbajtje e faqes zyrtare të ISSH-së, ka nisur me kërkesën e paraqitur me nr. 1417 prot, datë 24.02.2021, nga Drejtori i Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, miratuar nga titullari i AK. Me shkresën datë 24.02.2021, janë miratuar specifikimet teknike nga komisioni me përbërje R. D, F. D. dhe E. D. miratuar nga Drejtori Drejtorisë së Burimeve të Informacionit L. A.

Me datë 09.02.2021 është mbajtur procesverbali nga komisioni për përlogaritjen e fondit limit i cili ka caktuar vlerën prej 270,000 lekë pa TVSH, referuar kontratave të mëparshme.

Me urdhrin e prokurimit nr. 1417/1 prot., datë 11.03.2021 është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogla, i cili ka filluar procedurën e prokurimit me objekt "Mirëmbajtje e faqes zyrtare të ISSH-së" me fond limit në vlerën 270,000 lekë. Komisioni ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik ftesën për ofertë me të dhënat e objektit të prokurimit. Me datë 11.03.2021 është bërë klasifikimi përfundimtar ku rezulton se kanë marrë pjesë 9 operatorë ekonomik (OE), nga të cilët janë kualifikuar 2 OE, ndërsa 7 janë squalifikuar pasi kanë dhënë vlerë ofertë më tepër se fondi limit i procedurës. Janë kualifikuar OE A.H. me vlerë oferte në shumën 156,000 lekë dhe OE ÷Kö me vlerë oferte 254,000 lekë. Komisioni ka mbajtur procesverbalin me datë 12.03.2021, me anë të cilit kanë kaluar te OE i renditur i dyti pasi OE i renditur në vend të parë nuk është paraqitur brenda afatit.

Komisioni ka mbajtur procesverbalin më datë 16.03.2021, duke përcaktuar si ofertë fitues operatorin ekonomik òKò, me vlerë oferte 254,000 lekë pa TVSH, i cili ka konfirmuar nëpërmjet sistemit për realizimin e shërbimit të kërkuar. Me nr. 1417/3prot, datë 17.03.2021, është hartuar dhe lidhur kontrata e shërbimit ndërmjet titullarit të AK dhe OE fitues.

1. Me urdhër transfertën bankare të datës 04.08.2021, është likuiduar fatura tatimore nr. 189/2021, datë 17.06.2021, për mirëmbajtjen e faqes zyrtare të ISSH, ndaj operatorit òKò, në vlerën 76,200 lekë me TVSH për periudhën 17 mars deri me 17 qershor 2021. Pagesa është kryer bazuar në procesverbalin e datës 18.06.2021 mbajtur nga znj. M. Z. si specialiste në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun.

2. Me urdhër transfertën bankare të datës 05.10.2021, është likuiduar fatura tatimore nr. 323/2021, datë 16.09.2021, për mirëmbajtjen e faqes zyrtare të ISSH, ndaj operatorit òKò, në vlerën 76,200 lekë me TVSH për periudhën 17 qershor deri me 17 shtator 2021. Pagesa është kryer bazuar në procesverbalin e datës 17.09.2021, të mbajtur nga znj. M. Z. si specialiste në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun.

3. Me urdhër transfertën bankare të datës 28.12.2021, është likuiduar fatura tatimore nr. 494/2021, datë 17.12.2021, për mirëmbajtjen e faqes zyrtare të ISSH, ndaj operatorit òKò, në vlerën 81,000 lekë me TVSH për periudhën 17 shtator deri me 17 dhjetor 2021. Është mbajtur procesverbali me datë 17.12.2021 nga znj. M. Z. si specialiste në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun.

4. Me urdhër transfertën bankare të datës 23.03.2022, është likuiduar fatura tatimore nr. 494/2021, datë 17.03.2022, për mirëmbajtjen e faqes zyrtare të ISSH, ndaj operatorit òKò, në vlerën 81,000 lekë me TVSH për periudhën 17 dhjetor 2021 deri me 17 mars 2022. Është mbajtur procesverbali me datë 17.03.2022 nga znj. M. Z. si Përgjegjëse në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun, z. E. D. me detyrë përgjegjës i administrimit të rrjetit dhe teknologjisë së informacionit dhe znj. R. D. me detyrë përgjegjëse e sektorit të Administrimit të bazës së të dhënave.

-Nga auditimi i kësaj procedure rezulton se; Titullari i AK nuk ka ngritur komision për marrjen në dorëzim me jo më pak se 3 persona ku një ndër tyre të jetë specialist i fushës, për të garantuar kryerjen e shërbimit sipas specifikimeve teknike. Punonjësi i cili ka nënshkruar aktin e marrjes në dorëzim, nuk ka qenë i autorizuar nga titullari për kryerjen e nënshkrimit të aktit dhe certifikimin e kryerjes së shërbimit. Mbi këtë akt është bazuar dhe kryerja e shpenzimit nga Drejtoria e Financës. Faturat tatimore nuk janë nënshkruar nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018, "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, pika 19, si dhe me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve", i ndryshuar, pika 35, 42, 43.

- **Auditimi i procedurës dhe zbatimit të blerjes me vlera të vogla Riparim automjeti me targë AA165VX**

Procedura e prokurimit me objekt òRiparim/shërbim për automjetin tip Ford Kuga me targë AA 165 VXò, ka nisur me kërkesën e paraqitur me nr. 3451 prot, datë 28.05.2021, paraqitur nga Drejtori i Administrimit të Përgjithshëm, referuar kërkesës së paraqitur ndaj tij prej drejtuesit të automjetit z. T. E, miratuar nga titullari i AK.

Me datë 01.06.2021 është mbajtur procesverbali nga komisioni i blerjeve të vogla për përlllogaritjen e fondit limit i cili ka caktuar vlerën prej 73,740 lekë pa TVSH, referuar testimit të tregut për dy zëra dhe faturës së shërbimit të mëparshëm për 3 zëra të tjerë.

Me urdhrin e prokurimit nr. 3451/1 prot., datë 01.06.2021 është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogla, i cili ka filluar procedurën e prokurimit me objekt "Riparim/shërbim për automjetin tip Ford Kuga me targë AA 165 VX" me fond limit në vlerën 73,740 lekë pa TVSH. Komisioni ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik ftesën për ofertë me të dhënat e objektit të prokurimit dhe preventivin me shërbimet përkatëse. Me datë 03.06.2021 është bërë klasifikimi përfundimtar ku rezulton se kanë marrë pjesë 10 operatorë

ekonomik (OE), nga të cilët janë kualifikuar 1 OE dhe janë shkualifikuar 9 të tjerë, të cilët janë refuzuar për arsye se kanë dhënë ofertë me vlerë më të lartë se fondi limit i parashikuar. Komisioni ka mbajtur procesverbalin më datë 03.06.2021, duke përcaktuar si ofertë të kualifikuar në vend të parë operatorin ekonomik ðO. Hö, me vlerë oferte 65,340 lekë pa TVSH dhe 78,408 lekë me TVSH. Me procesverbalin e datës 04.06.2021, OE fitues ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga AK, duke u kualifikuar dhe shpallur fitues. Me datë 07.06.2021 është mbajtur akti i marrjes në dorëzim të shërbimeve të automjetit midis personit përgjegjës z. T. E. si përfaqësues i ISSH-së dhe OE fitues z. O. H.

Me urdhër transfertën bankare të datës 08.06.2021, është likuiduar fatura tatimore nr. 38, datë 07.06.2021, për riparimin e automjetit, ndaj operatorit ðO.H.ö, në vlerën 78,408 lekë me TVSH. -Nga kjo procedurë rezulton se; Titullari i AK nuk ka ngritur komision me jo më pak se 3 persona ku një ndër tyre të jetë specialist i fushës, për të garantuar kryerjen e shërbimit në sasi, cilësi dhe origjinalitetit të pjesëve të vendosura. Punonjësi i cili ka nënshkruar aktin e marrjes në dorëzim, nuk ka qenë i autorizuar për nga titullari për kryerjen e nënshkrimit të aktit dhe certifikimin e kryerjes së shërbimit. Mbi këtë akt është bazuar dhe kryerja e shpenzimit nga Drejtoria e Financës. *Veprime jo në përputhje me Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018, "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve", i ndryshuar, pika 35, 42, 43.*

- **Auditimi i procedurës dhe zbatimit të blerjes me vlera të vogla Riparim automjeti me targë AA166VX**

Procedura e prokurimit me objekt ðRiparim/shërbim për automjetin tip Ford Kuga me targë AA 166 VXö, ka nisur me kërkesën e paraqitur me nr. 3915 prot, datë 21.06.2021, paraqitur nga Drejtori i Administrimit të Përgjithshëm, miratuar nga titullari i AK.

Me datë 21.06.2021 është mbajtur procesverbali nga komisioni i blerjeve të vogla për përllogaritjen e fondit limit i cili ka caktuar vlerën prej 27,000 lekë pa TVSH, referuar shërbimeve të kryera për atumjetin e njëjtë me targë AA165VX.

Me urdhrin e prokurimit nr. 3915/1 prot., datë 21.06.2021 është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogla, i cili ka filluar procedurën e prokurimit me objekt "Riparim/shërbim për automjetin tip Ford Kuga me targë AA 166 VX" me fond limit në vlerën 27,000 lekë pa TVSH. Komisioni ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik ftesën për ofertë me të dhënat e objektit të prokurimit dhe preventivin me shërbimet përkatëse. Me datë 23.06.2021 është bërë klasifikimi në Sistemin e Prokurimeve Elektronike ku rezulton se kanë marrë pjesë 13 operatorë ekonomik (OE), nga të cilët janë kualifikuar 8 OE dhe janë shkualifikuar 5 të tjerë, të cilët janë refuzuar për arsye se kanë dhënë ofertë me vlerë më të lartë se fondi limit i parashikuar. Komisioni ka mbajtur procesverbalin më datë 24.06.2021, duke përcaktuar si ofertë të kualifikuar në vend të parë operatorin ekonomik ðKö, me vlerë oferte 16,250 lekë pa TVSH dhe 19,500 lekë me TVSH. Me shkresën nr. 4039 datë 24.06.2021, OE fitues ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga AK. Me datë 30.06.2021 është mbajtur procesverbal nga OE për kryerjen e shërbimeve të automjetit midis personit përgjegjës z. S. K. si përfaqësues i ISSH-së dhe OE fitues.

Me urdhër transfertën bankare të datës 02.07.2021, është likuiduar fatura tatimore nr. 43/2021, datë 01.07.2021, për riparim automjeti, ndaj operatorit ðKö, në vlerë 19,500 lekë me TVSH.

-Nga kjo procedurë rezulton se; Titullari i AK nuk ka ngritur komision me jo më pak se 3 persona ku një ndër tyre të jetë specialist i fushës, për të garantuar kryerjen e shërbimit dhe pjesëve të vendosura. Punonjësi i cili ka nënshkruar aktin e marrjes në dorëzim, nuk ka qenë i autorizuar për nga titullari për kryerjen e nënshkrimit të aktit dhe certifikimin e kryerjes së shërbimit. Mbi këtë akt është bazuar dhe kryerja e shpenzimit nga Drejtoria e Financës. *Veprime jo në përputhje me Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018, "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve", i ndryshuar, pika 35, 42, 43.*

- **Auditimi i procedurës dhe zbatimit të blerjes me vlera të vogla Blerje Karburant diesel.**

Procedura e prokurimit me objekt ÷Blerje karburant, ka nisur me kërkesën e paraqitur me nr. 4720prot, datë 22.07.2021, miratuar nga titullari i AK. Me shkresën datë 01.09.2021, janë miratuar specifikimet teknike nga komisioni i blerjeve të vogla me përbërje E. P, N. Ç. dhe B. D.

Me datë 27.08.2021 është mbajtur procesverbali nga komisioni i blerjeve të vogla për përlllogaritjen e fondit limit i cili ka caktuar vlerën prej 1,000,000 lekë pa TVSH, referuar testimi të tregut.

Me urdhrin e prokurimit nr. 4720/1 prot., datë 01.09.2021 është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogla, i cili ka filluar procedurën e prokurimit me objekt “Blerje karburant” me fond limit në vlerën 1,000,000 lekë për sasinë 7,000 litra. Komisioni ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik ftesën për ofertë me të dhënat e objektit të prokurimit. Me datë 03.09.2021 është bërë klasifikimi përfundimtar ku rezulton se kanë marrë pjesë 8 operatorë ekonomik (OE), nga të cilët janë kualifikuar 8 OE. Komisioni ka mbajtur procesverbalin më datë 03.09.2021, duke përcaktuar si ofertë fitues operatorin ekonomik ÷E D Aö, me vlerë oferte 931,000 lekë pa TVSH. Me procesverbalin e datës 10.09.2021, OE fitues ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga AK, duke u kualifikuar dhe me aktin nr. 4720/2prot, datë 13.09.2021, është hartuar dhe lidhur kontrata e shërbimit ndërmjet titullarit të AK dhe OE fitues.

Me urdhër transfertën bankare të datës 05.10.2021, është likuiduar fatura tatimore nr. 1945, datë 21.09.2021, për blerje karburanti, ndaj operatorit ÷E D A SHAö, në vlerën 478,800 lekë me TVSH për sasinë 3,000 litra. Sasia e furnizuar është bërë hyrje me FH nr. 35, datë 21.09.2021, në magazinën e Njesisë.

Me urdhër transfertën bankare të datës 12.01.2022, është likuiduar fatura tatimore nr. 23, datë 05.01.2022, për blerje karburanti, ndaj operatorit ÷E D A SHAö, në vlerën 638,400 lekë me TVSH për sasinë 4,000 litra, e cila është bërë hyrje në magazinën e njesisë me FH nr. 1, datë 05.01.2022.

- Nga kjo procedurë rezulton se: Komisioni ka kualifikuar 5 OE të cilët nuk kanë licencat përkatëse për ushtrimin e aktivitetit të shitjes në fushën e tregtimit të hidrokarbureve, pavarësisht se në ekstraktin e QKB-së ata kanë të cilësuar se tregtojnë karburante me shumicë apo pakicë, konkretisht OE 1-P., 2-M.-M., 3-P. A., 4-D.J dhe 5-K., të cilët duhet të skualifikoheshin për mos përmbushje të kriterëve të kërkuara. Këta OE kanë dhënë ofertë më të lartë se OE i kualifikuar dhe shpallur fitues.

Për zbatimin e kontratës rezulton se; Titullari i AK nuk ka ngritur komision me jo më pak se 3 persona ku një ndër tyre të jetë specialist i fushës, për të garantuar kryerjen e furnizimit në sasi, cilësi sipas kërkesave dhe specifikimeve teknike të kërkuara.. *Veprime jo në përputhje me Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018, “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve”, i ndryshuar, pika 35, 42, 43.*

- **Auditimi i procedurës dhe zbatimit të blerjes me vlera të vogla Furnizim vendosje ndriçues të jashtëm në fasadën e ISSH.**

Procedura e prokurimit me objekt ÷Furnizim vendosje ndriçues fasade për ISSH-në, ka nisur me kërkesën e paraqitur me nr. 7707 prot, datë 07.12.2021, miratuar nga titullari i AK. Me datë 07.12.2021 është mbajtur procesverbali nga komisioni i blerjeve të vogla për përlllogaritjen e fondit limit i cili ka caktuar vlerën prej 150,000 lekë pa TVSH, referuar testimi të tregut.

Me urdhrin e prokurimit nr. 7707/1 prot., datë 09.12.2021 është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogla, i cili ka filluar procedurën e prokurimit me objekt “Furnizim vendosje ndriçues fasade për ISSH-në” me fond limit në vlerën 150,000 lekë. Komisioni ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik ftesën për ofertë me të dhënat e objektit të prokurimit, por nuk ka argumentuar se përse ndriçuesit duhet 150 VV.

Me datë 14.12.2021 është mbajtur procesverbali nga komisionit të prokurimit me vlerë të vogël pas paraqitjes së kërkesës për tërheqje nga operatori ekonomik ò4A Cò i cili është renditur i pari, por ka paraqitur kërkesën për tërheqje nga realizimi i kontratës sipas kushteve të AK. Më pas, komisioni ka vazhduar me operatorin e renditur në vendin e dytë.

Me datë 15.12.2021 është mbajtur procesverbali nga komisionit të prokurimit me vlerë të vogël pas paraqitjes së kërkesës për tërheqje nga operatori ekonomik òP-Nò i cili është renditur i dyti, por ka paraqitur kërkesën për tërheqje për arsye pamundësie të realizimit të kontratës. Më pas, komisioni ka vazhduar me operatorin e renditur në vendin e tretë.

Me datë 16.12.2021 është mbajtur procesverbali nga komisionit të prokurimit me vlerë të vogël pas paraqitjes së kërkesës për tërheqje nga operatori ekonomik òJò e cila është renditur e treta, por ka paraqitur kërkesën për tërheqje për arsye objektive. Më pas, komisioni ka vazhduar me operatorin e renditur në vendin e katërt.

Me procesverbalin ne datës 22.12.2021, është klasifikuar dhe shpallur fitues OE òO Tò, me vlerë oferte në shumën 143,333 lekë pa TVSH dhe 172,000 lekë me TVSH.

Me procesverbalin e datës 28.12.2021, të mbajtur nga komisioni i BVV, OE fitues është paraqitur dhe ka kryer furnizimin dhe vendosjen e ndriçuesve në fasadën e godinës.

-Nga kjo procedurë rezulton se komisioni i BVV ka kërkuar në specifikimet teknike që ndriçuesi të jetë 150VV por nuk e ka të argumentuar si kriter, sipas kërkesave të Udhëzimit nr. 05, datë 25.06.2021, òMbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, pika 7, kriter i cili duhet të argumentohet përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit. Gjithashtu ftesa për ofertë nuk përmban argumentim të specifikimeve teknike sipas pikës 11 të udhëzimit. *Veprime këto jo në përputhje me udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", pika 7 dhe 11.*

- **Auditimi i procedurës dhe zbatimit të blerjes me vlera të vogla Riparim automjeti me targe AA165VX.**

Procedura e prokurimit me objekt òRiparim/shërbim për automjetin tip Ford Kuga me targë AA 165 VXò, ka nisur me kërkesën e paraqitur me nr. 7394 prot, datë 22.11.2021, paraqitur nga Drejtori i Administrimit të Përgjithshëm, referuar kërkesës së paraqitur ndaj tij me datë 19.11.2021 prej drejtuesit të automjetit z. T. E, miratuar nga titullari i AK.

Me datë 23.11.2021 është mbajtur procesverbali nga komisioni i blerjeve të vogla për përlllogaritjen e fondit limit i cili ka caktuar vlerën prej 24,000 lekë pa TVSH, referuar testimit të tregut 1 zë dhe shërbim të preventivit dhe ofertave të mëparshëm për 5 zëra të tjerë.

Me urdhrin e prokurimit nr. 7394/1 prot., datë 24.11.2021 është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogla, i cili ka filluar procedurën e prokurimit me objekt "Riparim/shërbim për automjetin tip Ford Kuga me targë AA 165 VX" me fond limit në vlerën 24,000 lekë pa TVSH. Komisioni ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik ftesën për ofertë me të dhënat e objektit të prokurimit dhe preventivin me shërbimet përkatëse. Me datë 25.11.2021 është bërë klasifikimi përfundimtar ku rezulton se kanë marrë pjesë 12 operatorë ekonomik (OE), nga të cilët janë kualifikuar 2 OE dhe janë shkualifikuar 10 të tjerë, të cilët janë refuzuar për arsye se kanë dhënë ofertë me vlerë më të lartë se fondi limit i parashikuar. Komisioni ka mbajtur procesverbalin më datë 25.11.2021, duke përcaktuar si ofertë të kualifikuar në vend të parë operatorin ekonomik òN SHPKò, me vlerë oferte 203,16 lekë pa TVSH dhe 24,380 lekë me TVSH. Me procesverbalin e datës 06.12.2021, komisioni ka shpall fitues OE òN SHPKò, pasi nuk pati edhe ankesa duke e klasifikuar si të suksesshme dhe njoftuar për paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar. Me datë 06.12.2021 është mbajtur procesverbal i realizimit të shërbimeve të automjetit midis personit përgjegjës z.T.E si përfaqësues i ISSH-së dhe përfaqësuesin e OE fitues z. E. K.

Me urdhër transfertën bankare të datës 20.12.2021, është likuiduar fatura tatimore nr. 2524/2021, datë 06.12.2021, për riparimin e automjetit, ndaj operatorit òN SHPKò, në vlerën

24,380 lekë me TVSH. Pagesa është kryer mbi procesverbalin për realizimin e shërbimit të mbajtur nga OE dhe nga z. T. E. si përfaqësues i ISSH, me pozicion drejtues mjete.

- Nga kjo procedurë rezulton se; Titullari i AK nuk ka ngritur komision me jo më pak se 3 persona ku një ndër tyre të jetë specialist i fushës, për të garantuar kryerjen e shërbimit në sasi, cilësi dhe origjinalitetit të pjesëve të vendosura. Punonjësi i cili ka nënshkruar procesverbalin për realizimin e shërbimit, nuk ka qenë i autorizuar për nga titullari për kryerjen e nënshkrimit të aktit dhe certifikimin e kryerjes së shërbimit. Mbi këtë procesverbal është bazuar dhe kryerja e shpenzimit nga Drejtoria e Financës. *Veprime jo në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve", i ndryshuar, pika 35, 42, 43.*

- **Auditimi i procedurës dhe zbatimit të blerjes me vlera të vogla Rinovimi i licencës së antivirusit.**

Procedura e prokurimit me objekt *ō*Rinovimi i licencës së antivirusit, ka nisur me kërkesën e paraqitur me nr. 6364 prot, datë 15.10.2021, nga Drejtori i Drejtorisë së Burimeve të Informacionit, miratuar nga titullari i AK.

Me datë 19.10.2021 është mbajtur procesverbali nga komisioni i blerjeve të vogla për përllogaritjen e fondit limit i cili ka caktuar vlerën prej 313,000 lekë pa TVSH, referuar ofertave të mëparshme të paraqitura nga OE.

Me urdhrin e prokurimit nr. 6364/2 prot., datë 05.11.2021 është urdhëruar komisioni i prokurimit për blerje me vlera të vogla, i cili ka filluar procedurën e prokurimit me objekt "Rinovimi i licencës së antivirusit" me fond limit në vlerën 313,000 lekë pa TVSH. Komisioni ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik ftesën për ofertë me të dhënat e objektit të prokurimit. Me datë 08.11.2021 është bërë klasifikimi përfundimtar ku rezulton se kanë marrë pjesë 9 operatorë ekonomik (OE), nga të cilët janë kualifikuar 3 OE. Komisioni ka mbajtur procesverbalin më datë 06.08.2021, duke përcaktuar si ofertë fitues operatorin ekonomik *ō*A. A*ō*, me vlerë oferte 215,000 lekë pa TVSH.

Me datë 09.11.2021 është mbajtur procesverbali nga komisionit të prokurimit me vlerë të vogël pas paraqitjes së kërkesës për tërheqje nga operatori ekonomik *ō*A. A*ō* i cili është renditur i pari, por ka paraqitur kërkesën për tërheqje për arsye të një problematike. Më pas, komisioni ka vazhduar me operatorin e renditur në vendin e dytë.

Me datë 12.11.2021 është mbajtur procesverbali nga komisionit të prokurimit me vlerë të vogël duke klasifikuar si fitues OE *ō*B. I. S. S.*ō*, të renditur në vend të dytë me vlerë oferte 249,999 lekë.

Me datë 10.11.2021, administruar me nr. 7023 prot, OE fitues ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar nga AK, duke u kualifikuar dhe me aktin nr. 6364/3 prot, datë 15.11.2021, është hartuar dhe lidhur kontrata e shërbimit ndërmjet titullarit të AK dhe OE fitues.

Me urdhër transfertën bankare të datës 06.12.2021, është likuiduar fatura tatimore nr. 28/2021, datë 13.11.2021, për blerje licencë antivirusi, ndaj operatorit *ō*B. I. S. S.*ō*, në vlerën 299,999 lekë me TVSH. Pagesa është kryer bazuar në procesverbalin e dorëzimit të hartuar nga OE fitues, me datë 12.11.2021, e nënshkruar nga përfaqësuesi i OE dhe nga z. E. D. për ISSH-në i cili ka marrë në dorëzim licencat e antivirusit.

- Nga kjo procedurë rezulton se; Titullari i AK nuk ka ngritur komision me jo më pak se 3 persona ku një ndër tyre të jetë specialist i fushës, për të garantuar kryerjen e furnizimit të produktit të kërkuar. Punonjësi i cili ka nënshkruar procesverbalin për realizimin e furnizimit, nuk ka qenë i autorizuar për nga titullari për kryerjen e nënshkrimit të aktit dhe dorëzimit të mallit. Nuk ka fletë hyrje të kryerjes në fakt të verifikimit të marrjes në dorëzim në magazinën e institucionit si dokument vërtetues për kryerjen e shpenzimit. Mbi këtë procesverbal është bazuar dhe kryerja e shpenzimit nga Drejtoria e Financës. *Veprime jo në përputhje me Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018, "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve", i ndryshuar, pika 35, 42, 43.*

Procedura të zhvilluara në formë shkresore, me vlerë deri në 100,000 lekë.

- **Blerje starter për ndriçuesit neon të godinës së ISSH.**

Procedura për blerjen e 200 copë starterave për ndriçuesit e ISSH ka nisur me kërkesën e paraqitur me nr. 8140 prot, datë 23.12.2021 nga Drejtori i Administrimit të Përgjithshëm, miratuar nga titullari i AK.

Me urdhër transfertën bankare të datës 24.12.2021, është likuiduar fatura tatimore nr. 81/2021, datë 15.12.2021, për blerjen e starterave, ndaj operatorit òSh. P.ò, në vlerën 10,000 lekë me TVSH. Komisioni i përbërë prej z. E. P. dhe z. B. D., kanë mbajtur procesverbalin e datës 23.12.2021, për marrjen në dorëzim të mallrave të cilat janë bërë hyrje në magazinën e ISSH me FH nr. 49, datë 28.12.2021.

Nga kjo procedurë rezulton se komisioni i blerjeve me vlerë të vogël nuk ka mbajtur formularin nr. 4, sipas dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, *duke vepruar jo në përputhje me Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 20.2.*

- **Blerje bllokues parkimi.**

Procedura për blerjen e bllokues parkimi ka nisur me kërkesën e paraqitur me nr. 7652 prot, datë 03.12.2021 nga Drejtori i Administrimit të Përgjithshëm, miratuar nga titullari i AK, si domosdoshmëri për pezullimin e parkimit të automjeteve të cilat nuk janë të institucionit dhe sistemimin e ambientit.

Me urdhër transfertën bankare të datës 03.12.2021, është likuiduar fatura tatimore nr. 17896, datë 03.12.2021, për blerjen e bllokuesve, ndaj operatorit òMö, në vlerën 12,090 lekë me TVSH. Komisioni i përbërë prej z. E. P, z. B. D. dhe z. V. P, kanë mbajtur procesverbalin e datës 03.12.2021, për vendosjen e bllokuesve të parkimit.

Nga kjo procedurë rezulton se komisioni i blerjeve me vlerë të vogël nuk ka mbajtur formularin nr. 4, sipas dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, *duke vepruar jo në përputhje me Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021, “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, pika 20.2.* Këto bllokues (mallra) nuk janë bërë hyrje në magazinën e institucionit, me fletëhyrje e fletëdalje për vendosjen më pas në vendin e caktuar, *veprim jo në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve”, i ndryshuar, pika 35, 42, 43.*

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi titullari i AK z. A. H, nëpunësi zbatues zj. L. Gj, zj. K. N. përgjegjëse e sektorit të buxhetit të brendshëm dhe anëtarët e komisionit të blerjeve me vlera të vogla z. E. P, zj. N. Ç. e z. B. D.

Titulli i gjetjes: Mangësi në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera për procedurat e prokurimit blerje me vlera të vogla u konstatua se:

- Nuk është dokumentuar dhe argumentuar përzgjedhja e operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për ofertë;
- Në 1 (një) rast komisioni ka kualifikuar OE që nuk kanë licencë për ushtrim aktiviteti të objektit të kontratës, konkretisht në procedurën e prokurimit me objekt òBlerje Karburant dieselö;
- Në 2 (dy) raste fatura tatimore nuk është e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit, konkretisht në procedurat e prokurimit me objekt òMirëmbajtja e faqes zyrtare të ISSHö dhe òRinovimi i licencës së antivirusitö;
- Në 5 (pesë) raste likuidimi është kryer pa krijuar komision prej 3 personash ku një prej tyre të jetë specialist i fushës, konkretisht në procedurat e prokurimit me objekt òMirëmbajtja e faqes zyrtare të ISSH-sëö, òRiparimi i automjetit me targë AA165VXö procedura e parë, òRiparimi i automjetit me targë AA166VXö òRiparimi i automjetit me targë AA165VXö procedura e dytë;

- Në 5 (pesë) raste nuk është krijuar komision për marrjen në dorëzim të mallrave apo shërbimeve të kërkuara, konkretisht në procedurën e prokurimit me objekt ÷Blerje Karburant dieselö, ÷Mirëmbajtja e faqes zyrtare të ISSH-sëö, ÷Riparimi i automjetit me targë AA165VXö procedura e parë, ÷Riparimi i automjetit me targë AA166VXö, ÷Riparimi i automjetit me targë AA165VXö procedura e dytë, ÷Rinovimi i licencës së antivirusitö;

- Në 1 (një) rast nuk është argumentuar kriteret apo specififikimet e vendosura në ftesën për ofertë të hartuar nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla, konkretisht në procedurën e prokurimit me objekt ÷Furnizim vendosje ndriçues të jashtëm në fasadën e ISH-sëö;

- Në 2 (dy) raste nuk është bërë fletë hyrje në magazinë mallrat apo shërbimet e kërkuara por janë marrë direkt në dorëzim nga punonjësi, konkretisht në procedurën e prokurimit me objekt ÷Rinovimi i licencës së antivirusitö dhe ÷Blerje bllokues parkimiö;

- Në 2 (dy) raste nuk është mbajtur formulari nr. 4, për rastet përkatëse sipas dokumenteve standardë, konkretisht në procedurën e prokurimit me objekt ÷Blerje starter për ndriçuesit neon të godinës së ISSH-sëö dhe ÷Blerje bllokues parkimiö.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018, ÷Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeö, i ndryshuar, pika 19, me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ÷Për menaxhimin e aktiveveö, i ndryshuar, pika 35, 42, 43, Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 ÷Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeö, pika 7 dhe 11.

Kriteri:

- Udhëzimi nr. 3, datë 08.01.2018, ÷Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeö, i ndryshuar, pika 19;

- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 ÷Për menaxhimin e aktiveveö, i ndryshuar, pika 35, 42, 43, Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 ÷Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronikeö, pika 7 dhe 11.

Ndikimi/Efekti:

Procedurat e prokurimit paraqesin një shmangie apo neglizhencë, duke mos respektuar rregullat e procedurave të Prokurimit Publik.

Shkaku:

Kjo situatë ka ndodhur për shkak të mosrespektimit të legjislacionit, nga Përgjegjësi i Prokurimeve dhe komisioni i prokurimit të blerjeve me vlera të vogla.

Rëndësia:

E mesme

Rekomandime:

Drejtori i Përgjithshëm në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mangësitë e evidentuara në prokurimet me vlera të vogla, si dhe të përfshijë zyrtarë të kualifikuar dhe të trajnuar, me qëllim zhvillimin e dokumentimit të saktë të procedurave të prokurimit.

3.5 Auditimi i administrimit të burimeve njerëzore, rekrutimet, largimet, ndjekja e procedurave.

Për auditimin e drejtimit të mësipërmu shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Struktura dhe organika e Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- Dosjet e punonjësve të vlerësimet e punës, trajnimet, përshkrimet e punës, rekrutime;

- Rregullorja e Brendshme e ISSH;
- Data baza e vendimeve gjyqësore për largimin e punonjësve nga puna, nga kurezulton: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, është një institucion publik, i pavarur, organizimi dhe funksionimi i të cilit rregullohet me dispozitat e Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993, *“Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar me ligjin nr.104/2014, datë 31.07.2014, VKM nr.161, datë 11.04.1994 *“Për miratimin e Statutit të ISSH-së si dhe Rregullores nr.1 datë 30.04.1996 “Për funksionimin e Këshillit Administrativ të ISSH-së. ISSH është e organizuar në tri nivele drejtimi: Drejtoria Qendrore, 12 Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Arkivit Qendror të Sigurimeve Shoqërore, si dhe në dy Agjencitë Lokale të Sigurimeve Shoqërore në nivel qyteti ose qendre banimi relativisht të mëdha.*

Tabela 1. Struktura organizative e Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH për vitin 2021

STRUKTURA ORGANIZATIVE DREJTORIA E PËRGJITHSHME		
Nr.	Emërtimi	Nr.
1	Drejtor i Përgjithshëm	1
2	Zv. Drejtor i Përgjithshëm	1
3	Zv. Drejtor i Përgjithshëm	1
4	Zv. Drejtor i Përgjithshëm	1
5	Kabineti i Drejtorit të Përgjithshëm	5
6	Drejtoria e burimeve të informacionit	10
7	Drejtoria e financës	19
8	Drejtoria e kontributeve	12
9	Drejtoria e administrimit të përgjithshëm	26
10	Drejtoria e marrëdhënieve me publikun	12
11	Drejtoria e përfitimeve	22
12	Njësia e inspektimit të përfitimeve	20
13	Drejtoria e auditimit të brendshëm	9
14	Drejtoria juridike	9
15	Drejtoria e integritetit, marrëveshjeve, reformave dhe kërkimit social	9
16	TOTAL	157

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Për vitin 2021 numri i punonjësve në strukturën organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH është 157, miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 3672 prot., datë 08.06.2021 në të cilin është bërë ndryshimi i strukturës:

- është pakësuar një (1) vend *“Operator në Sektorin e Administrimit të Bazës së të dhënave pranë Drejtorisë së Burimeve të Informacionit në ISSH,*
- është shtuar një (1) vend *“vënd Specialist përpunues në degën e përfitimeve pranë DRSSH Durrës.*

Tabelë 2. Numri punonjësve të miratuar

Vendim i Këshillit Administrativ	Numri punonjësve të miratuar
3/1, datë 26.02.2008	1153
Nr.5, datë 20.07.2010	1153
Datë 04.07.2011	1225
Nr. 7 , datë 29.04.2015	1279
Nr.26, datë 11.12.2015	1297
Nr. 18, datë 20.12.2017	1337

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Pra në total numri i punonjësve gjatë vitit 2021 mbetet i pandryshuar.

ISSH konstatohet se ka funksionuar mbi bazën rregullore për organizimin e detyrave funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme në ISSH-së, rregullore e cila i përshtatet strukturave të mëparshme organizative dhe si rrjedhojë nuk e përmbush funksionin e vet për strukturën aktuale të miratuar. Struktura organizative sipas kësaj rregullore, paraqitet me mangësi në përcaktimin e kriterëve të arsimit dhe eksperiencës në punë, për disa pozicione pune të

Drejtorisë Përgjithshme të ISSH-së si dhe për të gjitha pozicionet e punës për Drejtoritë Rajonale.

Në rregullore tek përshkrimi i punës për disa drejtori nuk janë të përcaktuara kriteri i arsimit dhe eksperiencës si më poshtë:

- *Drejtoria e financës (për 20 pozicione pune).*

- *Drejtoria e integritit, marrëveshjeve, marrëveshjeve reformave dhe kërkimi social (për 7 pozicione pune).*

- *Drejtoria e Burimeve të Informacionit (1 pozicion pune).*

- *Drejtoria e Administrimit të përgjithshëm (2 pozicione pune).*

Në rregulloren për organizimin e detyrave funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH-së janë përfshirë dhe detyrat funksionale për Drejtoritë Rajonale, por nuk janë të përcaktuara kriteret e arsimit dhe eksperiencës në punë.

Rregullorja organizative aktualisht është draft dhe pritet të miratohet në Këshillin Administrativ.

❖ Në lidhje me emërimet, transferimet dhe largimet e punonjësve, gjatë vitit 2021

Në lidhje me emërimet, transferimet dhe largimet e punonjësve, gjatë vitit 2021 konstatohet semarrëdhëniet e punës rregullohen nga Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë dhe Rregullorja për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore miratuar me Vendimin e Këshillit Administrativ nr. 3/2, datë 26.02.2008, Vendimit nr.5, datë 14.08.2020 për disa shtesa e ndryshime në rregulloren nr.3/2 për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, si dhe marrëdhëniet e pagave dhe shpërblimeve në rregulloren Financiare të ISSH nr. 5, datë 25.05.2009.

Përgjatë vitit 2021 në ISSH janë emëruar 9 punonjës dhe nga verifikimi i dosjeve, konstatohet se dosjet disponojnë dokumentacionin e nevojshëm, emërimet janë kryer nëpërmjet konkurrimit të hapur. Për të gjitha rastet është ndjekur procedura e rekrutimit të hapur të vendeve vakante duke u zbatuar VKA nr. 5 datë 14.08.2020 për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren Nr.3/2 datë 26.02.2008 për Personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Kreu 1, Rekrutimi dhe komandimi i përkohshëm në detyrë, pika 1, germa (b). Publikimi elektronik i të gjithë informacionit që i përket rekrutimit të personelit nëpërmjet konkurrimit të hapur është realizuar në faqen zyrtare të ISSH-së. Në fillim funksionojnë me kontrata tremujore për periudhën e provës pastaj është bërë kontrate pa afat sipas rregullores.

Për vitin 2021 janë kryer 11 largime nga detyra, nga të cilët:

- 5 (pesë) me dorëheqje,
- 3 (tre) dalje në pension,
- 1 (një) punonjës ka ndërruar jetë.
- 1 (një) punonjës me Urdhër nr. 7097 prot, datë 12.11.2021 ka kaluar në një detyrë tjetër pranë Drejtorisë Rajonale Tiranë, ku ka vazhduar me raport paaftësie dhe më pas nuk është paraqitur asnjë ditë në punë duke mos bërë asnjë njoftim zyrtar arsyen për mungesën e tij. Për rrjedhojë i është dhënë masë disiplinore dhe largim nga puna për braktisje të vendit të punës dhe mungesë të pajustificuar dhe të vijueshme për më shumë se 7 ditë.
- 1 (një) punonjës me Urdhër nr. 6852 prot, datë 04.11.2021 është larguar nga detyra Drejtor i Arkivit Qendror të ISSH-së si rezultat i analizës së performancës së dobët 9 mujore të drejtorisë ku drejtonte dhe ka kaluar në një detyrë tjetër pranë ISSH-së Specialist në Njësinë e Inspektimit të Përfitimeve ku nuk është paraqitur asnjë ditë në punë duke mos bërë asnjë njoftim zyrtar arsyen për mungesën e tij. Për rrjedhojë i është dhënë masë disiplinore dhe largim nga puna për braktisje të vendit të punës dhe mungesë të pajustificuar dhe të vijueshme për më shumë se 7 ditë.

Për sa më sipër ka 2 largime me masë disiplinore për pozicionin e punës Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm, dhe për pozicionin Specialist të Njësisë Inspektimit të Përfitimeve, të larguar bazuar në VKA nr.5 datë 14.08.2020 për një ndryshim në Rregulloren

Nr.3/2 datë 26.02.2008, “Për Personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” Ankesi 2, Kodi Etik, pika 5 ÷Zbatimi orarit të punës, Kapitulli V, pika 1 ÷Shkeljet disiplinore÷ pika 1.1, germa (d), Kapitulli VI, pika 6.2 ÷Largimi i menjëhershëm nga puna dhe zgjidhja e kontratës me motivacion disiplinore “Largim nga puna” për braktisje të vendit të punës dhe mungesë të pajustificuar dhe të vijueshme për më shumë se 7 ditë.

Vendet vakante;Për vitin 2021, janë 11 vende vakante të cilët nuk janë plotësuar me pretendimin se nuk është emëruar/plotësuar pozicioni i zv/Drejtorit të Përgjithshëm i cili është edhe kryetar i komisionit të rekrutimit të punonjësve të rinj.

Vlerësimi i performancës së punonjësve; Vlerësimi i punonjësve, për vitin 2021 është kryer çdo 3-mujor gjatë viti por edhe vjetor sipas përcaktimeve të ndryshimit të rregullores së personelit, të cilët janë depozituar brenda afatit të caktuar, datë 10.02.2022 në zyrën e burimeve njerëzore për t’u administruar në dosjet personale të secilit punonjës. I gjithë procesi i vlerësimit të punonjësve bëhet sipas Udhëzimit nr. 3032 prot, datë 09.06.2010, ku pasqyrohet realizimi i gjithë procesit të vlerësimit, sipas një formati tip, në të cilin pasqyrohen rezultatet e vlerësimit të punonjësit në pikë. Shkalla më e lartë e vlerësimit është deri në 100 pikë dhe punonjësit janë vlerësuar në intervalin 72 pikë ó 100 pikë.

Nga auditimi i vlerësimeve konstatohet se VKA nr. 3 datë 26.02.2008 ÷Për personelin e ISSH-së, është ndryshuar me VKA nr. 5, datë 14.08.2020, kapitullin IV, pika 2 ÷Vlerësimi i detyrës, nën-pika 2.1 ku vlerësimi i punonjësve të bëhet çdo 3-muaj, gjë e cila ka sjellë një vlerësim pothuajse formal pasi identifikohen të njëjta pikë vlerësimi çdo 3- mujor dhe një shtim të dokumentacionit në dosjet e personelit, kur kjo gjë nuk është e përcaktuar në kodin e punës në bazë të cilit emërohen, vlerësohen dhe lirohen nga detyra punonjësit e ISSH-së.

Gjatë vitit 2021 me Urdhër nr. 4114 prot ,datë 28.06.2021 është bërë rritja e pagës në shkallë për 62 punonjës sipas propozimeve të Përgjegjësit të Sektorit dhe Drejtorit përkatës, në bazë të rregullores ÷Për personelin e ISSH-së, ANEKSI 3/B ÷Për pagat e punonjësve te ISSH-së.

❖ Funksionimi i Këshillit Administrativ të ISSH dhe veprimtaria për vitin 2021.

Bazuar në nenin 71, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 ÷Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Instituti i Sigurimeve Shoqërore drejtohet nga:

1. Këshilli Administrativ
2. Drejtori i Përgjithshëm.

Këshilli Administrativ është organi më i lartë ekzekutiv e përbëhet nga 12 anëtarë nga të cilët:

- 6 përfaqësues nga Këshilli i Ministrave;
- 3 përfaqësues të punëdhënësve;
- 3 përfaqësues të sindikatave të cilët përzgjidhen dhe vendosen me VKM.

Gjatë vitit 2021 ka pasur ndryshime në përbërjen e anëtarëve të KA-së dhe konkretisht është konfirmuar Ministri i Financave dhe Ekonomisë si përfaqësues i MFE , dhe përfaqësuesi i Shoqatës të Ndërtuesve të Shqipërisë.

Nga auditimi i aktivitetit të Këshilli Administrativ konstatohet se janë zhvilluar gjithsej 4 mbledhje gjë e cila është në përputhje me Statutin e ISSH-së, Kreu V, neni 15 i tij. Në këto mbledhje janë shqyrtuar çështje të përcaktuara në rendin e ditës gjithashtu procesverbalet janë mbajtur nga personi përgjegjës për mbajtjen e tyre znj. Dh. P. Sipas mbledhjeve të organizuara për vitin 2021, bazuar në projektvendimet e paraqitura, të shoqëruara me relacionet përkatëse Këshilli Administrativ ka nxjerrë gjithsej 9 vendime.

Tabela 3. Mbledhjet e zhvilluara nga Këshilli Administrativ për vitin 2021

Nr.	Data	Vendimet e marra
1	22.07.2021	Vendim nr.1, ÷Për një ndryshim në Rregulloren ÷Mbi kriteret, dokumentacionin dhe procedurat e vlerësimit të kërkesave të invalidëve për rimbursim të shpenzimeve për blerjen e karburanteve dhe vajrave lubrifikante Vendim nr.2, ÷Për disa ndryshime në Rregulloren nr. 3/2, datë 26.02.2008 ÷Për personelin e institutit të sigurimeve shoqërore dhe rritjen e pagave. Vendim nr.3, Ngritjen e një Grupi Teknik Ndërmintros Pune me qëllimin rishikim e skemës së pensione.

2	28.09.2021	Vendim nr.4, ðPër miratimin e Rregullores ðPër procedurat e funksionimit të komisioneve dhe veprimet administrative për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore, në zbatim të ligjit nr. 169/ 2020. Vendimi nr. 5, Proces verbal i mbledhjes së datës 28.09.2021. për përmbledhjen e vendimeve të mbledhjes
3	07.12.2021	Vendim nr.6, ðPër miratimin e projekt VKM ðPër shpërblimin e pensionistëve për festat e fund vitit 2021. Vendim nr.7, ðPër miratimin e rezultatit financiar të sigurimeve shoqërore për vitin 2020. Vendimi nr.8 Proces verbal i mbledhjes së datës 07.12.2021. për përmbledhjen e vendimeve të mbledhjes
4	29.12.2021	Vendim nr.9, ðPër ndarjen e buxhetit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2022.

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Sa më sipër konstatohet se, për vitin 2021 në mbledhjet e KA asnjëherë nuk kanë marrë pjesë 12 anëtarët e saj duke influencuar në vendimmarrje. Gjithashtu në dosje mungojnë njoftimet për mbledhje i cili duhet të dërgohet nga Drejtori i Përgjithshëm 10 ditë përpara fillimit të saj tek të gjithë anëtarët e Këshillit Administrativ . Në mbledhjen e datës 07.12.2021 është miratuar rezultati financiar i vitit 2020 në kundërshtim me zbatimin e Rregullores Financiare, Kreu VI ðKontrolli financiar dhe raportimi’’çështja D ðRaportimiö/nën çështja 3, ku specifikohet se ðRaporti vjetor së bashku me bilancin si shtojcë pas aprovimit nga KA, duhet botuar jo më vonë se fundi i tremujorit të dytë, që pason vitin të cilit ai i referohetö.

❖ Trajnimet dhe Aktivitetet trajnuese të realizuara gjatë vitit 2021

Gjatë vitit 2021 janë trajnuar 70punonjës dhe të gjithë të punësuarit e rinj në sistemin e Sigurimeve Shoqërore. Aktivitete trajnuese janë kryer në ambientet e ISSH-së me specialistë të degëve të ndryshme nga të gjitha DRSSH-të, sipas temave e grupeve të caktuara në planin vjetor të vitit 2021 të miratuar me shkresë nr. 3695 prot, datë 09.06.2021 nga i cili janë realizuar vetëm 4 programe trajnimi si rezultat i vështirësive të krijuara prej pandemisë Covid - 19 në realizimin e aktiviteteve trajnuese, në përputhje me planin vjetor të miratuar në fillim të vitit. Megjithatë pavarësisht situatës, është arritur që gjatë vitit 2021 të realizohet. Gjithashtu të punësuarit e rinj kanë marrë asistencë teknike nga punonjës me eksperiencë në sistemin e sigurimeve.

Kalendari paraprak i aktiviteteve trajnuese për punonjësit e sistemit të sigurimeve shoqërore, përgjatë vitit 2021 është në aneksin e këtij raporti.

❖ Vendimet gjyqësore ndiqen dhe ekzekutohen nga ISSH.

(tabelat e vendimeve gjyqësore janë në aneks)

Nga auditimi i vendimeve gjyqësore për largimet nga puna, konstatohet se janë 23 raste që ndiqen nga ISSH për ish-punonjës të larguar. Gjithashtu konstatohet se vendimet gjyqësore ndiqen dhe ekzekutohen nga secila DRSSH nga të cilat për vitin 2021 janë ekzekutuar gjithsej gjashtë me vlerën 9,346,663 lekë

Për sa më sipër në mënyrë të përmbledhur konkluzionet nga auditimi i menaxhimit të burimeve njerëzore konstatohet:

- mos realizimin plotësisht i aktiviteteve trajnuese për stafin e ISSH-së,në përputhje me planin vjetor të miratuar në fillim të vitit si pasojë e vështirësive të krijuara nga pandemia Covid -19,
- Instituti i Sigurimeve Shoqërore përgjatë vitit 2021, ka funksionuar mbi bazën e Rregullores të pa miratuar nga Këshilli Administrativ e cila paraqitet me mangësi në përcaktimin e kriterëve të kualifikimit dhe të eksperiencës në punë. Kjo rregullore i përshtatet strukturave të mëparshme organizative dhe si rrjedhojë nuk e përmbush funksionin e vet për strukturën aktuale;

-në dosje mungojnë njoftimet për mbledhje i cili duhet të dërgohet nga Drejtori i Përgjithshëm 10 ditë përpara fillimit të saj tek të gjithë anëtarët e Këshillit Administrativ;

- mos miratimit në kohë të rezultatit financiar të vitit 2020 në kundërshtim me zbatimin e Rregullores Financiare, Kreu VI ðKontrolli financiar dhe raportimi’’çështja D ðRaportimiö/nën çështja 3, ku specifikohet se ðRaporti vjetor së bashku me bilancin si shtojcë

pas aprovimit nga KA, duhet botuar jo më vonë se fundi i tremujorit të dytë, që pason vitin të cilit ai i referohet;

- në vlerësim individual i performancës së punonjësve është kthyer në formalitet pasi identifikohen të njëjta pikë vlerësimi çdo 3- mujor dhe një shtim të dokumentacionit në dosjet e personelit.

Titulli i gjetjes: Në zbatimin e procedurave të administrimit të burimeve njerëzore dhe veprimtarisë Komitetit të Shqyrtimit Administrativ.

Situata: Nga shqyrtimi i administrimit të marrëdhënieve të punës dhe dokumentacionit që i rregullojnë ato, si dhe Këshillit Administrativ rezultojnë se:

- Nuk janë realizuar plotësisht aktivitetet trajnuese për stafin e ISSH-së, në përputhje me planin vjetor të miratuar në fillim të vitit, gjë për të cilën ka ndikuar dhe pandemia Covid -19;

- Instituti i Sigurimeve Shoqërore përgjatë vitit 2021, ka funksionuar mbi bazën e Rregullores të pa miratuar nga Këshilli Administrativ e cila paraqitet me mangësi në përcaktimin e kriterëve të kualifikimit dhe të eksperiencës në punë dhe përshtatjes me strukturën organizative aktuale,

- Vlerësimi individual i performancës së punonjësve është kthyer në formalitet pasi identifikohen të njëjta pikë vlerësimi çdo 3- mujor dhe një shtim të dokumentacionit në dosjet e personelit.

Këshilli Administrativ nuk ka miratuar në kohë rezultatin financiar të vitit 2020 në kundërshtim me zbatimin e Rregullores Financiare, Kreu VI *“Kontrolli financiar dhe raportimi”/çështja D* *“Raportimi”/nën çështja 3*, jo më vonë se fundi i tremujorit të dytë, që pason vitin të cilit ai i referohet.

Kriteri: -ligji nr. 7703, datë 11.05.1993, *“Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar

- ligji nr.104/2014, datë 31.07.2014,

- VKM nr.161, datë 11.04.1994 *“Për miratimin e Statutit të ISSHö*

- *VKA Nr.3/2 datë 20.02.2008 “Për personelin e ISSH”.*

- *VKM nr. 262, datë 07.05.2014.*

- *VKM Nr.263, datë 07.05.2014*

- *Urdhri Nr.2518 prot datë 03.04.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm*

- *Urdhri Nr.2597 prot datë 05.04.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm*

- *Urdhri Nr.8115 prot datë 05.12.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm*

- *Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,*

- *Urdhri Nr.3672 prot datë 08.06.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm*

- Rregullores nr.1 datë 30.04.1996 *“Për funksionimin e Këshillit Administrativ të ISSHö*

Ndikimi/Efekti: Në rritjen e bashkëpunimit në administrimin e burimeve njerëzore dhe veprimtarisë Komitetit të Shqyrtimit Administrativ.

Shkaku: Mangësi në zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator për menaxhimin dhe administrimin e marrëdhënieve të punës.

Rëndësia: E mesme

Rekomandime: Drejtori i përgjithshëm të marrë masa për dërgimin dhe miratimin e Rregullores së brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e ISSH-së në përputhje me strukturën organizative aktuale, si dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të sigurojë trajnimin dhe rishikimin e kohës dhe mënyrës së vlerësimit të punonjësve e duhur të punonjësve. Këshilli i Administrativ të zhvillojë veprimtarinë e tij sipas kuadrit përkatës rregullator dhe në afate, me qëllim që të ndikoj në përmirësimin e ecurisë së ISSH.

3.6 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.

Për auditimin e zbatimit të rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm, sipas vendimit të Kryetarit të KLSH-së nr. 126 datë 24.09.2021 dhe të dërguar me shkresën nr. 95/9 prot., datë 24.09.2021 u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion për zbatimin e rekomandimeve, plane pune për zbatimin e tyre dhe relacione nga të cilat konstatohet se:

ISSH ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor prej 20 ditëve, gjithashtu nga institucioni nuk ka patur kundërshtime për rekomandimet e KLSH, si dhe janë përcaktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet përkatëse, pra janë pranuar të gjitha rekomandimet. ISSH ka përgatitur programin e masave që do të merren dhe realizohen për zbatimin e rekomandimeve ku janë përcaktuar afatet, personat apo drejtoritë përgjegjëse si dhe janë nxjerrë shkresat përkatëse për zbatim dhe është dërguar në KLSH me shkresën nr. 468/7, datë 22.10.2021.

Gjithashtu, në zbatim të afatit ligjor të përcaktuar në pikën nr. 2, neni 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, për të raportuar per ecurinë e zbatimit nuk është përmbushur afati 6 mujor.

Në auditimin e mëparshëm janë rekomanduar 27 masa organizative, të cilat janë pranuar nga ISSH dhe nga auditimi rezultojn: *janë realizuar 19 masa dhe janë në procesin e realizimit në vijimësi 8 masa organizative.* Në mënyrë të detajuar po i paraqesim më poshtë:

1.1. Rekomandim: Strukturat përgjegjëse për hartimin e buxhetit vjetor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të mundësojnë përfshirjen e ISSH në të gjitha fazat e programimit të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore së bashku me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në rolin e agjentit tatimor për mbledhjen e këtyre të ardhurave, në mënyrë që ato mos vijnë të gatshme në ISSH, por të programohen referuar një analize të drejtë dhe përfshirjen e të gjithë faktorëve ndikues.

1.2. Rekomandim: Strukturat drejtuese të ISSH, të mundësojnë programimin e shpenzimeve nga të gjitha strukturat e varësisë dhe në të gjitha fazat e programimit, duke pasur parasysh zgjidhjen e problematikave në shpejtimin e plotësimit të bazës së të dhënave për periudhën e sigurimit të personave që kanë kontribuar në skemë.

Deri me datë 31.12.2021 dhe në vijimësi

✓ Nga auditimi konstatohet se, në zbatim të këtij rekomandimi nga Drejtori i Përgjithshëm është nxjerrë shkresa me nr. 4848 prot, datë 27.07.2021 òPër hartimin e treguesve të projekt-buxhetit të ISSH për vitin 2022-2024 ò drejtuar Drejtorive Rajonale e cila bashkëngjitur ka: Udhëzimin nr. 8, datë 27.07.2021 dhe kalendarin e hartimit të Projektbuxhetit të vitit 2022. Raportet standarde të evidentimit të treguesve të vitit 2020, 2021 dhe treguesve të projektbuxhetit të vitit 2022, parashikimet për prokurime, së bashku me objektivat strategjike afatmesme dhe objektiva të veçanta për aktivitetin ekonomik-financiar të vitit 2022. Gjithashtu u konstatua se, në vijim të shkresës së nxjerrë nga ISSH për fillimin e procesit të përgatitjes së projekt buxhetit Drejtoritë Rajonale dërgojnë në ISSH programimin përkatës,

(marrë si shembull: Shkresa nr. 7426/1 prot. datë 13.08.2021, òProjekt buxheti 2022ò lidhur me hartimin e treguesve të buxhetit të vitit 2022), pasi shikohen programimet e DRSSH-ve, ekipi i menaxhimit përgatit programimi e PBA-së për vitin 2022-2024, të cilin e kanë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 5314/1 datë 25.08.2021.

Rekomandimi i realizuar

2.1-Rekomandimi:ISSH në bashkëpunim me MFE të ndërmarrin masat e nevojshme për mbledhjen dhe sistemimin e borxheve të subjekteve buxhetore dhe krahas tyre të marrin masat për sistemimin e kontributeve individuale në llogaritë e periudhave të sigurimit.

Brenda vitit 2021

✓ Nga auditimi konstatohet se, në zbatim të këtij rekomandimi Drejtori i Përgjithshëm i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve me: shkresën nr. 5731 prot., datë 17.09.2021 òMbi subjektet me detyrime të prapambetura në përgjegjësi të organeve tatimoreò ku theksohet shqetësimi i krijuar nga rritja e numrit të subjekteve me detyrime të prapambetura si dhe vlera e lartë e këtyre detyrimeve që mbartin këto subjekte. Në të theksohet se kjo rritje e numrit të subjekteve debitorë dhe detyrimeve të prapambetura të tyre, si rrjedhojë e mos pagesës së detyrimeve dhe kohës që kalon nga momenti i krijimit të detyrimit, ekspozon jo vetëm problematikën e një mungese të konsiderueshme fondesh, por shfaq gjithashtu edhe një problem të madh social, në fushën e përfitimeve nga ligji i sigurimeve shoqërore.

Gjithashtu shqetësimi i mësipërm i është transmetuar edhe një herë Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve me shkresën nr. 7705 prot, datë 07.12.2021 drejtuar DPT òMbi gjendjen e detyrimeve të subjekteve për kontribute, të papaguara dhe problemet shqetësuese.

Rekomandimi i realizuar

2.2-Rekomandimi: Nga ana e ISSH me qëllim për të zgjidhur problematikën e krijuar ndaj individëve të punësuar në subjekte juridike e që rezultojnë me detyrime kontributeve të papaguara, si dhe për të zgjidhur problematikat e shfaqura në mosnjohjen e periudhave të sigurimit, të punëmarrësve, subjektet e të cilëve kanë detyrime kontributeve, të ndërmarrë të gjitha masat procedurale administrative, duke përfshirë përsa është e mundur dhe e nevojshme inicimin e ndryshimeve ligjore të kërkuara për këtë qëllim.

Brenda vitit 2021

✓ Nga auditimi konstatohet se, në zbatim të këtij rekomandimi Drejtori i Përgjithshëm i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve me: shkresën nr. 1864 prot, datë 16.03.2021 òMbi dërgimin e listë pagesave formatit elektronikò, në të cilën theksohet se problematikat si mungesa e listëpagesave të cilat duhet të jenë edhe të kontrolluara dhe të vlerësuar në drejtim të respektimit të pagës minimale apo maksimale, përqindjes së derdhjes së kontributeve, etj., sepse sjellin vonesa të konsiderueshme në krijimin e një historiku të plotë kontributiv individual për çdo kontribuues dhe si pasojë në lëshimin e vërtetimeve. Bashkëngjitur saj është shkresa nr. 5192, datë 06.06.2017 òPër lëshimin e vërtetimeve për kontributet e paguara për personat e punësuar dhe të vetëpunësuarò.

Gjithashtu problematika janë dërguar DPT edhe me shkresat nr. 5331 prot, datë 25.08.2021 òMbi problematikën e konstatuar për ish punonjësit e DARò dhe shkresën nr. 5331/3 prot, datë 29.10.2021, drejtuar DPT òMbi dërgimin e listëpagesave të formatit elektronikò.

Rekomandimi i realizuar

3.1 Rekomandimi: Nga ISSH të merren masat e nevojshme për uljen e deficitit të skemës së fshatit si dhe të barrës kontributeve të buxhetit të shtetit për këtë skemë, duke rritur numrin e kontribuuesve bujq, si dhe të vazhdohet realizimi i inicimit të ndryshimeve të nevojshme në ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 òPër Sigurimet Shoqërore në RSHò, i ndryshuar, me qëllim që në

të të parashikohet mundësia, që nëse një bujk dëshiron të përfitojë një pension më të lartë të ketë mundësinë e pagimit të një kontributi të përllogaritur mbi bazën e një page më të lartë.

✓ Nga auditimi konstatohet se, në zbatim të këtij rekomandimi Drejtori i Përgjithshëm i është drejtuar me shkresën nr. 7161 prot, datë 15.11.2021 të gjitha DRSSH-ve në lidhje me zbatimin e planit të masave për rritjen e numrit të kontribuuesve dhe të ardhurave për të vetëpunësuarit në bujqësi kjo dhe në zbatim të rekomandimeve të KLSH.

Rekomandimi i realizuar

4.1 Rekomandimi: ISSH të intensifikojë bashkëpunim me BKT dhe INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA të cilat kanë 90 % të pensioneve që paguhen në banka off-line, me qëllim finalizimin e automatizimit të sistemit të pagesave të pensioneve nga këto banka (kalimin on-line), duke synuar eliminimin e pagesave të dubluara.

Brenda vitit 2021

✓ Nga auditimi konstatohet se, në zbatim të këtij rekomandimi Drejtori i Përgjithshëm i është drejtuar bankave të nivelit dytë që, dërgimi i listëpagesave të pensioneve të cilat janë off line të mundësohet kalimi i tyre on line. Gjithashtu janë bërë takime direkt me përfaqësues të bankës Intesa SanPaolo më datë 12.10.2021, si dhe me BKT më datë 13.10.2021. Vazhdojnë shkëmbimet për anën teknike me qëllim finalizimin e automatizimit të sistemit të pagesave të pensioneve nga këto banka.

Rekomandimi i realizuar

5.1. Rekomandimi: ISSH të zhvillojë një program informatik, nëpërmjet të cilit të mundësojë krijimin e bazës së të dhënave për personat tË vetëpunësuar të vetëm, duke përdorur informacionin e marrë zyrtarisht nga DPT, me synim zgjidhje në mbi 80% të rasteve, për këtë kategori personash, që rezultojnë me liste pagesa të munguara. Për personat tË vetëpunësuar që kanë edhe të punësuar të tjerë, që rezultojnë të kenë derdhur kontribute, ISSH të marrë masa që të kryejë njoftime dhe në rastet pa adresë të bëjë fushatë sensibilizimi, me qëllim maksimizimin e grumbullimit të listë pagesave për këtë kategori.

Brenda vitit 2021

✓ Nga auditimi konstatohet se, në zbatim të këtij rekomandimi Drejtori i Përgjithshëm i është drejtuar me shkresë DRSSH-ve dhe Drejtorisë Arkivit Qendror për njoftimin e subjekteve buxhetore dhe jo buxhetore, në lidhje me detyrimin ligjor për të dorëzuar listëpagesat e munguara, konkretisht me shkresën nr. 6804 prot, datë 03.11.2021, në zbatim të shkresës nr. 2835 prot, datë 13.04.2018 për grumbullimin dhe arkivimin në arkivat e sigurimeve shoqërore të listëpagesave të munguara të institucioneve buxhetore, si dhe për plotësimin e vërtetimit për bazën e vlerësuar për efekt pensioni. Gjithashtu, është komunikuar me AKSHI-n për mundësinë e kalimit të dhënave nga formati Excel në CMIS. Listëpagesat e të vetëpunësuarve të vetëm të marra nga DPT, janë migruar në CMIS (në databasën e sistemit, nga stafi i Drejtorisë së Burimeve të Informacionit), duhet një vendimmarrje për mënyrën si duhet të shfaqen pasi këto listëpagesa nuk kanë individë (NID personi), por NIPT të subjekteve dhe periudhat janë 3 mujore sipas pagesës së bërë në DP.

Rekomandimi në proces për të mundësuar përfundimin e tij në bashkëpunim me DPT.

6.1. Rekomandimi: Strukturat përgjegjëse në ISSH, me synim arritjen e objektivave të strategjisë kombëtare, në drejtim të skemës së pensioneve të qytetit, të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme përmbushjen e indikatorëve të vendosur në plan veprimin e zbatimit të strategjisë afatmesme, me synim minimizimin e risqeve, që vënë në rrezik përmbushjen e indikatorëve të vendosur me fokus, rritjen e qëndrueshmërisë financiare dhe reduktimin e deficitit të skemës së pensioneve duke synuar rritjen graduale, por më të shpejtë të kontributeve në krahasim me rritjen e përfitimeve si dhe duke minimizuar subvencionet buxhetore.

Brenda vitit 2021

- ✓ Nga auditimi konstatohet se, në zbatim të këtij rekomandimi Drejtori i Përgjithshëm i është drejtuar të gjitha DRSSH-ve për ndjekje të vazhduar të indikatorëve dhe raportim periodik për vlerësim pranë Këshillit Administrativ të ISSH-së, me shkresën nr. 7161 prot, datë 15.11.2021 të zbatimit të veprimit dhe programit të masave për të vetëpunësuarit në bujqësi, si një shqetësim për rritjen e numrit të kontribuuesve dhe të ardhurave në këtë fushë dhe monitorimin e hedhjes së rekordeve në sistemin CMIS e transferimin e tyre në historikun kontributiv për të vetëpunësuarit në bujqësi. *Rekomandimi i realizuar*

7.1. Rekomandimi: ISSH të ndërmarrë të gjitha masat procedurale administrative me qëllim arkëtimin e fondeve të dëmtuara nga pagesat e pensioneve të kryera pas vdekjes së përfituesve me autorizim ose prokurë. *Brenda vitit 2021*

- ✓ Nga auditimi konstatohet se në zbatim të këtij rekomandimi Drejtori i Përgjithshëm bazuar në marrëveshjen me Postën Shqiptare sha, lidhur me nr. 3341, datë 12.06.2014 ku çdo Drejtori Rajonale, për të gjitha shkeljet e konstatuara nga këto kontrole sistematike i evidenton me dokumentacionin përkatës dhe në rastet e dëmtimit të fondeve ato janë mbajtur konform dispozitave ligjore. Për masën dhe natyrën e dëmtimit të fondeve, Posta Shqiptare sh.a është informuar në mënyrë të vazhdueshme me shkrim, duke përcaktuar edhe përgjegjësit për secilën zyrë postare e sidomos për rastet e përsëritura. *Rekomandimi në proces*

8.1. Rekomandimi: Njësia e Inspektimit të Përfitimeve, me qëllim administrimin me efektivitet të fondeve të pensioneve të marrë masa, që planifikimi i inspektimeve të kryhet brenda një viti nga data e lidhjes së pensioneve dhe të përfundojë inspektimin e certifikimin e dosjeve të lidhura nga viti 2017 e në vazhdim. *Brenda vitit 2021*

- ✓ Nga auditimi konstatohet se, në zbatim të këtij rekomandimi Drejtori i Përgjithshëm ka hartuar Programet e Inspektimit në bazë të Programit Vjetor të miratuar, si më poshtë:
 - Programi Vjetor i miratuar nr. 405 prot, datë 10.01.2021 e në vijim:
 - Nga Sektori i Inspektimit të Përfitimeve Afatgjata:
 - Program Inspektimi nr. 433 prot, datë 19.01.2021.
 - Program Inspektimi nr. 434 prot, datë 19.01.2021.
 - Program Inspektimi nr. 3890 prot, datë 19.01.2021.
 - Programi nr.4569 prot, datë 14.07.2021
 - Programi nr.5350 prot, datë 27.08.2021
 - Programi nr.6090 prot, datë 04.10.2021
 - Programi nr.7095 prot, datë 12.11.2021
 - Programi për DRSSH Tiranë miratohet, bazuar në Programin Vjetor.
 - Nga Sektori i Inspektimit të Përfitimeve Suplementare:
 - Programi nr.432 prot, datë 19.01.2021
 - Programi nr.2293 prot, datë 02.04.2021
 - Programi nr.3964 prot, datë 21.06.2021
 - Programi nr.6360 prot, datë 15.10.2021

Rekomandimi i realizuar

9.1. Rekomandimi: ISSH të marrë masa të fillojë procesin e arkëtimin për 11 përfitues në vlerën 1,990,346 lekë si dhe të ndjekë në vazhdimësi procesin e arkëtimin për 81 përfitues në vlerën e mbetur 20,668,185 lekë.

Në zbatim të këtij rekomandimi janë marrë masat nga Drejtoritë Rajonale për arkëtimin e të gjithë debitorëve e cila është detyrë funksionale e tyre, të cilat janë të verifikueshme në kartelat personale të pensionistëve, të hedhura në sistem. *Rekomandimi i realizuar*

10.1. Rekomandimi: ISSH nëpërmjet Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve të rekomandojë marrjen e masave disiplinore në raport me mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, duke zbatuar të njëjtin standard për çdo subjekt të inspektuar, gjithashtu të identifikojë Inspektorët e të vetëpunësuarve në bujqësi për shkeljet dhe mangësitë e konstatuara në dosjet e përfitimit.

Brenda vitit 2021

✓ Nga auditimi konstatohet se, gjatë inspektimeve të kryera në vitin 2021 janë dhënë një sërë masash disiplinore për mangësitë e konstatuara nga sigurimi i të vetëpunësuarve në bujqësi, të cilat kanë sjellë për pasojë rishqyrtime të përfitimeve dhe kanë gjetur zgjidhjen, me miratimin e VKM-së nr. 660, datë 10.10.2019 e konkretisht:

- me shkresën nr. 433/5 prot., datë 01.10.2021, janë dhënë 4 masa administrative në DRSSH Elbasan.
- me shkresën nr. 434/4 prot., datë 12.10.2021, janë dhënë 6 masa administrative në DRSSH Durrës.

Rekomandimi i realizuar në bazë të inspektimeve dhe në vijimësi të aktivitetit të DRSSH-ve.

11.1. Rekomandimi: ISSH të marrë masa për të bërë ndryshime në rregulloret, mbi bazën e të cilave ushtron veprimtarinë e saj, duke përcaktuar qartësisht afatet e procedurave të inspektimit, nga përfundimi i inspektimit në terren deri tek evadimi i materialeve të inspektimit, afatin për raportimin periodik nga çdo inspektor dhe Përgjegjësi i Sektorit. Gjithashtu të bëjë ndryshimet përkatëse në ÒRregulloren për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, me qëllim shmangien e mbivendosjes së kompetencave ndërmjet Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm dhe Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve.

Brenda vitit 2021

✓ Nga të dhënat konstatohet së është përfunduar hartimi i rregullores për funksionimin e Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve dhe do të kalojë për miratim në Këshillin Administrativ, ndërsa rregulloret e evadimit të materialeve të inspektimit dhe rregullorja e përgjithshme e ISSH janë në procesin e përpunimit përfundimtar.

Rekomandimi i realizuar pjesërisht

12.1. Rekomandimi: ISSH të marrë masa për menaxhimin me efektivitet të burimeve njerëzore në dispozicion, sipas përcaktimeve të bëra në ÒRregulloren për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Gjithashtu ISSH duhet të marrë masa të shtojë burimet njerëzore për këtë Njësi, me qëllim inspektimin dhe certifikimin e pensioneve të përfituara brenda afatit ligjor 3 vjeçar, si dhe shmangien e efekteve financiare për ISSH dhe buxhetin e shtetit për shkak të tejkalimit të këtij afati për kërkimin e tepricave të përfituara padrejtësisht nga përfituesit.

Në vijimësi

✓ Në zbatim të këtij rekomandimi janë organizuar disa programe inspektimi me qëllim vlerësimin e certifikimit të pensioneve të përfituara brenda afatit ligjor e konkretisht:

- Program Inspektimi nr. 433 prot, datë 19.01.2021;
- Program Inspektimi nr. 1366 prot, datë 23.02.2021;
- Urdhër nr. 5611 prot, datë 10.09.2021;
- Program Inspektimi nr. 434 prot, datë 19.01.2021;
- Shkresë nr. 1366 prot, datë 23.02.2021;
- Urdhër nr. 5612 prot, datë 10.09.2021;
- Program Inspektimi nr. 8022 prot, datë 21.12.2021;
- Program Inspektimi nr. 3890 prot, datë 17.06. 2021;
- Urdhër nr. 9 prot, datë 06.10.2021;

- Program Inspektimi nr. 6060 prot, datë 04.10.2021;
- Shtesë Program Inspektimi nr. 6090 prot, datë 08.11.2021.

Rekomandimi i realizuar

13.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike në ISSH në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në DRSSH të hartojnë një databazë të plotë të vendimeve gjyqësore, për ndjekjen dhe ecurinë e tyre për të gjitha shkallët e gjyqësorit, për t'i mundësuar menaxhimit monitorimin, analizën dhe vlerësimin e ecurisë së proceseve në tërësinë e tyre.

- ✓ Në zbatim të këtij rekomandimi janë marrë masat përkatëse për ndjekjen e procedurave gjyqësore, i është kërkuar për t'ia patur në vëmendje të gjitha DRSSH-ve, si dhe Drejtorisë së Arkivit Qendror Lundër, me shkresën nr. 635 prot, datë 27.01.2021, òMbi ndjekjen e procedurave gjyqësore. Gjithashtu me shkresën nr. 6393/1, datë 23.10.2021, Drejtoria Juridike në ISSH i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm me òInformacionin lidhur me trajnimin e zhvilluar nga Drejtoria Juridike për rritjen e performancës së juristëve në ndjekje të procedurave gjyqësore ku ndërmjet të tjerave në pikën 4 të saj është sqaruar edhe mbajtja e regjistrit të ri si databazë e plotë e vendimeve gjyqësore në referim të rekomandimit të KLSH. Regjistri është hartuar në formatin Excel me 15 rubrika.

Rekomandimi i realizuar

13.2. Rekomandimi: Drejtoria Juridike në ISSH në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në DRSSH të evidentojë shpenzimet e vendimeve gjyqësore, duke mbajtur evidence dhe të dhëna analitike për çdo DRSSH për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për rastet e vendimeve që janë ekzekutuar me përmbarim vullnetarisht apo ekzekutim të detyrueshëm, ndjekjen dhe raportimin e tyre, si dhe të marrë masa për zbatimin e afateve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke shmangur rritjen e shpenzimeve përmbarimore.

- ✓ Në zbatim të këtij rekomandimi janë marrë masat përkatëse, sipas shkresës së Drejtorisë Juridike drejtuar DRSSH me nr. 636 prot, datë 27.01.2021 òMbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë”; gjithashtu janë marrë edhe disa masa e konkretisht:
 - Me shkresën nr. 2249, datë 31.03.2021, òPër shtesa dhe ndryshime në planin e shpenzimeve administrative të vitit 2021;
 - Me shkresën nr. 2249/2 prot, datë 04.05.2021; “Program kontrolliò;
 - Me shkresën nr. 2249/5 prot, datë 26.07.2021, “Rekomandime në zbatim të programit të kontrollitò;

-Me shkresën nr. 6318 prot, datë 13.10.2021 òKërkesë drejtuar gjykatës administrative për komunikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. *Rekomandimi i realizuar*

-14.1. Rekomandimi: ISSH të marrë masa të menjëhershme për përcaktimin e strukturës përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollin e zbatimit të procedurave ligjore dhe tërheqjen e ankimimeve në proceset gjyqësore në rastin e zbatimit të VKM nr. 482, datë 29.06.2016 òPër disa çështje të dokumentimit të periudhave të sigurimit dhe vjetërsisë në punë, për efekt pensioniò; VKM nr. 660, datë 10.10.2019 òPër disa shtesa në vendimin nr. 77, datë 28.01.2015, të Këshillit të Ministrave òPër kontributet e detyrueshme dhe përfitimit nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësorò të ndryshuar; VKM nr. 657, datë 10.10.2019, òPër disa shtesa në Vendimin nr. 793, datë 24.09.2010, të Këshillit të Ministrave -Për zbatimin e ligjit nr.10142, datë 15.05.2009 òPër sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura”.

- Në zbatim të këtij rekomandimi janë marrë masa që Drejtoria e Auditit të Brendshëm të kryejë edhe auditimin e veprimtarisë së zyrave juridike si dhe monitorimin e kontrollin e zbatimit të procedurave ligjore dhe tërheqjen e ankimimeve në proceset gjyqësore në rastin e zbatimit të procedurave ligjore në zbatim të VKM nr. 482, datë 29.06.2016 òPër disa çështje të dokumentimit të periudhave të sigurimit dhe vjetërsisë në punë për efekt

pensionit, zbatimit të VKM nr. 660, datë 10.10.2019 dhe VKM nr. 657, datë 10.01.2019 duke i përfshirë në angazhimet audituese si çështje të veçanta. Për sa më sipër konstatohet se, në programet e auditimit për Drejtoritë Rajonale është mundësuar përfshirja e zbatimit nga ana e tyre e VKM nr. 482, datë 29.06.2016, konkretisht në programet e auditimit për:

- DRSSH Vlorë nr. 5395 datë 01.09.2021;
- DRSSH Sarandë nr. 5395 datë 01.09.2021;
- DRSSH Gjirokastrë nr. 6126 datë 06.10.2021;
- DRSSH Fier nr. 7096 datë 12.11.2021.

Rekomandimi i realizuar

15.1. Rekomandimi: ISSH të marrë masa për të finalizuar procesin e rishikimit të përmbajtjes së Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të saj, në lidhje me përcaktimin e statusit organizativ të strukturës së DAB, detyrat, përgjegjësitë dhe kushtet e posaçme për punësim në njësinë e auditimit të brendshëm si për drejtuesin e njësisë dhe audituesit e brendshëm, si dhe mos përfshirjen e DAB në veprimtari operacionale me qëllim mos cënimin e objektivitetit, kompetencën dhe paañsinë e audituesve.

Menjëherë dhe në vijimësi

✓ Në zbatim të këtij rekomandimi nga Drejtori i Përgjithshëm janë marrë masa për ngritjen e grupit të punës dhe për miratimin e ndryshimeve të rregullores së datës 15.03.2018, e konkretisht me nr.7410 datë 23.11.2021. Gjithashtu, grupi i punës ka paraqitur ndryshimet përkatëse të cilat kanë marrë formë me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 50, datë 05.01.2022 për miratimin e ndryshimeve në rregulloren organizative të përgjithshme të ISSH në lidhje me përcaktimin organizativ të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, detyrat, përgjegjësitë dhe kushtet për punësim.

Rekomandimi i realizuar

15.2. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i ISSH të marrë masa, që të shmangë vonesat dhe të kërkojë nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në ushtrimin e veprimtarisë, të respektojë dhe ti përmbahet kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, në drejtim të respektimit të afateve të hartimit të dokumenteve të auditimit dhe përcjelljes së tyre në subjekt, përkatësisht projektraportit dhe raportit përfundimtar të auditimit.

Në zbatim të këtij rekomandimi nga Drejtori i Përgjithshëm janë marrë masa për dërgimin në kohë të projekt raporteve dhe raporteve në subjektet e audituar, e konkretisht në:

- DRSSH Vlorë janë dërguar me shkresat nr. 5395/2 datë 08.10.2021 dhe nr. 5395/4 datë 27.10.2021;
- DRSSH Sarandë janë dërguar me shkresat nr. 5395/1 datë 07.10.2021 dhe nr. 5395/6 datë 08.11.2021;
- DRSSH Gjirokastrë janë dërguar me shkresat nr. 6126/1 datë 17.11.2021 dhe nr. 6126/2 datë 20.12.2021.

Rekomandimi i realizuar

16.1. Rekomandimi: ISSH të marrë të gjitha masat, që për çdo procedurë prokurimi me vlerë të vogël, të argumentohet hartimi i fondit limit, hartimi i kriterëve për kualifikim, të administrohet procesverbali për marrjen në dorëzim të mallit, të punëve apo shërbimeve, procesverbali konstatues paraprak për ato rastet kur nevojitet, ngritja e grupeve për marrjen në dorëzim të punëve, mallrave apo shërbimeve të përbërë nga punonjës kompetent dhe me njohuri sipas fushave përkatëse të procedurave të zhvilluara; të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP, duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre sipas kriterëve të përcaktuara në ftesën për ofertë. *Në vazhdimësi*

✓ Në zbatim të këtij rekomandimi nga Drejtori i Përgjithshëm janë marrë masat përkatëse duke urdhëruar ngritjen e Komisionit për pranimit e artikujve të prokuruar me Urdhërin nr. 6657 prot, datë 27.10.2021 për krijimin e Komisionit për pranimin e artikujve të prokuruar me procedurën e prokurimit me vlerë të vogël.

Rekomandimi i realizuar

17.1. Rekomandimi: ISSH të marrë të gjitha masat dhe të ketë në konsideratë që, për çdo procedurë prokurimi që zhvillon, të përcaktojë nevojën për punë, shërbime dhe mallra si dhe të

bëjë argumentimin e fondit limit bazuar në dokumentacion justifikues. Gjithashtu në vlerësimin e procedurave të prokurimit dhe dokumentacionit të Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës, të shqyrtojë dhe vlerësojë secilin prej dokumenteve të ngarkuara në SEP, duke krahasuar pajtueshmërinë e tyre, sipas kriterëve të përcaktuara në DST, më tej të vijoj me shpalljen fitues të ofertës më të favorshme ekonomike.

✓ Në zbatim të këtij rekomandimi, nga Drejtori i Përgjithshëm janë marrë masat duke nxjerrë urdhrat përkatës për ndjekjen e procedurave në përgatitjen e termave të referencës dhe zbatimin e procedurave ligjore e konkretisht:

- Urdhër nr. 3784, datë 02.07.2020, òPër ngritjen e grupit të punës për rishikimin e rregullores organizative të përgjithshme të ISSH dhe për hartimin e rregullores së re të personelit dhe organizimit të detyrave funksionale;
- Urdhër nr. 2115, datë 15.03.2018;
- Urdhër nr. 133, datë 07.01.2021, òPër krijimin e komisionit mbi hartimin e Termave të referencës për sigurimin e aseteve të ISSH-së, DAQ-Lundër, DRSSH-ve dhe ALSSH-ve përkatëse për një periudhë një vjeçare.

Rekomandimi i realizuar

17.2. Rekomandimi: ISSH të marrë masa të analizojë rast pas rasti mangësitë e konstatuara në procedurat e prokurimit, të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të iniciojë kontrolle për respektimin e procedurave.

✓ Në zbatim të këtij rekomandimi nga Drejtori i Përgjithshëm janë marrë masa, për të evidentuar mangësitë në procedurat e prokurimit, gjë e cila edhe do të auditohet në vijimësi.

Rekomandimi do të realizohet në vijimësi

18.1. Rekomandimi: ISSH të marrë të gjithë masat, që në përlllogaritjen e nevojave për karburant të bazohet në dokumentacion justifikues, tabelën e konsumit të karburantit, procesverbalin për përlllogaritjen e normës së harxhimit të karburantit për çdo automjet dhe pajisje të mbajtur nga komisioni përkatës.

✓ Në zbatim të këtij rekomandimi nga Drejtori i Përgjithshëm janë marrë masa dhe është nxjerrë urdhër i brendshëm për Drejtorinë e Administrimit me qëllim përmirësimin e veprimtarisë së menaxhimit të karburantit e konkretisht:

- Urdhër i Brendshëm, nr. 3536 prot, datë 02.06.2021 òPër ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e gjendjes teknike të automjeteve dhe përcaktimin e normativës së sasisë së karburantit që harxhohet nga automjeti për 100 km për automjetet në pronësi të ISSH, grupi i përbërë nga M. T. K/Grupi, V. S., T. E., S. K. dhe P. Z. anëtar;
- Urdhër nr. 1855 prot, datë 08.03.2019 òPër të përcaktuar konsumin e harxhimit të karburantit për automjetet e ISSH për vitin 2019, të ngrihet komisioni i përbërë nga punonjësit E P, F N, T E, S K dhe B. D.

Për sa më sipër në dokumentacionin e paraqitur konstatohet se ka procesverbale mbi sasinë e karburantit që ato harxhojnë për 100 km.

Rekomandimi realizuar pjesërisht dhe për këtë është mbajtur një akt më vete sepse procedurat e llogaritjes dhe shpenzimit të karburantit vazhdojnë të mos jenë plotësisht konform legjislacionit për vitin 2021.

19.1. Rekomandimi: ISSH të marrë të gjitha masat dhe të ketë në konsideratë, që për çdo procedurë prokurimi që zhvillon, kriteret e veçanta për kualifikim ti argumentojë në një procesverbal dhe ti justifikojë ato me volumet dhe natyrën e punëve të kërkuara, në mënyrë që të krijojë një pjesëmarrje të gjerë të operatorëve ekonomikë

Në zbatim të këtij rekomandimi janë marrë masat për zbatimin e ligjit nr. 162/2020 òPër Prokurimin Publik si dhe është nxjerrë Urdhër për Krijimin e Komisionit, të prokurimit publik me nr. 398, datë 18.01.2021.

Rekomandimi realizohet në vijimësi kjo konfirmuar edhe gjatë auditimit të procedurave të prokurimit.

20.1. Rekomandimi: ISSH të marrë masa, për amendimin e Rregullores dhe miratimin e saj me VKA, me qëllim përmirësimin në lidhje me organizimin dhe funksionimin e strukturës organizative të ISSH, për t'iu përgjigjur strukturës aktuale organizative, duke patur në konsideratë dhe ndryshimet ligjore për struktura të veçanta. Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm të marrë masa për mbikëqyrjen e Rregullores dhe implementimin e saj në ISSH, sipas përcaktimeve dhe kuadrit ligjor në fuqi.

- ✓ Në zbatim të këtij rekomandimi konstatohet se është miratuar rregullore me vendimin nr. 5 datë 14.08.2020 e cila ka hyrë në fuqi më datë 01.10.2020, gjithashtu ka vijuar puna për përmirësimin e saj me Urdhër nr. 3784 prot, datë 02.07.2020 òPër ngritjen e grupit të punës për rishikimin e Rregullores Organizative të Përgjithshme dhe për hartimin e Rregullores së re të Personelit dhe organizimin e detyrave funksionale, si dhe Urdhër nr. 4741/1 prot, datë 30.09.2020.

Rekomandimi pjesërisht i realizuar

21.1. Rekomandimi: Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve në bashkëpunim me strukturat drejtuese të ISSH të marrin masa për plotësimin e vendeve të lira të punës me staf të kualifikuar dhe në përputhje me strukturën organizative, si dhe përfshirjen në trajnime të gjithë personelit të ISSH-s dhe DRSSH-ve, me qëllim mbështetjen dhe rritjen e kapaciteteve profesionale.

- ✓ Në zbatim të këtij rekomandimi konstatohet se, është miratuar me vendimin nr. 5 datë 14.08.2020 dhe ka hyrë në fuqi më datë 01.10.2020 rregullore si dhe hartuar Urdhër nr. 3784 prot, dt.02.07.2020 òPër ngritjen e grupit të punës për rishikimin e Rregullores Organizative të Përgjithshme dhe për hartimin e Rregullores së re të Personelit dhe organizimin e detyrave funksionale, gjithashtu me Urdhër nr. 4741/1 prot, datë 30.09.2020. Për trajnimet është hartuar programi i tyre sipas shkresës nr. 3695 prot, datë 09.06.2021, për programin e aktiviteteve trajnuese për punonjësit e sistemit të sigurimeve shoqërore përgjatë vitit 2021. Ndërsa konstatohet se njoftimet e punësimit janë të publikuara në faqen web të institucionit.

Rekomandimi i realizuar

22.1. Rekomandimi: ISSH të marrë masa që të krijojë kushte, që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Këshillit Administrativ të sigurohet zbatimi i rregullave në zhvillimin e mbledhjeve me qëllim ushtrimin e kompetencave në zbatimin e detyrave e përgjegjësitë e tij, për shmangien e parregullsive të konstatuara, me qëllim përmirësimin e aktivitetit të tij.

- ✓ Në zbatim të këtij rekomandimi janë marrë masat për ndjekjen e procedurave, rregulloreve dhe legjislacionit në fuqi, në lidhje me funksionimin e Këshillit Administrativ. Me urdhrin nr. 7513 Titullari i Institucionit ka komanduar sekretaren e Këshillit Administrativ.

Rekomandimi i realizuar

Titulli i gjetjes: Zbatimi i rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.

Situata: ISSH ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor prej 20 ditëve, gjithashtu nga institucioni nuk ka patur kundërshtime për rekomandimet e KLSH, si dhe janë përcaktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet përkatëse, pra janë pranuar të gjitha rekomandimet.

-ISSH ka përgatitur programin e masave që do të merren dhe realizohen për zbatimin e rekomandimeve ku janë përcaktuar afatet, personat apo drejtoritë përgjegjëse si dhe janë nxjerrë shkresat përkatëse për zbatim. Ky program masash është dërguar në KLSH me shkresën nr. 468/7, datë 22.10.2021, òDërgohet programi i masave në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, dërguar me shkresën nr. 95/9, datë 24.09.2021 òDërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Ri-Auditimin e përputhshmërisë në Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

-Gjithashtu, në zbatim të afatit ligjor të përcaktuar në pikën nr. 2, neni 30,

të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 *ËPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, e cila citon: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna."* nga ana e ISSH nuk është mundësuar sepse nuk janë përmbushur afatet, si dhe për realizimin e rekomandimeve është mbajtur akt i veçantë në zbatim të programit auditimit.

- Në total janë rekomanduar 27 masa organizative, të cilat janë pranuar nga ISSH dhe nga auditimi rezulton: *janë realizuar 19 masa dhe janë në procesin e realizimit në vijimësi 8 masa organizative.*

Kriteri:	Ligji nr. 154, datë 27.11.2014 <i>ËPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.</i>
Ndikimi/Efekti:	Përmirësimi e funksionimit ekonomik dhe mirë menaxhimin financiar të fondeve publike.
Shkaku:	Mungesëpërgjegjësie në zbatimin e rekomandimeve nga strukturat drejtuese të ISSH.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	Këshilli Administrativ të shqyrtojë dhe të analizojë në veçanti zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm, duke nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin dhe/ose mosrealizimin në afat, si dhe të marrë masa që të sigurojë zbatimin e plotë të tyre.

3.7 Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

- Mbi administrimin e automjeteve dhe konsumit të karburantit

Në administrimin e mjeteve në ISSH konstatohet se mbështetur në dispozitat e ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009 *ËPër rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe punonjësit civilë;* në VKM nr. 1242, datë 16.12.2009, *ËPër zbatimin e ligjit 10160, datë 15.10.2009,* dhe shkresës së Ministrisë së Financave lidhur me numrin e automjeteve të ISSH, komisioni i ngritur me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH nr. 4798, datë 07.09.2010, nisur nga gjendja teknike e automjeteve në përdorim të ISSH dhe njërive në vartësi të tij u lanë në përdorim vetëm 17 automjete nga të cilat:

- 5 automjete në përdorim të ISSH
- 12 të tjera në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, me parimin nga një mjet për çdo DRSSH.

Në kuadër të zbatimit të këtij ligji u suprimua pozicioni i shoferëve duke u shkurtuar si vend pune në të gjitha DRSSH-të, ndërsa në ISSH u ruajtën vetëm dy pozicione pune shoferë në shërbim të nevojave të administratës.

Si pasojë e kufizimit të përcaktuar, të numrit të shoferëve, sipas strategjisë së Këshillit të Ministrave *ËPër rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe punonjësit civilë,* 5 automjetet në përdorim të ISSH-së, përdoren sipas nevojave nga dy shoferë dhe nga punonjës të tjerë sipas autorizimit të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm i ISSH.

Për sa sipër konstatohet se: në këtë institucion menaxhimi i këtyre automjeteve bazohet në Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2000 *ËPër programimin, evidentimin dhe ndjekjen e Treguesve të Transportit* si dhe Rregulloren nr. 2261, datë 19.07.2000 *ËPër funksionimin e automjeteve, detyrat e drejtuesit të automjeteve dhe detyrat e përgjegjësit të administratës në lidhje me transportin, rregullore të cilat janë shumë të vjetra për nga koha si pasojë e ndryshimeve në strukturë që kanë ndodhur në këtë institucion, si dhe nuk janë të përshtatura me:*

- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 *ËPër menaxhimin financiar dhe kontrollin e ndryshuar;*

- Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *ËPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikë i ndryshuar;*

- Rregulloren e Brendshme të ISSH nr. 2115, datë 15.03.2018 oRregullore për organizimin dhe detyrat funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSHö;

- Inventarët e mjeteve;

Drejtoria e Përgjithshme e Sigurimeve Shoqërore ka në inventarin e saj 5 mjete e konkretisht sipas targave, AA165VX, AA592PM, AA593PM, AA166VX, TR7975J të cilat sipas kartelave dhe inventarëve deri më datë 31.12.2021 janë në ngarkim të:

1. mjeti më targë AA165VX, (Ford Kuga me vit prodhimi 2018), është në ngarkim të z. T.E (shofer i institucionit)

2. mjeti më targë AA592PM, (Wolksvagen Tiguan me vit prodhimi 2016), është në ngarkim të z. T. E. (shofer i institucionit)

3. mjeti më targë AA593PM, (Wolksvagen Transportier me vit prodhimi 2016), është në ngarkim të z. T. E. (shofer i institucionit)

4. mjeti më targë AA166VX, (Ford Kuga me vit prodhimi 2016), është në ngarkim të z. S.K.i (shofer i institucionit) dhe në përdorim të z. A. A. (me detyrë Drejtor i Administrimit Përgjithshëm me autorizim nr. 258, datë 08.07.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm deri me 31.12.2020)

5. mjeti më targë TR7975J, (Fiat Doblo me vit prodhimi 2004), është në ngarkim të z. S. K. (shofer i institucionit)

• Urdhra udhëtimi, autorizime të dala për mjetet cilësuar më sipër:

1. Autorizimi nr. 344, datë 17.11.2020 ku nëpërmjet tij autorizohet punonjësi i ISSH-së z. T. E. me detyrë shofer i Drejtorit të Përgjithshëm në ISSH **të lëvizijash të fashës orare** për motive punë, pasi Instituti i Sigurimeve Shoqërore nën varësi të Ministrisë së Financave, për shkak të natyrës së punës e ka të domosdoshme lëvizjen me makinë.

1. Automjeti tip Ford Kuga me targa AA 166 VX

2. Automjeti tip Volkswagen Tiguan me targa AA 592 PM

Ky autorizim është i vlefshëm për një periudhë kohore 6 muaj nga data e lëshimit.

2. Autorizimi nr. 345, datë 17.11.2020 ku nëpërmjet tij autorizohet punonjësi i ISSH-së z. A. A. me detyrë Drejtor i Administrimit të Përgjithshëm në ISSH **të lëvizijash të fashës orare** për motive pune, pasi Instituti i Sigurimeve Shoqërore nën varësi të Ministrisë së Financave, për shkak të natyrës së punës e ka të domosdoshme lëvizjen me makinë.

1. Automjeti tip Ford Kuga me targa AA 166 VX

Ky autorizim është i vlefshëm për një periudhë kohore 6 muaj nga data e lëshimit.

3. Autorizimi nr. 347, datë 17.11.2020 ku nëpërmjet tij autorizohet punonjësi i ISSH-së z. S. K. me detyrë shofer i Administratës në ISSH **të lëvizijash të fashës orare** për motive punë, pasi Instituti i Sigurimeve Shoqërore nën varësi të Ministrisë së Financave, për shkak të natyrës së punës e ka të domosdoshme lëvizjen me makinë.

1. Automjeti tip Fiat me targa TR 7975 J

Ky autorizim është i vlefshëm për një periudhë kohore 6 muaj nga data e lëshimit.

4. Autorizimi nr. 258, datë 08.07.2020 ku nëpërmjet tij autorizohet z. A. A. Drejtor i Administrimit të Përgjithshëm në ISSH **të përdorë automjetin** tip Ford në pronësi të ISSH me targa AA 166 VX për nevoja pune. Ky autorizim është i vlefshëm deri më datë 31.12.2020.

5. Autorizimi nr. 52, datë 12.03.2020 ku nëpërmjet tij autorizohet automjeti tip Volkswagen Tiguan me targa AA 592 PM **të drejtohet** nga shoferi i Drejtorit të Përgjithshëm. z. T. E. dhe të qarkullojë për arsye pune. Autorizimi është i vlefshëm prej datës 12.03.2020 deri në një autorizim të dytë. (nënshkruar nga znj. R. M. Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm)

6. Autorizimi nr. 55, datë 12.03.2020 ku nëpërmjet tij autorizohet automjeti tip Ford Kuga me targa AA 166 VX **të drejtohet** nga shoferi i Drejtorit të Administrimit të Përgjithshëm z. S. K. dhe të qarkullojë për arsye pune. Autorizimi është i vlefshëm prej

datës 12.03.2020 deri në një autorizim të dytë. (nënshkruar nga znj. R. M. Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm)

7. Autorizimi nr. 18, datë 28.01.2020 ku nëpërmjet tij autorizohet z. T. E. punonjësi i ISSH-së **të drejtojë automjetet** në pronësi të Instituti i Sigurimeve Shoqërore si më poshtë:

1. Automjeti tip Ford Kuga me targa AA 165 VX
2. Automjeti tip Volkswagen me targa AA 592 PM
3. Automjeti tip Volkswagen me targa AA 593 PM

Ky autorizim është i vlefshëm deri më datë 31.12.2020.

8. Autorizimi nr. 19, datë 28.01.2020 ku nëpërmjet tij autorizohet z. S. K. punonjësi i ISSH-së **të drejtojë automjetet** në pronësi të Instituti i Sigurimeve Shoqërore si më poshtë:

1. Automjeti tip Ford Kuga me targa AA 166 VX
2. Automjeti tip Fiat me targa TR 7975 J

Ky autorizim është i vlefshëm deri më datë 31.12.2020.

Për më sipër konstatohet se nga analiza e 8 (tetë) autorizimeve të mësipërme nuk ka një formulim të saktë të përcaktuar në autorizim, mbi lëvizjen, kohën cilësuar, qëllimin e saj në rastet kur mjeti do të lëvizë jashtë kohës së punës orarit zyrtar, kush duhet ta përdorë dhe kush duhet ta drejtojë atë sepse:

-në formatin e autorizimeve i cili është sipas përcaktimit në Udhëzimin Metodik nr.1, datë 12.07.2000 òPër programimin dhe ndjekjen e treguesve të transportit për të gjithë sistemin e sigurimeve shoqëroreò, gjatë vitit 2021 në të kanë firmosur edhe shoferët që kanë në ngarkim automjetet si dhe është shtuar edhe firma e pozicionit të Përgjegjës të Sektorit të Administratës;

-z. T. E. me detyrë shofer i Drejtorit të Përgjithshëm në ISSH, z. A. A. me detyrë Drejtor i Administrimit të Përgjithshëm në ISSH dhe z. S. K. me detyrë shofer i Administratës në ISSH sipas autorizimeve duhet të lëvizin jashtë fashës orare për motive pune nga data 17.11.2020 deri 17.05.2021 (pa dhënë arsyen se çfarë pune është jashtë orarit zyrtar si dhe z. A. A. i është dhënë e drejta e lëvizjes jashtë orarit me mjet por jo e përdorimit të tij sepse mjeti Ford Kuga me targa AA 166 VX është në inventar dhe në përdorim të shoferit z. S. K.);

- z.A. A. i është dhënë e drejta e përdorimit të mjetit tip Ford me targa AA 166 VX nga 08.07.2020 deri më 31.12.2020 (5 muaj) pa përcaktuar qëllimin por vetëm për nevoja pune kur mjeti është në inventar të z.S. K (shofer i institucionit). Gjithashtu autorizimi nuk është përsëritur për vitin 2021 çka do të thotë se z. A A e ka drejtuar mjetin pa autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm për vitin 2021;

- shoferëve të institucionit z. T. E dhe z. S. K. ju është dhënë e drejta të drejtojnë automjetet sipas përkatësisë për vitin 2020 kur ata i kanë në inventar këto mjete dhe autorizim duhet të jetë për drejtim dhe përdorimin sipas kohës, qëllimit për nevoja të institucionit.

- Normat e konsumit të karburantit sipas automjeteve

- a. Për vitin 2021 nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH me Urdhrin e Brendshëm, nr. 3536 prot, datë 02.06.2021 òPër ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e gjendjes teknike të automjeteve dhe përcaktimin e normativës së sasisë së karburantit që harxhohet nga automjeti për 100 km për automjetet në pronësi të ISSHò, është ngritur grupi i punës i përbërë nga

1. M. T. K/Grupi,
2. V. S. anëtare,
3. T. E.anëtar,
4. S. K. anëtar,
5. P. Z. anëtar,

Për sa më sipër konstatohet se:

- ✓ Për vitin 2020 nuk është ngritur grup pune për të përcaktuar normat e harxhimit të karburantit,

- ✓ Ngritja e grupit të punës për llogaritjen e normave të konsumit të karburantit për vitin 2021 është bërë me shumë vonesë ose duke e kaluar afatin me 5 muaj,
 - ✓ Janë hartuar procesverbalet e normave të konsumit të karburantit për disa automjete kështu:
 - nga pesë automjete vetëm për tre prej tyre janë realizuar procesverbalet e matjes së konsumit të karburantit, e konkretisht nuk janë realizuar matjet për automjetet:
 - (Wolkswagen Tiguan me vit prodhimi 2016),
 - (Wolkswagen Transportier me vit prodhimi 2016),
 - në tre procesverbalet e realizuar për matjen e konsumit të karburantit konstatohet se ato nuk janë kryer në prezencë të gjithë komisionit si dhe nuk janë firmosur nga të gjithë pjesëtarët e tij edhe kur ata kanë qenë pjesë e tij e konkretisht:
 - Procesverbal datë 19.07.2021 mbi matjen e konsumit të karburantit për 100 km për mjetin tip Fiat Doblo me kapacitet motori 1900 naftë viti i prodhimit 2004. Pas testimit për këtë mjet është konstatuar se norma e konsumit të karburantit për 100 km do të jetë 14 lirtra naftë. Komisioni që e ka konstatuar dhe është firmosur nga M.T., V. S., T. E. dhe S. K.,
 - Procesverbal datë 19.07.2021 mbi matjen e konsumit të karburantit për 100 km për mjetin tip Ford Kuga me kapacitet motori 2000 naftë viti i prodhimit 2018. Pas testimit për këtë mjet është konstatuar se norma e konsumit të karburantit për 100 km do të jetë 14 lirtra naftë. Komisioni që e ka konstatuar dhe firmosur është V. S., T. E., S. K. dhe P. Z. anëtar,
 - Procesverbal datë 30.07.2021 mbi matjen e konsumit të karburantit për 100 km për mjetin tip Ford Kuga me kapacitet motori 2000 naftë viti i prodhimit 2018. Pas testimit për këtë mjet është konstatuar se norma e konsumit të karburantit për 100 km do të jetë 12.5 litra naftë. Komisioni që e ka konstatuar dhe firmosur është P. Z., V. S., T. E. dhe S. K. i cili nuk e ka nënshkruar këtë procesverbal.
 - Fletë udhëtimet dhe dokumentacioni justifikues i lëvizjeve të kryera
- Nga auditimi konstatohet se për vitin 2021 konsumi i karburantit në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë sipas mjeteve e konkretisht:

Tabela e shpërndarjes dhe konsumit të karburantit për vitin 2021 në litra dhe vlerë

Muaji		Totali	AA165VX, AA592PM, AA593PM	AA166VX	TR7975J
Janar	Litër	1,750	250	250	150
	Vlerë	224,789	32,113	32,113	19,268
Shkurt	Litër	560	280	180	100
	Vlerë	71,932	35,966	23,121	12,845
Mars	Litër	380	130	100	150
	Vlerë	48,812	16,699	12,845	19,268
Prill	Litër	810	410	250	150
	Vlerë	115,256	58,334	35,771	21,151
Maj	Litër	540	160	230	150
	Vlerë	84,199	23,478	40710	20,011
Qershor	Litër	655	240	260	155
	Vlerë	96,115	35,218	38,152	22,745
Korrik	Litër	590	150	280	110
	Vlerë	86,576	22,011	41087	16,141
Gusht	Litër	690	270	280	140
	Vlerë	101,251	39,620	41087	20,544
Shtator	Litër	460	160	150	150
	Vlerë	67,500	23,478	22011	22,011
Tetor	Litër	475	200	180	95
	Vlerë	73,495	30,634	27699	15,162
Nëntor	Litër	590	300	140	150
	Vlerë	94,164	47,880	22344	23,940
Dhjetor	Litër	450	250	200	
	Vlerë	71,820	39,900	31920	
	Litër total	7,950	2,800	2,500	1,500
	Vlerë total	1,135,909	405,331	368,860	213,086

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Në mënyrë që të evidentohen saktë kilometrat e përshkruara dhe në kuadër të mirëadministrimit të shpenzimeve lëvizja e mjeteve në ISSH realizohet duke u bazuar në përcaktimet e Udhëzimit Metodik nr.1, datë 12.07.2000 òPër programimin dhe ndjekjen e treguesve të transportit për të gjithë sistemin e sigurimeve shoqërore dhe Rregullores nr. 2261, datë 19.07.2000 òPër funksionimin e automjeteve, Detyrat e drejtuesit të automjeteve dhe detyrat e përgjegjësit të administratës në lidhje me transportin të saj. Kështu, për lëvizjen e automjetit sipas Udhëzimit Metodik nr. 1, datë 18.07.2000 janë dy lloje autorizimesh të miratuara dhe fleta e udhëtimit:

- ❖ për lëvizjet e brendshme në Tiranë dhe ato jashtë Tiranës. Këto autorizime lëshohen nga titullari ose personit të autorizuar prej tij dhe Drejtori Administrimi ose përgjegjësi përkatës, mbi bazën e kërkesës së bërë nga Drejtoritë apo sektorët në Drejtorinë Qendrore të ISSH-së,
- ❖ dokumenti tjetër është fletë udhëtimi, i cili është dokumenti bazë që evidenton lëvizjen e mjetit sipas destinacioneve të përshkruara si dhe llogaritjen e të gjithë treguesve të tjerë normativë dhe jo normativë për automjetin. Fleta e udhëtimit plotësohet çdo javë nga drejtuesit e mjeteve dhe administrohet në magazinë nga ku lëshohet edhe karburanti për tu bërë pjesë e përmbledhëses mujore të shpenzimeve të karburantit.

Në aneks janë tabelat përmbledhëse sipas muajve të konsumit të karburantit dhe mjeteve ku me X janë shënuar nënshkrimet në autorizim të personave përkatës ku është përcaktuar mjeti, sasia e karburantit, shoferi dhe drejtimi i lëvizjes.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore për periudhën janar - shtator të vitit 2021 është furnizuar me karburant nëpërmjet dy kompanive sipas VKM nr. 561 datë 29.07.2016 òPër Standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme ò ku shërbimi i furnizimit të automjeteve ofrohet nëpërmjet kartave, gjithashtu sipas të dhënave çmimi i karburantit për vitin 2021 ka qenë 159.6 lekë për litër.

Në fund të çdo muaji punonjësja e magazinës dërgon pasqyrën përmbledhëse në Sektorin e Administrimit të Buxhetit të Brendshëm në Drejtorinë e Financës në ISSH, bashkë me dokumentacionin shoqëruar për konsumin mujor të karburantit. Sa i përket rregullave të dokumentacionit, nënshkrimit, miratimit të shpenzimit dhe pranimit të dokumentacionit në kontabilitet, janë të përcaktuara në Rregulloren financiare të ISSH dhe në planin e llogarive dhe janë përgjegjësi e hartuesit dhe buxhetit të brendshëm òFinancimi i shpenzimeve të administrimit dhe drejtimit.” në manualin kontabël të ISSH “llogaritë e gjendjeve të inventarit”, si dhe në dokumente të tjera dhe gjurmën e auditit të zbatimit të buxhetit”)

Për sa më sipër sipas të dhënave në tabela dhe dokumentacionit konstatohet se:

- autorizime janë dhënë nga:
 - o z. A. A. Drejtor Administrimi për periudhën janar- qershor të vitit 2021 për të gjitha mjetet, përfshirë dhe mjetin në përdorim të tij ku vlen të theksohet se autorizimi për lëvizjet e këtij mjeti në përdorim të tij janë urdhëruar e firmosur vetëm nga ana e tij, dhe në asnjëherë nga përgjegjësja e administrimit dhe shoferi i mjetit,
 - o për muajt prill, maj qershor të vitit 2021 autorizimet janë firmosur z. A. A. Drejtor Administrimi, znj. M. T. Përgjegjësja e Administrimit dhe nga shoferi përkatës, mbi bazën e kërkesës së bërë nga Drejtoritë apo sektorët në Drejtorinë Qendrore të ISSH-së, ku këtu vlen të theksohet se përsëri mjeti i drejtuar nga z. A. A. është firmosur vetëm prej tij,
 - o për muajt korrik, gusht, shtator, tetor dhe nëntor autorizimet e të gjitha mjeteve janë firmosur nga znj. M. T. Përgjegjësja e Administrimit së bashku me shoferët ndërsa për mjetin e drejtuar nga z. A. A. autorizimi është firmosur vetëm prej tij.

Çka tregon se administrimi i mjetit *Ford Kuga me targa AA 166 VX* ka qenë jashtë kontrollit për lëvizjet dhe kilometrat e përshkruara sepse mjeti është administruar nga Drejtori i Administrimit.

- fletë udhëtimi, i cili është dokumenti bazë që evidenton lëvizjen e mjetit sipas destinacioneve të përshkruara si dhe llogaritjen e të gjithë treguesve të tjerë normativë dhe jo normativë për

automjetin. Fleta e udhëtimit duhet të plotësohet çdo javë nga personat të cilët kanë mjetin në ngarkim janë të autorizuar për përdorimin e mjetit dhe më pas administrohet për të bërë të mundur që nga magazina të lëshohet karburanti e llogaritjet mujore të shpenzimeve të tij dhe shpenzimeve buxhetore të ISSH-së e më tej për tu bërë pjesë e përmbledhëses. Nga auditimi i fletëve të udhëtimit dhe dokumentacionit shoqërues të tyre sa paraqitur edhe më sipër muaj për muaj konstatohet se:

- fletët e udhëtimit të gjitha nuk janë të firmosura si nga drejtuesit e mjeteve ashtu dhe nga personat që kanë udhëtuar në to, nuk kanë data kur janë bërë lëvizjet, e mbërritjet gjithashtu destinacionet janë shumë të përgjithshme përveç rasteve të qyteteve i cili është i përcaktuar,
- në fletët e udhëtimit për mjetin e drejtuar nga z. A. A. konstatohet se:
 - gjatë muajit janar 2021 është furnizuar me 250 litra karburant për lëvizje të brendshme dhe ka përshkruar gjithsej 2565 km të brendshme ose mesatarisht 2565 km : 22 ditë pune = 116 km në ditë. Nëse bëjmë llogaritë sipas normës se konsumit 12.5 litra për 100 km dhe karburantit të tërhequr për këtë mjet 250 litra rezulton se mjeti me këtë sasi karburanti dhe norme harxhimi duhet të përshkruante 2000 km ose ka përshkruar me shumë 564 km, dhe të paargumentuara me sasinë e karburantit të tërhequr (564 km X 12.5 litra/për 100 km = 70.5 litra karburant X 159.6 lekë/litri = 11.251,8 lekë). Gjithashtu në fletën e udhëtimit nuk ka asnjë përcaktim të saktë të destinacionit por ai është i përgjithshëm,
 - gjatë muajit shkurt 2021 është furnizuar me 180 litra karburant për lëvizje të brendshme dhe një rrugë Fier dhe ka përshkruar gjithsej 1490 km të ndara 1260 km të brendshme dhe 230 km Tiranë ó Fier e Fier - Tirane ose mesatarisht 1260 km : 22 ditë pune = 57 km në ditë. Nëse bëjmë llogaritë sipas normës se konsumit 12.5 litra për 100 km dhe karburantit të tërhequr për këtë mjet 250 litra rezulton se mjeti me këtë sasi karburanti dhe norme harxhimi duhet të përshkruante 1440 km ose ka përshkruar me shumë 50 km, dhe të paargumentuara me sasinë e karburantit të tërhequr (6.25 litra karburant X 159.6 lekë /litri = **997,5 lekë**). Gjithashtu në fletën e udhëtimit nuk ka asnjë përcaktim të saktë të destinacionit por ai është i përgjithshëm,
 - gjatë muajit prill 2021 është furnizuar me 250 litra karburant për lëvizje të brendshme dhe nga një rrugë Durrës-Lezhë, Fier dhe Berat dhe ka përshkruar gjithsej 1720 km të ndara 1020 km të brendshme dhe 700 km të jashtme ose mesatarisht 1720 km : 22 ditë pune = 78 km në ditë. Nëse bëjmë llogaritë sipas normës se konsumit 12.5 litra për 100 km dhe karburantit të tërhequr për këtë mjet 250 litra rezulton se mjeti me këtë sasi karburanti dhe norme harxhimi duhet të përshkruante 2000 km ose ka përshkruar me pak 280 km, të paargumentuara me sasinë e karburantit të tërhequr (280 km X 12.5 litra/për 100 km = 35 litra karburant X 159.6 lekë/litri = **5.586 lekë**) . Gjithashtu në fletën e udhëtimit nuk ka asnjë përcaktim të saktë të destinacionit por ai është i përgjithshëm,
 - gjatë muajit maj 2021 është furnizuar me 230 litra karburant për lëvizje sipas një dokumenti përmbledhës òshpenzimi i naftës me tollona sipas fletë daljes nr. 122/1, datë 04.05.2021ò me itineraret Fier - Vlorë 50 litra, Kuçovë - Berat - Skrapar 50 litra , Kukës 30 litra, Tropojë 50 litra, Gjirokastër 50 litra gjithashtu ka të plotësuar vetëm në fletën e udhëtimit lëvizjet e brendshme për datat 27-30 prill 2021 lëvizje të brendshme gjithsej me 340 km ndërsa lëvizjet e tjera nuk i ka të shënuara në këtë fletë udhëtimi ku të gjitha datat nga 1-26 janë të fshira me vizë nga fillimi deri në fund të fletës së udhëtimit, (340 km X 12.5 litra/ për 100 km = 42.5 litra karburant janë të justifikuar me lëvizje të brendshme sipas fletë udhëtimit ndërsa sasia prej 187.5 litra = 230 litra - 42.5 litra nuk është e justifikuar, dokumentuar vlera e të cilës është 187.5 litra X 159.6 lekë/litri = **29.925 lekë**)
 - gjatë muajit qershor 2021 është furnizuar me 260 litra karburant për lëvizje të brendshme dhe nga një rrugë Ura Vajgurore - Berat ó Skrapar, Tiranë - Shkodër - Pukë,

Tiranë - Burrel - Dibër dhe ka përshkruar gjithsej 2190 km të ndara 910 km të brendshme dhe 1280 km jashtë Tiranës. Në fletën e udhëtimit nuk ka asnjë përcaktim të saktë të destinacionit për lëvizjet e brendshme por ai është i përgjithshëm,

- gjatë muajit tetor ka marrë 50 litra karburant për Berat dhe lëvizje të brendshme sipas autorizimit më datë 08.10.2021 të firmosur nga ana e tij, lëvizje e cila nuk është justifikuar, dokumentuar në fletën e udhëtimit, (50 litra X 159.6 lekë/litri = **7.980 lekë**)
- për sa më sipër mjeti i drejtuar nga z. A. A. për periudhën janar - nëntor të vitit 2021 ka konsumuar gjithsej 2300 litra karburant me vlerë 367.080 lekë i cili përveç problematikave të mësipërme të trajtuara rast pas rasti nuk është plotësisht i justifikuar me dokumentacionin,
- gjithashtu përdorimi i automjetit nga z. A.A. nuk është bërë duke përcaktuar qëllimin për lëvizjen e punonjësve, por i pa argumentuar, lëvizja e tij pothuajse përditë ku përshkruhen me qindra kilometra kryesisht drejt Ministrisë apo DRSSH, ALSSH brenda Tiranës nënkupton justifikime, duke marrë në konsideratë edhe faktin se në ditë të veçanta edhe automjetet e tjera të administratës lëvizin drejt Ministrisë, madje edhe me disa rrugë në ditë vajtje - ardhje, pa marrë në konsideratë faktin se kombinimi i tyre mund të kufizonte lëvizje të pa argumentuara. Gjithashtu plotësimi dhe nënshkrimi i dokumentacionit justifikues, si urdhër shërbime, fletë udhëtimi, përmbledhëse e harxhimit të karburantit, nuk janë nënshkruar nga drejtuesi i mjetit i cili e ka në inventar por nga persona të tjerë në emër të tij, lëvizjet e njëkohshme dhe paralele të automjeteve në të njëjtin destinacion, krijojnë dyshime për plotësim të dokumentacionit, thjesht për justifikim të shpenzimeve për karburant, duke patur parasysh se mjeti është drejtuar nga vetë Drejtori z. A.A.

*Për sa më sipër arrihet në konkluzionin se për veprimet e mosveprimet e mësipërme për të gjitha mospërputhjet në mënyrën në llogaritjes, justifikimin e shpenzimeve të karburantit si dhe në moszbatimin e legjislacionit dhe rregullore të ISSH në plotësimin e kriterëve për miradministrimin e tij ngarkohet me përgjegjësi z. A. A. me detyrë Drejtor i Administrimit të Përgjithshëm për periudhën janar- nëntor në ISSH nuk justifikon me dokumentacion lëvizjet e mjetit për **1826 km me vlerën 36,508 lekë** të konsumit karburantit ndërsa në total nuk argumentohet plotësisht sasia prej 2300 litra gjithsej karburant të harxhuar me vlerë 367,080 lekë për lëvizjet e brendshme për mjetin *Ford Kuga me targa AA 166 VX* të administruar nga ai vetë, kur sipas pozicionit e detyrës duhet të ushtronte kontroll në plotësimin e dokumentacionit justifikues për konsum karburanti për mjetet e tjera, konkretisht në zbatim të:*

- mos hartimit në kohë të dokument të normës së harxhimit të karburantit për 100 km, për çdo automjeti e cila çon në llogaritjen e pasaktë të fondin limit në plotësimin e nevojave për karburant, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë e ndryshuar, neni 59 - Për llogaritja e vlerës limit të kontratës,*
- ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015,*
- Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikë,*
- Udhëzimit Metodik nr.1, datë 12.07.2000 *“Për programimin dhe ndjekjen e treguesve të transportit për të gjithë sistemin e sigurimeve shoqërore,*
- Rregullores nr. 2261, datë 19.07.2000 *“Për funksionimin e automjeteve, Detyrat e drejtuesit të automjeteve dhe detyrat e përgjegjësit të administratës në lidhje me transportin,*

Rregullores së brendshme e ISSH nr. 2115, datë 15.03.2018 “Rregullore për organizimin dhe detyrat funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH ku: Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm “Mbështet Drejtorin e Përgjithshëm dhe Bordin e Drejtorëve duke realizuar një administrim efektiv në ISSH dhe duke mbikëqyrur dhe kontrolluar po ashtu në mënyrë efektive stafin. Siguron lidhjen dhe bashkëpunimin midis stafit administrativ, teknik dhe menaxhues” .

Titulli i Gjetjes: Administrimi i karburantit dhe normat e harxhimit të tij.

Situata:	<p>Nga shqyrtimi i administrimit të karburantit në ISSH rezulton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në ISSH menaxhimi i automjeteve bazohet në Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2000 òPër programimin, evidentimin dhe ndjekjen e Treguesve të Transportit si dhe Rregulloren nr. 2261, datë 19.07.2000 òPër funksionimin e automjeteve, detyrat e drejtuesit të automjeteve dhe detyrat e përgjegjësit të administratës në lidhje me transportinò, rregullore të cilat janë shumë të vjetra për nga koha, si pasojë e ndryshimeve në strukturë që kanë ndodhur në këtë institucion si dhe nuk janë të përshtatura me Rregulloren e Brendshme të ISSH, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò i ndryshuar. - Nga analiza e 8 (tetë) autorizimeve nuk ka një formulim të saktë të përcaktuar në autorizim, mbi lëvizjen, kohën e cilësuar, qëllimin e saj në rastet kur mjeti do të lëvizë jashtë kohës së punës orarit zyrtar, kush duhet ta përdorë dhe kush duhet ta drejtojë atë. - Për vitin 2020 nuk është ngritur grup pune për të përcaktuar normat e harxhimit të karburantit, si dhe për vitin 2021 është bërë me shumë vonesë ose duke e kaluar afatin me 5 muaj. - Sipas autorizimeve rezulton se administrimi i mjetit <i>Ford Kuga me targa AA 166 VX</i> ka qenë jashtë kontrollit për lëvizjet dhe kilometrat e përshkruara, pasi mjeti është përdorur nga Drejtori i Administrimit për periudhën janar-nëntor e nuk justifikohen plotësisht me dokumentacion lëvizjet e mjetit dhe të konsumit të karburantit.
Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar; - Urdhri i Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit nr.125, datë 26.12.2011 òPër miratimin e hartave të azhurnuara të Rrjetit Rrugor Kombëtar dhe distancave kilometrike ndërmjet qyteteve në RSHò; -Rregullorja nr. 2115, datë 15.03.2018, òPër organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqëroreò; -Rregullore Financiare nr. 5, datë 25.05.2009 e Institucionit të Sigurimeve Shoqërore; -etj.
Ndikimi/Efekti:	Keqandministrimi i harxhimit të karburantit
Shkaku:	Mungesë përgjegjesie në zbatimin e legjislacionit dhe në përputhje me rregulloren.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandime:	<ul style="list-style-type: none"> -Drejtorja e Administrimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe atë Juridike të hartojnë rregullore të brendshme mbi mënyrën e administrimit të mjeteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, karburantit për konsum sipas çdo mjeti si dhe për mjetet e Drejtorive Rajonale të saj. -Institutit i Sigurimeve Shoqërore të kërkojë dhe të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 36,508 lekë nga z. A. A. ish Drejtor i Administrimit të Përgjithshëm për konsum karburanti të paargumentuar me dokumentacion mbështetës.

IV.GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi:

Nga auditimi ka rezultuar se mungon Strategjia për zhvillimin e sistemit të sigurimeve shoqërore në periudhë afat-mesme dhe afat-gjatë; legjislacioni përkatës është shoqëruar me ndryshime të shumta (deri më tani 22 herë) pa arritur reformimin e sistemit dhe zgjidhjen e problematikave të tij: financimi buxhetor ka ardhur duke u rritur nga viti në vit; ka një rritje të ngadaltë dhe të ulët të numrit të kontribuuesve, dhe kjo kryesisht në sektorin publik, ndërsa është në ulje numri i të siguruarve të vetëpunësuar në bujqësi; ka tendencë në rritje numri i përfituesve (pensionistëve), duke e mbajtur shkallën e vartësisë së sistemit në nivele të ulëta 1 kontribuues për 1.42 përfitues; shkalla e zëvendësimit (pension mesatar/kontribute mesatare) është shumë e ulët, duke nxitur informalitetin në këtë drejtim; megjithëse niveli i kontributeve nuk ka ndryshuar për një kohë të gjatë, paga minimale dhe maksimale që nga viti 2014 janë rritur përkatësisht me rreth 65 % dhe 45 %, duke sjellë për pasojë që rritja e të ardhurave kontributeve të jetë kryesisht nga rritja e pagës; krahasuar edhe me vendet e rajonit, vijon të ketë një nivel të ulët të ardhurave nga kontributet shoqërore në raport me prodhimin e brendshëm bruto prej 5.4 % në vitin 2021; ka një numër të konsiderueshëm të subjekteve debitorë prej 103,628 njësi (kryesisht të biznesit të vogël rreth 75 %), duke shkaktuar pasoja këtyre kontribuuesve në përfitimin e pensioneve; edhe ndryshimet e gjëra të ligjit në 2014 nuk i kanë dhënë zgjidhje problematikave të skemës së sigurimeve shoqërore në vendin tonë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (12) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të hartojë Strategjinë e zhvillimit të sistemit të sigurimeve shoqërore, me qëllim arritjen e konsolidimit të skemës, si dhe të mundësojë rritjen e performancës nëpërmjet një reforme të qëndrueshme që i përgjigjet problematikave të sistemit të sigurimeve shoqërore.

Brenda vitit 2022 dhe vazhdimisht

2.Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimii zbatimit të buxhetit për vitin 2021rezulton se:

- *Planifikimi i treguesve të fondit të sigurimeve shoqërore* nuk mbështet në nivelin bazë të rajoneve, si dhe nuk shoqërohet me një analizë të detajuar, por në përgjithësi i përmbahet skemave fikse të miratuara nga institucioni epror e konkretisht: në planifikimin strategjik të dhënat e dërguara nga MFE janë njësoj me ato të përgatitura nga ISSH, çka tregon se planifikimi nuk është realizuar plotësisht në bazë të analizave dhe studimeve konkrete, por është thjeshtë një përshtatje shifrash midis institucioneve të cilat llogariten në bazë të eksperiencës dhe një trendi rritës, madje shifrat e ISSH-së përshtaten njësoj me ato të organit epror; hartimi i treguesve të buxhetit vjetor e atij afatmesëm në fazën e I strategjike është kryer i përqendruar në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH-së, duke mos përfshirë në këtë fazë programimi njësitë shpenzuese rajonale, me justifikimin se ato nuk kanë tregues të mjaftueshëm për të realizuar atë, por përfshirja e tyre në këtë fazë të planifikimit strategjik mund të ishte e dobishme, sepse do të përmbledhte eksperiencat e tyre në vite pavarësisht se nuk kanë të dhëna makro Plani i buxhetit të ISSH ka ndryshuar tre herë e konkretisht sipas ligjit nr. 137/2020, sipas Aktit Normativ nr. 18, datë 14.04.2021 dhe Sipas Aktit Normativ nr. 34, datë 03.12.2021 të dërguara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Të ardhurat gjithsej nga kontributet e sigurimeve shoqërore për vitin 2021 në shkallë vendi, nga 91,576,000 mijë lekë të programuara, u realizuan 94,857,582 mijë lekë ose në masën 104% .

- Rezultati fiskal vjetor, i cili paraqitet si diferencë midis të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit, tregon se nevojat për financimin e shpenzimeve të vitit, janë ulur në krahasim me planin në vlerën 2,994 milionë lekë, megjithatë ato vazhdojnë të mbeten akoma të larta, sepse subvencionin nga buxheti i shtetit për skemën e pensioneve i llogaritur për vitin 2021 është 37,715 milionë lekë.

- Të ardhurat nga kontributet nuk janë të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të skemës së pensioneëve për të dy skemat (qytetin dhe fshatin) duke krijuar një deficit të vazhdueshëm nga viti në vit. Ky deficit konstatohet në rritje në vlerë absolute për vitin 2021 në vlerën 899,901 mijë lekë kundrejt vitit 2020, megjithëse ka një përmirësim prej 0.14 pikë. Ky deficit fiskali sistemit, pavarësisht rezultatit vjetor dhe mbulimit të planifikuar të tij, rezulton të jetë 30,413 milionë lekë dhe nëse i zbritet kontributi për papunësinë i pa transferuar e ligjërisht i lënë në llogaritë e ISSH në shumën 3,179 milionë lekë, redukton financimin buxhetor në vlerën 27,233.4 milionë lekë.

- Numri i përfituesve të pensioneëve të pleqërisë, invaliditetit dhe familjarë për vitin 2021, konstatohet se në fillim të vitit 2021, në skemën e detyrueshme ishin 665,567 pensionistë dhe në fund të vitit 2021, rezultuan 673,542 pensionistë, me një shtesë në total, prej 7,975 pensionistë.

- Konstatohet mungesa e bashkëveprimit dhe komunikimit të rregullt në marrëdhëniet ndër-institucionale midis ISSH dhe DPT të cilat janë kthyer pothuajse në fenomen. ISSH në mënyrë të vazhdueshme ka ndjekur mangësitë që evidentohen në sistemin e transmetimit të listë-pagesave ashtu dhe në bashkëpunimin që kërkohet lidhur me angazhimin e organeve tatimore, për sa i përket rolit të tyre në drejtim të mbledhjes së detyrimeve të prapambetura.

Sipas të dhënave të marra e përpunuara konstatohet se subjektet debitorë kanë pësuar një rritje të konsiderueshme prej 6,795 subjektësh si dhe një rritje të detyrimeve të prapambetura me 1,474,616 mijë lekë në vitin 2021. Ndërsa deri tani Instituti të Sigurimeve Shoqërore nuk i janë vënë në dispozicion rreth 15.8 miliard lekë detyrime të prapambetura që ju përkasin mbi 103 mijë subjekteve debitorë.

- Për vitin 2021 një tregues i rëndësishëm është edhe treguesi i skemës së sigurimeve krahasuar me PBB, (shpallur nga MFE, në procesin e hartimit dhe miratimit të treguesve në buxhet), i cili megjithëse ka ardhur në rritje është larg pritshmërisë dhe objektivave, kështu për vitin 2021 ai është realizuar 5.36 % nga 5.16 % i planifikuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (29) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore të mundësojë rritjen e të ardhurave e numrin e kontribuuesve, uljen e deficitit të skemës së pensioneëve, zvogëlimin e subvencionit të buxheti shtetit për skemën e pensioneëve dhe përmirësimin e raportit kontribute me prodhimin e brendshëm bruto (PBB).

Në vijimësi

2.2 Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore t'ia bëjë prezent dhe të kërkojë që Ministria e Financave dhe Ekonomisë të ndërhyjë në zgjidhjen problematikave të mbartura në marrëdhëniet e saj me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për diferencat e kontributeve të derdhura nga subjektet privatë dhe shtetërorë për sigurimet shoqërore të cilat konstatohen në 103 mijë subjekteve debitorë me vlerë rreth 15.8 miliard detyrime prapambetura.

Brenda muajit tetor 2022

3. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i veprimtarisë së Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve rezulton se:

- Për vitin 2021 nga 42,713 dosje për t'u inspektuar janë paraqitur 42,155 dosje nga të cilat janë certifikuar 39,963 dosje. Nga dosjet e inspektuara kanë rezultuar 2,232 dosje (ose 5.6%) me problematika të ndryshme të cilat konsiderohen të pa certifikuara nga ku, 980 dosje përfitimesh kanë rezultuar me efekte debitorë apo kreditorë. Janë 424 dosje me efekt debitor në shumën 17,835,579 lekë dhe 556 dosje me efekt kreditor në shumën 17,052,504 lekë. Kjo vjen si rezultat i mangësive të konstatuara nga dokumentacioni i verifikuar në dosjet e përfituesve të cilat vijnë prej llogaritjeve të gabuara të punonjësve në Degët e Përfitimeve referuar dokumentacionit të disponueshëm në dosjet e përfituesve, edhe pse këto konstatime janë hasur edhe në auditimet e mëparshme.

- Gjithashtu, konstatohet se për dy subjekte rajonale, DRSSH Elbasan dhe DRSSH Korçë, inspektimet e kryera për dosjet e përfitimeve të vitit 2017 kanë qenë përtej afatit 3 vjet nga marrja e tyre. Konkretisht kanë qenë pa inspektuar 7,355 dosje në DRSSH Korçë prej të cilave kanë rezultuar 241 dosje me probleme dhe 118 prej tyre me efekte financiare ndërkohë që në

DRSSH Elbasan kanë qenë pa inspektuar 9,993 ku kanë rezultuar 561 dosje me problema dhe 176 dosje me efekte financiare. Mbikëqyrja e sektorit të Njesisë së Inspektimit të Përfitimeve nuk ka siguruar monitorim efikas të zbatimit të politikave dhe strategjive të ISSH, në drejtim të sugjerimeve për përmirësimin e dhënies së ekspertizës së mjaftueshme, mbi zgjidhjen e problemeve të metodologjisë së përlogaritjes së përfitimeve, për të bërë të mundur uljen e riskut të diferencave të konstatuara dhe rritjen e përgjegjësisë për mbarëvajtjen e aktivitetit Institucional në këtë drejtim. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (54) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm në bashkëpunim me Njësinë e Inspektimit të Përfitimeve, të hartojnë plan masash me afate, për të mundësuar certifikimin e 980 dosjesh përfitimesh të cilat kanë rezultuar me efekte debitorë dhe kreditorë, si dhe të marrë masa për inspektimin dhe certifikimin e të gjitha dosjeve të përfituesve brenda afatit 3-vjeçar.

Menjëherë e në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm në ISSH rezulton se: Struktura e DAB është organizuar me 9 punonjës, nga të cilët 1 Drejtor, 1 Kryetar Dege dhe 7 Specialistë Auditues. Nga auditimi u konstatua se, përgjatë vitit 2021, DAB ka funksionuar me strukturë jo të plotë, duke patur 1 vend vakant/ të lirë, gjë që ka sjellë mosfunksionim me kapacitet të plotë të kësaj drejtorie.

Në identifikimin e sistemeve dhe vlerësimin e nivelit të riskut për subjektet e planifikuara për auditim në vitin 2021, u konstatua se janë vlerësuar edhe *sistemet e teknologjisë së informacionit*. Për Drejtorinë e Arkivit Qendror të ISSH, niveli i riskut është vlerësuar *i lartë*, ndërsa për të 15 DRSSH e tjera, niveli i riskut është vlerësuar *i mesëm*, si fushat e planifikuara, kanë qenë kryesisht ekonomiko-financiar/ të kombinuara. Në shqyrtimin e dokumentit *oHarta e riskut për ISSH viti 2021*ö, u evidentua: *mungesa e një audituesi të brendshëm, ekspert në fushën e informatikës me risk të mesëm, para dhe pas kontrollit*.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se audituesit e DAB nuk kanë kryer trajnimet e planifikuara në Planin e vitit 2021 nga ISSH, të konsideruara të nevojshme për audituesit e brendshëm. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (54) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të plotësojë pozicionin në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm vakant në fushën e teknologjisë së informacionit, si dhe të marrë masa që të kryejë trajnime të punonjësve të kësaj drejtorie.

Brenda muajit shtator dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vlerësimin e veprimtarisë së auditit të brendshëm rezultoi se:

- Grupi i punës nuk ka krijuar një dosje të veçantë për çdo angazhim auditimi, pasi në angazhimet të cilat kanë patur të njëjtin numër programi, arkivimi i dokumentacionit është kryer në një dosje; inventarizimi i dokumentacionit që përmbajnë dosjet, është kryer me inventar personal nga secili anëtar i grupit të auditimit, pramungoneshkresa einventarit të dosjeve sipas Formatit Standard nr. 1, në Kapitullin VI, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar; rezultuan mungesa të nënshkrimeve të audituesve dhe drejtorit të drejtorisë tek dokumenti i takimit fillestar, dokumenti i takimeve të angazhimit të auditimit ballafaques ose përmbyllës, kontrolli i cilësisë pas përfundimit të auditimit, ndërsa shkalla e vlerësimit nga subjekti i audituar ishte e paplotësuar.

- Në auditimin e dosjeve, u konstatua se, në të gjitha rastet, plan veprimi për realizimin e rekomandimeve, i plotësuar nga subjekti i audituar nuk është kryer sipas kërkesave që përcakton Formatin Standard 10 i Manualit të Auditimit të Brendshëm, në kolonën: *Reagimi i menaxhimit të subjektit të audituar*. Për të gjitha rekomandimet, rezultoi se nga subjekti i audituar është dhënë përgjigjja: i dakordësuar, si dhe po në këtë mënyrë janë pranuar nga grupet e auditimit të ISSH. Pra, nga subjektet vetëm është konfirmuar pranimi i rekomandimit,

fazë e cila kryhet në takimin përmbyllës së auditimit në terren, pa pasqyruar hapat që duhet të ndërmerret subjekti i audituar për realizimin e rekomandimeve të lëna.

- Në shkresën përcjellëse të raportit përfundimtar të audituar në DRSSH Lezhë, DSSH Sarandë dhe DRSSH Gjirokastrë, referenca ditore e përcaktuar nga DAB është vendosur 20 ditë pune për përgatitjen e programeve me afate dhe persona përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, ndërsa afati i duhur është brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të raportit përfundimtar.

- DRSSH Lezhë ka dërguar observimet me 6 ditë pune, në tejkalim të afatit ligjor nga marrja e projektraportit, DRSSH Tropojë ka konfirmuar projektraportin me 10 ditë pune, në tejkalim të afatit ligjor. Ndërsa nga ana e grupit të angazhimit të kryer në DRSSH Gjirokastrë, i është dërguar subjektit, raporti përfundimtar me 5 ditë pune në tejkalim të afatit ligjor.

- Në Rishikimin e Cilësisë së Punës për auditimin në DRSSH Elbasan, disa nga komentet e dhëna nga përgjegjësi i grupit nuk vërtetohen, pasi në dosje nuk ka gjurmë të dokumenteve.

- Në vlerësimin e brendshëm të cilësisë për vitin 2021, që kryhet nga vetë DAB dhe dërgohet te Komiteti i Auditimit të Brendshëm në MFE, përmes Aneksit 3 ÷Pyetësori i Vetëvlerësimit të DAB, të gjitha përgjigjet janë dhënë: ÷përputhshmëri e plotë, por nga auditimi u konstatua se jo e gjithë veprimtaria e DAB është në përputhshmëri të plotë.

- Dosjet e auditimit për vitin 2021, janë ende të pa arkivuara, veprim ky në kundërshtim me ÷Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 ÷Për arkivat. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (54) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Drejtori i përgjithshëm të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mangësitë e evidentuara në veprimtarinë e auditit të brendshëm, si dhe të marrë masa në bashkëpunim me Drejtorin e Auditit të Brendshëm që të realizojë dokumentimin e punës audituese gjatë dhe pas kryerjes së auditimit.

Brenda muajit shtator dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera për procedurat e prokurimit blerje me vlera të vogla u konstatua se:

- Nuk është dokumentuar dhe argumentuar përzgjedhja e operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për ofertë;

- Në 1 (një) rast komisioni ka kualifikuar OE që nuk kanë licencë për ushtrim aktiviteti të objektit të kontratës, konkretisht në procedurën e prokurimit me objekt ÷Blerje Karburant diesel;

- Në 2 (dy) raste fatura tatimore nuk është e nënshkruar nga të gjithë anëtarë e komisionit, konkretisht në procedurat e prokurimit me objekt ÷Mirëmbajtja e faqes zyrtare të ISSH dhe ÷Rinovimi i licencës së antivirusit;

- Në 5 (pesë) raste likuidimi është kryer pa krijuar komision prej 3 personash ku një prej tyre të jetë specialist i fushës, konkretisht në procedurat e prokurimit me objekt ÷Mirëmbajtja e faqes zyrtare të ISSH-së, ÷Riparimi i automjetit me targë AA165VX ÷procedura e parë, ÷Riparimi i automjetit me targë AA166VX ÷Riparimi i automjetit me targë AA165VX ÷procedura e dytë;

- Në 5 (pesë) raste nuk është krijuar komision për marrjen në dorëzim të mallrave apo shërbimeve të kërkuara, konkretisht në procedurën e prokurimit me objekt ÷Blerje Karburant diesel, ÷Mirëmbajtja e faqes zyrtare të ISSH-së, ÷Riparimi i automjetit me targë AA165VX ÷procedura e parë, ÷Riparimi i automjetit me targë AA166VX, ÷Riparimi i automjetit me targë AA165VX ÷procedura e dytë, ÷Rinovimi i licencës së antivirusit;

- Në 1 (një) rast nuk është argumentuar kriteret apo specifikimet e vendosura në ftesën për ofertë të hartuar nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla, konkretisht në procedurën e prokurimit me objekt ÷Furnizim vendosje ndriçues të jashtëm në fasadën e ISH-së;

- Në 2 (dy) raste nuk është bërë fletë hyrje në magazinë mallrat apo shërbimet e kërkuara por janë marrë direkt në dorëzim nga punonjësi, konkretisht në procedurën e prokurimit me objekt ÷Rinovimi i licencës së antivirusit dhe ÷Blerje bllokues parkimi;

- Në 2 (dy) raste nuk është mbajtur formulari nr. 4, për rastet përkatëse sipas dokumenteve standardë, konkretisht në procedurën e prokurimit me objekt ÷Blerje starter për ndriçuesit neon të godinës së ISSH-së dhe ÷Blerje bllokues parkimi.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018, ÷Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, i ndryshuar, pika 19, me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ÷Për menaxhimin e aktiveve, i ndryshuar, pika 35, 42, 43, Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 ÷Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, pika 7 dhe 11. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (69) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mangësitë e evidentuara në prokurimet me vlera të vogla, si dhe të përfshijë zyrtarë të kualifikuar dhe të trajnuar, me qëllim zhvillimin e dokumentimit të saktë të procedurave të prokurimit.

Brenda muajit shtator dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procedurës së prokurimit me objekt ÷Sigurimi i aseteve të ISSH, DAQ-së Lundër, DRSSH-ve dhe ALSSH-ve përkatëse për periudhën 1-vjeçare për vitin 2021, me fond limit në vlerën 7,800,000 lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate në shumën 7,778,000 lekë pa TVSH, rezultoi:

Njësia e Prokurimit, në procesverbalin e mbajtur për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, nuk ka argumentuar teknikisht dhe ligjërisht kriteret e vendosura e konkretisht: 1. ÷Kopje e deklaratave të xhiros vjetore, realizuar gjatë vitit 2018 dhe 2019, ku vlera mesatare e xhiros vjetore gjate këtyre viteve të jetë sa vlera e fondit limit që prokurohet, 2. ÷Kopje të certifikuara të bilanceve të viteve 2018 dhe 2019 të paraqitura në autoritetet përkatëse dhe 3. ÷Dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit në një vlerë sa 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Veprime jo në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 61 pika 2.

- Referuar sistemit elektronik të prokurimit rezultoi se në datë 04.02.2021 u ka bërë ftesë për pjesëmarrje 5 operatorëve ekonomik, por nuk ka argumentuar dhe dokumentuar përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë të cilëve u ka dërguar ftesë në SEP. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (69) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm në bashkëpunim me Sektorin e Prokurimeve, të krijojë komisionet për zbatimin e kontratave, për verifikimin e produktit apo shërbimit final në përputhje me kërkesat e vendosura nga AK dhe sugjerimet e APP, si dhe të argumentohen ftesat për pjesëmarrje të cilat ju dërgohen operatorëve ekonomik.

Në vazhdimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i administrimit të marrëdhënieve të punës dhe dokumentacionit që i rregullojnë ato, si dhe Këshillit Administrativ rezultoi se:

- Nuk janë realizuar plotësisht aktivitetet trajnuese për stafin e ISSH-së, në përputhje me planin vjetor të miratuar në fillim të vitit, gjë për të cilën ka ndikuar dhe pandemia Covid -19;

- Instituti i Sigurimeve Shoqërore përgjatë vitit 2021, ka funksionuar mbi bazën e Rregullores të pa miratuar nga Këshilli Administrativ e cila paraqitet me mangësi në përcaktimin e kriterëve të kualifikimit dhe të eksperiencës në punë dhe përshtatjes me strukturën organizative aktuale,

- Vlerësimi individual i performancës së punonjësve është kthyer në formalitet pasi identifikohen të njëjta pikë vlerësimi çdo 3- muor dhe një shtim të dokumentacionit në dosjet e personelit. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.5) faqe (78) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Drejtori i përgjithshëm të marrë masa për dërgimin dhe miratimin e Rregullores së brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e ISSH-së në përputhje me

strukturën organizative aktuale, si dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të sigurojë trajnimin dhe rishikimin e kohës dhe mënyrës së vlerësimit të punonjësve.

Brenda muajit shtator dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Këshilli Administrativ nuk ka miratuar në kohë rezultatin financiar të vitit 2020 në kundërshtim me zbatimin e Rregullores Financiare, Kreu VI *“Kontrolli financiar dhe raportimi”* /çështja D *“Raportimi”* nën çështja 3, jo më vonë se fundi i tremujorit të dytë, që pason vitin të cilit ai i referohet. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.5) faqe (78) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1 Rekomandimi: Këshilli i Administrativ të zhvillojë veprimtarinë e tij sipas kuadrit përkatës rregullator dhe në afate, me qëllim që të ndikoj në përmirësimin e ecurisë së ISSH.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i zbatimit të rekomandimeve konstatohet se:

-ISSH ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor prej 20 ditëve, gjithashtu *nga institucioni nuk ka patur kundërshtime për rekomandimet e KLSH, si dhe janë përcaktuar strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve dhe afatet përkatëse, pra janë pranuar të gjitha rekomandimet.*

-ISSH ka përgatitur programin e masave që do të merren dhe realizohen për zbatimin e rekomandimeve ku janë përcaktuar afatet, personat apo drejtoritë përgjegjëse si dhe janë nxjerrë shkresat përkatëse për zbatim. Ky program masash është dërguar në KLSH me shkresën nr. 468/7, datë 22.10.2021, *“Dërgohet programi i masave në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, dërguar me shkresën nr. 95/9, datë 24.09.2021”* *“Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Ri-Auditimin e përputhshmërisë në Institutin e Sigurimeve Shoqërore”*.

-Gjithashtu, në zbatim të afatit ligjor të përcaktuar në pikën nr. 2, neni 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 *“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, e cila citon: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”* nga ana e ISSH nuk është mundur sepse nuk janë përmbushur afatet, si dhe për realizimin e rekomandimeve është mbajtur akt i veçantë në zbatim të programit auditimit.

- Në total janë rekomanduar 27 masa organizative, të cilat janë pranuar nga ISSH dhe nga auditimi rezultojnë: *“janë realizuar 19 masa dhe janë në procesin e realizimit në vijimësi 8 masa organizative.”* *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.6) faqe (84) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1 Rekomandimi: Këshilli Administrativ të shqyrtojë dhe të analizojë në veçanti zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm, duke nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin dhe/ose mosrealizimin në afat, si dhe të marrë masa që të sigurojë zbatimin e plotë të tyre.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i administrimit të karburantit në ISSH rezultojnë se:

- Në ISSH menaxhimi i automjeteve bazohet në Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2000 *“Për programimin, evidentimin dhe ndjekjen e Treguesve të Transportit si dhe Rregulloren nr. 2261, datë 19.07.2000”* *“Për funksionimin e automjeteve, detyrat e drejtuesit të automjeteve dhe detyrat e përgjegjës të administratës në lidhje me transportin, rregullore të cilat janë shumë të vjetra për nga koha, si pasojë e ndryshimeve në strukturë që kanë ndodhur në këtë institucion si dhe nuk janë të përshtatura me Rregulloren e Brendshme të ISSH, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010”* *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin e ndryshuar, Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011”* *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publiko i ndryshuar.”*

- Nga analiza e 8 (tetë) autorizimeve nuk ka një formulim të saktë të përcaktuar në autorizim, mbi lëvizjen, kohën e cilësuar, qëllimin e saj në rastet kur mjeti do të lëvizë jashtë kohës së punës orarit zyrtar, kush duhet ta përdorë dhe kush duhet ta drejtojë atë.

- Për vitin 2020 nuk është ngritur grup pune për të përcaktuar normat e harxhimit të karburantit, si dhe për vitin 2021 është bërë me shumë vonesë ose duke e kaluar afatin me 5 muaj.

- Sipas autorizimeve rezulton se administrimi i mjetit *Ford Kuga me targa AA 166 VX* ka qenë jashtë kontrollit për lëvizjet dhe kilometrat e përshkuara, pasi mjeti është përdorur nga Drejtori i Administrimit për periudhën janar-nëntor e nuk justifikohen plotësisht me dokumentacion lëvizjet e mjetit dhe të konsumit të karburantit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.7) faqe (93) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Drejtoria e Administrimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe atë Juridike të hartojnë rregullore të brendshme mbi mënyrën e administrimit të mjeteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, karburantit për konsum sipas çdo mjeti si dhe për mjetet e Drejtorive Rajonale të saj. **Menjëherë**

1.2 Rekomandimi: Institutit i Sigurimeve Shoqërore të kërkojë dhe të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej **36,508 lekë** nga z. A. A ish Drejtor i Administrimit të Përgjithshëm për konsum karburanti të paargumentuar me dokumentacion mbështetës.

Brenda muajit tetor 2022

IV. ANEKSE

Të gjitha evidencat janë pjesë e raportit sipas pikave të programit dhe janë trajtuar në mënyrë të detajuar më sipër si dhe rastet e trajtuara në këtë aneks.

Ligje dhe me aktet normative të sistemit të pensioneve i cili për rreth 30 vite është ndryshuar me deri më tani 22 herë konkretisht:

- *akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 7, datë 30.11.2019* òPër një shtesë në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, òPër sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar,
- *ligji nr. 111/2016, datë 03.11.2016* òPër disa ndryshime në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, òPër sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar,
- *ligji nr. 104/2014, datë 31.07.2014* òPër disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, òPër sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar,
- *ligji nr. 13/2014, datë 13.02.2014* òPër disa ndryshime në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 òPër sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar,
- *ligji nr. 10447, datë 14.07.2011* òPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 òPër sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar,
- *ligji nr. 10070, datë 05.02.2009* òPër disa ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 òPër sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar,
- *ligji nr. 9768, datë 09.07.2007* òPër një ndryshim në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,
- *ligji nr. 9708, datë 05.04.2007* òPër disa shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,
- *ligji nr. 9600, datë 27.07.2006* òPër disa ndryshime në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,
- *ligji nr. 9498, datë 03.04.2006* òPër disa ndryshime në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,
- *ligji nr. 9377, datë 21.04.2005* òPër disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
- *ligji nr. 9114, datë 24.07.2003* òPër disa shtesa e ndryshime ne ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,
- *ligji nr. 9058, datë 20.03.2003* òPër disa ndryshime ne ligjin nr.7703, date 11.5.1993 "Për Sigurimet Shoqërore ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjet nr.7932, date 17.5.1995; nr. 8286, datë 16.2.1998; nr. 8392, datë 2.9.1998; nr. 8575, datë 3.2.2000; nr. 8776, datë 26.4.2001; nr. 8852, datë 27.12.2001 dhe nr. 8889, datë 25.4.2002,
- *ligji nr. 8889, datë 25.04.2002* òPër disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë ", ndryshuar me ligjin nr. 7932, datë 17.05.1995; nr. 8286, datë 16.02.1998; nr. 8392, datë 02.09.1998; nr. 8575, datë 03.02.2000; nr. 8776, datë 26.04.2001 dhe nr. 8852, datë 27.12.2001,
- *ligji nr. 8852, datë 27.12.2001* òPër një ndryshim në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjet nr. 7932, datë 17.05.1995, nr. 8286, datë 16.02.1998, nr. 8392, datë 02.09.1998, nr. 8575, datë 03.02.2000 dhe nr. 8776, datë 26.04.2001,
- *VKM, nr.159, datë 07.04.2000* òPër zbatimin e ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë",
- *ligji nr. 8575, datë 03.02.2000* òPër një ndryshim në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 7932, datë 17.05.1995, me ligjin nr. 8286, datë 16.02.1998 dhe me ligjin nr. 8392, datë 02.09.1998,

- ligji nr.8392, datë 02.09.1998 òPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 7932, datë 17.05.1995 dhe me ligjin nr. 8286, datë 16.02.1998,
- ligji nr.8286, datë 16.02.1998 òPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 7932, datë 17.05.1995,
- ligji nr. 7932, datë 17.05.1995 òPër disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

Tabela Rakordimit ISSH me MFE për transferimin dhe të ardhurat e sigurimeve shoqërore

Tiranë, më 14/01/2022

Rakordim për transferimet dhe arketimet nga TSA për të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhën Janar Dhjetor 2021

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë
1	Gjendja në fillim Janar 2021	2,876,999,356.04
2	Tatimore (llog. 75)	91,152,488,061.00
3	Llog. 711 - Jo tatimore (gjoja)	267,712,164.00
4	Llog. 7090101-Kamatëvonesa sig.shoq.	113,307,767.00
5	Totali i të ardhurave	91,533,507,992.00
	Transferuar nga TSA progresive	93,420,000,000.00
	Gjendja në fund për tu mbartur dhe transferuar	990,507,348.04

Për Institutin e Sigurimeve Shoqërore

Drejtor i Përgjithshëm

Astrit Hado

Drejtor e Financës
Lindita Gjinaj

Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit të Përgjithshëm
Esmeralda Doci

Specialiste e Buxhetit të Përgjithshëm
Flutura Gjoni

Për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit

Alma Bejo

Drejtor e Drejtorisë së Operacioneve të Thesarit
Mimoza Peço

P/Sektorit të Raportimit Financiar dhe Kontabilitetit
Alketa Braçe

Specialiste e Raportimit Financiar dhe Kontabilitetit
Renalda Murrani

Specialist i Sektorit të Llogarisë së Unifikuar të Thesarit
Ardit Tele

Tiranë, më 14/01/2022

Rakordim për transferimet dhe arketimet nga TSA për të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhën Janar Dhjetor 2021

Nr.	Emërtimi	Vlera në lekë
1	Gjendja në fillim Janar 2021	2,876,999,356.04
2	Tatimore (llog. 75)	91,152,488,061.00
3	Llog. 711 - Jo tatimore (gjoja)	267,712,164.00
4	Llog. 7090101-Kamatëvonesa sig.shoq.	113,307,767.00
5	Totali i të ardhurave	91,533,507,992.00
	Transferuar nga TSA progresive	93,420,000,000.00
	Gjendja në fund për tu mbartur dhe transferuar	990,507,348.04

Për Institutin e Sigurimeve Shoqërore

Drejtor i Përgjithshëm

Astrit Hado

Drejtor e Financës
Lindita Gjinaj

Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit të Përgjithshëm
Esmeralda Doci

Specialiste e Buxhetit të Përgjithshëm
Flutura Gjoni

Për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit

Alma Bejo

Drejtor e Drejtorisë së Operacioneve të Thesarit
Mimoza Peço

P/Sektorit të Raportimit Financiar dhe Kontabilitetit
Alketa Braçe

Specialiste e Raportimit Financiar dhe Kontabilitetit
Renalda Murrani

Specialist i Sektorit të Llogarisë së Unifikuar të Thesarit
Ardit Tele




REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E THESARIT
DREJTORIA E OPERACIONEVE TË THESARIT

Nr. 961/1 prot.

Tiranë, më 18.1.2022

Lenda: Akt-rakordim-2021



INSTITUTIT TE SIGURIMEVE SHOQERORE ✓
Adresa: Rruga e Durrësit, Tirana

Në vijim të shkresës Nr. 278, date 14.01.2022 të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, protokolluar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me Nr. 961, date 18.01.2021, bashkelidhur do te gjeni akt-rakordimin për arketimet dhe transferimet e të ardhurave të kontributeve të sigurimeve shoqërore për vitin 2021.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA E FINANCËS

Nr. 278 prot.

Tiranë, më 14/01 /2022

Lënda: Mbi rakordimin e të ardhurave të realizuara nga kontributet për Sigurimet Shoqërore nga DPT për vitin 2021

MINISTRISË SË FINANCAVE
Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit

TIRANË

Në bazë të e mail-it të datës 11.01.2022 të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve lidhur "Me të ardhurat e realizuara për kontributet e Sigurimeve Shoqërore nga sistemi informatik C@TS për periudhën Janar – Dhjetor 2021", bashkëngjitur ju dërgojmë për konfirmim Akt-Rakordimin dhe pasqyrën me të ardhurat e detajuara nga kontributet e Sigurimeve Shoqërore për vitin 2021.

Në pritje të nënshkrimit të Akt-Rakordimit të të ardhurave përfundimtare për vitin 2021.

Faleminderit për bashkëpunimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Astet **HADO**



KUFIRI I PAGËS MINIMALE DHE MAKSIMALE, AFATET DHE % E KONTRIBUTIT SIPAS VITEVE

Nr.	Baza ligjore	Nr. VKM, ligji, data	Periudha		Kufiri i pagës		% e kontributit			
			Fillon	Mbaron	Min	Max	Gjithsej	Punëdhënësi	Punëmarrës	Ivetëpunësuar
1	VKM	452,16.09.1993	01.10.1993	31.12.1993	1,639	4,917	32.5	32.5	0	34.5
2	VKM	610, 31.12.1993	01.01.1994	12.31.1994	2,560	7,680	35.5	32.5	3	34.5
3	VKM	42, 23.01.1995	01.01.1995	28.02.1995	3,180	9,540	38.5	32.5	6	34.5
	VKM	42, 23.01.1995	0.1.03.1995	31.12.1995	3,180	9,540	41.9	34.2	7.7	41.5
4	VKM	180, 18.03.1996	01.01.1996	31.12.1996	4,100	12,300	45.9	34.2	11.7	41.5
5	VKM	20, 13.01.1997	0.1.01.1997	31.01.1998	4,910	14,730	45.9	34.2	11.7	41.5
6	VKM	73, 30.01.1998	01.02.1998	31.12.1998	6,040	18,120	45.9	34.2	11.7	41.5
7	VKM	73, 30.01.1998	01.01.1999	31.3.1999	6,040	18,120	45.9	34.2	11.7	41.5
	VKM	112, 18.03.1999	01.04.1999	31.12.1999	6,645	19,935	45.9	34.2	11.7	41.5
8	VKM	112, 18.03.1999	01.01.2000	30.6.2000	6,645	19,935	45.9	34.2	11.7	41.5
	VKM	384, 14.07.2000	01.07.2000	31.12.2000	7,773	23,319	45.9	34.2	11.7	41.5
9	VKM	384, 14.07.2000	01.01.2001	30.06.2001	7,773	23,319	45.9	34.2	11.7	41.5
	VKM	402, 11.06.2001	01.07.2001	31.12.2001	8,396	25,188	45.9	34.2	11.7	41.5
10	Ligji	8852, 27.12.2001	01.01.2002	30.06.2002	8,396	41,980	45.9	34.2	11.7	41.5
	Ligji	8889, 25.04.2002	01.07.2002	31.12.2002	9,403	47,015	41.9	30.7	11.2	39.2
11	VKM	346, 07.06.2002	0.1.01.2003	30.06.2003	9,403	47,015	41.9	30.7	11.2	39.2
	VKM	446, 26.06.20023	01.07.2003	31.12.2003	10,343	51,715	41.9	30.7	11.2	39.2
12	VKM	446, 26.06.20023	01.01.2004	30.06.2004	10,343	51,715	41.9	30.7	11.2	39.2
	VKM	424, 02.07.2007	01.07.2004	31.12.2004	11,376	56,880	41.9	30.7	11.2	39.2
13	VKM	424, 02.07.2007	01.01.2005	31.05.2005	11,376	56,880	41.9	30.7	11.2	39.2
	VKM	385, 31.05.2005	01.06.2005	31.12.2005	12,514	62,570	41.9	30.7	11.2	39.2
14	VKM	385, 31.05.2005	01.01.2006	30.06.2006	12,514	62,570	41.9	30.7	11.2	39.2
	VKM	444, 21.06.2006	01.07.2006	31.08.2006	13,140	65,700	41.9	30.7	11.2	39.2
	VKM, ligji nr. 9600	557, 16.08.2006	01.09.2006	31.12.2006	13,140	65,700	32.9	21.7	11.2	33.2
15	VKM	557, 16.08.2006	01.01.2007	30.06.2007	13,140	65,700	32.9	21.7	11.2	33.2
	VKM	557, 16.08.2006	01.07.2007	31.12.2007	13,140	65,700	32.9	21.7	11.2	33.2
16	VKM	557, 16.08.2006	01.01.008	30.06.2008	13,140	65,700	32.9	21.7	11.2	33.2
17	VKM	1114, 30.07.2008	01.07.2008	31.12.2008	14,830	74,150	32.9	21.7	11.2	33.2
	VKM	1114, 30.07.2008	01.01.2009	30.04.2009	14,830	74,150	32.9	21.7	11.2	33.2
18	VKM, ligji nr.10070	700, 18.06.2009	01.05.2009	31.12.2009	16,120	80,600	27.9	16.7	11.2	30
	VKM, ligji nr.10070	700, 18.06.2009	01.01.2010	30.06.2010	16,120	80,600	27.9	16.7	11.2	30
19	VKM	477, 30.06.2010	01.07.2010	31.12.2010	16,820	84,100	27.9	16.7	11.2	30
	VKM	477, 30.06.2010	01.01.2011	30.06.2011	16,820	84,100	27.9	16.7	11.2	30
20	VKM	541, 27.07.2011	01.07.2011	30.06.2012	17,540	87,700	27.9	16.7	11.2	30
21	VKM	414, 27.06.2012	01.07.2012	31.12.2012	18,295	91,475	27.9	16.7	11.2	30
	VKM	414, 27.06.2012	01.01.2013	31.07.2013	18,295	91,475	27.9	16.7	11.2	30
22	VKM	581, 17.7.2013	01.08.2013	31.12.2013	19,026	95,130	27.9	16.7	11.2	30
			01.01.2014	31.07.2014	19,026	95,130	27.9	16.7	11.2	26.4
23	VKM	457, 9.7.2014	01.08.2014	31.12.2014	19,406	97,030	27.9	16.7	11.2	26.4
24	VKM	77, 2801.2015	01.01.2015	31.12.2015	22,000	97,030	27.9	16.7	11.2	26.4
25	VKM	77, 2801.2015	01.01.2016	31.12.2016	22,000	97,030	27.9	16.7	11.2	26.4
26	VKM	77, 2801.2015	01.01.2017	30.04.2017	22,000	97,030	27.9	16.7	11.2	26.4
27	VKM	399, 03.05.2017	01.05.2017	31.12.2017	24,000	105,850	27.9	16.7	11.2	26.4
28	VKM	399, 03.05.2017	01.01.2018	31.12.2018	24,000	105,850	27.9	16.7	11.2	26.4
29	VKM	809, 26.12.2018	01.01.2019	31.12.2019	26,000	114,670	27.9	16.7	11.2	26.4
30	VKM	809, 26.12.2018	01.01.2020	31.12.2020	26,000	114,670	27.9	16.7	11.2	26.4
31	VKM	1025 16.12.2020	01.01.2021	31.03.2022	30,000	132,312	27.9	16.7	11.2	26.4
32	VKM	158, 12.03.2022	01.04.2022	vazhdim	32,000	141,133	27.9	16.7	11.2	26.4

• Burimi: ISSH, punuar nga grupi i KLSH.

Tabela e të dhënave për burimet njerëzore të auditit të brendshëm për vitin 2021

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Arsimi Bazë	Niveli i Diplomës	Vite pune gjithsej	Vitet e punës në DAB	Certifikimi	Trajnime nga NJQAB
1	P. B.	DREJTOR	FAK. EKONOMIK	MASTER	38	5	2019	40 orë/vit
2	A. B.	Kryetar DEGE	FAK. EKONOMIK	MASTER	35	10	2008	40 orë/vit
3	F. H.	AUDITUES	FAK. EKONOMIK	MASTER	36	19	2009	40 orë/vit
4	M. T.	AUDITUES	FAK. EKONOMIK	MASTER	15	8	2009	40 orë/vit
5	Sh. B.	AUDITUES	FAK. EKONOMIK	MASTER	20	8	2021	40 orë/vit
6	G. B.	AUDITUES	FAK EK/JURIDIK	MASTER	13	8	2012	40 orë/vit
7	O. I.	Sp/ RISKU	FAK. EKONOMIK	MASTER	7	6	2013	40 orë/vit
8	V.Gj.	Sp/RAPORTE	FAK. JURIDIK	MASTER	36	11	2011	40 orë/vit

Burimi: DAB në ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Kalendari i aktiviteteve trajnuese gjatë vitit 2021

Nr.	Temat e trajnimit	Prioritetet, nga 1-5	Pjesëmarrësit	Trajnuesit	Muaji
DREJTORIA E KONTRIBUTEVE					
1	Trajnim për programin CMIS, të kontributeve	5	Audit DRSSH	2, 3	Qershor
2	Sigurimi vullnetar dhe listpagesat- Dega e Kontributeve	4	Specialistët e sig. në DRSSH Gjirokastër	2, 3	Qershor
3	Dr.e Fondit te Kontributeve	3	DAQ	2, 3	Qershor
4	Përdorimi I programit te dixhitalizimit,të periudhave te kontributeve, te të vetpunesuarve në bujqësi.	4	Specialistët e sig. në DRSSH DIBER	2, 3	Shtator
DREJTORIA JURIDIKE					
1	Ndjekja me korrektësi i procedurave gjyqësore sipas udhëzimit te ISSH Nr. 635 Prot. dt. 27.01.2021 dhe raportimi i tyre prane ISSH sipas regjistrimit te ri.	5	Juristët e DRSSH-ve	2, 3	Mars
2	Zbatimi i ligjeve për faljen: Nr. 156/2020 "Për faljen e detyrimeve të ushtarakëve ndaj fondit të sigurimeve	4	Juristët e DRSSH-ve	2, 3	Mars
3	Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore te formës se prere sipas udhëzimit te ISSH Nr. 636 Prot dt. 27.01.2021, duke shmangur ndërhyrjen e përbarimit.	3	Juristët e DRSSH-ve	2, 3	Qershor
4	Njohje me legjislacionin për pensionin posaçëm dhe suplementar. Dallimi midis konflikteve juridike administrative dhe juridike civile.	2	Juristët e DRSSH-ve	2, 3	Tetor
DREJTORIA E IT					
1	Problematika të dala gjatë funksionimit të Aplikimit online.	3	Specialistët e IT në DRSSH	3	Qershor
2	Problematika të dala gjatë funksionimit të sistemit PCAMS.	3	Specialistët e IT në DRSSH	3	Qershor
3	Probleme me dhënien e vërtetimeve nga sistemi DMAIS	3	Specialistët e IT në DRSSH	3	Qershor
DREJTORIA E AUDITIMIT TE BRENDSHËM					
1	Trajnim për program e Burimeve Njerëzore	2	Specialistët e Drejtorisë së Auditit	3	Mars
2	Trajnim për programin CMIS, të kontributeve	2	Specialistët e Drejtorisë së Auditit	3	Prill
3	Trajnim për program e PASH	2	Specialistët e Drejtorisë së Auditit	3	Tetor
4	Trajnim Programimi Oracle	3	Specialistët e Drejtorisë së Auditit	3	Dhjetor
DREJTORIA E PËRFITIMEVE					
1	Diskutim rreth lidhjes së përfitimeve, afatgjata, pleqërie të reduktuar afatgjata, pleqërie të reduktuar	5	Përgjegjës Agjencie, K/Dege përfitimeve,	2, 3	Janar e në vazhdim
2	Sigurimi I bujkut	5	K/d dhe spec. e përfitimeve në DRSSH,	2, 3	Shkurt
3	Në zbatim te ligjit nr.10142 dhe akt. Normativ në lidhje me pagat referuese, zbatim ligji.	4	K/d dhe specialistet e përfitimeve suplementare dhe trajtimeve të veçanta në DRSSH	2, 3	Mars
DREJTORIA E FINANCËS					
1	Zbatimi i ligjshmërisë financiare në fushën e sigurimeve shoqërore. Njohja dhe përpilimi i bilanceve sipas formateve të reja. Trajnimi dhe përgatitja për mbylljen e bilancit të vitit 2020 me Sistemin ORACLE Mënyra e mbajtjes dhe kontabilizimit të llogarive financiare në FMS Diskutimi për problematikat në disa rajone, mbi veprimet në sistemin Oracle deri në momentin aktual.	5	Specialistë të Degës së Financës në DRSSH, Kryetarët e Degës së Financës në DRSSH	2, 3	Qershor
2	Rakordomi i Debitorëve të evidentuar në kontabilitet me ato të hedhur në Sistemin Financiar Oracle, si edhe me evidencat e raportuara nga Rajonet në ISSH. Ndjekja me përparësi e debitorëve duke ia dërguar degës Juridike për ndjekje penale si edhe të bëhen përpjekjet maksimale me qëllim lidhjen e Akt-Marrëveshjeve me ta për shlyerjen e tyre përfundimisht.	4	Specialistë të Degës së Financës në DRSSH, Kryetarët e Degës së Financës në DRSSH	1,2,3	Shtator
3	Mbi procedurën e pranimit te faturave dhe procesi I fiskalizimit te tyre	3	Kryetarët e Degës së Financës në DRSSH	2	Dhjetor
NJËSIA E INSPEKTIMIT TË PËRFITIMEVE AFATGJATA					
1	Mbi ndryshimet e akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën e sigurimeve suplementare, dhe problematika te dala gjate inspektimit te dosjeve	2	Specialistët e sek. të inspektimit të përfit. supl. dhe trajtimeve të	3	Korrik

			veçanta		
	DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PËRGJITHSHËM				
1	Zbatimi i rregullores në lidhje me komandimet, procedurat e konkurrit dhe emërimet e punonjësve të rinj	5	K/Degës së Administrimit të Përgjithshëm + spec.	2, 3	Shkurt
2	Zbatimi i rregullores në lidhje me vendosjen e pagave , rritjet në klasë për vjetërsi në profesion dhe rritjet në shkallë mbi vlerësimin e performancës	5	K/Degës së Administrimit të Përgjithshëm + spec.	2, 3	Prill
3	Zbatimi i shkresave unifikuese si dhe i shkresave të veçanta të dërguara nga ISSH	4	K/Degës së Administrimit të Përgjithshëm + spec.	2, 3	Maj
4	Realizimi i trajnimeve për thellimin dhe përditësimin e njohurive në zbatimin e rregullores së personelit dhe kodit të punës	4	K/Degës së Administrimit të Përgjithshëm + spec.	2, 3	Shtator
5	Evidentimi i problemeve të sistemit të burimeve njerëzore	3	K/Degës së Administrimit të Përgjithshëm + spec.	2, 3	Nëntor
6	Bashkëpunimi me APP, për përsosjen e procedurave të prokurimit publik. Zbatimi i Ligjit të prokurimeve nga DRSSH	4	K/Degës së Administrimit të Përgjithshëm + spec. e prokurimeve	2, 3	Qershor
7	Prokurimi publik, njohja me ndryshimet e parashikuara në ligjin e prokurimeve, unifikimi i procedurave të prokurimit publik në DRSSH	4	K/Degës së Administrimit të Përgjithshëm + spec. e prokurimeve	2, 3	Shtator
8	Trajnimi punonjësve të Arkivit për sistemin e ri DMAIS, Problematika të ndryshme të dala gjatë punës së përditshme nga specialistët e DRSSH-ve.	3	Koordinatorët dhe K/Degës së Arkivit në DRSSH	2	Maj
9	Ballafaqime dhe shkëmbime eksperiencash nga specialistët e DRSSH-ve, Raste tipike problematike ku mund të hasin specialistët dhe zgjidhja e tyre.	3	Koordinatorët dhe K/Degës së Arkivit në DRSSH	2	Nëntor

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Tabela kontrolleve të kryera për vitin 2021, si dhe rezultatet e gjetjeve të konstatuara, nga sektori i inspektimit të përfitimeve afatgjata

RAJONET	DRSSH KORÇË	DRSSH DURRËS	DRSSH ELBASAN	DRSSH BERAT	DRSSH DIBËR	DRSSH GJIROKA STËR	DRSSH VLORË	DSSH SARANDË	TOTALI
PERJUDHA KONTROLLUAR	01.01.2017 31.12.2018	01.01.2018 31.12.2019	01.01.2017 31.12.2019	01.01.2018 31.12.2019	01.01.2018 31.12.2019	01.01.2018 – 31.12.2019	01.01.2018 -31.12.2019	01.01.2018 – 31.12.2019	
AFATI KONTROLLIT	05.10.2020 29.01.2021	25.01.2021 16.06.2021	25.01.2021 - 7.06.2021	23.06.2021- 28.07.2021	02.08.2021 03.09.2021	13.09.2021 – 08.10.2021	14.10.2021 – 19.11.2021	25.11.2021 – 17.12.2021	
Dosje për kontroll	7,355	7,763	9,993	4,392	2,380	3,171	5,152	2,507	42,713
Dosje te paraqitura	7,303	7,661	9,854	4,336	2,308	3,099	5,113	2,481	42,155
Dosje te manguara	52	102	139	56	72	72	74	26	593
(nga këto me pr.mjek+KQA)									
transferuar (mbyllur, kal.pens.tje)	38	47	68	47	55	71	37	20	383
AKTIVE NE SISTEM	14	55	71	9	17	1	2	6	175
Dosje te certifikuara	7,062	7,271	9,293	4,171	2,199	2,882	4,803	2,282	39,963
Dosje me problematike	241	390	561	165	149	217	310	199	2,232
% e dosjeve me problematike	3.30%	5.09%	5.69%	3.81%	6.46%	7.53%	6.1%	8.02%	5.29%
Konstatime te kontrollit									
pezullime		2	7	2	1	1			13
rishqyrtime	122	299	213	118	102	194	245	183	1,476
rishqyrtuar gjate kontrollit	118	262	170	73	40	92	129	120	1,004
mbeten detyre për rishqyrtim	4	37	43	45	62	102	116	63	472
mbeten detyre për plotësim	10	35	96	44	37	21	21	11	275
dosje me probleme mjekësore	109	54	245	1	9	1	44	5	468
GJITHESJ/DETYRA	123	126	384	90	108	124	181	79	1,215
dosje te rezultuara debitore/pezullime (llogaritur)		1	6	2					9
leke		380,553	2,390,017	2,020,756					4,791,326
dosje te rezultuara debitore/rishqyrtime	36	113	78	15	15	34	57	67	415
leke	451,206	3,320,775	3,509,257	574,131	574,131	1,395,935	1,450,712	1,768,106	13,044,253

DEBITORE (RISHQ+PEZ)									
NR.DOSJE	36	114	84	17	15	34	57	67	424
LEKE	451,206	3,701,328	5,899,274	2,594,887	574,131	1,395,935	1,450,712	1,768,106	17,835,579
KREDITORE									
dosje te rezultuara kreditore	82	149	92	25	25	58	72	53	556
leke	3,133,330	3,671,469	3,044,009	1,365,418	1,365,418	1,848,603	1,630,364	993,893	17,052,504
Nr. dosjeve te certifikuara ne përfundim te programit	7,180	7,533	9,463	4,244	2,199	2,974	4,932	2,402	40,927
% e dosjeve te certifikuara ne përfundim	98%	98.33%	96.03%	97.88%	95.28%	95.97%	96.46%	96.82%	97.09%
NR.DOSJEVE ME EFEKTE	118	263	176	42	40	92	129	120	980

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Tabelë inspektive të kryera për vitin 2021, si dhe rezultatet e gjetjeve të konstatuara, nga sektori i inspektimit të përfundimeve suplementare dhe trajtimeve të veçanta.

RAJONET	DRSSH FIER	DRSSH ELBASAN	DRSSH VLORË	DSSH SARANDË	DRSSH BERAT	TOTALI
PERJUDHA E KONTROLLUAR	<i>01.07.2018 – 30.06.2020</i>	<i>01.07.2018 – 31.12.2020</i>	<i>01.07.2018 – 31.12.2020</i>	<i>01.07.2018 – 31.12.2020</i>	<i>01.07.2018 – 31.12.2020</i>	
AFATII KONTROLLIT	<i>20.01.2021 – 31.03.2021</i>	<i>07.04.2021- 18.06.2021</i>	<i>23.06.2021 – 22.10.2021</i>	<i>23.06.2021 – 22.10.2021</i>	<i>27.10.2022 – 22.12.2022</i>	
Dosje për kontroll	1,959	2,162	1,953	686	1,276	8,036
Dosje te paraqitura	1,959	2,162	1,950	686	1,274	8,031
Dosje te rregullta	1,812	1,936	1,840	638	1,066	7,292
Dosje me problematike	147	226	110	48	208	739
% e dosjeve me prob.	7.50%	10.45%	5.64%	7.00%	16.33%	9.2%
Te plotësuar dhe rishq. gjate kontrollit	99	186	90	38	107	520
Te pezulluara		4	4	7	38	53
Te rreg.ne fund	1,911	2,122	1,930	676	1,173	7,812
Mbeten detyra	48	36	16	10	101	211
Ligji 8097	18		11	3	7	39
Konstatime te kontrollit pezullime		4	4	7	38	53
plotësime/rishqyrtime	147	226	106	41	170	690
Plotësuar dhe certifikuar gjate kontrollit	99	186	90	38	107	520
rishqy. gjate kontrollit/efekte	27	61	81	33	99	301
Plotësuar me dokument.	72	125	9	5	8	219
mbeten detyre për rishq./plot.	48	36	16	3	63	166
dosje me probleme te tjera.						0
dosje te rezultuara debitore/pezullime/llogaritur leke		4	4	7	38	53
leke		751,083	763,532	163,184	3,787,068	5,464,867
dosje te rezultuara debitore/rishqyrtime leke	15	36	30	20	76	177
leke	457,353	708,449	761,751	510,055	2,612,843	5,050,451
DOSJE TE VLE.DEB.PUNESIMI						0
VLERA E DEMIT						0
DEBITORE						0
NR.DOSJE	15	40	34	27	114	230
LEKE	457,353	1,459,532	1,525,283	673,239	6,399,911	10,515,318
dosje te rezultuara kreditore	12	25	51	13	23	124
leke	144,503	398,121	994,472	608,407	216,290	2,361,793
Nr. dosjeve te certifikuar ne përfundim te programit	1,911	2,122	1,930	676	1,173	7,812
% e dosjeve te certifikuar ne përfundim	97.55%	98.15%	98.97%	98.54%	92.07%	5
Dosje te mbetura për plotësim apo rishqyrtim	48	36	16	3	63	166
Dosje te pezulluara			4	7	38	49
% e dosjeve te rishqyrtuara/pezulluara me efekte	1.38%	3.01%	4.36%	3.94%	10.75%	4.41%

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Tabela nr. 3950 SUBJEKTET DEBITORE TË SUBJEKTEVE BUXHETORE ME DEBINË MË TË MADHE
lekë

Nr.	Nipit	Subjekte buxhetore	DRT	Detyrimi	Gjoha	Interesa	Debia
1	KV	REPARTI USHTARAK		306	37,404,473	66,507,827	103,912,606
2	KL	BASHKIA K		16,479,312	9,910,415	20,508,136	46,897,863
3	KV	REPARTI USHTARAK		2,533,900	13,305,815	22,554,284	38,393,999
4	JJ	REPARTI USHTARAK		26,774,910	502,078	380,921	27,657,909
5	KV	KOMUNA N		4,988,543	2,303,796	2,852,229	10,144,568
6	KG	REPARTI USHTARAK		30	3,548,270	6,446,824	9,995,124
7	KA	REPART USHTARAK		-	3,240,281	4,672,634	7,912,915
8	KO	BASHKIA T		-	3,706,263	3,328,692	7,034,955
9	KH	MINISTRIA E F		3,922,163	1,095,814	1,161,906	6,179,883
10	KO	BASHKIA V		4,379,413	-	-	4,379,413
11	KE	ZYRA ARSIMORE M		12,749	1,095,497	3,063,529	4,171,775
12	KE	DREJTORIA E ASHK		-	139,708	3,688,992	3,828,700
13	JW	DREJTORIA E POLICISE		486,191	929,007	2,377,107	3,792,305
14	KM	REPARTI USHTARAK		2,695,965	576,626	432,025	3,704,616
15	KL	MINISTRIA E M		168,941	981,824	1,616,038	2,766,803
16	K2U	APARATI I MINISTRISE		1,544,731	269,164	417,540	2,231,435
17	LL	DREJTORIA SPITALOR		2,187,524	-	-	2,187,524
18	KC	BASHKIA K		1,772,244	87,307	64,149	1,923,700
19	KP	DREJTORIA E ASHK-së		1,811,740	-	-	1,811,740
20	KD	KOMUNA A		1,091,520	314,181	314,367	1,720,068
21	KL	KOMUNA K		940,046	316,767	423,180	1,679,993
22	KB	MINISTRIA D		-	555,422	1,108,558	1,663,980
23	KS	ND. KOMUNALE T		1,029,652	355,994	220,731	1,606,377
24	JU	INSTITUTI KEREKIMEVE		1,544,385	-	-	1,544,385
25	KW	SHERBIMI SPITALOR P		-	304,542	1,148,234	1,452,776
26	KE	NDERMARJA E RRUGEVE		937,081	242,272	201,098	1,380,451
27	KT	AKADEMIA E S		-	287,561	874,388	1,161,949
28	JT	TEATRI K		1,142,545	-	-	1,142,545
29	KU	REPARTI USHTARAK		1,119,572	-	-	1,119,572
30	KS	KOMUNA S		623,373	301,689	147,375	1,072,437
31	KC	BASHKIA V		-	610,713	443,719	1,054,432
32	KG	KOMUNA SH		938,208	67,986	36,551	1,042,745
33	KT	DR RAJONALE E MONUMENT		958,486	44,262	6,740	1,009,488
34	KC	AGJENS. SHQIPT. E		1,001,082	-	-	1,001,082
35	LT	INSPEKTORIATI A		548,354	184,848	238,361	971,563
36	KT	KOMUNA SH		448,093	277,399	224,907	950,399
37	KL	DREJT. E SIG. TE INFOR.		-	353,618	572,239	925,857
38	KA	KOMISIONI QENDROR		1,492	222,679	672,809	896,980
39	JG	MINISTRIA E K		-	104,466	787,368	891,834
40	KR	REPARTI USHTARAK		804,549	-	-	804,549
41	KU	Q INST.I REHABILIT.		623,379	170,000	-	793,379
42	K9R	KOMUNA F		652,489	114,970	-	767,459
43	KI	DREJTORIA E SPITALOR		742,958	-	-	742,958
44	KC	AGJENSIA		166,642	368,252	165,474	700,368
45	KT	KOMUNA M		579,765	40,310	20,848	640,923
46	KP	BASHKIA H		632,016	938	232	633,186
47	KS	SHKOLLA ARTISITIKE		508,023	78,168	8,507	594,698
48	KR	KOMUNA K		-	139,275	442,873	582,148
49	LE	AGJENCIA MJEDISIT		547,763	-	-	547,763
50	KN	REPARTI USHTARAK		531,997	7,188	779	539,964
				87,872,132	84,559,838	148,132,171	320,564,141

Tabela nr. 4050 SUBJEKTET DEBITORE SUBJEKTE JOBUXHETORE ME DEBINË MË TË MADHE
në lekë

Nr.	Nipit	Subjekte jobuxhetore	DRT	Detyrimi	Gjoha	Interesa	Debia
1	L	Futboll Club		41,603,033	4,179,936	1,672,151	47,455,120
2	L	KLUBI I FUTBOLLIT		22,858,617	10,654,290	10,523,724	44,036,631
3	J	HShqiptare		37,272,415	1,124,205	277,201	38,673,821
4	J	Ujësjetllës Kanalizime		33,507,678	1,698,150	397,446	35,603,274
5	J	NDERMARJA E UJESJELLSIT		16,081,811	6,661,083	344,514	23,087,408
6	K	KLUBI I FUTBOLLIT		18,678,527	327,065	81,447	19,087,039
7	J	KOMBINATI MEKANIK		16,504,847	1,027,639	319,397	17,851,883
8	L	KLUBI I FUTBOLLIT		12,879,912	2,995,798	1,898,488	17,774,198

9	K	FUTBOLL CLUB		11,709,762	735,491	503,947	12,949,200
10	K	Ujësjetllës - Kanalizime		10,893,532	914,369	227,247	12,035,148
11	K	F.K. A SH.A. Total		6,898,426	3,371,045	1,455,554	11,725,025
12	L	KF		10,731,945	44,304	2,687	10,778,936
13	J	PARKU UDHETAREVE		6,950,002	1,486,466	1,094,472	9,530,940
14	L	KLUB FUTBOLL		7,952,360	93,165	36,012	8,081,537
15	J	UJESJELLES KANALIZIME		5,849,425	1,295,858	357,434	7,502,717
16	K	"Ujësjetllës - Kanalizime" Sh.a.		6,690,931	258,510	57,537	7,006,978
17	K	KLUBI		6,731,287	7,100	590	6,738,977
18	J	UZINA MEKANIKE		5,257,233	864,754	379,688	6,501,675
19	J	Ujësjetllës kanalizime		5,162,547	765,061	402,074	6,329,682
20	J	UZ REMONTIV MAK		4,606,383	296,826	161,002	5,064,211
21	J	HOTEL		4,917,531	-	-	4,917,531
22	J	UJESJELLES-KANALIZIME		-	3,038,066	1,499,831	4,537,897
23	J	UJESJELLES KANALIZIME		3,741,454	555,851	139,410	4,436,715
24	L	KLUBI I FUTBOLLIT		4,210,570	-	-	4,210,570
25	J	SH.A UJESJELLES		3,395,329	164,385	412,835	3,972,549
26	J	UJESJELLES KANALIZIME		3,102,069	290,983	82,599	3,475,651
27	K	KLUBI I FUTBOLLIT		3,181,957	37,858	18,532	3,238,347
28	J	Ujësjetllës Kanalizime		3,155,883	5,986	4,635	3,166,504
29	K	TRAJTIM I STUDENTEVE SH.A. VL		2,599,159	433,265	103,539	3,135,963
30	K	PARTIA		2,726,480	205,014	45,840	2,977,334
31	J	N_D_C		2,905,959	-	-	2,905,959
32	L	Ujësjetllës Kanalizime		2,756,158	-	-	2,756,158
33	K	TREGU A I SH		1,852,683	267,679	282,132	2,402,494
34	K	KOMB. TEKSTILEVE		-	634,399	1,564,515	2,198,914
35	K	Ujësjetllës Kanalizime Fushe		1,076,117	771,888	334,843	2,182,848
36	K	F.K SH.A		1,915,317	168,233	91,145	2,174,695
37	J	Ujësjetllës Kanalizime		2,103,030	36,433	7,209	2,146,672
38	J	UZINA MEKANIKE		1,958,199	110,862	28,253	2,097,314
39	J	NDERTIM ASFALTIM RRUGA		1,267,832	264,702	128,886	1,661,420
40	K	UJESJELLES KANALIZIME		1,284,286	220,279	84,242	1,588,807
41	J	N N H/C		420,248	770,489	307,125	1,497,862
42	L	UJESJELLES KANALIZIME		1,475,904	10,000	-	1,485,904
43	K	UJESJELLES		1,329,741	122,179	30,124	1,482,044
44	J	Ujësjetllës Kanalizime		-	811,585	628,770	1,440,355
45	J	NDERMARRJA		1,031,027	154,446	88,239	1,273,712
46	J	UJESJELLES KANALIZIME		908,094	240,438	77,729	1,226,261
47	K	Ujësjetllës-Kanalizime		1,135,075	18,009	3,946	1,157,030
48	L	KF i sh.p.k		1,097,989	44,440	12,342	1,154,771
49	L	SPORT KLUB		567,214	188,126	289,239	1,044,579
50	J	Ujësjetllës Kanalizime		-	605,212	439,332	1,044,544
				344,935,978	48,971,922	26,897,904	420,805,804

Tabela Emërimet në ISSH gjatë vitit 2021

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni punës	Data e punësimit
1	A.R.	Specialist trajnimesh, Sek burime njerëzore	30.03.2021
2	A. V.	Specialist Sektori Marrëdhënies me Tatimet dhe Administrimit të Dhënave	30.03.2021
3	E. V.	Specialist sek marrëdhënies me tatimet dhe administrimit të dhënave	15.04.2021
4	D. R.	Specialist i kontabilitetit implementimi program i ri, sek i kontabilitetit, dr. Financës	24.02.2021
5	L.Xh.	Specialist në sektorin e përfitimeve afatshkurtra	26-07-21
6	B. I.	Specialist për Kërkimin Social	23-07-21
7	E. T.	Këshilltar për problemet organizative	28-06-21
8	E. C.	Specialist në Sektorin e marrëdhënies me tatimet dhe administrimin e të dhënave	22.11.2021
9	K. C.	Specialist për Kërkimin Social	23.12.2021

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Tabela Largimet nga detyra për vitin 2021

nr.	Emër mbiemër	Larguar	Arsyeja Largimit
1	A. N.	01.01.2021	Dorëheqje
2	R. N.	06.05.2021	Dorëheqje
3	M. L.	12.05.2021	ndërruar jete
4	A. K.	14/07/2021	Dorëheqje
5	A. Th.	29.06.2021	dalje pension
6	E. F.	16/06/2021	dalje pension
7	E. N.	02.11.2011	Dorëheqje
8	A. A.	15.11.2021	Transferim pranë DRSSH Tirane

9	B. Sh.	01.11.2021	Dorëheqje
10	A. E.	15.12.2021	dalje pension
11	D. M.	16.11.2021	masë disiplinore

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Përbërja e Këshillit Administrativ, në fillim të vitit 2021

Nr.	Emër mbiemër	Institucioni nga vjen	Nr. data e emërimit	Pozicioni	Emërtesa e Bordit/Këshilli	Me pagesë
1.	A.D.	Ministria e Financës dhe Ekonomisë	VK M nr.263, date 07.05.2014		Kryetar i Këshillit Administrativ	Po
	D. I.	Ministria e Financës dhe Ekonomisë	28.09.2021		Kryetar i Këshillit Administrativ	Po
2.	L. B.	B. A.	VKM nr.264, dt.07.05.12014		N/kryetar Këshillit Administrativ	Po
3	K. N.	Konfederata e Sindikatave	VKM nr.264, dt.07.05.12014		N/kryetar Këshillit Administrativ	Po
4	V. V.	Ministria e Financave	Shkrese nr.2794 prot, dt. 26.05.2020		Anëtar	Po
5.	A. Ç.	F S D K SH	Shkrese nr.7750/1 prot, dt. 21.12.2020		Anëtar	Po
6.	E.DH.	INSTAT	Shkrese nr.1907 prot dt. 30.03.2020		Anëtar	Po
7.	S.H.	Ministria e Financës dhe Ekonomisë	Shkrese nr.2794 prot, dt.26.05.2020		Anëtar	Po
8.	B. B.	Ministria e Drejtësisë	Shkresa nr.7882 prot, dt.21.11.2020		Anëtar	Po
9.	N. H.	Shoqata e Bizneseve te Ushqim Pije	Shkresanr.3036/2 prot,dt.04.06.2014 e MMSR		Anëtar	Po
10.	A. K.	Shoqata e Ndërtuesve te Shqipërisë	Shkresa nr.2801 prot, dt.11.06.2014 e SH N SH		Anëtar	Po
	L.M.	Shoqata e Ndërtuesve te Shqipërisë	Shkresa nr. dt. 2021		Anëtar	Po
11.	G. K.	Bashkimi i Sindikatave te Pavarura te Shqipërisë	Shkresa nr.626 prot, dt.27.05.2014 e B S P SH		Anëtar	Po
12.	B. K.	Sindikata Autonome Ushqim, Tregti, Turizëm	Shkresa 3295/1 prot, dt.05.06.2014 e S A U T T		Anëtar	Po

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

❖ Vendimet gjyqësore ndiqen dhe ekzekutohen nga ISSH.

Tabelë Vendimet gjyqësore në proces me objekt dëmshpërblim page deri me 31.12. 2021

Nr.	Emër/Mbiemër	Drejtoria	Pozicioni	paga pretenduar në padi	paga dhëna në gjykimin e parë
1	Y. XH.	KORCE	Specialist verifikues	16.5 PAGA	Proces
2	B. B.	DRSSH-Kukës	Inspektor Bujku/Shishtavec	19-paga	Është rrezuar padia
3	R. GJ.	DRSSH-Kukës	K/Degës Arkives	19-paga	Është rrezuar padia
4	M. H.	DRSSH Berat	Drejtor DRSSH BERAT	18 PAGA	12 PAGA
5	F. K.	DRSSH Berat	Përgjegjës ALSSH SKRAPAR	21 PAGA	12 PAGA
6	K. R.	DRSSH Lezhe	Arkiviste		Rikthim ne pune
7	D. R.	DRSSH Durrës	Specialist Arkive në Agjencisë Kruje	18 Paga	11 Paga
8	Gj.N.	DRSSH Shkodër	Specialist/vetpunuesarit ne bujqësi	30.5 Pg/2,280,296	29 pg = 1,674,141
9	R. K.	DRSSH Elbasan	Inspektor Bujku	15 PAGA	Proces
10	H. M.	DRSSH ELBASAN	Inspektor Bujku	19 PAGA	14 PAGA
11	E. K.	DRSSH ELBASAN	Specialiste	21 PAGA	13 PAGA
12	I. M.	DRSSH ELBASAN	Përgjegjës ALSSH	16.5 PAGA	15.5 PAGA
13	I.K.	DRSSH ELBASAN	Kryetare DEGËS FINANCES	21.5 PAGA	17 PAGA
14	V. H.	DRSSH ELBASAN	Përgjegjëse ALSSH	17 PAGA	9 PAGA
15	S. L.	ISSH	Drejtor i Auditit	14 paga	10 paga
16	E.N.	ISSH	Drejtor i Administrimit të Përgjithsh	21 paga	17 paga
17	A. D.	DAQ LUNDER	Drejtor I DAQ Lundër	19.5 paga	proces
18	A. B.	ISSH	Drejtor Drejtorie	26 paga	25 paga
19	L. D.	DAQ LUNDER	Kryetare Degës Juridike	32 paga	18 paga
20	M. GJ.	DRSSH Dibër	Inspektor Bujku	12 paga	Rrezuar (viti 2018)
21	H.SH.	ISSH TR e DRSSH DI	Titullar	18 paga	14 paga (Viti 2018)
22	V. B.	DRSSH Dibër	Specialiste e Ekspertizës Mjekësore	Rik pune + 1 vit pg	18 paga (viti 2019)
23	J. H.	DRSH VLORE	Përgjegjëse ALSSH VLORE	19.5 paga	13,5 paga

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Tabela Vendimet gjyqësore të ekzekutuara viti 2021

NR	Emër	Drejtoria	Pozicioni	Data e largimit nga puna	Përfunduar		Ekzekutuar	
					Nr/Dt	Vlera	Nr/Dt	Vlera
1	S.S.	DRSSH DIBER	SHEF FINANCE	20.01.2016	Nr.455, 23.09.2021 Gjykata Administrative e Apelit	23 PAGA	08.10.2021	1,730,924
2	S.Q.	DRSSH ELBASAN	PERGJEGJES ALSSH PEQIN	16.04.2018	Nr.444 datë 09.12.2020 Gjykata Apelit Durrës	16 PAGA	18.01.2021	1,035,104
3	A. M.	DRSSH ELBASAN	INSPEKTOR BUJKU	31.03.2014	Nr.62 datë 28.01.2021 Gjykata Administrative Apelit Tiranë	26 PAGA	10.02.2021	1,129,992
4	G.K.	DRSSH ELBASAN	SPECIALIST VERIFIKUES	08.01.2019	Nr.360 datë 17.06.2021 Gjykata Apelit Durrës	18 PAGA	23.06.2021	1,047,816
5	P.D.	DRSSH BERAT	DREJTOR	23.10.2020	Nr.355, datë 19.04.2021, Gjykata Shkalles pare Berat	17.5 PAGA	07.05.2021	1,899,967
6	H.H.	ISSH	NENDREJTOR	24.11.2017	Nr.385, datë 17.12.2020, Gjykata Apelit Tiranë	18 PAGA	26.01.2021	2,502,860
TOTALI								9,346,663

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Tabelat përmbledhëse sipas muajve të konsumit të karburantit dhe mjeteve ku me X janë shënuar nënshkrimet në autorizim të personave përkatës ku është përcaktuar mjeti, sasia e karburantit, shoferi dhe drejtimi i lëvizjes.

Janari

	AA165VX/AA592PM/AA593PM	Fletë dalje nr. .12 Datë 07.01.2021	Drejtor D.A.P A. A.	Përgjegjësja e administrimit	Shoferi
Litër	250 litra	T.E.			
Vlerë	32,113	50 litra Tiranë - Korçë	X		X
		50 litra lëvizje të brendshme	X		X
		50 litra lëvizje të brendshme	X		X
		50 litra lëvizje të brendshme	X		X
		50 litra lëvizje të brendshme ne Tiranë	X		X
		1940 km gjithsej			
	AA166VX	Fletë dalje nr. .13 Datë 07.01.2021			
Litër	250 litra	A. A.			
Vlerë	32,113	50 litra lëvizje të brendshme	X		
		50 litra lëvizje të brendshme	X		
		50 litra lëvizje të brendshme	X		
		50 litra lëvizje të brendshme	X		
		50 litra lëvizje të brendshme	X		
		2565 km gjithsej			
	TR7975J	Fletë dalje nr. .14 datë 07.01.2021			
Litër	150 litra	S. K.	X		X
Vlerë	19,268	50 litra lëvizje të brendshme	X		X
		50 litra lëvizje të brendshme	X		X
		50 litra lëvizje të brendshme	X		X
		1045 km gjithsej			
	E. D. IT	Fletë dalje nr. .15 datë 07.01.2021	X		
Litër	100 litra	100 litra për gjeneratorin IT.			
Vlerë	12,845	Karta Gold			
	Drejtoria DAQ	Fletë dalje nr. .29 Datë 18.01.2021			
Litër	1000 litra	E. Sh.			
Vlerë	128,450	Kërkesë për transferim issh-DAQ			

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Shkurti

	AA165VX/AA592PM/AA593PM	Fletë dalje nr. .46 Datë 08.02.2021	Drejtor D.A.P A.A.	Përgjegjësja e administrimit	Shoferi
Litër	280 litra	T. E.			
Vlerë	35,966	30 litra Tiranë - Kukës	X		X
		50 litra tr-fr-ku	X		X
		50 litra lëvizje të brendshme	X		X
		50 litra lëvizje të brendshme	X		X
		100 litra tr-ko dhe lëvizje të brendshme	X		X
		1200 km gjithsej			
	AA166VX	A. A.			
Litër	180 litra	50 litra lëvizje të brendshme	X		
Vlerë	23,121	50 litra lëvizje të brendshme			
		30 litra tr-fr	X		
		50 litra lëvizje të brendshme	X		

		1490 m gjithsej		
	TR7975J	S. K.		
Litër	100 litra	50 litra lëvizje të brendshme	X	X
Vlerë	12,845	50 litra lëvizje të brendshme		
		1045 km gjithsej		

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Marsi

	AA165VX/AA592PM/AA593PM	Fletë dalje nr. 67 datë 03.03.2021	Drejtor D.A.P A.A.	Përgjegjësja e administrimit	Shoferi
Litër	130 litra	T. E.			
Vlerë	16,699	30 litra Tr-Fr	X		X
		100 litra Tr-Fr-Gj	X		X
		900 km gjithsej			
	AA166VX	Fletë dalje nr. 68 datë 03.03.2021			
Litër	100 litra	50 litra lëvizje të brendshme	X		
Vlerë	12,845	50 litra lëvizje të brendshme	X		
		1160 km gjithsej			
	TR7975J	Fletë dalje nr 69 datë 03.03.2021			
Litër	150 litra	50 litra lëvizje të brendshme	X		X
Vlerë	19,268	50 litra lëvizje të brendshme	X		X
		50 litra lëvizje të brendshme	X		X
		1050 km gjithsej			

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Prilli

	AA165VX/AA592PM/AA593PM	Fletë dalje nr. 102 datë 01.04.2021	Drejtor D.A.P A. A.	Përgjegjësja e administrimit	Shoferi
Litër	410 litra	T. E.			
Vlerë	58,334	30litra Tr-Dr-Br	X	X	X
		30 litra Tr-Gj	X	X	X
		30 litra Le-Shk	X	X	X
		70 litra Fr-Sr	X	X	X
		1340 km gjithsej			
		100 litra Tr-Di-Tropoje	X	X	X
		100 litra Lëvizje të brendshme-Korçë	X	X	X
		50 litra lëvizje të brendshme	X	X	X
		2720 km gjithsej			
	AA166VX	Fletë dalje nr. 103.Datë 01.04.2021			
Litër	250 litra	A.A.			
Vlerë	35,771	50 litra lëvizje të brendshme	X		
		50 litra lëvizje të brendshme	X		
		50 litra lëvizje të brendshme ,DR-LE	X		
		50 Litra tr-fr, lëvizje të brendshme	X		
		50 litra Tr-Br	X	X	
		1720 km gjithsej			
	TR7975J	fletë dalje nr. 104 datë 01.04.2021			
Litër	150 litra	S. K.			
Vlerë	21,151	50 litra lëvizje të brendshme	X	X	X
		50 litra lëvizje të brendshme	X	X	X
		10 litra lëvizje të brendshme	X	X	X
		40 litra lëvizje të brendshme	X	X	X
		1050 km gjithsej			

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Maj

	AA165VX/AA592PM/AA593PM	fletë dalje nr. 122 datë 04.05.2021	Drejtor D.A.P A. A.	Përgjegjësja e administrimit M T	Shoferi
Litër	160 litra	T. E.			
Vlerë	23,478	50 litra lëvizje të brendshme	X	X	X
		50 litra lëvizje të brendshme	X	X	X
		1165 km gjithsej			
		30 litra Tr-Ko	X	X	X
		850 km gjithsej			
		30 litra Tr-Ko	X	X	X
		380 km gjithsej			
	AA166VX	fletë dalje nr. 122/1 datë 04.05.2021			
Litër	230 litra	A. A.			
Vlerë	40,710	50 litra fr-vl	X		
		50 litra Kuçovë-Berat-Skrapar	X		

		30 litra Kukës	X		
		50 litra Tropojë	X		
		50 litra Gjirokastrë	X		
	TR7975J	fletë dalje nr. 121 datë 04.05.2021			
Litër	150 litra	S. K.			
Vlerë	22,011	50 litra lëvizje të brendshme	X	X	X
		50 litra lëvizje të brendshme	X	X	X
		50 litra lëvizje të brendshme	X	X	X
		1050 km gjithsej			

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Qershori

	AA165VX/AA592PM/AA593PM	fletë dalje nr. 152 datë 11.06.2021	Drejtor D.A.P A. A.	Përgjegjësja e administrimit	Shoferi
Litër	240 litra	T E			
Vlerë	35,218	40 litra Tr-Pogradec-Korçë	X	X	X
		30 litra Tirane - Vlorë	X	X	X
		30litra Tr- Kukës	X	X	X
		40 litra Tr-Ko	X	X	X
		1850 km gjithsej			
		50 litra të brendshme	X	X	X
		50 litra të brendshme	X	X	X
		2800 km gjithsej			
	AA166VX	fletë dalje nr. 153 datë 11.06.2021			
Litër	260 litra	50 litra tr-dr dhe lëvizje të brendshme	X		
Vlerë	38,152	50 litra ura vajguore-berat- Skrapar	X		
		50 litra lëvizje të brendshme	X		
		30 km tiranë ó Shkodër - Pukë	X		
		50 km Tiranë ó Burrel - Dibër	X		
		30 litra lëvizje të brendshme	X		
	TR7975J	fletë dalje nr. 151 datë 11.06.2021			
Litër	155 litra	50 litra lëvizje të brendshme	X	X	X
Vlerë	22,745	50 litra lëvizje të brendshme	X	X	X
		55 litra lëvizje të brendshme		X	X

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Korriku

	AA165VX/AA592PM/AA593PM	Fletë dalja nr. 201 datë 23.07.2021	Drejtor D.A.P	Përgjegjësja e administrimit	Shoferi
Litër	150 litra	50 litra lëvizje të brendshme		X	X
Vlerë	22,011	50 litra lëvizje të brendshme		X	X
		50 litra lëvizje të brendshme			
		1620 km gjithsej			
	AA166VX	Fletë dalja nr. 202 datë 23.07.2021			
Litër	280 litra	60 litra tr-sr	X		
Vlerë	41,087	50 litra Tr-Ko	X		
		60 litra tr-di	X		
		40 litra tr-vl	X		
		50 litra lëvizje të brendshme, tiranë-berat	X		
		20 litra tr-el-peqin	X		
	TR7975J	fletë dalje nr. 200 datë 23.07.2021			
Litër	110 litra	50 litra lëvizje të brendshme	X	X	X
Vlerë	16,141	20 litra lëvizje të brendshme	X	X	X
		10 litra lëvizje të brendshme	X	X	X
		30 litra lëvizje të brendshme	X	X	X
		800 km gjithsej			
Karta	50 litra	për gjeneratorin e It		X	
	7,337				

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Gushti

	AA165VX/AA592PM/AA593PM	Fletë dalje nr. 230 datë 19.08.2020	Drejtor D.A.P	Përgjegjësja e administrimit	Shoferi
		T E			
Litër	270 litra	50 litra lëvizje të brendshme		X	X
Vlerë	39,620	60 litra lëvizje të brendshme		X	X
		50 litra lëvizje të brendshme		X	X
		50 litra lëvizje të brendshme		X	X
		60 litra tr-di		X	X
		fletë dalje nr. 232 datë 19.08.2020			
	AA166VX	A A			
Litër	280 litra	50 litra tr-gj	X		

Vlerë	41,087	30 litra tr-shk	X		
		50 litra tr-fr, lëvizje të brendshme	X		
		50 litra tr-vl, lëvizje të brendshme	X		
		50 litra tr-le, lëvizje të brendshme	X		
		50 litra tr-ku	X		
		fletë dalje nr. 233 datë 19.08.2020			
	TR7975J	S. K.			
Litër	140 litra	30 litra lëvizje të brendshme		X	X
Vlerë	20,544	30 litra lëvizje të brendshme		X	X
		30 litra lëvizje të brendshme		X	X
		50 litra lëvizje të brendshme		X	X
Litër	50 litra	Për gjeneratorin IT		X	X
Vlerë	7337	S K			

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Shtator

	AA165VX/AA592PM/AA593PM	Fletë dalje nr. 267 datë 15.09.2021	Drejtor D.A.P	Përgjegjësjë e administrimit	Shoferi
Litër	160	T E			
Vlerë	23478	50litra lëvizje të brendshme		X	X
		50litra lëvizje të brendshme		X	X
		60litra tr-di		X	X
	AA166VX	fletë dalje nr. 266 datë 16.09.2021			
Litër	150	A A			
Vlerë	22011	50 litra tr-sr	X		
		50litra tr- Burrel - Shkodër	X		
		50 litra tr-br-fr, lëvizje të brendshme	X		
	TR7975J	fletë dalje nr. 268 datë 16.09.2021			
Litër	150	S K			
Vlerë	22011	50 litra lëvizje të brendshme		X	X
		20 litra lëvizje të brendshme		X	X
		40 litra lëvizje të brendshme		X	X
		40 litra lëvizje të brendshme		X	X

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Tetor

	AA165VX/AA592PM/AA593PM	Fletë dalje nr. 284.datë 05.10.2021	Drejtor D.A.P	Përgjegjësjë e administrimit	Shoferi
Litër	200 litra	TE			
Vlerë	30,634	50 litra lëvizje të brendshme		X	X
		40 litra lëvizje të brendshme		X	X
		10 litra lëvizje të brendshme		X	X
		50 litra lëvizje të brendshme		X	X
		50 litra lëvizje të brendshme		X	X
	AA166VX	fletë dalje nr. 285 datë 05.10.2021			
Litër	180 litra	AA			
Vlerë	27,699	50 litra tr-gj	X		
		30 litra lëvizje të brendshme	X		
		50 litra tr-le, lëvizje të brendshme	X		
		50 litra tr-fr, lëvizje të brendshme	X		
	TR7975J	fletë dalje nr. 286 datë 05.10.2021			
Litër	95 litra	SK			
Vlerë	15,162	45 litra lëvizje të brendshme		X	X
		50 litra lëvizje të brendshme		X	X

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Nëntor

	AA165VX/AA592PM/AA593PM	Fletë dalje nr. 318 datë 04.11.2021	Drejtor D.A.P	Përgjegjësjë e administrimit	Shoferi
Litër	300 litra	TE			
Vlerë	47,880	50 litra lëvizje të brendshme		X	X
		50 litra lëvizje të brendshme		X	X
		50 litra lëvizje të brendshme		X	X
		50 litra lëvizje të brendshme		X	X
		40 litra Tr-Gj		X	X
		60 litra Tr-Di		X	X
		fletë dalje nr. 317 datë 04.11.2020			
	AA166VX	AA			
Litër	140 litra	30 litra tr-fr	X		
Vlerë	22,344	30 litra lëvizje të brendshme	X		

		30 litra lëvizje të brendshme	X		
		50 litra Tr-Br, lëvizje të brendshme	X		
		fletë dalje nr. 319 datë 04.11.2020			
	TR7975J	SK			
Litër	150 litra	50 litra lëvizje të brendshme		X	X
Vlerë	23,940	50 litra lëvizje të brendshme		X	X
		50 litra lëvizje të brendshme		X	X

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Dhjetor

			Drejtor D.A.P	Përgjegjësja e administrimit	Shoferi
	AA165VX/AA592PM/AA593PM	Fletë dalje nr. 343 datë 01.12.2021			
Litër	250 litra	TE			
Vlerë	39,900	50 litra lëvizje të brendshme		X	X
		50 litra lëvizje të brendshme		X	X
		100 litra Tiranë - Kosovë	X		X
		50 litra lëvizje të brendshme	X		X
	TR7975J/AA166VX	fletë dalje nr. 344 datë 01.12.2021			
Litër	200 litra	SK			
Vlerë	31,920	50 litra lëvizje të brendshme		X	X
		50 litra lëvizje të brendshme	X		X
		50 litra lëvizje të brendshme	X		X
		50 litra lëvizje të brendshme	X		X

Burimi: ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

GRUPI I AUDITIMIT

1. A.Z. Auditues
2. E.B. Auditues
3. E.M. Auditues